

20

VJET-YEARS
RIINVEST

MONOGRAFI

VJET-YEARS
RIINVEST

15 MAJ 2015

1995

Nën udhëheqjen e profesor Muhamet Mustafa, intelektualë e ekonomistë nga Kosova, themelojnë Institutin Riinvest.



1998 Publikohet studimi i parë i Riinvestit me titull: “Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës”. Studimi prezantohet edhe në Budapest. Lidhen kontaktet e para me OSI të Budapestit.



1999 (Prill) Ekipi dhe zyret e Riinvestit deportohem përkatësisht zhvendosen si refugjatë në Tetovë të Maqedonisë.

1999 (Korrik) Pas çlirimit e kthimit, në bashkëpunim me Fondacionin Friedrich Ebert, Instituti Riinvest organizon konferencën e parë ndërkombëtare në Prishtinë; dedikuar rindërtimit.

1999 (Gusht) Nën bështetjen e DFID, fillon anketimi i 3500 familjeve kosovare, lidhur me pasojat e luftës. Organizohet gjithashtu shkolla e parë verore e Riinvest.

2003 Për periudhën e ardhshme 8 vjeçare, Riinvesti angazhohet në zhvillimin e mbi 20 strateghive komunale në Kosovë.

1995

1996

1997

1998

1999

2000

2001

2002

2003

2004

1996 Bordi i CIPE dhe Bordi i NED aprovojnë projekt propozimin e parë ndërkombëtar të Riinvestit.



1997 Nënshkruhet marrëveshja e parë ndërmjet CIPE dhe Riinvest.



1999 (Shtator) Anketohet sektori privat në Kosovë. Anketimi i NVM-ve, që nga atëherë, është bërë në baza të rregullta periodike.

2000 Lidhet kontrata e parë me USAID. Në katër vitet e ardhshme, Riinvest, nën mbështetjen e USAID do të prodhonte mbi 20 raporte studimore, po aq tryeza e konferenca diskutuese.

2001 Nën udhëheqjen e profesor Iraj Hashi, fillon bashkëpunimi me Staffordshire University.



2002 Në bashkëpunim me KFOS të përfaqësuar nga Luan Shllaku, dhe KACI të përfaqësuar nga Veton Surroi, themelohet “Forumi 2015”. Forumi shërben sot e kësaj dite si ombrellë e organizimeve e diskutimeve më të rëndësishme për vendin.

2005 QInstituti Riinvest, dekorohet nga Presidenti Ibrahim Rugova me "Medaljen e Artë për Pavarësi" për meritat për lirinë, pavarësinë dhe demokracinë e Kosovës, dhe kontributin në zhvillimin ekonomik dhe projektimit të së ardhmes së Kosovës.

2009 Fillon angazhimi i parë i Riinvest jashtë regjionit. Në bashkëpunim me CIPE, Riinvest angazhohet në një projekt ndërkombëtar në Lindjen e Mesme.



2012 Fillon bashkëpunimi afatgjatë me Zyrën e Komisionit Evropian në Prishtinë. Themelohet Akademia Zhvillimore.



2013 Mbështetur nga Komisioni Evropian, Riinvest bëhet pjesë e dy nismave rajonale; asaj për anti-korrupsion SELDI dhe për qeverisje të hapur.

20
VJET-YEARS
RIINVEST
2015

Riinvest mbushë 20 vjet.



2007 Themelohet Kolegji Riinvest, një nga partnerët e ardhshëm më sinergjik të Institutit Riinvest.



2010 Përgjegjësitë menaxheriale e udhëheqëse barten tek menaxhmenti i ri. Lumir Abdixhiku caktohet si Drejtor Ekzekutiv, ndërsa Alban Hashani si Drejtor i Kërkimeve.



2014 Riinvest, mbështetur nga SDC, në partneritet me Swiss Contact e PEM, themelon zyren për Promovimin e Sektorit Privat dhe të Punësimit - PPSE.

2006 Ekipi i Riinvestit angazhohet me këshillëdhënie për Ekipin e Unitetit në procesin dialogues të Vienës, për definimin e statusit final të Kosovës.

2011 Fillon bashkëpunimi afatgjatë me SDC në fushën e Hortikulturës.

PËRMBAJTJA

10 / 1. HYRJE

13 / 2. “RIINVEST”-I SOT

16 / LUMIR ABDIXHIKU

20 / SEJDI OSMANI

24 / ALBAN HASHANI

29 / 3. “RIINVEST”-I NËPËR VITE

30 / MUHAMET MUSTAFA

54 / PRESIDENTI RUGOVA DEKOROI
“RIINVEST”-IN ME RASTIN E
10-VJETORIT

59 / 4. PARTNERËT NË DEKADA

60 / ISA MUSTAFA

61 / USAID

62 / CIPE

63 / KOMISIONI EVROPIAN

64 / ZYRA ZVICËRRANE PËR
BASHKËPUNIM

66 / BANKA BOTËRORE

67 / FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI
TË HAPUR

68 / FONDACIONI FRIEDRICH EBERT (FES)

71 / 5. MIQTË TANË

72 / IRAJ HASHI

73 / VETON SURROI

74 / SHKËLQIM CANI

75 / BATON HAXHIU

76 / AGRON BAJRAMI

77 / AFËRDITA SARAÇINI

78 / ARBANA XHARRA

79 / MICHAEL WEICHERT

81 / 6. BORDI I “RIINVEST”-IT

83 / ILAZ RAMAJLI

84 / NAIM HOXHA

85 / YMER HAVOLLI

86 / ISUF BERISHA

87 / ARTANE
RIZVANOLLI

88 / MERITA GASHI

91 / 7. PERIUDHA 2000-2009

94 / 2000	102 / 2005
96 / 2001	103 / 2006
98 / 2002	104 / 2007
100 / 2003	106 / 2008
101 / 2004	108 / 2009

153 / 10. BASHKËPUNËTORËT NËPËR VITE

154 / BUJAR PIRA	158 / MUHAMET SADIKU
155 / BARDHA QIREZI	159 / SELMAN SELMANAJ
156 / BESNIK KRASNIQI	160 / SALVADOR ELMAZI
157 / HAZIR GASHI	161 / VENERA DEMUKAJ

111 / 8. PERIUDHA 2010-2015

114 / 2010	120 / 2013
116 / 2011	124 / 2014
118 / 2012	126 / 2015

131 / 9. PËRSHTYPJET TONA

132 / AGON NIXHA	142 / ILIRE MEHMETI
133 / ALBANA GASHI	143 / ISREN FEJZULLAHU
134 / ALBAN ZOGAJ	144 / MENSUR MUSTAFA
135 / ANTIGONA UKA	145 / MERITA ZHUSHI PEJA
136 / DIELLZA GASHI	146 / PREMTON HYSENI
137 / EDONA KURTOLLI	147 / SAXHIDE MUSTAFA
138 / ERANDA BASHOLLI	148 / VISAR VOKRRI
139 / FISNIK BAJRAMI	149 / YLLI TAFARSHIKU
140 / FISNIK REÇICA	
141 / GENT BEQIRI	

165 / 11. PUBLIKIMET E “RIINVEST”-IT

173 / 12. STAFI AKTUAL I “RIINVEST”-IT

185 / IN MEMORIAM

189 / FALËNDERIME

01



HYRJE

01 / HYRJE

Kjo Monografi është shkruar me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Institutit "Riinvest" dhe përmban një përmbledhje të aktiviteteve, angazhimeve e perceptimeve ndaj "Riinvest"-it përgjatë gjithë kësaj kohe. Monografia paraqet rrugëtimin e Institutit nëpër vite, nga dita e parë e themelimit deri te përpjekjet gjithëshoqërore për liri, nga rindërtimi e zhvillimi deri te pavarësia e angazhimi pas pavarësisë. Ky publikim përmbledh edhe mendimet, perceptimet dhe vlerësimet e akterëve, partnerëve, miqve e bashkëpunëtorëve të "Riinvest"-it, vendorë e ndërkombëtarë, nëpër vite.

Monografia është e strukturuar në njëmbëdhjetë kapituj. Pas hyrjes, publikimi nis me një përmbledhje të përgjithshme të gjendjes së tanishme të "Riinvest"-it dhe elaborimeve të menaxhmentit të tanishëm mbi potencialet zhvillimore dhe ecjen institucionale për vitet në vijim. Ky seksion përbëhet nga shkrimet e Lumir Abdixhikut (drejtor ekzekutiv), Sejdi Osmanit (kryetar i Bordit Drejtues) e Alban Hashanit (drejtor kërkimor). Në kapitullin e tretë elaborohen kujtimet e nisjes dhe zhvillimit të Institutit "Riinvest" nga ideatori dhe themeluesi i organizatës, Muhamet Mustafa; për të vazhduar më pas në kapitullin e katërt, të partnerëve në dekada ku përmbledhen mendimet e organizatave partnere kryesore të "Riinvest"-it nëpër vite, si USAID, CIPE, SDC, KFOS e FES, bashkë me mendimet e Qeverisë së Kosovës. Në kapitullin e pestë, Monografia pa-

surohet me shkrimet e miqve të "Riinvest"-it, nisur nga Iraj Hashi, Veton Surroi, Shkëlqim Cani, Ilaz Ramajli, Michael Weichert, Agron Bajrami (KOHA DITORE), Arbana Xharra (GAZETA ZËRI) e Afërdita Saraçini (RTV21). Kapitulli i gjashtë dhe i shtatë bën një përmbledhje të angazhimit nëpër vite – të ndarë në dy periudha 2000-2009 dhe 2010-2015. Në kapitullin e tetë jepen përshtypjet dhe përvojat personale të stafit të Institutit "Riinvest", të renditur sipas alfabetit: Agon Nixha, Albana Gashi, Antigona Uka, Diellza Gashi, Edona Kurtolli, Eranda Basholli, Faton Selani, Fisnik Bajrami, Fisnik Reçica, Gent Beqiri, Ilire Mehmeti, Isren Fejzullahu, Mensur Mustafa, Merita Zhushi Peja, Premton Hyseni, Saxhide Mustafa, Visar Vokrrri e Ylli Tafarshiku. Kapitulli tjetër, i nënti, vazhdon me përmbledhjet e disa bashkëpunëtorëve nëpër vite, përkatësisht me shkrimet e Alban Zogaj, Artane Rizvanolli, Naim Hoxha, Bujar Pira, Venera Demukaj, Bardhyl Meta e Besnik Krasniqi. Kapitujt e fundit vazhdojnë me elaborimin e projekteve të "Riinvest"-it, biografitë e stafit aktual si dhe me kujtimet – in memori-am – të bashkëpunëtorëve të cilët gjatë kësaj periudhe u ndanë nga ne.

Instituti "Riinvest" falënderon të gjithë partnerët, miqtë, bashkëpunëtorët e vet, stafin, për kontributin e vazhdueshëm në realizimin e misionit tonë.



20
VIET-YEARS
REINVEST

48

2

“RIINVEST”-I
SOT

02 / "RIINVEST"-I SOT

Instituti "Riinvest" është "think-tank" më i vjetër në Kosovë, duke vepruar që nga viti 1995. Ne promovojmë zhvillim modern ekonomik të bazuar në filozofinë e ndërmarrësisë. Përgjatë dy dekadave të fundit, kemi prodhuar analiza, publikime dhe raporte të ndryshme socio-ekonomike; kemi organizuar seminare, konferenca, tryeza dhe takime me vlerë të madhe ekonomike dhe biznesore për vendin; kemi zhvilluar tregje, sektorë dhe ndërhyrje të tjera në vlerën zinxhirore. Njohuria dhe përvoja jonë na lejon që të jemi konkurrues dhe kompetentë në trajtimin e çështjeve socio-ekonomike dhe biznesore.

Sot, organizata jonë është një "think-tank" lider, jopartiak, në fushën e zhvillimeve socio-ekonomike në vend. Stafi i "Riinvest"-it përbëhet nga 18 hulumtues me orar të plotë (2 doktorë shkence; 4 studentë të doktoratës; 8 magjistra shkence dhe 4 me titull bachelor) si dhe 5 asistentë administrativë me orar të plotë – gjithsej 23 punëtorë me orar të plotë. Menaxhmenti i Institutit "Riinvest" përbëhet nga z. Lumir Abdixhiku, drejtor ekzekutiv; z. Alban Hashani, drejtor i hulumtimeve; dhe z. Sejdi Osmani, kryetar i Bordit Drejtues. Mes organizatave të tjera, partnerët dhe donatorët kryesorë të "Riinvest"-it janë: Komisioni Evropian (KE), Zyra Zvicerane për Koordinim dhe Bashkëpunim (SDC), Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Qendra për Zhvillim të Ndërmarrjeve Private (CIPE), dhe Friedrich Ebert Stiftung (FES).

Avantazhi më i fortë i "Riinvest"-it mbështetet në stafin e tij, kualifi-

kimin profesional dhe akademik, si dhe në përvojën dhe përkushtimin në kryerjen e aktiviteteve në përputhshmëri me misionin e tij, mision i cili synon nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë, i bazuar në ekonominë e tregut. Stafi ynë përbëhet nga individë të dalluar të shoqërisë kosovare – shumica hulumtues të rinj me kualifikim akademik nga shtetet perëndimore – dhe si rezultat i këtij grupi të dalluar hulumtuesish, kualiteti i produkteve të "Riinvest"-it ka qenë gjithmonë sipas standardeve më të larta profesionale dhe etike. Në fakt, për shkak të kualitetit të raporteve, analizave, tryezave, diskutimeve dhe misioneve të avokimit, "Riinvest"-it ka arritur të sigurojë qëndrueshmërinë dhe të mbajë raporte partneriteti me donatorët, partnerët dhe organizatat e tjera më relevante në Kosovë; për më tepër, ka arritur të mbajë besueshmërinë ndaj publikut të gjerë duke treguar qëndrime në çështje të ndryshme socio-ekonomike të vendit. Reputacioni ynë na ka mundësuar që të jemi më efektivë gjatë avokimit në komisione parlamentare, gjatë diskutimit në debate publike, apo gjatë konsultimeve me biznese, ndërmarrës, pjesëmarrës tregu, parti politike ose organizata ndërkombëtare në Kosovë. Një pjesë e rëndësishme e kësaj qëndrueshmërie derivon nga lidhjet e forta të brendshme të organizatës, të cilat sigurojnë kualitet, transparencë dhe qeverisje të mirë institucionale. "Riinvest"-i përpaket vazhdimisht t'u përmbahet parimeve më të larta të qeverisjes.

Sot, Instituti "Riinvest" është i angazhuar në katër fusha kryesore: a)

Përderisa zhvillimet e së ardhmes vazhdimisht krijojnë sfida të reja për ne, Instituti "Riinvest" mbetet i gatshëm që mbi përvojën e ndërtuar deri më tani, mbi parimet e kredibilitetit e paanshmërisë, dhe mbi aktivizimin e vazhdueshëm zhvillimor, do të arrijë të ndërtojë dhe ofrojë zgjidhje për zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror.

hulumtime dhe avokim; b) zhvillimi i tregut; c) trajnime dhe edukim; dhe d) hulumtime akademike.

Fusha e hulumtimeve dhe avokimit përfaqëson fokusin kryesor të organizatës; ku shumica e temave dhe e zhvillimeve më të rëndësishme socio-ekonomike në vend adresohen vazhdimisht. Përgjatë viteve të fundit, "Riinvest"-i ka prodhuar një pjesë të madhe të raporteve kualitative në temat më të rëndësishme socio-ekonomike në Kosovë, mes tjerash duke përfshirë punësimin, privatizimin, qeverisjen korporative, energjinë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, informalitetin, prokurimin publik, korrupsionin, transparencën, diasporën dhe remitancat, financat dhe investimet publike – të cilat më vonë janë përdorur, cituar, dhe adresuar nga palë të interesuara; kryesisht nga Qeveria, Kuvendi, organizatat ndërkombëtare, shoqëria civile dhe shoqatat biznesore.

Në fushën e zhvillimit të tregut, organizata jonë ka qenë e angazhuar në ofrimin e asistencës teknike dhe njohurisë në tregje të ndryshme; veçanërisht në hortikulturë, turizëm, procesim të ushqimit dhe në sektorët shëndetësorë. Përvoja disavjeçare me metodologjitë më të avancuara zhvillimore, ka përgatitur ekipin tonë jo vetëm për të ofruar asistencë lokale, por edhe për t'i implementuar aktivitetet nga më të ndërlikuarat e më komplekset në këtë drejtim.

Në fushën e trajnimeve dhe edukimit, "Riinvest"-i është angazhuar po ashtu me zyrtarë komunalë, pronarë biznesesh dhe/ose përfaqësues,

shoqërinë civile dhe me gazetarë, me qëllim të ngritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve të tyre në disa sfera – të specifikuar sipas programeve trajnuese. Bashkëpunimi ynë është shprehur – në veçanti – me pothuajse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Në fund, duke pasur parasysh informacionet e pasura që "Riinvest"-i ka në dispozicion, hulumtuesit tanë kanë qenë të angazhuar aktivisht në hulumtime akademike, ku janë përgatitur dokumente dhe punime udhëzuese për të adresuar dhe kontribuar në mënyrë empirike në shumë hapësira (mangësi) letrare në fushën e ekonomiksit.

Përderisa zhvillimet e së ardhmes vazhdimisht krijojnë sfida të reja për ne, Instituti "Riinvest" mbetet i gatshëm që mbi përvojën e ndërtuar deri më tani, mbi parimet e kredibilitetit e paanshmërisë, dhe mbi aktivizimin e vazhdueshëm zhvillimor, do të arrijë të ndërtojë dhe ofrojë zgjidhje për zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror.



LUMIR ABDIXHIKU
DREJTOR EKZEKUTIV

Shënimi i sivjetshëm na bëhet megjithatë më i veçantë. Sepse, në 15 majin e këtij viti, ne përmbyllim një ecje dy dekadëshe, me sfida plot – por dhe me suksese, miq e partnerë edhe më shumë.

Për Institutin "Riinvest", 15 maji ka qenë gjithmonë më shumë se ditë kremtimi; ka qenë një shënim rikujtimi. E në këtë shënim – të përvjetshëm pra – ne kemi rikujtuar, më shumë për vetën se sa për të tjerët, misionin dhe rezonin e të qenit think-tank, të pavarur, siç ja rikujtojmë vetes shpesh, kredibil e inovativ; mbi të gjitha, kontribuues të zhvillimit ekonomik modern të Kosovës.

Shënimi i sivjetshëm na bëhet megjithatë më i veçantë. Sepse, në 15 majin e këtij viti, ne përmbyllim një ecje dy dekadëshe, me sfida plot – por dhe me suksese, miq e partnerë edhe më shumë.

"Riinvest" sot vazhdon të jetë think-tanku më i madh në vend. Me një staf profesional e të zhvilluar brenda dhe jashtë, me përvojë të konsiderueshme vendore e ndërkombëtare, me aleanca e partneritete brenda, në rajon dhe nëpër botë, "Riinvest"-i vazhdon të mbetet një aset që tejkalon përkufizimet e një organizate të rëndomtë. Përvoja, dija dhe kapitali human e intelektual që ky organizim bartë në vetë, në bashkërendim me angazhim kredibil, të pavarur e inovativ – dhe mbi të gjitha aktiv – kanë bërë Institutin "Riinvest" sot një adresë të konsoliduar e të nënkuptuar të trajtimit e shtjellimit të temave më të rëndësishme ekonomike për vendin dhe gjithë shoqërinë. Kjo adresë ka shërbyer gjithashtu edhe për ndërtimin e gjeneratave të tëra ekonomistësh, individë të dalluar e përkushtuar

që sot i shërbejnë vendit në institucione të ndryshme vendimmarrëse. Në të vërtetë, vetëm falë një trashëgimie të tillë, "Riinvest" ka arritur të përmbushë përgjatë gjithë 20 viteve të shkuara misionin e tij.

E në këtë 20 vjetor tonin, në këtë shënim jubilar të "Riinvestit", ne rikujtojmë hapat e parë të Institutit tonë, konsolidimin e pasluftës, kontributin në rrugëtimin e pavarësisë e angazhimit vendor e ndërkombëtar pas saj. Në këtë rikujtim, të përmbledhur dhe në këtë Monografi, në shpërfaqim jo vetëm lindjen e ecjen, por edhe arritjet e të ardhmen tonë. Dhe janë pikërisht mendimet e të tjerëve – përveç përshtypjeve tona – që japin fotografinë e madhe të rrugë sonë.

E në fakt, i gjithë rrugëtimi jonë – lindja, pjekja e maturimi deri në mësimnxënje të përjetshme – përputhet me gjithë rrugëtimin e vendit tonë, të Kosovës. "Riinvest"-i lindi në kohën më të rëndë të mundshme, gjithsesi në më të nevojshme të mundshme. Më 15 maj të vitit 1995, intelektualë – ekonomistë – të Kosovës, themeluan organizatën e parë think-tank, qëllimi i së cilës ishte promovimi i zhvillimit ekonomik të Kosovës – atëherë të pushtuar – nëpërmjet filozofisë së ndërmarrësisë. Në këtë periudhë, viabiliteti ekonomik i vendit, si shtet i pavarur e sovran, do të dokumentohej. Në këtë kohë, "Riinvest" gjenë edhe mbështetjen e

parë tek Qendra për Ndërmarrje Private Ndërkombëtare – në Washington D.C – partneritet i cili zgjatë dhe sot, tash e 20 vjet. Vitet vijuese – njëjtë sikurse për Kosovën – janë përpjekje për mbijetesë – deri tek 15 maji vitit 1999 – që gjenë “Riinvest”-in të dëbuar. Atëherë, zyrat refugjate ishin hapur në Maqedoni. 15 maji i vitit vijues – pas çlirimit – përveç kthimit e rinisjes, shënon lindjen e një partneritet afatgjatë me USAID – qëllimi i së cilit ishte ofrimi i mendimeve e alternativave ekonomike drejt rindërtimit të vendit. Në këtë periudhë, ndërtohen edhe partneritete të reja – që zgjasin dhe sot – me Fondacion Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), me Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim (SDC), me Fondacionin Friedrich Ebert (FES), me organizata vendore e ndërkombëtare – të angazhuara të gjitha në rimëkëmbjen e Kosovës. I gjithë rrugëtimi i dhjetë viteve të para, më 15 maj të vitit 2005, veçohet e dekorohet nga Presidenti i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova me “Medaljen e Artë të Pavarësisë”. Medalja jepet për meritat e “Riinvest”-it për liri, pavarësi dhe demokracinë e Kosovës, si dhe për kontributin në zhvillimin ekonomik e të projektimit të së ardhmes së Kosovës. Një medalje si kjo, para shërbimit të mirënjohjes, ishte barrë rikujtuese për rëndësinë e punës që bënë këtu, projektimin e të ardhmes së Kosovës pra. 15 maji i viteve 2006 e 2007, mbanë ekipin e “Riinvest” në këshilldhënie për delegacionin kosovar të bisedimeve për statusin final të Kosovës – pavarësinë. E në 15 maj të vitit 2008, kur ëndrra e “Riinvest”-it tashmë ishte pjekur e prekur, angazhimi jonë drejtohet në zhvillimin ekonomik, demokratizimin shoqëror dhe integrimin evropian të Kosovës. Në këtë vijë, përveç aleancave të shkuara, partneriteti me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë bëhet i veçantë. “Riinvest” post-pavarësisë, vazhdon të ruaj zërin e pavarur e kredibil në analiza, hulumtime, avokime e angazhime socio-ekonomike për temat më të rëndësishme në vend.

Kur shikon pas në gjithë këta gurë historie – të themeleve e pjekës tonë – kupton dhe madhështinë e një vizioni të nisur nga ata pak intelektual të

Kosovës, të ndërtuar nga partnerë e miq në kohë të vështira e të mira, e të trashëguar – në pandërprerë – nga gjenerata të tjera hulumtuesish e studiuesish që kanë kaluar e do të kalojnë nëpër “Riinvest”. Kur shikon pas në këtë histori, kupton dhe idenë dhe misionin e institucionit tonë; kupton se para së gjithash “Riinvest” është një pasuri e Kosovës.

Në këtë ditë shënimi e rikujtimi, ne shprehim mirënjohje për themeluesit e “Riinvestit”, në veçanti për profesor Muhamet Mustafa, idetë, udhëheqja dhe trashëgimia profesionale e së cilit kanë projektuar e ndërtuar një themel që do të mbajë “Riinvest”-in përjetësisht në këmbë. Është vetëm për shkak të vizionit e angazhimit të tij, që një projekt kaq i madh arrin t’i mbijetojë – përkundër të gjitha gjasave – represionit, dëbimimi, papërcaktueshmërisë – deri tek zhvillimi e qëndrueshmëria.

Në këtë ditë shënimi e rikujtimi, ne shprehim mirënjohje edhe për të gjithë partnerët tanë; nga organizatat ndërkombëtare e miqtë vendorë që na dhanë mbështetje kur ishim vet, e deri tek të tjerat me të cilat edhe sot vazhdojmë të ndërtojnë ura bashkëpunimi për një Kosovë evropiane; të zhvilluar, demokratike e moderne. U jemi mirënjohës të gjitha mediave, organizatave të shoqërisë civile, asociacioneve të biznesit, vendimarrësve të ndryshëm e individëve të tjerë që kanë bashkëndarë rrugën tonë nëpër 20 vitet e shkuara.

Mbi të gjitha, “Riinvest” mbetet mirënjohës ndaj stafit të tij, individë profesionalë – shtyllat e organizatës – të hapur e me plot përkushtim, që nëpërmjet përpjekjeve të përditshme që duken rutinë, ekzekutojnë një mision e vizion për gjithë vendin e tyre. Më mbetet nder e privilegj i veçantë ndarja e kohës, rrugës dhe qëllimit ultim – me njerëz të tillë. “Riinvest” gjithashtu mbetet mirënjohës ndaj gjithë atyre profesionistëve e bashkëpunëtorëve që dikur kanë qenë pjesë e institucionit tonë e të tyre nëpër këto vite.



Dhe në fund, përtej kremtës e shënimit, "Riinvest" i rikujton vetes për nevojën e angazhimit të mëtutjeshëm në zhvillimin ekonomik e demokratik të Kosovës. Sepse, pavarësisht gjithë sfidave e arritjeve nëpër vite, gjithë ngjarjeve e shënimeve vështirë të përsëritshme më, Kosova – anipse e lirë dhe e pavarur – vazhdon e do të vazhdojë ballafaqimin me

vështirësi të reja, me mundësi të reja e me transformime të reja. Në gjithë këtë rrugë, "Riinvest" do të mbetet aktiv, i pavarur e inovativ – për të shërbyer si një zë alternativ i brendshëm e si një promotor i vendit i jashtëm.

Deri në shënimet e ardhshme, gëzuar e ju faleminderit!



SEJDI OSMANI
KRYETAR I BORDIT DREJTUES

Një telefonatë, pastaj një nisje në një rrugë plot sfida e suksese

Ishte fillimi i pranverës, muaji mars i vitit 1995. Nuk më kujtohet data. Një ditë e zakonshme, monotone, zyrtësi gjithandej. Sapo isha kthyer në shtëpi, pasi kisha mbaruar punën që e bëja atëherë si kontabilist i disa bizneseve private, punë kjo që më ishte imponuar për të mbajtur familjen pasi që 6 vjet më parë regjimi okupator serb më kishte larguar nga puna. Cingëron telefoni. "Sejdo, duhet të vish menjëherë tek unë në shtëpi, kam një ide pune, na duhesh edhe ti", – më tha shkurt Muhameti dhe e mbylli telefonin".

Me Muhamet Mustafën takoheshim shpesh, konsultoheshim për çdo gjë, për hallet tona familjare, për situatën e rëndë. Nuk kisha ide se çka do të më thoshte, kësaj here. Fakti që më tha se duhet të takoheshim shpejt, e kuptova se ishte diçka me rëndësi. Unë banoja në 'Bregun e Diellit', afër Qendrës Tregtare. Pas 10 minutash arrita në shtëpinë e Muhametit, që ndodhej nja 150-200 metra mbi Tregun e Qytetit, tash rruga e Prizrenit nr. 161. Nuk më kishte shkuar mendja se që nda dita e nesërme këtë rrugë do ta bëja çdo ditë, nganjëherë disa herë në ditë. Kjo shtëpi do të bëhej edhe adresë e Institutit "Riinvest" deri në përfundim të luftës.

- E kam diskutuar me disa shokë idenë për themelimin e një instituti dhe na duhesh edhe ti në ekipin për jetësimin dhe zhvillimin e këtij projekti, më tha ai menjëherë posa hyra në zyrën e Kompanisë RIMA, që ishte ngjitur me hyrjen në oborrin e shtëpisë familjare. Ishte një lokal i vogël, jo më shumë se 10 metra katror hapësirë, që ishte

përshtatur për zyrë të administratës së kësaj ndërmarrje tregtare private, që Muhameti e kishte themeluar disa vite më parë.

Muhameti e zbërtheu në detaje idenë për themelimin e institutit. E kishte gati edhe formulimin e misionit.

- Me kontributin edhe të njerëzve që i kam paraparë të angazhohen në këtë punë, jam i sigurt se ky institut relativisht shpejt do të bëhet emër i respektueshëm në Kosovë dhe rajon, u shpreh ai me një siguri absolute. Për ata që nuk e kanë njohur profesorin Muhamet, siç e njihja unë, kjo ide do t'u dukej vetëm si një iluzion, e perealizueshme në ato rrethana, nën okupim klasik të Serbisë. Por, duke e njohur mirë, që nga fëmijëria, e dija që Muhameti, kur donte të arrinte diçka, nuk kishte pengesë që e ndalte.

U gëzova dhe u entuziazmova shumë. I besova pa asnjë rezervë këtij projekti. Vazhdoi elaborimin në detaje teknike për themelimin e tij, mënyrën e funksionimit nën kushte të okupimit, kamuflimin e tij, misionin e tij, nën ombrellën e Kompanisë RIMA, si një njësi kërkimore në kuadër të saj. Kishte edhe ide për projektet e para që do t'i fillonim.

Ishim nën një okupim të egër. Ishin mbyllur shkollat, universiteti, institucionet. Kuadrot shqiptare, profesorë universiteti, akademikë, inxhinierë, juristë, doktorë, ishin larguar nga vendet e tyre të punës nga regjimi serb, praktikisht ishin në rrugë, pa pasur mundësinë si të japin kontributin e tyre në dobi të popullit dhe vendit. Serbia, përveç dhunës fizike, ishte duke



bërë kërdi edhe në fushën e eksploatimi të egër ekonomik e financiar të Kosovës dhe të popullatës shqiptare të saj. Bota kishte dijeni për dhunën fizike që ushtrohej kundër shqiptarëve, por nuk kishte informacione të besueshme për dhunën ekonomike-financiare të regjimit serb që ushtronte ndaj bizneseve shqiptare, ndërmarrjeve shoqërore, resurseve minerare dhe plaçkitjes së popullatës shqiptare.

-Ky është qëllimi madhor që po e themelojmë këtë institut – u shpreh Muhameti. Së shpejti do t'i fillojmë hulumtimet në terren, anketa dhe intervista, në mënyrë që me fakte ta informojmë botën, për përmasat edhe të dhunës ekonomike-financiare që po ushtron Serbia ndaj nesh – tha ai.

Instituti i ardhshëm, që do të emërtohej Instituti për Hulumtime Zhvillimore RIINVEST, shumë shpejt filloi punën. U krijuan ekipe për të bërë hulumtime në terren, analiza dhe rekomandime për përballimin e pasojave të okupimit serb dhe mbijetesën e bizneseve shqiptare dhe familjeve shqiptare. U angazhuan rreth 100 ekspertë nga fusha të ndryshme, ekonomistë, inxhinierë, juristë, sociologë, kryesisht profesorë të Universitetit të Prishtinës, ekspertë nga ekonomia, studentë, si dhe konsulentë të jashtëm.

Më tregoi se kishte biseduar edhe me disa shokë të tjerë, kolegë të tij nga Universiteti dhe bashkëpunëtorë, si me Muhamet Sadikun, Naim

Hoxhën, Haki Shatrin, Halim Gjergjizin. Më tha se e kishte në plan ta angazhojmë edhe Nail Reshidin dhe Ymer Havollin. Punuam deri vonë në konceptin e strukturës organizative, në hartimin e misionit, vizionit, synimeve dhe objektivave të Institutit. Punën e nisëm me një entuziazëm të madh. Filluam t'i thërrasim bashkëpunëtorët, trajnimin e ekipeve të studentëve për të bërë hulumtime në terren.

-Deri në sigurimin e mjeteve financiare nga projektet e Institutit, kompania RIMA do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet operative dhe logjistike – tha Muhameti në takimin e parë të stafit të Institutit. Ishte ky një lehtësim i madh.

Pasi që zhvilluam disa aktivitete hulumtuese për pozitën e rëndë dhe nën okupim të bizneseve shqiptare, u paraqit nevoja që të kemi një ambient më komod për të organizuar debate dhe konferenca për prezantimin e gjetjeve nga këto hulumtime. Ishte një kafe-bar ngjitur me Rektoratin e Universitetit të Prishtinës në 'Velani'. Pronari, Xhevdet Shoshi, na e dha në shfrytëzim. I bëmë disa përshtatje të domosdoshme teknike që nevojiteshin për t'u përdorur si sallë debatesh, konferencash, por edhe për trajnime të ndryshme.

Ishte mesi i gushtit të vitit 1996. Ishte dita e fundit kur duhej ta dërgonim në CIPE-Uashington për aprovim propozimin e projektit "Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës". Nën mbikëqyrjen e profesorit Muhamet deri kah ora 2 e mëngjesit, unë, Naim Hoxha, Ymer Havolli, Muhamet Sadiku, Nail Reshidi.

Arritëm që faktorit ndërkombëtar t'ia ofrojmë të vërtetën, me argumente, se Serbia e mbante Kosovën nën okupim për motive kolonialiste, ngase përfitimet ekonomike ishin shumë të mëdha.

Muaj më herët, versioni elektronik i këtij studimi në gjuhën shqipe dhe anglishte, ishte vendosur në internet.

Ia dolëm që në kohën e duhur edhe si libër ta dërgojmë jashtë vendit në kryeqytetet kryesore perëndimore, në duart e diplomatëve më me ndikim. Studimi "Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës", i shërbeu edhe delegacionit të Kosovës në bisedimet e Rambujesë. Realizimi i këtij projekti në ato kushte shumë të vështira ishte një test i kryer me sukses i "Riinvest"-it, që do t'i hapë rrugë zhvillimit të hovshëm të tij, sidomos pas përfundimit të luftës në Kosovë.

Ishte dhjetori i vitit 1998. Me propozimin e prof. Muahmet Mustafës, vendosëm që me publikimet tona të marrim pjesë në Panairin e Librit në Tiranë. U vendos që unë të përfaqësoj "Riinvest"-in në dy ditët e para të panairit, ndërsa pas dy ditësh të më zëvendësojë Ymer Havolli. Librat i dërguam ilegalisht nëpërmes një kompanie private. Pjesëmarrja jonë zgjoi kureshtje të madhe te pjesëmarrësit dhe vizitorët. Interesim të veçantë zgjoi publikimi "Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës". Kolegët dhe vizitorët habiteshin se, si ia kishim dalë që të realizonim një projekt të tillë në Prishtinë, para hundëve të aparatit të hekurt represiv serb, sidomos kur e kuptonin se me këtë projekt demaskohej me fakte okupimi serb i Kosovës, në veçanti represioni ekonomik që ushtrohej ndaj shqiptarëve të Kosovës, dhe projektohej sistemi i ri ekonomik i shtetit të ardhshëm të Kosovës.

Gjatë qëndrimit në Tiranë isha ngarkuar edhe me një detyrë tjetër: regjistrimin dhe certifikimin e Institutit në Ministrinë e Arsimit të Kosovës që vepronte në ekzil, përmes Zyrës së Republikës së Kosovës në Tiranë.

Ato ditë ambientet e Përfaqësisë Diplomatike së Republikës së Kosovës në Tiranë frekuentoheshin nga shumë kosovarë, ushtarë e oficerë që përgatiteshin të hynin në Kosovë, familjarë të ushtarëve të plagosur që



shëroheshin në spitalet e Tiranës, dhe hallexhi të tjerë që kërkonin ndonjë shërbim apo informatë mbi gjendjen në Kosovë.

Ilaz Ramajli, që atë kohë ishte përfaqësues diplomatik i Kosovës në Tiranë, me karizmin e një diplomati prej karriere, impresiononte se si i kryente punët nga domeni i misionit të tij. Ai njëkohësisht arrinte që te kosovarët, të cilët sikur lumi që del nga shtrati i tij, i vërshonin zyrat e përfaqësisë, të ofronte ndonjë zgjidhje, të reflektonte shpresë dhe siguri për ardhjen e shpejtë të lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës.

Dorëzova dokumentacionin që kërkohej dhe pas disa ditësh morëm certifikatën mbi regjistrimin e Institutit "Riinvest" në Ministrinë Arsimit të Republikës së Kosovës që vepronte në ekzil. Certifikata mbante numrin 1 të protokollit, numër ky që edhe sot ka një simbolikë të rëndësishme për ne.



ALBAN HASHANI
DREJTOR I KËRKIMEVE

Instituti Riinvest ka krijuar një bazë të gjerë të hulumtimeve të cilat përfaqësojnë një kapital të rëndësishëm intelektual dhe janë unike për rrethanat e Kosovës.

Instituti Riinvest po feston njëzet vjetorin e themelimit. Në këtë jubile, ne fillimisht dëshirojmë të shprehim falënderimin tonë të përzemërt për mbështetësit dhe partnerët tanë si dhe të nderojmë përpjekjet e gjithë atyre që ishin pjesë e Instituti Riinvest ndër vite të cilët ndihmuan që ne sot të mirëpresim e festojmë këtë ditë.

I themeluar në kushte jashtëzakonisht të rënda, Instituti Riinvest padyshim mbetet një projekt i veçantë në gjithë rajonin. Instituti Riinvest ka ndjekur një trajektore të ngjashme me atë të proceseve politike në Kosovë. Madje, në shumë tema kyçe lidhur me zhvillimet ekonomike dhe politike të vendit, Instituti Riinvest ka pasur rrol nismëtar.

Në këto njëzet vjet, Instituti Riinvest ka arritur të ruaj dhe forcojë reputacionin e tij që e dallon atë për cilësi dhe besueshmëri. Padyshim, studimet e Institutit Riinvest mbeten një pikë e rëndësishme reference nga studiuesit, media dhe politikë-bërësit lidhur me çështjet ekonomike në vend. Instituti Riinvest ka krijuar një bazë të gjerë të hulumtimeve të cilat përfaqësojnë një kapital të rëndësishëm intelektual dhe janë unike për rrethanat e Kosovës. Për më tepër, Instituti Riinvest ka krijuar dhe kultivuar partneritet strategjik me organizata vendore dhe ndërkombëtare në mënyrë që të zbatoj misionin e tij. Ky bashkëpunim para se gjithash ka qenë i mundur si rezultat i përkushtimit dhe punës cilësore të Institutit Riinvest si dhe qëndrimit jo-partizan që ai ka mbajtur për tema specifike gjatë këtyre viteve. Bashkëpunimi i Institutit

Riinvest me organizata vendore dhe ndërkombëtare është në zhvillim të përhershëm dhe listës së partnerëve u shtohen në vijimësi anëtarë të rinj.

Instituti Riinvesti ka qenë dhe mbetet një grumbull i jashtëzakonshëm i njerëzve të përkushtuar. Gjatë dy dekadave të ekzistencës së tij ai ka ndërmarrë dhe zbatuar projekte të fushave dhe madhësive të ndryshme. Mbështetur nga një numër i madh donatorësh dhe në bashkëpunim me partnerë strategjik gjatë zbatimit të projekteve, Instituti Riinvest ka fituar përvojë domethënëse e cila është bartur në mënyrë organike tek stafi i ri i cili është bërë pjesë e Institutit Riinvest përgjatë viteve. Sot, Instituti Riinvest ka një kuadër të kualifikuar me shkollim shumë cilësor dhe përvojë domethënëse në fushën e hulumtimeve në shkencat sociale dhe zbatimin e projekteve zhvillimore. Në bashkëpunim edhe me organizata partnere, Instituti Riinvest ka marrë mbështetje të rëndësishme në zhvillimin e stafit të tij. Për më tepër, Instituti Riinvest ka mbështetur dhe vijon të mbështes stafin e tij në avancimin e tij akademik dhe profesional.

Përtej kësaj, Instituti Riinvest dallohet për nga kultura e punës dhe sjelljes organizative. E rrënjosur qysh prej themelimit, Instituti Riinvest ka kultivuar një mjedis pune ku kultura dhe sjellja organizative tejkalon obligimet kontraktuale. Në fakt, Instituti Riinvest ka arritur të trashëgoj dhe ruaj një memorie kolektive që pozicionon në nivelin më të lartë këtë bashkëpunim ndërmjet punëtorëve. Ky mjedis mundëson që punëtorët të jenë më të përkushtuar, të



identifikohen me organizatën si dhe të mishërojnë karrierën e tyre afatgjate me misionin e Institutit Riinvest.

Instituti Riinvest ka një pozicion unik në Kosovë si dhe njohuri të qarta lidhur me nevojat strategjike të vendit. Riinvest ka qenë dhe mbetet pjesë e rëndësishme e zhvillimeve ekonomike dhe politike në Kosovë. Bazuar në kërkimet e tij, Instituti Riinvest arrin që të kuptoj rrethanat në të cilën zhvillohet ekonomia e vendit si dhe të rekomandoj hapa të cilët do të siguronin zhvillim të përshpejtuar dhe të qëndrueshëm të Kosovës. Instituti Riinvest ka qenë i gatshëm që të përballoj sfidat të cilat i ka hasur gjatë këtij rrugëtimi njëzet vjeçar. Padyshim se rrugëtimi i mëtutjeshëm do të sjell sfida të reja, mirëpo ne jemi njëlloj të bindur se me ekipin që Instituti Riinvest ka sot, ai do të përballlet me sukses edhe me sfidat që vijnë.

Ne besojmë se përvjetori i njëzetë na ofron një mundësi të veçantë të riafirmojmë qëndrimin tonë se realizimi i misionit të Institutit Riinvest është i mundur vetëm në sajë të përkushtimi të njerëzve që punojnë aty. Përderisa shikojmë me mburrje vitet që kaluam, ne gjithashtu jemi të entuziazmuar për vitet që po vijnë. Ne vijojmë të mbetemi të përkushtuar ndaj misionit që i kemi vënë vetës. Personalisht, unë jam shumë i lumtur që si pjesë e kësaj shtëpie vijoj të jap kontributin tim modest në përmbushjen e këtij misioni.

Duke falënderuar të gjithë juve që keni mbështetur Institutin Riinvest gjatë këtyre dy dekadave, ju ftoj që të bashkoheni me ne që të festojmë këtë arritje.

Gëzuar!



3

“RIINVEST”-i
NËPËR VITE

MUHAMET MUSTAFA

THEMELUES I "RIINVEST"-IT



03 / "RIINVEST"-I NËPËR VITE

Një inxhiniering i pavarësisë ekonomike

Nga mesi i viteve '90 të shekullit të kaluar, diskutimet lidhur me zgjidhjen e problemit të Kosovës dhe përgjithësisht konfliktit të gjatë shqiptaro-serb ishin mjaft intensive, por në tërë këtë çështjet ekonomike ishin neglizhuar pothuajse tërësisht. Qarqet politike dhe akademike serbe Kosovën e kishin mitizuar me përvetësimin e historisë dhe ngjarjeve nga mesjeta. Shqiptarët e shihnin autenticitetin e tyre këtu që nga kohët antike dhe kontinuitetin iliro-shqiptar. Serbët e kishin konsideruar dhe propaganduar Kosovën si tokë të tyre, por në realitet ishin sjellë si me një koloni, në kontinuitet. Ata kishin punuar që për enklavat serbe të krijonin kushte më të mira për jetesë, që serbët të punësoheshin në sektorin publik e të kishin shkollë më të mira, por në esencë Kosovën si tërësi e mbanin në një varësi ekonomike, të pazhvilluar qysh nga Jugosllavia e parë, pastaj në atë të dytën socialiste, deri kah fundi i viteve '60. Vetëm rreth dy dekada Kosova deri në një masë kishte qeverisur burimet e veta dhe kishte krijuar një buxhet domethënës. Dhe tash që nga fillimi i viteve '90 në proceset e shkatërrimit të Jugosllavisë e kishin ripushtuar duke zhbërë autonominë dhe strukturën e saj institucionale dhe duke e vënë atë nën subordinim të Qeverisë serbe. Shqiptarët ndërkaq vazhdonin të ishin të detyruar që t'i paguanin taksat Qeverisë serbe, edhe pse nga ato nuk

përfitonin asgjë përveç represionit dhe dhunës. Dihej se çështja e Kosovës do të vihej në tavolinë të negociatave ose do të niste lufta. Në opinion botëror dhe në analizat politike çështja e Kosovës shtrohej më shumë si një çështje separatizmi, ndarjes së një territori nga një shtet ekzistues, një ndryshim kufijsh, e jo si një tokë e pushtuar që ishte mbajtur me politikë koloniale. Kolonializmi nuk ishte shoqëruar as në diskurs me Evropën. Si duket ky koncept edhe nuk shkonte me Evropën, ishte më tepër i lidhur me Afrikën, Lindjen e Mesme ose disa vise në Azi dhe në Amerikën Latine. E Kosova ishte në fakt një koloni. Dhe kjo duhej dokumentuar me studime të ftohta, rationale të argumentuara ekonomike dhe politike. Filozofisë politike të Kosovës, nga e cila kishte lindur ideja për pavarësinë e saj, i mungonte të them ashtu një lloj inxhinieringu ekonomik.

"Riinvest"- filozofi e re e ekonomisë politike të Kosovës

Na dukej se këtu një grup bashkëpunëtorësh e miqsh mund ta jepnim një kontribut dhe se duhej patjetër ta jepnim. Kur po e bisedoja këtë çështje me Muhamet Sadikun, Halim Gjergjizin në fillim dhe më vonë me Haki Shatrin, Sejdi Osmanin, Naim Hoxhën, Ymer Havollin dhe Nail Reshidin, diku në mars ose shkurt të vitit 1995 erdhëm në përfundim se do të duhej

ta formojmë një Institut për kërkime zhvillimore apo diçka të ngjashme. E bëra një koncept për misionin dhe orientimin programor të këtij instituti, të cilin e diskutuam bashkë, e plotësuam dhe u dakorduam për këtë. Më 15 maj 1995 e nënshkruam marrëveshjen për themelimin e Institutit për Hulumtime Zhvillimore "Riinvest", si institut privat joprofitabil. Ai do të punonte në fillim në kuadër të Kompanisë Rima, si njësi e veçantë kërkimore. Rima ishte regjistruar derisa funksiononin institucionet e Kosovës. Sipas Ligjit për Ndërmarrjet, kompanitë mund të kishin në kudër të tyre njësi të veçanta kërkimore pa pasur nevojë t'i regjistrojnë. E shfrytëzuam këtë mundësi për ta bërë punën publikisht pa pasur nevojë të regjistrohemi si institut kërkimor, që në ato kohë do të duhej ta bënim në Ministrinë e Shkencës të Serbisë. Këtë nuk donim ta bënim. Emri "Riinvest" u krijua nga dy shkronjat e para të Rimes dhe fjalën "invest", që është sinonim për zhvillim dhe ka kuptimin e investimit të vazhdueshëm në dije e zhvillim. Në fakt ne e kishim menduar misionin e "Riinvest"-it që të promovojmë mendimin modern ekonomik në Kosovë, iniciativën e lirë e private, t'i kontribuojë edukimit dhe informimit të mirë të faktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe opinionit për aspektet e ndryshme të ekonomisë së Kosovës, përkatësisht ndërtimit të një vizioni dhe politikave që e shoqërojnë ata mbi zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. E filluam punën në zyrat e RIMES të adaptuara në hyrje të shtëpisë sime. Filluam të dukemi edhe në opinion dhe të marrim pjesë edhe në tubime që organizonte Lidhja e Ekonomistëve të Kosovës, ku unë isha nënkryetar. Organizuam një tubim të përbashkët me Lidhjen e Ekonomistëve lidhur me pozitën ekonomike të Kosovës me vështrim të posaçëm për ekonominë private, e cila ishte mjaft e suksesshme. Publikimin nga ky tubim e organizoi dhe përgatiti "Riinvest"-i. Në bashkëpunim me LDK-në i mbështetëm aktivitetet për krijimin e Shoqatës së Afaristëve të Kosovës, të njohur si SHAK, nëpërmjet të cilës synonim të krijonim një partner strategjik për të organizuar sektorin privat edhe më mirë në funksion të rezistencës aktive paqësore. Më vonë erdhën disa nga agjencitë turistike, me një kërkesë që t'u bënim një projekt për krijimin e një unioni, apo holdingu të agjencive që do të forconte aftësinë e tyre konkurruese ndaj partnerëve të tretë, sidomos ndaj aviokompanive që merreshin me transportin në linja të rregullta dhe çarter të emigrantëve tanë nga Evropa Perëndimore. Ne vendosëm që



edhe vetë të hyjmë aty partnerë dhe ua bëjmë planin e biznesit. Ato ditë organizuam edhe një seminar trajnimi- planifikimin e biznesit dhe analizën financiare. Pra, faza e parë e punës sonë ishte e lidhur me një partneritet me biznesin privat dhe komunitetin akademik. Natyrisht në këtë fazë ne nuk kishim para për paga e as për zyra dhe shpenzime të tjera. Ne i investonim kohën dhe punën tonë, kurse shpenzimet e funksionimit përballoheshin nga Rima dhe fondet tona private.

Diku në fillim të vitit 1996 kolegu H. Gjergjizi solli një dokument të NED (National Endowment for Democracy, Uashington) që financohet nga fonde të Qeverisë amerikane dhe promovon zhvillimet demokratike dhe reformat në gjithë botën. Ai kishte dëgjuar se ata ishin aktivë edhe në Kosovë. Kishte marrë një dokument që përmbante objektivat dhe prioritetet e NED, si dhe udhëzimet për përgatitjen e propozimeve të projekteve që mund të dërgoheshin për t'u konsideruar për mbështetje financiare. Vendosëm të përgatisim një propozim sipas atyre udhëzimeve që dukeshin mjaft të qarta. Kontributi ynë më i mirë në këtë kohë do të ishte ta analizojmë situatën ekonomike në Kosovë,

Në fillim të 1997-s, CIPE na informoi se nënshkrimin e kontratës do ta bënim në Bukuresht, në fund të marsit, ku CIPE organizonte një Konferencë të madhe rajonale mbi aspekte të ndryshme të reformave ekonomike

pozitën koloniale që kishte imponuar regjimi serb, mënyrën se si sigurohej mbijetesa, si dhe të zhvillonim një projektion se si Kosova në kushtet e reformave ekonomike të tregut, duke u bazuar në burimet e saja natyrore, njerëzore dhe të tjera, mund të ndërtojë qëndrueshmërinë e saj ekonomike (viabilitetin). Kjo në fakt do të thoshte pavarësinë ekonomike. Kishte shumë spekulime sidomos nga ata që e kundërshtonin pavarësinë e Kosovës, se gjoja ajo nuk do të mund të mbijetonte si e pavarur, nuk mund ta buxhetonte pavarësinë e vet ekonomike. E rregulluam edhe më tutje, duke u bazuar në disa sugjerime që morëm veçmas nga Veton Surroi, krijuam një buxhet, nëse më kujtohet diku rreth 90 mijë \$, prej të cilave rreth 60 mijë kërkonim nga NED e të tjerat do t'i financonim nga burime të tjera. E përkthyem anglisht, i bëmë një redakturë dhe e dërguam në adresë të NED në Washington D.C. Projekti parashihte eksplorim të përvojave në tranzicion, analizë të literaturës, parashihte studime mbi ekonominë private të Kosovës, një vështrim historik mbi pozitën ekonomike të Kosovës në ish-Jugosllavi dhe mbi pozitën në regjimin serb pas vitit 1989/90, përfshinte një historik të shkurtër të zhvillimit. Ajo që ishte më me rëndësi, projektonte ecurinë dhe përmbajtjen e reformave për të ndërtuar një sistem të ekonomisë së lirë të tregut, përviçonte strategjinë dhe politikat ekonomike që siguronin qëndrueshmërinë ekonomike të Kosovës. Projekti përmbante pesë module, për secilin nga një konferencë shkencore e profesionale, qëndrime studimore në Slloveni dhe Kroaci dhe mundësisht edhe në vende të tjera. E titulluam "Aktivitet Ekonomike dhe Zhvillimi Demokratik i Kosovës". Ishte një titull që shprehte përmbajtjen e aktiviteteve e gjithashtu edhe më tepër filozofinë e NED.

CIPE: Worthy to Consider

Kaluam më tepër se tre muaj kur, diku në fillim të verës, na erdhi një letër nga Howard Wallack, zyrtar i lartë programor i CIPE (Center for International Private Enterprise/Qendra e Ndërmarrjeve Private Ndërkombëtare, nga Washington DC) për Evropën Qendrore e Lindore. Wallack na dërgonte një letër ku shpjegonte se NED e kishte përcjellë propozimin e projektit tonë te CIPE, pasi ata realizonin projektet e NED nga fusha e reformave ekonomike, ekonomia e tregut dhe zhvillimi i sektorit privat. Letra ishte inkurajuese dhe plot ngrohtësi. Pasi jepte udhëzime shumë të qarta se si duhej të përplotësohej projekti ynë, thoshte se nëse do t'i ndiqnim këto udhëzime dhe do ta plotësonim propozimin tonë sipas tyre, ai do të ishte i vlefshëm për t'u konsideruar seriozisht për aprovim nga Bordi i CIPE. Në momentin kur po lexoja këto fjalë, e kisha plotësisht të qartë se tani kishim hyrë në një rrugë kur vizioni ynë lidhur me Institutin "Riinvest", për krijimin e një Instituti të standardeve ndërkombëtare, do të mund të bëhej realitet. Na kishte kapluar një gëzim, pasi që ajo që kërkohej për t'u korrigjuar ishte formuluar qartë dhe kërkonte në fakt vetëm një ndërlidhje më të qartë midis objektivave të projektit, moduleve dhe aktiviteteve që kishim propozuar, një specifikim më të mirë të indikatorëve dhe buxhetit. Sqarimet ishin aq të qarta, sa që nuk e kishim fare problem për t'i zbatuar. E kishim të qartë se rruga e zhvillimit të "Riinvest"-it do të ishte më e shpejtë sesa që e kishim paramenduar. Diku kah fundi i gushtit, ashtu siç ishim porositur me sugjerimet e Wallack, përfunduam gjithë intervenimet, duke u munduar që të kishim një anglishte sa më të mirë, edhe pse ishim të vetëdijshëm se kjo nuk do të ishte

ana e fortë e propozimit tonë. Ishim në pritje të një vendimi përfundimtar. Gjatë asaj vjeshte e konsideruam të nevojshme që lidhur me projektin tonë të informonim edhe Ambasadën amerikane, Ambasadën gjermane dhe Ambasadën britanike në Beograd, duke u dorëzuar nga një kopje të propozimit dhe kërkuar mbështetjen e tyre me fonde shtesë. Në nëntor të vitit 1996 Andrew Vilson që ishte zyrtar programor i CIPE për Evropën Lindore dhe Qendrore, më mori në telefon një pasdite, në fillim të orarit të punës së tij. Më bëri ca pyetje lidhur me projektin dhe me faktin se kujt i drejtoheshim me rekomandimet e studimit tonë. Do të llobojmë me rekomandimet tona tek institucionet legale të Kosovës, faktorët politikë të shqiptarëve të Kosovës, te faktorët ndërkombëtarë, do ta përmirësojmë nivelin e njohurive dhe informacionit të faktorëve të involvuar rreth Kosovës mbi aspektet ekonomike të problemit të pazgjidhur të Kosovës.

- Edhe qeverisë në ekzil?
- Po, i thashë.
- Mirë tha, këtë kisha për ta sqaruar dhe dëshiroj të të informoj se ne do t'i propozojmë Bordit të CIPE që projekti juaj të aprovohet dhe shpresoj se gjithçka do të jetë mirë. Ne zakonisht nuk aprovojmë projekte pa e njohur partnerin dhe vizituar atë në selinë e tyre, por ne nuk kemi mundur të marrim vizë. Viza jonë është refuzuar nga Qeveria jugosllave, kur kemi thënë se duam të vizitojmë Kosovën.

Nuk shkoi shumë gjatë, ndoshta 30-40 ditë kur morëm lajmin se Bordi i CIPE kishte aprovuar projektin tonë dhe njëllor kishte vepruar edhe Bordi i NED, diku rreth 42 mijë \$. Kjo ishte një argument i mirë që të kërkonim edhe mbështetje në Fondacionin Soros dhe nga fondacionet gjermane dhe britanike. Në Ambasadën gjermane takuam ambasadorin në detyrë Victor Pelett, që në fakt kishte konsull i përgjithshëm. Ai na priti shumë ngrohtë. Kishte kuptuar thelbin e projektit dhe po ecte përreth tavolinës. Po mendoj se si mund t'u ndihmoj, po përsëriste për të satën herë. Do të flas me fondacionet gjermane. Të njëjtën ditë patëm bisedë inkurajuese edhe në Ambasadën britanike ku menaxhonin fondin e tyre "British Know How". Në Prishtinë kjo ishte marrë vesh në LDK. Si duket NED i kishte informuar ata se do të mbështeste një projekt të rëndësishëm për ekonominë. Morëm urime nga Fatmir Sejdiu dhe Alush Gashi. Tash duhej përgatitur një sërë dokumentesh në përgatitje të kontratës.

Some Concerns dhe "Happy-End"

Në fillim të 1997-s, CIPE na informoi se nënshkrimin e kontratës do ta bënim në Bukuresht, në fund të marsit, ku CIPE organizonte një Konferencë të madhe rajonale mbi aspekte të ndryshme të reformave ekonomike, zhvillimin e sektorit privat dhe ndërmarrësisë. U nisëm me Muhametin dhe Naimin me veturë nëpër Sofje, drejt Bukureshtit. Një ditë e tërë rrugë rreth 700 km deri në Bukuresht. Kur arritëm në takimin fillestar në darkë, në hyrje takuam A. Wilson, i cili na përshëndeti shumë përzemërsisht.

- Mirë u bë që u takuam më në fund, të njihemi dhe ta nënshkruajmë kontratën për të filluar projektin, po komentoja unë.

- Po tha, e për kontratën janë disa brenga.

Xhyljeta Mushkolaj nga Qendra Informative Amerikane në Prishtinë, që ishte themeluar pak kohë përpara, gjatë kohës kur ne ishim në Bukuresht, më kishte thirr disa herë në shtëpi. Ajo kishte lënë një numër telefoni dhe kishte kërkuar t'i paraqitesha në çfarëdo kohe që arrija. Xhyljetën e njihja nga fakulteti, ishte mësime dhënëse në Juridik. E mora menjëherë në telefon edhe pse tanimë gati ishte ora 11.

- Profesor, më tha ajo, z. Gregory Burton, ka dy ditë që po qëndron në Prishtinë, nuk do të kthehet pa ju takuar, po insiston që t'ju takojë vetëm ai juve dhe stafin tuaj, pa përkthyes dhe kërkon që takimi gjithsesi të bëhet në zyrat tuaja.

Më erdhi mirë që do të takoheshim kaq shpejt me përfaqësuesin e Ambasadës së ShBA-së dhe do t'ua shpjegojmë në detaje projektin dhe objektivat e tij. Të nesërmen, në orën 9:00 të mëngjesit, z. Burton ishte te ne. I tërë diskutimi u zhvillua në anglisht, pa përkthim. I bëra një hyrje për "Riinvest"-in, pse ishim themeluar, si e shihnim ne situatën në ekonominë e Kosovës tani, cilat ishin mundësitë dhe zgjidhjet. Ia prezantova projektin, i cili duhet të hidhte dritë në perspektivën ekonomike në kuadër të një zgjidhjeje optimale të çështjes së Kosovës, e kjo zgjidhje nuk do të mund të ishte reale në qoftë se neglizhohej aspekti ekonomik, të cilin fatkeqësisht nuk e merrnin parasysh sa duhet as faktorët ndërkombëtarë as ata vendorë. I thash

se ne donim të kontribuonim me një studim objektiv, se e dinim që projekti ynë ishte aprovuar nga Bordi i CIPE-s dhe se kishte ca hezitime nga Ambasada, më saktësisht nga vetë ai. I thamë se sapo ishim kthyer nga Konferenca rajonale e CIPE-s në Bukuresht, ku kishim shkuar për ta nënshkruar kontratën, porse kjo nuk ishte bërë për shkak se Ambasada e ShBA-së në Beograd kishte kërkuar disa sqarime shtesë të shqetësimeve ("concerns") që kishte ngritur ambasada.

- Jo, tha- CIPE vendos pavarësisht, ne nuk ndërhyjmë. Më thoni kujt do t'ia drejtoni rekomandimet nga studimi juaj?
- Faktorit ndërkombëtar dhe faktorit politik, partive politike dhe strukturave të tjera legjitime të Kosovës, i thamë.
- E Qeverisë së Serbisë, pyeti ai?
- Jo, i thamë ne, nuk komunikojmë me ta.
- E pse jo?
- I konsiderojmë ilegjitimë dhe okupues të Kosovës - u përgjigjëm. Mirëpo ne do ta publikojmë studimin në shqip dhe anglisht dhe ata mund ta lexojnë.
- E Qeverisë së Bukoshit? – pyeti.
- Po - i thamë, sigurisht ne do t'i prezantojmë dhe diskutojmë rezultatet e studimeve dhe rekomandimet tona me Qeverinë e Kosovës në ekzil, të njohur si 'Qeveria Bukoshi'.
- Po atë qeveri nuk e njeh askush - komentoi ai.
- Nuk di - i thash, por ai po takohet edhe në Departamentin e Shtetit, Qeverinë gjermane, e tjera.

Bëri edhe ca pyetje të tjera lidhur me përmbajtjen e projektit, mënyrën se si do ta realizonim atë, modulet dhe aktivitetet. Në fund tha se është i kënaqur me bisedën, që i pëlqeu qasja jonë, se kishte takuar edhe disa grupe të tjera, duke buzëqeshur përmendi një institut tjetër, e kishte fjalën për Institutin Ekonomik. Nuk dija se si ta interpretoj këtë buzëqeshje, që në fakt përmbante një lloj pikëpyetje. E mora me mend se mund të kenë folur diçka kundër nesh. Po, ne njihemi, i kam kolegë në fakultet, nuk do të thotë se mendojmë njësoj për të gjitha çështjet- po sqaroja unë.

Pas nja një muaji me M. Sadikun kaktuam takimin në ambasadë. Tash, përveç

Burton prezent ishte edhe personi përgjegjës politik, Nicolas Hill (i vëllai i politikanit të njohur të involvuar rreth Kosovës, Christifer Hill, atëherë ambasador në Shkup). Biseda u zhvillua përsëri rreth projektit, ne kishim marrë me veti planin e projektit, metodologjinë e hulumtimeve duke përfshirë edhe pyetësorin që do ta përdornim për hulumtime në ndërmarrjet private për kushtet e tyre të afarizmit nën regjimin serb. Kjo u bëri përshtypje.

Amerika për herë të parë: Sprovat polemizuese për kolonializimin e okupimin

Atë verë të nxehtë e kaluam në shenjë të aktiviteteve të projektit. Me A. Wilson kishim planifikuar vizitën time të parë në CIPE, përkatësisht në Uashington dhe ShBA për fund të shtatorit . Duhet të dërgonim raportin e progresit dhe pasqyrën e shpenzimeve të buxhetit për tre muajt e parë. Gjithashtu po dërgonim edhe raportin për zhvillimin dhe problemet e sektorit privat që kishim përgatitur në ndërkohë, bashkë me botimin nga Konferenca që kishim mbajtur në këtë temë. Ishte hera e parë që po shkoja në ShBA, u gëzohesha takimeve dhe diskutimeve në CIPE, e i gëzohesha shumë edhe vizitës në Kansas City te Qefserja dhe Edmondi. Një natë para udhëtimit pothuajse nuk fjetëm fare për t'i përgatitur të gjitha raportet. Ymeri e Naimi ndenjën me mua edhe më gjatë edhe kur të tjerët pas mesnate (Sadiku, Sejda e Naili) shkuan në shtëpi.

CIPE kishte ftuar një audiencë të zgjedhur ekspertësh e politikanësh që merreshin me Kosovën në State Department e gjetiu dhe aty duhej të bëja një prezantim për situatën politike dhe ekonomike në Kosovë. Kjo do të ndodhë gati secilën herë që kam vizituar edhe më vonë CIPE e Uashingtonin. Pasi u akomodova në qendër të Uashingtonit, fillova me programin e dëndur të bisedave. Bisedat në Dhomën Tregtare të Amerikës që kishte një bashkëpunim të ngushtë me CIPE, u pasuan me njohjen dhe bisedimet të shumë njerëzve të mirë në CIPE, e sidomos H. Wallack, i cili edhe i pari na kishte kontaktuar. Iu falënderova për udhëzimet e vlefshme që na kishte

dhënë lidhur me propozimin e projektit dhe planin e tij. Me të diskutuam edhe raportin e progresit dhe raportin që kishim përgatitur për sektorin privat. Ai u befasua me progresin tonë të shpejtë për tre muajt e parë të projektit. Dha shumë propozime të vlefshme për qasjen në vazhdim. Një bisedë që mbetet në kujtim për energjinë pozitive dhe konstruktivitetin. Wilson vërtet më kishte bërë një program shumë të ngjeshur vizitash në Uashington. Veç bisedave me CIPE, takova USAID e NED, State Department, dy 'think tank' më të njohur në Uashington – CATO e Brookings (Një liberal ekstrem, tjetri më shumë kah demokratët dhe Keyns), Federatën Kombëtare të Bizneseve (NFB), Small Business Administration në Qeverinë amerikane, Atlas Economic Foundation, Amerikan University, German Marshall Foundation Kaufman Foundation më impresionoi me ndërtesën, stafin, programin dhe publikimet. Pa mëdyshje është një nga fondacionet dhe institucionet që bëjnë më së shumti për ndërmarrësinë në përmasa globale. Mora shumë libra dhe publikime, që sigurisht do të na ndihmonim që të bënim një diferencë në punën tonë hulumtuese e akademike.

Në Uashington u takova edhe njëherë me Wilson, për të bërë një përmbledhje të bisedimeve dhe punëve që na prisnim në vazhdim. Ai kishte blerë dhe paketuar pajisjet për Institutin "Riinvest", që na bënte ndër organizatat më të pajisura në rajon. Në të kthyer, kur po rezimoja frytet e kësaj vizite – pashë se kisha mësuar aq shumë dhe kisha marrë literaturë e pajise shumë të vlefshme, kisha krijuar kontakte me njerëz dhe institucione shumë të rëndësishme dhe kisha vërejtur se 'Riinvest' -i po krijonte një hapësirë të tij për Kosovën edhe në Uashington. Ajo që më la më së shumti mbresa ishte gjithë ai angazhim i Wilson dhe stafit të CIPE-s, për ta bërë këtë vizitë timen të suksesshme. Ata investonin shumë kohë dhe angazhim për këtë. Shpjegimi për suksesin amerikan, efektivitetin e punës së tyre, është para së gjithash një angazhimin serioz, përkushtimi i plotë ndaj punës dhe për arritjen e objektivave. Këtu duhet llogaritur dhe kultura e përkushtimit për arritje kulminante, perfekte. Puna jo vetëm që duhet të kryhet por edhe duhet të kryhet mirë. Dhe pastaj po mendoja edhe për atë se sa pika janë në botën e ndërlikuar dhe të ndërvarur, si Kosova dhe "Riinvest"-i, që ky vend u kushton vëmendje, sa burime financiare dhe investime të mëdha kërkonte e gjithë kjo.

PROFILE: Dr. Muhamet Mustafa



Dr. Muhamet Mustafa

Dr. Muhamet Mustafa wasn't sure what he would say to Madeleine Albright. After all, Mustafa, an academician from Kosovo, wasn't accustomed to sharing the limelight with the U.S. Secretary of State. He had spent months behind the scenes, toiling with his colleagues to lay the groundwork for Kosovo's reconstruction. In the end, when the opportunity to meet with Mrs. Albright presented itself in mid-September, Mustafa didn't miss a beat. "I told her about our appreciation of the U.S. role in assisting Kosovar efforts to rebuild our society," he says, "and I expressed a hope that our next meeting would take place in Pristina."

Being in the limelight is new to Mustafa. In the 1970s, he was a newspaper editor at a weekly youth magazine, and he subsequently served as head of the Kosovo Association of Youth Organization. By the mid-1980s, he had worked his way up to become Yugoslavia's Minister Coordinator for Development and Planning, responsible for reinvigorating his nation's economy through foreign direct investment and joint ventures. But by early 1989, under pressure from strongman Slobodan Milosevic, Mustafa resigned from the government.

Mustafa linked up with CIPE in 1997, when he was serving as President of the Riinvest Institute, a private think tank. With funding from CIPE, and under very difficult conditions, Riinvest produced a groundbreaking report, a blueprint for the future, "Economic Activities and the Democratic Development of Kosovo."

Following NATO's bombing earlier this year, col-

laboration between CIPE and Riinvest produced another key report, "Kosovo's Reconstruction." The very first words of this report read: "The renewal and postwar reconstruction of Kosovo should be a comprehensive and integrated process resulting in the creation and strengthening of democratic institutions and the establishment of an open market economy." The return of Kosovo's deported population doesn't mean simply a continuation of previous living standards, but

in most cases it means the rebuilding of lives from the beginning, not only for individuals and families, but also in the public sector."

This policy paper, coupled with Mustafa's indefatigable dedication to reconstructing Kosovo, played a vital role in hammering out in September the so-called Landsdowne Declaration, which envisages a "multi-ethnic society that includes equal opportunity for all."

Mustafa says that his relationship with CIPE has made a big difference in the Riinvest Institute's ability to encourage democracy and a market economy in Kosovo. He notes, "Without CIPE, the realization of our first and most important study would have never been possible. CIPE's recognition of Riinvest and the importance of our work came at a critical time for both Riinvest and Kosovo."

When he's not laying groundwork for the future of Kosovo, Mustafa heads the Department of Management and Informatics in the Faculty of Economics at the University of Pristina. He also serves as Vice President of the Association of Economists of Kosovo.

Does Mustafa ever have doubts about the ability of Kosovo or Kosovars to get back on their feet? "Of course," he admits, "but ten years of repression couldn't dampen the entrepreneurial spirit and energy of the Kosovar people, and now we're looking at a whole new world of opportunity."

"Without CIPE, the realization of our first and most important study would have never been possible. CIPE's recognition of Riinvest and the importance of our work came at a critical time for both Riinvest and Kosovo."

— Dr. Muhamet Mustafa



Mustafa greets U.S. Secretary of State Madeleine Albright.

Një projekt për administratën e pavarësisë

Asaj vjeshte ishim tejet të involvuar për të përfunduar modulet e tjera të projektit. Përveç zhvillimit të sektorit privat, ne i kishim edhe modulet për menaxhimin e projekteve të rindërtimit dhe tranzicionit, moduli për strategjinë e zhvillimit dhe reformat, moduli për integrimin rajonal e evropian, moduli për edukimin me një përqendrim në edukimin për biznes. Puna zhvillohej në atë mënyrë që ekipi i projektit bënte një draft të analizave, projeksioneve dhe rekomandimeve, porositnim edhe ndonjë mendim e kontribut të konsulentëve jashtë ekipit të projektit, ato prezantoheshin në konferenca dhe workshope dhe pas kësaj përpunohej raporti studimor edhe njëherë dhe bëhej drafti, i cili do të përfshihej në kapitullin përkatës të raportit final studimor. Prandaj ky projekt për kushtet në të cilat zhvillohej shënonte një ngjarje unike. Pra deri në qershor 1998 ne kishim mbajtur 5 konferenca tematike sipas moduleve të projektit, ku ishin rreth 100 kontribute ekipore dhe autoriale. Projekti në këtë mënyrë u afirmua si një formë e rezistencës dhe po gëzonte përkrahje nga shumë pjesëtarë të forcave politike, sidomos nga mediet, inteligjencia, por edhe nga përfaqësuesit e institucioneve të rezistencës që ishin të lidhura me LDK-në. Bashkëpunimi ynë zhvillohej, siç e theksova, sidomos me Naip Zekën. Ai merrte gjithë inputet që i duheshin. Ai kishte një ide për të zhvilluar një strategji ekonomike të qeverisë dhe ishte shumë i interesuar që t'i bënim një plan të aftësisimit të burimeve njerëzore për administratën që do të duhej të formohej pas largimit të Serbisë nga Kosova. Kjo mund të them se më impresionoi. Ai na kërkoi se, a mundemi ta bënim ne në "Riinvest" një propozim për profilet, trajnimi që duhej të bëhej dhe buxheti që duhej siguruar. Sugjerova që të bënim një ekip më të gjerë, që kjo mos ta marrë vetëm ngjyrën e "Riinvest"-it, dha ai u pajtua. Në qershor të 1998-s pothuajse kishim përfunduar të gjitha modulet e projektit dhe tash duhej të përfundonim edhe raportin final studimor, ku paraqitnim në mënyrë sintetike rezultatet e studimeve tona dhe rekomandimet. Kjo na kërkonte ende bukur shumë angazhim dhe për këtë morëm një zgjatje të afatit të projektit edhe për 3 muaj.

Projekti që krijoi diferencë

Diku nga fundi i shtatorit 1998 ne e kishim të përfunduar edhe raportin studimor Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës në shqip e anglisht dhe publikuar në një dizajn impresiv të cilin e nxori Naimi. Ai nuk kishte ndonjë përvojë në dizajn grafik, ishte eksperti më i mirë në Kosovë për softuerë biznesi, po si duket i gjithë ai frymëzim që e kishte pushtuar ekipin, e kishte frymëzuar edhe atë për ta nxjerrë kopertinën që simbolizonte Kosovën evropiane, jo vetëm me ngjyrat por edhe me përmbajtjen dhe idetë që dilnin nga studimi. Rasti e deshi që pas pak, diku në fillim të nëntorit CIPE na ftoi përsëri në një Konferencë rajonale me format e tema të ngjashme me atë paraprahen, kur ishim takuar për herë të parë me liderët e CIPE-s rreth një vit e gjysmë më parë, gjithashtu në Bukuresht. Përsëri po udhëtonim me Naimin e Muhametin, në marshutën e njëjtë. Morëm me vete edhe rreth 50 kopje të studimit anglisht.

Në Bukuresht, derisa po i merrnim dhomat e hotelit, te recepsioni u takuam me Zef Preçin, për të cilin kisha dëgjuar ngase udhëhiqte Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomie në Tiranë, por nuk ishim takuar më herët. Në përshëndetje dhe njoftim e sipër i dhamë raportin studimor, e shikoi i befasuar atë raport rreth 200 faqesh dhe nisi të kërkojë falje. Ne u habitëm përse kërkonte falje.

- Po, tha, unë nuk ju kam njohur juve dhe kur CIPE më kërkoi informatë për juve dhe unë e pyeta (drejtorin e një Instituti Ekonomik që e njihja). Ai më dërgoi një faks me vlerësime shumë negative. Thoshte "Riinvest"-i është inekzistent, nuk kanë as zyrë, janë 'komunistë', 'titistë' e të ngjashme. Kështu kishte shkruar ai, e unë e përcolla atë telefaks ashtu siç ishte në Uashington. Fatbardhësisht e paskan injoruar, po thoshte Zefi. Ende e kam atë telefaks, mund t'jua jap kur të vini në Tiranë, përfundoi ai.

J. Sullivan, drejtori ekzekutiv i CIPE na gjeti të hutuar nga kjo që fliste Zefi, por shpejt morëm veten. I treguam se kemi përfunduar projektin dhe se kemi sjellë raportin studimor përmbledhës. Kur po ia dorëzonim mundëm të vërenim menjëherë se po i bënte përshtypje dizajni. Ia hodhi një sy përmbajtës, u falënderua. Ne ishim të prekur nga ajo që thoshte Zefi. Ai e pa këtë dhe për ta zbutur situatën po na thoshte

të mos i japim rëndësi kësaj, kryesore është se e kemi marrë projektin dhe se e kemi përfunduar aq mirë. Tash po e kuptonim se përse përfaqësuesi i Ambasadës amerikane kërkonte të takohej vetëm në zyrën tonë dhe atë pa përkthyes. Kur po e bisedoja njëherë këtë me A. Wilson, duke e pyetur se si e kishin trajtuar atë telefaks, ai duke buzëqeshur po më thoshte se ata merrnin informatë nga disa burime. Njëri nga burimet me influencë më të madhe kishte qenë Veton Surroi, i cili kishte folur në superlativ dhe sigurisht kishte pasur ndikim të fortë. Ata kishin biseduar edhe me udhëheqësin e Zyrës së Fondacionit Soros, Anton Berisha, i cili po ashtu kishte folur pozitivisht për kapacitetet tona dhe integritetin tonë etik e politik.

- Pas kësaj, tha ai, ne e kishim të qartë se telefaksi ishte tendencioz.

Të nesërmen në mëngjes, para se të fillonte punën konferenca, gjatë ngrënies së mëngjesit, Sullivan erdhi te tavolina jonë.

- E kam lexuar tërë natën studimin tuaj, tha ai. Jam impresionuar edhe nga përmbajtja por edhe nga fakti se keni mundur të prodhoni diçka të tillë në kushtet në të cilat veproni ju. E kam shoqe studimesh Medeleine Albright dhe me krenari të madhe do t'ia jap një kopje edhe asaj sapo të arrij në Uashington. Kur e kemi aprovuar projektin tuaj, ne nuk kemi pritur diçka të tillë - po vazhdonte ai. *Dua të ndryshoj agjendën e paralajmëruar të konferencës me një prezantim të projektit nëse ju jeni dakord.*

Natyrisht që ishim dakord. Prezantimi shkoi mirë, edhe pse e përgatitëm shpejt. Pati pyetje e komente të mira.

Biseda informative në Suboticë dhe promovimi në Budapest

Tash po merreshim me promovimin e rezultateve të këtij projekti më tutje, te faktorët politikë dhe ndërkombëtarë në Kosovë dhe mundësisht edhe jashtë Kosovës. Në fillim të dhjetorit mora një e-mail nga Alush Gashi, student në master në Shkencat politike në Universitetin e Evropës Qendrore (CEU) në Budapest. Ai na ftonte që të

bënim një prezantim të studimit tonë. E kishin parë studimin në faqen e internetit në CIPE, se kishte biseduar me profesorët dhe Alushi thoshte se ekzistonte një interes për këtë.

Në prezantim erdhën mjaft studentë nga Shqipëria, Serbia, Kosova (3-4), Kroacia, disa profesorë. Pati mjaft pyetje dhe përgjithësisht kaloi mirë sa për të arsyetuar gjithë këtë rrugë. Atje, përveç tjerëve takuam edhe Alush Gashin, Nexhmedin Spahiun, (tash analist dhe pronar i TV Mitrovica), Altin Ilirjanin nga Shqipëria (tash në sektorin e demokracisë në USAID në Washington D.C), Iva Zajmi (më vonë ishte zëvendësministre e Punëve të Brendshme në Shqipëri). Ndenjëm gjatë pas prezantimit me studentët. Pos Alushit dhe Nexhmendinit, Altini gjithsesi na la përshtypjen më të thellë për pjekurinë dhe mprehtësinë që shfaqte. Ai kishte edhe lidhje në OSI dhe tha se e kishte biseduar me sektorin e tyre për qeverisje lokale, se ata ishin të interesuar të studionin funksionimin e institucioneve të rezistencës aktive paqësore dhe ai kishte një ide lidhur me këtë. Propozoi që të nesërmen të bënim një takim me ta. I shpjeguam për propozimet që kishim dërguar dhe nuk po merrnim asnjë përgjigje. Ai na sugjeroi se do të ishte mirë ta takonim drejtoreshën Katalin Kontz dhe ta njoftonim për aplikimet tona. Ajo ato ditë nuk ndodhej në Budapest dhe pastaj provuam se nuk ishte lehtë të bëje termin për takim me të. Bashkë me Altinin, para se të ktheheshim, zhvilluam biseda për bashkëpunim me OSI në sektorin e qeverisjes lokale dhe të zhvillimit të arsimit të lartë. U shfaqën të interesuar për projektin lidhur me institucionet e rezistencës aktive paqësore, kërkuam të përgatisim propozimin e projektit. Gjithashtu nga Sektori i Mbështetjes së Arsimit të Lartë (HESP) kërkuam që të bënim një raport të shkurtër për Universitetin e Prishtinës dhe mënyrën e funksionimit të tij. Me këto dy projekte gati pas nja një muaji, me Muhamet Sadikun po shkonim përsëri atje ndërkohë që ishim ftuar edhe në një konferencë. Kisha aranzhuar një intervistë për një revistë që botohej në Budapest me fizionomi të ngjashme me 'Economist' dhe lexohet shumë, do të diskutonim propozimet për projektet e reja. E kishim bërë gati raportin për UP-në dhe do të gjenim një mënyrë për ta takuar Katalin Kontz. Gjithçka po shkonte mirë dhe sipas planit, por takimi me Katalin ngecte. Kryeredaktori i revistës hungareze pas bisedës na mori për drekë.

Duke u kthyer pyeta rastësisht mos e njihje Katalin Kontz, ngase na duhej takim me të lidhur me projektet që kishim në plan. Po, tha ai, çdo të tretën ditë jemi bashkë me familjet. E mori menjëherë në celular dhe i shpjegoi hallin tonë.

- A mund të shkoni në orën 3 në zyrën e saj?

Kjo i binte afërsisht pas një ore e gjysmë. E morëm me veti edhe Altinin, sinonim që ai të bëhej një lloj kontakti ynë atje. Katalin Kontz na impresionoi me pritje të ngrohtë dhe kujdes. Ia dorëzuam studimin që sapo kishim përfunduar dhe folëm për aktivitetet e planet tona dhe pastaj kaluam te propozimet e projekteve që u kishim dërguar, kishte më shumë se dy muaj dhe nuk po merrnim përgjigje. Ajo shikoi zëvendësudrejtorin Slobodan Nakarada, në një mënyrë si të kërkonte sqarim. Ai filloi të arsyetohej disi e midis të tjerash edhe duke na pyetur se si e kemi komunikimin në Zyrën Soros në Prishtinë, duke u munduar ta hedhë fajin atje. Soros më thërret gati çdo dy javë dhe porositi të lansojmë në Kosovë projekte të ngjashme me këto, e ne i kemi këtu dhe i neglizhojmë - komentoi me pezëm Katalin. Na falënderoi për vizitën dhe premtoi se do ta kemi vëmendjen dhe përkrahjen e tyre. Dhe vërtet shpejt projektet tona gjetën aprovim dhe bashkëpunimi i "Riinvest"-it me OSI ka zgjatur pothuajse gjatë gjithë kohës.

Deportimi nga Kosova dhe vazhdimi i punës së "Riinvest"-it në Tetovë

Në fillim të prillit 1999 në qendrën e Tetovës më shumë se dy të tretat ishin prishtinas dhe të tjerë nga Kosova, që kishin përjetuar deportimin e dhunshëm. Bashkë me Muhamet Sadikun krijuam si një lloj zyre të përkohshme të "Riinvest"-it te zyrat e Isakut në kompaninë "Fama Cola". I dërgova e-mail Andrew Wilson në CIPE në Uashington. I shpjegova se si ishte situata me ne dhe me "Riinvest"-in dhe se kishim ndërmend të vazhdonim punën në Tetovë, tani në projektet që kishim dhe të përgatisnim projektet për periudhën pasi të përfundonte bombardimi i NATO-s dhe Serbia t'i plotësonte kushtet që i kishte vënë NATO-ja. Andrew u paraqiti menjëherë duke shprehur gëzimin

se ishim mirë dhe duke shprehur gjithë mbështetjen e tij dhe duke ofruar çfarëdo asistence të nevojshme. Ai kishte lajmëruar edhe gjithë partnerët e CIPE-s për ne, se tash ishim në Tetovë. Shpejt u lajmërua Zefi (Preçi) nga Tirana, duke na ftuar atje, por ne më shumë preferonim të qëndronim në Tetovë. Shpejt morëm një zyrë me qira te Qendra Tregtare e Tetovës dhe hapëm llogarinë bankare në Bankën Komerciale.

Skenarë: Ballkani 2010

Filluan të na vijin edhe thirrjet për tubimet e ndryshme rajonale dhe të tjera. Qendra për Studime Liberale (CLS) dhe Instituti për Ekonominë e Tregut (IME) nga Sofja bashkë me Freedom House nga Uashingtoni kishin thirr një panel ekspertësh për t'i diskutuar skenarët e Ballkanit 2010. Udhëheqësit e këtyre dy 'think-tank', Ivan Krastev dhe Krassen Stanchev i kisha takuar shpesh në tubime gjithandej. Doja të merrja pjesë në këtë tubim por ne kishim probleme ta lëshojmë Maqedoninë pasi që kishim statusin e refugjatit. Duhej leje speciale nga Policia maqedonase. Arbër Xhaferi e dinte mirë rëndësinë e prezencës tonë në këto tubime, andaj pa përtesë u angazhua që t'i marrin lejet dhe dokumentet e duhura për këtë udhëtim. Angazhoi për këtë Arben Lufin, i cili më sa më kujtohet ishte zëvendësministër i Punëve të Brendshme. U nisëm me Muhametin. Kur arritëm në hotelin ku mbahej konferenca, ata pothuajse kishin mbaruar me darkën. Kishte vetëm dy karrige të lira. Njëra afër Predrag Simiqit dhe tjetra në anën e kundërt të tavolinës. Unë e mora këtë që ishte larg tij, e tjetra i mbeti Muhamet Sadikut. Ai shkoi e mori karrigen dhe erdhi e u ul afër meje. Kjo natyrisht nuk kaloi pa rënë në sy dhe pa bërë përshtypje. Predrag Simiqi ishte drejtor i Institutit apo Qendrës për Studime Strategjike të Serbisë, mjaft i përgatitur, qëndronte fort në vijën nacionaliste me një paketim pak më të kujdesshëm, por pa dallime esenciale nga qëllimet e Milosheviqit. U habita kur e pash aty, por edhe në Serbi në fakt vështirë gjeje sidomos në kohë të luftës të tjerë për t'i ftuar në këso lloj konferencash.

A ishte kjo liria?

Të nesërmen filloi kjo konferencë interesante. Neve na kushtonin shumë vëmendje, jo vetëm nikoqirët por edhe mediet. Kam dhënë mbi dhjetëra intervista atë ditë për mediet bullgare dhe të tjera. Konferenca përcillej edhe nga kori diplomatik që vinte nga rajoni. Aty ndjeva përherë të parë lirinë. Derisa po thosha se skenarët e Ballkanit 2010 varen nga pavarësia e Kosovës, cilësia e reformave ekonomike në rajon e sidomos nëse Serbia do të hiqte dorë nga politika e tashme dhe shprehite të tendencat e vjetra për ta dominuar rajonin. Përballë kisha ambasadorin jugosllav që tërë kohën merrte shënime, por po e ndjeja se ai asnjëherë nuk do të jetë më ambasador i shtetit që unë do t'i përkas, shënimet që ai do të dërgonte kësaj herë për çfarë thosha ishin irelevante për mua personalisht. Në Sofje po ndjeja diçka nga liria për herë të parë në jetë. E Simiqi vërtet i dëshpëroi keq me fjalimin e tij.

- Ne nuk jemi në luftë me NATON - tha ai. Neve na bombardon vetëm Amerika. Ja këtë pako cigaresh. Këtë ma dha para ca ditësh sekretari i dytë i Ambasadës kineze, i cili u vra me bombardimin amerikan. Kjo ndërmarrje është gabim i madh i Amerikës, po thoshte Simiqi, do të përfundojë me mospasje dhe me prishje të unitetit brenda NATO-s. Shumë vende të NATO-s do të kërkojnë të ndërpriten bombardimet.

Borshard: Një plan për organizimin e shërbimeve pas kthimit

Duhet të ketë qenë mesi i muajit maj 1999, kur Afrim Etemi pronar i Arda Rei, një nga partnerët e hershëm të "Riinvest"-it, më ftoi ta takonim Ben Borshard, atëherë më duket ishte në OSBE, më vonë ishte ambasador i Gjermanisë në Tiranë dhe shef i EULEX-it në Prishtinë. Borshard ishte i preokupuar me atë se si mund të organizohej jeta në Kosovë pasi të përfundonte lufta, të largohej Serbia dhe të ktheheshin refugjatët. Duhet organizuar shërbimet bazike publike- uji, energjia, prodhimi i miellit e bukës, transporti, tregtia, admin-



istrata, ndërtimi. Ai kërkoi që t'i përgatisnim një material, me një vlerësim tonin se si do të mund të ishte gjendja në këta sektorë dhe cilat ishin detyrat më urgjente për ta rifilluar funksionimin e këtyre shërbimeve publike elementare, jetike për jetën e përditshme të qytetarëve. Në Tetovë krijuam disa ekipe për t'i përgatitur këto propozime dhe i dërguam te Borshard. Kërkesa e tij ishte sinjal i mirë për ne. Do të ktheheshim shpejt në Kosovë.

Ato ditë morëm edhe ftesë nga CIPE dhe NED, Freedom House, German Marshall Fund për tubime të rëndësishme në Budapest që mbaheshin kah fundi i muajit. Duhet

edhe njëherë intervenimi i Arbër Xhaferit që të mund ta bënim atë rrugë. CIPE kishte një konferencë përmbyllëse të punës që kishte bërë gjatë një dekade për promovimin e reformave ekonomike dhe të ekonomisë së tregut në Hungari dhe po e mbyllte zyrën që kishte në Budapest. Ishte një rast i mirë që të shohim se si ka ecur tranzicioni në Hungari. Anrew Wilson dhe zëvendësudrejtori i CIPE-s, Stive Rogers dhe Jean Rogers, drejtoreshë e Zyrës në Budapest po shprehin një kujdes prekës gjatë tërë kohës për ne duke i ndjerë vuajtjet e Kosovës. Na thanë se kemi dashur që t'i shihni këto përvoja, por edhe të ndërroni atë mjedis prej refugjati. Tubimi i dytë ishte shumë i madh. Kishte pjesëmarrës nga i tërë rajoni i Evropës Qendrore dhe Lindore dhe nga gjithë shtetet që ishin krijuar nga ish-Jugosllavia. Bombardimet ende vazhdonin.

Të nesërmen gjatë konferencës po lexoja në 'Financial Times' tekstin e marrëveshjes që e kishte ofruar Marti Ahtissari dhe e kishte nënshkruar Milosheviqi, pasi siç thuhet Ahtissari i kishte thënë se ky ishte teksti më i mirë që do t'i ofrohej, versionet e ardhme do të ishin secili e më i pavoritshëm për të. Marrëveshja siguronte përmbushjen e plotë të kushteve që kishte vënë NATO-ja. Tërheqja e Policisë dhe Ushtrisë serbe nga Kosova do të fillonte më 9 qershor dhe po atë ditë Aleanca veriatlantike do t'i ndërpriste bombardimet dhe më 10 qershor NATO-ja do të hynte në Kosovë e kështu me radhë. Sasho Ordanoski, gazetar nga Shkupi po më komentonte: 'kjo duket goxha si një lloj kapitullimi, pak i habitur. Shumëkush nuk kishte mundur ta paramendonte se Milosheviqi do të gjunjëzohej në këtë formë. Ne po ktheheshim diku më 7 apo 8 qershor në Shkup. Më 10 dhe 11 qershor NATO-ja dhe UÇK-ja po shkonin drejt Prishtinës e menjëherë pas tyre edhe refugjatët. U nisëm bashkë me Isak Ajrullin me veturën e tij. Isaku pas gjithë atij kujdesi për më tepër se dy muaj, po kujdesej që të më kthente edhe në shtëpi. Përplot emocione. Po kalonim përherë të parë atë kufi pa Policinë serbe. Përgjatë rrugës shenjat e luftës. Shtëpi të djegura, kamionë të djegur, tollovi gjithandej. NATO-ja kishte prezencë të dukshme. Prishtina nuk ishte me shumë shenja të dukshme lufte, ashtu dukej nga jashtë. Ende nuk kishte internet e kjo ishte domosdoshme për komunikimin që na duhej lidhur me projektet që kishim nisur. Në këtë kohë pata edhe një udhëtim në Lubjanë. Ishte një konferencë e organizuar nga CEPS (Center for Economic and Political Studies) 'think-tank' nga Brukseli, i udhëhequr nga profesor Michael Emmerson, një ish-ambasador britanik në Moskë.

Politikat e rindërtimit

Diku rreth 10 korrikut në bashkëpunim me Friedrich Ebert Stiftung po mbanim ndoshta konferencën e parë në Kosovën e pasluftës dedikuar rindërtimit. Merrnin pjesë shumë ekspertë vendorë, UNMIK-u, organizata ndërkombëtare. Qeveria e përkohshme dhe Qeveria e Bukshit nuk kishin ardhur. Ekziston një përmbledhje e botuar e kontributeve për këtë konferencë. Salla e Kuqe e Pallatit të Rinisë ku po zhvillohej konferenca shprehte pak a shumë atmosferën e pasluftës, pikonte brenda nga shiu që binte. Një grup oficerësh të UÇK-së erdhi aty dhe kjo nuk kishte vetëm rëndësi simbolike.

Po përgatitnim një hulumtim – anketë me mostër respektabile (3500 familje), lidhur me pasojat e luftës me mbështetjen e DFID britanik, kishim në organizim e sipër edhe dy shkolla vere, një në Ohër dhe tjetrën në Prizren. Vazhdonim projektin me CIPE-n lidhur me edukimin për biznes si dhe OSI e Budapestit për përvojat e funksionimit të pushtetit lokal gjatë viteve '90, nëpërmjet institucioneve të rezistencës aktive veçanërisht lidhur me sistemin e financimit dhe të edukimit dhe arsimit. Pra kishim shumë punë, kishim hapur mirë frontin e punës. Në fillim të korrikut shkova në seli të UNMIK-ut me porosi të profesor Emerssonit, për ta takuar Joly Dickson, udhëheqësin e Shtyllës IV – ekonomia. Vuri në dukje studimin tonë që e kishte marrë më herët dhe tha se, ai ishte i vetmi burim në anglisht nga i cili kishim marrë informacione për ekonominë e Kosovës dhe mundësitë e zhvillimit të saj. Aty e njoha edhe bashkëpunëtorin e tij më të afërt dhe ndihmësin e tij, Renzo Daviddi. Të dy kishin qenë profesor të Economics-it dhe më premtuan se do të vinin për të dhënë një kontribut në shkollat tona verore. Në fillim të gushtit pas një trajnimit të më tepër se 50 anketuesve, me një pyetësor mjaft kompleks që përfshinte të dhënat demografike dhe migrimin, pasojat e luftës dhe deportimet nga shtëpitë dhe banesat, në pajisjet shtëpiake dhe të ekonomisë tjetër familjare, vetura, traktorë, fondin e bagëtive, plaçkitjet e sendeve të çmueshme dhe të parave, cili ishte perceptimi i tyre për rindërtimin dhe cilat ishin pritjet e tyre, po fillonim hulumtimin për pasojat e luftës. Anketa bëhej sipas metodave standarde të zgjidhjes së mostrës, ndërsa mostra e madhe, gati trefish më shumë se standardi ishte bërë për t'i evituar gabimet. Një anketë të ngjashme gjatë tetorit e bëme edhe me bizneset private. Veç kësaj themeluan 17 ekipe me ekspertë për

t'i vlerësuar dëmet në sektorin publik, në industritë kryesore që nuk përfshiheshin në anketën për ekonomitë familjare dhe bizneset private. Në këto 17 ekipe ne kishim angazhuar më tepër se 50 ekspertë, më të mirët që kishte Kosova. E gjithë kjo po mbështetej nga DIFID-i britanik. Mund të them se tash këto studime janë me një vlerë shumë të madhe dhe unike, ndoshta i vetmi dokumentacion i bazuar në metodologji shkencore lidhur me pasojat shumë të rënda të luftës. Anketa udhëhiqej në terren nga Naili dhe Ymeri. Ne kishim marrë një donacion për 25 kompjuterë nga USAID-i i Shkupit dhe tash aty, nga fundi i gushtit më shumë se 20 studentë po punonin në futnin e të dhënave nga anketa. Paralelisht me këtë studim ne kishim organizuar nga 8- 29 gusht shkollën e verës për ndërmarrësi, në të cilën përveç neve kishin dhënë mësim edhe 2 profesorë britanikë, 1 holandez dhe një amerikan. Dedikimi i 30 studentëve që sapo kishin përfunduar Ekonomikun ose do ta përfundonin shpejt ishte mbresëlënëse. Të gjithë ata do të punësohen shpejt në "Riinvest", organizata ndërkombëtare dhe bankat e para dhe thuaja që të gjithë edhe sot janë në pozita të larta. Ata i gjenim shpesh me profesorët mysafirë edhe në orën 2 të mëngjesit duke bërë detyrat e tyre dhe përgatitur prezantimet për ditën e nesërme. Të lutem thuaju të shkojnë të pushojnë, po më thoshin James Skyrmes dhe Ger Yonkergouw, dy profesorë të shkëlqyer dhe miq të "Riinvest"-it që vinin nga Maastricht-i. Por studentët as që donin të dëgjonin të linin punën para se të bënin gjithçka duhej që të nesërmen të ishin të përgatitur. Ishin të përfshirë nga entuziazmi për jetën e re në liri dhe gjithë ato mundësi që u hapeshin. Me përkushtimin, inteligjencën dhe potencialet nuk ishin prapa moshatarëve të tyre në Evropë. Edhe atëherë, si edhe sot, krenohesha me ta.

Andrew Wilson nga CIPE erdhi kah fillimi i shtatorit të na vizitojë dhe të njihet nga afër me pasojat e luftës. Me Wilson dhe Muhamet Sadikun dhe vetë po bëja për herë të parë një vizitë në Kosovën e pasluftës. Kisha qenë i zënë me Shkollën e Verës në Ohër dhe aktivitetet e tjera. Po udhëtonim me të për në Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Dëmet në Pejë dhe Gjakovë ishin shumë të mëdha dhe pasojat shkatërruese. Prizreni fatmirësisht ishte ruajtur, me përjashtim të kompleksit të Lidhjes së Prizrenit. Barbaria e makinerisë ushtarake serbe ishte e dukshme e shkatërrimtare. Wilson bënte shumë fotografi. Kishte gjithandej shumë rrëime, por kishte edhe më shumë entuziazëm dhe energji për rindërtim, për t'i evituar pasojat e luftës dhe vetëndërtuar jetën. Kur u kthyem atë

natë në zyrat e "Riinvest"-it që tash ndodheshin përballë Grandit në qendër, aty erdhën edhe drejtori i Freedom House, Peter Wibler dhe drejtori për Evropë i German Marshal Foundation, Pavol Demesh (ish-ministër i Punëve të Jashtme të Sllovakisë). Edhe ai kishte bërë shumë fotografi sikurse Wilson. Do të kthehem pas 10 vjetësh, tha ai, në të njëjtat vende dhe do të provoj t'i fotoj të njëjtit njerëz. Ide interesante. Pas gjithë atyre shkatërrimeve, varrezave dhe vuajtjeve njerëzore që kishte fotografuar, atij i bënë shumë përshtypje ata 25 studentë që po i futnin të dhënat e mbledhura nga terreni lidhur me hulumtimin e pasojave të luftës. Bëri shumë foto. Nga kjo kohë na mbeti një miqësi me të gjithë dhe kuptohet edhe me Demesh, që është një mik i Kosovës aspak i kënaqur me politikën e qeverisë së vendit të tij lidhur me njohjen e pavarësisë së saj. Derisa po bisedoja me Wibler dhe Demes, Wilson po shkruante në njërën nga kompjuterët. Pas një ore ai po jepte një koncept për një projekt që duhej ta realizonin ne dhe CIPE. Ideja ishte që "Riinvest"-i të bëjë studime mbi aspektet kyçe ekonomike të rindërtimit të pasluftës dhe reformave ekonomike dhe t'i promovojë ato. Të krijojë një Bord autoritativ këshillëdhënës nga bizneset dhe akademika që do t'i përcaktojë temat e studimeve. Të bëhen raportet studimore për këto tema në shqip dhe anglisht. Të formojë një forum ndërkombëtar që përfshinte akterët ndërkombëtarë, partitë politike, bizneset dhe shoqërinë civile për t'i diskutuar gjetjet dhe rekomandimet.

- Ju do të qeveriseni nga UNMIK-u. Ajo është një makinë e rëndë burokratike, ju duhet ta zgjoni dhe bëni opozitën, filloi të sqarojë idenë e tij Wilson. Zëri i kosovarëve duhet të dëgjohet edhe para se të zgjedhen institucionet, po e arsyetonte këtë ide shumë interesante Wilson.

Nga mesi i shtatorit fillonim shkollën tjetër verore për një grup tjetër prej 30 të rinjve për Ekonomi e Financa. Po zinin vetëm pak ditë të asaj vere sa për ta arsyetuar epitetin shkollë vere. Edhe këtu profesorët ishin të shumtën nga Britania dhe gjithçka bëhej në gjuhën angleze. Kur po shkoja atë mbrëmje para se të fillonim me punë, derisa kisha kaluar Suharekën, Therandën si quhej tani, më kishin kapluar emocione të forta. Prizreni, historik e antik, tani ishte i lirë nga zgjedha serbe. Ishim vendosur në Hotel 'Theranda', ende të pakonsoliduar dhe ende me erë lufte. Ligjëratat, seminarët dhe diskutimet që zgjatnin gati tërë ditën i bënë në një restorant në Marash. Ora policore më duket fillonte



Ilaz Ramajli dhe Isa Mustafa në konferencën e riinvestimit në Prishtinë, 2000.

nga ora 8 e mbrëmjes-deri 6 në mëngjes. Në Prishtinë nuk kishte fare orë policore, por këtu gjithçka komandohej nga KFOR-i gjerman si pjesë e NATO-s dhe ata nuk i lënin asgjë rastit. Në këto kushte kishte vështirësi pak a shumë për të organizuar gjithçka në nivelin e kërkuar. Dy profesorët që bartën pjesën më të madhe të programit – Iraj Hashi profesor nga Staffordshire University dhe Will Barttlet, profesor nga Universiteti i Bristolit, e tash në London School of Economics, do të bëhen miq të "Riinvest"-it. Një pjesë të kursit e mbuluan edhe Joly Dickson dhe Renzo Daviddi. Sidomos me profesorin Iraj Hashi do të fillonim shumë projekte, të cilat vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Në vizitën e radhës në Uashington pas një takimi konsultativ të liderëve të forcave politike dhe shoqërisë civile të Kosovës, ku bisedohej se si do të dukej e ardhmja e Kosovës, u desh t'i prezantoja rekomandimet e tubimit para znj. Albright. Ajo premtoi mbështetjen e Qeverisë amerikane në rindërtimin e pasluftës, në reforma ekonomike dhe ndërtim të institucioneve demokratike. Dukej se partneriteti do të vazhdojë edhe në paqe dhe përkujdesja e ShBA-së do të vazhdonte. Pas kësaj CIPE kishte bërë një program të veçantë. Duket se edhe ata kishin fituar një kredit të veçantë për punën që kishim bërë me "Riinvest"-in në Kosovë. Ato ditë J. Sullivan dhe A.Wilson kishin botuar një artikull lidhur me "Riinvest"-in në 'Washington Times'. Kjo ishte një kohë e artë e bashkëpunimit tonë me CIPE. "Riinvest"-i ishte adresë e paevitueshme në Prishtinë.

"Riinvest"-i në rol të ri

"Riinvest"-i kishte shumë punë. Ilaz Ramajli dhe Isa Mustafa, pas kthimit nga ekzili, nuk ishin aktivë në jetën politike, andaj dhe duke i njohur potencialet e tyre i thirra që të vinin të na bashkoheshin në "Riinvest", njëri si nënkryetar (Isa) dhe tjetri si drejtor administrativ (Ilazi). Kjo forcoi mjaft përbërjen tonë. Po bënim punë në disa fronte. Puna më e madhe po bëhej në analizimin e të dhënave të mbledhura lidhur me pasojat e luftës dhe strategjinë dhe politikën e rindërtimit të pasluftës, përgatitjen e raportit përkatës të cilin mendonim ta prezantonim në një konferencë të madhe ndërkombëtare. Gjithçka ishte bërë gati dhe konferenca do të mbahej në shkurt të vitit 2000. Konferenca vërtet ishte madhështore. Tuboi mbi 200 pjesëmarrës nga vendet e ndryshme dhe faktorët më të rëndësishëm politikë, akademikë dhe të shoqërisë civile nga vendi. Prezencë të madhe kishin edhe aktorët kryesorë në krizën kosovare, amerikanët, anglezët dhe gjermanët, faktorët politikë kosovarë si dhe shumë profesorë e miq që kishim krijuar. Në konferencë ishin shumë aktivë Joly Dicskon dhe Renzo Daviddi. Konferenca do të mbahet mend edhe për një paraqitje shumë të mirë të Nicolas White nga CEPS (Qendra për Studime Politike e Brukselit), i cili tha se më parë nuk kishte menduar kështu, por ajo çfarë kishte dëgjuar në këtë konferencë e kishte bindur se përfundimisht Kosova duhet të bëhet e

Në fund të projektit për "Riinvest"-in punonin rreth 30 hulumtues me studime të përfunduara të paktën në nivel master, të shumtën jashtë vendit nga fusha e ekonomisë, biznesit, teknologjisë informatike.

pavarur dhe këtë e tha hapur në panel. Në këtë konferencë do t'i shohim çarjet e para midis "Riinvest"-it dhe Administratës ndërkombëtare lidhur me politikat ekonomike, me karakterin e pronës shoqërore të Kosovës dhe të drejtën e Kosovës që ta qeverisë e ta privatizojë atë njësoj sikurse edhe gjithë entitetet e tjera të ish-Federatës jugosllave. Që nga kjo kohë "Riinvest"-i do të shihet si një opozitë e UNMIK-ut dhe, kështu që një pjesë e UNMIK-ut dhe të bashkuar me disa kosovarë do ta zhvillojnë në vazhdim propagandën kundër "Riinvest"-it, si një Institut pak a shumë nacionalist dhe "tepër kosovar". Kjo rrymë ishte e fuqishme sidomos në Agjencinë Evropiane për Rindërtim dhe sponsorizohet nga një grup vendorësh dhe ndërkombëtarësh. Ndërkohë që rekomandimet tona për politikat ekonomike dhe reformat e nevojshme ekonomike hasnin kryesisht në një mirëkuptim tek USAID-i. Nuk kishim asnjë sforcim nga CIPE ose USAID-i lidhur me qëndrimet tona. Ato, thjesht, shkonin në një vijë.

Kontrata e parë me USAID: 20 raporte studimore

Në vjeshtë të vitit 2000 në CIPE dhe "Riinvest" lidhëm një kontratë dyvjeçare me USAID-in, që në fakt për bazë kishte konceptin që e zhvilloi A.Wilson atë natë që po ktheheshim nga vizita në Pejë dhe me plot përshtypje të rënda për shkatërrimet e luftës. Por tash zgjerohej edhe me një fuqizim të asociacioneve të biznesit të cilët ne do t'i ndihmonim, do të siguronim një asistencë të fuqishme teknike për ndërtim të

kapaciteteve të "Riinvest"-it dhe që do t'i kontribuonte zhvillimit dhe fuqizimit institucional të "Riinvest"-it. Ky projekt do të zgjasë edhe për dy vjet të tjera gjatë periudhës 2002-2004, duke i kontribuar hartimit dhe publikimit në shqip dhe anglisht të rreth 20 raporteve studimore lidhur me çështjet më vitale të zhvillimit të Kosovës, formimit dhe konsolidimit të AKB-së (Aleanca Kosovare e Bizneseve), rritjes së ndjeshme të kapaciteteve të "Riinvest"-it dhe forcimit të pozitës së tij në shoqëri. Në fund të projektit për "Riinvest"-in punonin rreth 30 hulumtues me studime të përfunduara të paktën në nivel master, të shumtën jashtë vendit nga fusha e ekonomisë, biznesit, teknologjisë informatike.

Universiteti Staffordshire dhe Iraj Hashi

Ndihmesë të madhe në zhvillimin e kapaciteteve pati edhe bashkëpunimi me Staffordshire University (BM), i krijuar nëpërmjet profesor Iraj Hashit, duke e krijuar edhe një mbështetje nga Fondacioni Soros për dhënie të bursave. Ky projekt i filluar diku më 2001 vazhdon edhe sot dhe që atëherë kanë diplomuar më shumë se 80 veta në master dhe rreth 205 prej tyre në studimet e doktoratës. Ata kanë krijuar një masë kritike të mendimit modern ekonomik në Kosovë. Shumica prej tyre kanë punuar ose ende punojnë në "Riinvest", ose janë të lidhur me të në kërkime e mësimdhënie. Për këtë profesor Hashi është dekoruar nga Mbretëresha Elizabet, për kontribut në Kosovë. Unë e prof. Muhamet Sadiku e shkruam propozimin dhe arsyetimin për këtë me iniciativën e

Ambasadës britanike në Prishtinë. Veç bursave që u jepte Fondacioni Soros nëpërmjet programit të tij për mbështetjen e arsimit të lartë HESP, deri vonë edhe "Riinvest"-i u jepte një pjesë të pagës për t'i mbështetur familjet e tyre pasi shumica e tyre vinin prej familjeve në nevojë. Shumica prej tyre kanë mbetur korrektë dhe kur kanë shkuar nga "Riinvest"-i, për të punuar, të shumtën për organizata ndërkombëtare por edhe gjetiu.

Duke i ikur një sekuençe kronologjike në vazhdim do të prezantoj disa nga fushat në të cilat u angazhua "Riinvest"-i me kërkime të tija dhe që u bënë edhe objekt i një diskutimi të gjerë. Ky diskutim në një mënyrë vazhdon ende me gjithë implikimet e zgjidhjeve të bëra, të shumtën nga UNMIK-u dhe bashkësia ndërkombëtare.

Privatizimi

Shumica e vendeve në tranzicion, tashmë pothuajse kishin përfunduar privatizimin duke zbatuar përvoja dhe modele të ndryshme. Kosova ballafaqohej me dilema të mëdha dhe pengesa të ndryshme për fillimin e këtij procesi. Fundi i luftës e kishte gjetur me rreth 500 ndërmarrje shoqërore dhe publike, të cilat po tentonin ose rifillonin punën. Punëtorët dhe menaxhmenti i atyre ndërmarrjeve, të cilët regjimi serb i kishte përjashtuar nga puna dhe shkarkuar nga pozitat menaxheriale para se të instalonte me forcë strukturat e tij, po ktheheshin aty ku kishin punuar deri në shtator 1990. Qeveria e Përkohshme e Kosovës kishte marrë mbi vete administrimin e këtyre ndërmarrjeve, i kishte shpall ato pronë shtetërore dhe kishte intervenuar në shumë raste për ndryshim të ekipeve menaxheriale. Pas një kohe kur edhe pushuan së ekzistuari të dy qeveritë e ndara të Kosovës, kur u krijuan departamente për çështje të ndryshme ekonomike në kuadër të Shtyllës IV të UNMIK-ut, ndërmarrjet publike e shoqërore u futën në kompetencë të Departamentit të Tregtisë dhe Industrisë. Aty krahas udhëheqësit ndërkombëtar kishte edhe bashkëkryesues dhe koordinatore vendorë por kompetencat reale shkonin me ato të shefit të Shtyllës IV të UNMIK-ut, që rëndom vinte nga BE-ja. Diskutimet lidhur me fillimin e procesit të privatizimit i kishim nisur që para çlirimit me projektin tonë. Kishim shtruar domos-

donë e privatizimit dhe kishim propozuar edhe modele, të cilat do të mund të ishin të zbatueshme në Kosovë dhe me efekte përkatëse në zhvillim ekonomik. Mirëpo, UNMIK-u dhe bashkësia ndërkombëtare, duke përjashtuar amerikanët, hezitoin t'i hynin këtij procesi. Ata kishin një keqkuptim të thellë lidhur me natyrën e pronës shoqërore dhe kompetencat e njësive federale të ish-Federatës jugosllave, pra edhe të Kosovës, për ta qeverisur këtë pronë brenda kufijve të tyre. Ata niseshin nga një keqkuptim se prona shoqërore ishte një derivat i pronës shtetërore dhe meqenëse Kosova nuk ishte shtet edhe nuk kishte pronë shtetërore. Ata nuk e thoshin këtë hapur, por e lënin të nënkuptohej se këto të drejta mund të shkonin me Serbinë, ose së paku Serbia mund të kishte një hise në këtë. Joly Dickson, njëri nga udhëheqësit më korrektë dhe shumë profesionistë të UNMIK-ut ishte i zhytur në këtë hall dhe ishte i disponuar që të gjente një mundësi për ta filluar privatizimin me gjithë kundërshtimeve që bënin Serbia dhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare. Ai dhe zëvendësi i tij, Renzo Daviddi do të përgatisin një raport të njohur si "Letra e bardhë", ku po angazhoheshin për të shkuar përpara me privatizimin. Mirëpo, diku nga fillimet e këtij teksti ata kishin vënë një fjali që minonte gjithë qëllimin e tyre. "Prona shoqërore në Kosovë është e paqartë...". Në një darkë me Renzon dhe profesor Will Bartlett nga Universiteti i Bristolit, e kishim diskutuar para se të dilte 'Letra e bardhë'. Po i sqaroja Renzos se kompetencat e Kosovës rreth pronës shoqërore kishin qenë të njëjta si e të gjitha njësive tjera të asaj federate, duke përfshirë edhe Serbinë, ndaj Serbia nuk kishte bazë juridike për kurrfarë interference në këtë çështje. Ai nuk bindej dhe në një moment Will Bartlett intervenoi: Renzo, më duket se Muhameti ka të drejtë. Renzo nuk kundërshtoi më. Will kishte autoritet dhe merrej në ato qarqe edhe si njohës i sistemit specifik ekonomik të ish-Jugosllavisë të bazuar në vetëqeverisjen jugosllave. Mendova se kjo do të mjaftonte që Renzo të dilte nga ky keqkuptim. Andaj u befasova kur në 'Letrën e bardhë' e pash këtë fjali, e cila i ulte vlerën një projekti me ide të mira dhe në fakt e minonte atë. Sepse si mund të privatizohej diçka që nuk ishte e qartë, që do të thotë se nuk i dihej mirë pronari. Kjo ishte shumë serioze ngase dëmtonte thelbin e sovranitetit të Kosovës. Duke mbështetur idetë e tjera në 'Letrën e bardhë', këtë fjali "Riinvest"-i e kritikoi ashpër. Pak më

PAGE B4 / SUNDAY, JULY 25, 1999 *

The Washington Times

JOHN SULLIVAN / ANDREW WILSON

As American and European leaders continue to discuss the framework for reconstruction in Kosovo and the Balkans, much attention is being paid to the lessons previously learned from other large-scale political upheavals.

Whether it's the reconstruction of the post-Marcos Philippines, the transitions in Central and Eastern Europe or the more recent efforts in Bosnia, one of the key lessons to be learned is that local stakeholders must be in the forefront of reconstruction.

Without the direct involvement of the people of Kosovo in the planning effort, international aid runs the risk of being viewed as an imposed set of priorities, plans and structures, lacking reference to the economic, societal and cultural conditions in Kosovo.

To avoid such pitfalls, the international community must engage representative private organizations from the earliest possible stage to ensure the objectives of the redevelopment process match the aspirations of those that are most affected. Fortunately, over the last three or four years, a number of Kosovar nongovernmental organizations (NGOs) have emerged as leaders with strong links throughout the local community and experience in working with international organizations.

For several years, we at the Center for International Private Enterprise have been privileged to work with one such courageous group in Pristina, the Riinvest Institute.

Despite the oppressive conditions within Kosovo during the 1990s, Riinvest managed to produce the first and only economic analysis of Kosovo and a concrete blueprint for Kosovo's inclusion into regional and European trade structures. Much of the recent analysis and planning for Kosovo we read about today was recommended by Riinvest a year before the recent conflict began. Muhamet Mustafa and his col-

Reconstructing Kosovo



laboring narrowly escaping arrest by death squads, the core of Riinvest's staff escaped to Macedonia, where with the assistance of local colleagues they quickly established an office in exile. Riinvest researchers immediately set to work salvaging their programs, planning for their return to Kosovo and engagement in its reconstruction.

Based on their existing knowledge of Kosovo and the shared experiences of their colleagues and others, Riinvest's researchers have already created a strategy for Kosovo reconstruction that deserves to be heard by those international players currently planning its redevelopment. Key to the Riinvest strategy is the active engagement of the local population not only in the physical reconstruction of the coun-

entrepreneurial. Riinvest highlights five critical strategic objectives for Kosovar reconstruction:

- (1) Creating and then strengthening Kosovo's economic independence from Serbia, through economic reconstruction and development within regional, European and other economic integration structures.
- (2) Maximizing the use of the labor-capable population through dynamic development.
- (3) Mobilization of the natural, human and financial development potentials of the population by creating a system of free markets and entrepreneurship as a fundamental philosophy of development.
- (4) Strengthening civil society institutions.
- (5) Incorporation in technologi-

were unable to participate in government or industry, and where economic policy was based on wealth extraction rather than creation. Ironically, these weaknesses have contributed to Kosovo's strengths in reconstruction, which if well used may help in avoiding a repeat of the problems of previous reconstruction efforts.

The effects of Serbian domination on Kosovo's civil society are well documented. During that era, Albanians formed parallel institutions in health care and education; an independent media flourished, and the seeds of democracy—while fragile—were planted.

In the economic sphere, Albanian exclusion from the traditional engines of economic growth forced individuals to become entrepre-

adverse conditions and therefore are well-placed to actively participate in all phases of reconstruction. No one would discount the importance of international support and leadership in Kosovo's reconstruction. To the contrary, Kosovars view international support as critical to establishing long-term stability, by providing a framework in which democracy and civil society can develop, and in which reconstruction and economic reform can be coordinated.

The Riinvest strategy, however, does emphasize that the key to Kosovo's long-term stability and viability is the creation of an entrepreneurial class that has access to new regional markets and domestic policy supportive of private sector growth. These are the factors that have proven to be the downfall of private sector growth in Bosnia and have continued to foster regional instability. Kosovo is at a crucial turning point.

The albatross of the former regime has been removed and attention is now focused on humanitarian assistance. However, it is unclear whether either the leadership of the KLA's new political wing, the PDU, or the previous shadow government of Ibrahim Rugova possess the philosophical and political will to pursue market-oriented reform. International support for independent pro-market groups, such as Riinvest, is therefore essential.

Such support will ensure that Kosovars can play a leading role in the development of a market economy in Kosovo. It will also strengthen the prospects that democratic dialogue in Kosovo occurs. Both are essential to growing an entrepreneurial economy by restoring business confidence and creating conditions for Kosovar businesses to participate in reconstruction.

John D. Sullivan is executive director and Andrew Wilson is Central and Eastern Europe program officer for the Center for Interna-

JUL-26-1999 09:36

CIPE WASHINGTON

P. 02/02

vonë, në vjeshtë të vitit 2000, kur "Riinvest"-i dhe CIPE e Uashingtonit nënshkruan kontratë me USAID-in për projektin e kërkimeve dhe debateve lidhur me reformat ekonomike e sociale në Kosovë, privatizimi ishte në epiqendër të kërkimeve dhe përpjekjeve tona. Në dy vjetët vijuese bëmë një analizë të gjendjes së ndërmarrjeve shoqërore. Diku më shumë se 60% e tyre ishin aktivizuar, duke punuar me një kapacitet 20-60% me një tendencë përmirësimi. Megjithatë, ishte e qartë se duheshin investime të mëdha në përmirësimin e teknologjisë dhe menaxhmentit. Ato investime mund të vinin vetëm me privatizim. Andaj, ne filluam të llobojmë dhe avokojmë fuqishëm për këtë. Përveç anës ekonomike ishte edhe aspekti tjetër, ai politik i ndërlidhur me statusin e Kosovës dhe pretendimet serbe. Faktori politik i Kosovës ishte shumë pasiv në këtë çështje. Vendosëm të provojmë dhe mundësisht ta bëjmë më të interesuar. E prezantuam problemin në një informatë të shkurtër me gjithë dimensionin ekonomik dhe politik dhe kërkua që të gjitha partitë politike të hartojnë një deklaratë të përbashkët me të cilën kërkonin nga UNMIK-u dhe faktorët e tjerë ndërkombëtarë që të fillojë privatizimi. Organizuam një seri diskutimesh, ku kishim angazhuar edhe profesor Iraj Hashi si konsulent tonin. Iraj ishte ekspert i tranzicionit dhe privatizimit dhe kishte doktoruar në sistemin ekonomik të ish-Jugosllavisë. Pikëpamjet tona dhe të profesor Hashi ishin identike, por ai si ekspert ndërkombëtar ishte i dobishëm për të forcuar kredibilitetin tonë. Bëmë një material prej 10 faqesh, ku shkurt e përshkruam problemin, zgjidhjet e mundshme, pasojat ekonomike e politike dhe kërkua unitet të faktorit politik në këtë çështje. Zhvilluam biseda me secilin nga liderët partiakë. Me keqardhje konstatuam se përveç Presidentit Rugova, asnjëri nuk e kishte lexuar atë material të shkurtër dhe ndonëse nuk e kundërshtuan hapur një deklaratë të përbashkët për këtë çështje, kjo nuk ndodhi. Duke e mbajtur këtë çështje vazhdimisht të hapur dhe me debate, duke bërë presion tek UNMIK-u bashkë me USAID-in për të filluar privatizimi, duke kundërshtuar operacionet gjysmake siç ishte ajo e komercializimit të pronës ose forma të ngjashme me ish-vetëqeverisjen socialiste. Në maj të vitit 2002, UNMIK-u nxori Rregulloren për AKM-në (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit), me të cilën e formonte këtë Agjenci dhe e autorizonte atë të bënte privatizimin nëpërmjet shitjes, siç thuhej me një procedurë transparente,

për ofertën më të mirë të shprehur me çmimin më të lartë. Kjo ishte relativisht mirë, por ky akt kishte megjulluar pronësinë. Atë e kishte lënë të "paqartë", andaj fondet e krijuara nga shitja do të mbeteshin të ngrira, jashtë funksionit ekonomik, në llogari të ndara për secilën kompani derisa të zgjidheshin të gjitha kërkesat e kreditorëve ose pretendentëve tjerë të pronës. Kjo ishte krejtësisht e padrejtë, andaj e kundërshtuam me shumë argumente, por UNMIK-u dhe të tjerët nga bashkësia ndërkombëtare nuk mërzhiteshin shumë për këtë punë. Fatkeqësisht, kështu vepronin edhe akterët politikë në Kosovë, të cilët edhe ashtu nuk ishin të preokupuar me problemet ekonomike, aq më pak kur duhej të konfrontoheshin me përfaqësues të caktuar të bashkësisë ndërkombëtare. Në qershor të atij viti organizuam një Konferencë të madhe ndërkombëtare lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, me më shumë se 200 pjesëmarrës vendorë dhe ndërkombëtarë, me ekspertët më të njohur nga Evropa Qendrore (Polonia, Çekia, Hungaria), Sllovenia, Mali i Zi, Shqipëria, pastaj me ekspertë nga Britania e Madhe, Gjermania dhe ShBA-ja. Gjatë përgatitjes së konferencës, para fillimit të saj, "Riinvest"-i përgatiti dhe prezantoi një analizë të gjerë të kontekstit në të cilin po bëhej privatizimi, argumentet se Kosova ka pasur dhe duhet të ketë ingerenca të plota për ta zbatuar privatizimin dhe se ishin të panevojshme dhe të dëmshme zgjedhjet speciale për ngrirje të fondeve që krijoheshin nga privatizimi. Ne gjithashtu ishim edhe në favor të privatizimit të pjesshëm të ndërmarrjeve publike. USAID-i (amerikanët) dhe britanikët, ndonëse pajtoheshin me argumentet tona e shihnin më të rëndësishëm faktin se privatizimi do të zhvillohej dhe si çmim për këtë ishin pajtuar me këtë ngrirje fondesh që vërtet ishte dhe mbetet një nonsens ekonomik. Në konferencë u prezantuan rezultate shumëvjeçare të kërkimeve të shkencëtarëve eminentë, rezultate këto edhe teorike që ishin verifikuar me sukseset dhe dështimet e privatizimit në shumë vende të Evropës Qendrore e Lindore. Por përfaqësuesit e UNMIK-ut ende mbeteshin të ngarkuar me paragjykimin për pronën e Kosovës.

“Riinvest”-i hodhi poshtë konceptin e Marie Fucit për privatizimin

Serbia vepronte me tërë fuqinë e vet propagandistike se gjoja, me fillimin e privatizimit në Kosovë po shitej prona e saj, po shkelej Ligji ndërkombëtar, se ajo e kishte krijuar atë pronë dhe investimet në të ishin të saj. E gjithë kjo ishte larg realitetit, mirëpo disa qarqe të bashkësisë ndërkombëtare dhe një pjesë e Administratës ndërkombëtare ndikoheshin nga kjo, frikoheshin nga pasojat e mundshme juridike, ose thjesht punonin për interesat serbe. Nën ndikimin e kësaj propagande, pasi që filloi privatizimi me një raund gjatë verës së vitit 2012, në vjeshtë u ngadalësua dhe u ndërpre tërësisht. Me këtë Serbia donte të thoshte se prona e Kosovës është e saj, ajo nuk mund të privatizohet andaj rrjedhimisht nuk ka për çfarë të bisedohet as për statusin që përfshin pavarësinë e saj. Pikërisht në këtë kohë të propagandës intensive nga Serbia, në AKM (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit) kishte ardhur një drejtoreshë me emrin Marie Fuci, e cila pothuajse ishte bërë zëdhënëse e propagandës serbe këtu dhe praktikisht e ndërpreu zhvillimin e privatizimit. Edhe udhëheqësi i ri i Shtyllës IV të UNMIK-ut, Lambsdorf ishte indolent dhe nuk i bëhej vonë për makinacionet e kësaj të parës. Ne e kishim në zhvillim e sipër projektin me USAID-in që lidhej me çështjet e reformave ekonomike. Unë propozova që të përgatisim një analizë rreth koncepteve të M. Fuci dhe ndryshimeve që proklamonte ajo, të organizojmë një tryezë të Forumi 2015, debat të hapur publik, i cili do të transmetohej direkt në KTV dhe në këtë mënyrë këto koncepte të mbrapshta do t'i ekspozonim para presionit të medieve, ekspertëve dhe opinionit. USAID-i ishte përkrahës i kësaj qasjeje. Brenda një kohe të shkurtër bashkë me prof. Iraj Hashin, diku në pranverë të 2003-s po e përgatisnim këtë analizë, e cila prezantonte dëmet që po bëheshin nga puna e UNMIK-ut dhe AKM-së dhe paqëndrueshmërinë e koncepteve dhe dilemave që shtronte Marie Fuci. I shkrova një letër dhe me mirësjellje e thirra që të vinte në debatin tonë dhe të prezantonte pikëpamjet e saj. Ajo në fillim e pranoi ftesën tonë, andaj edhe e futëm në agjendë, që ajo, unë dhe profesor Hashi t'i prezantonim pikëpamjet para se të hapej debati. Pak para fillimit të punës, rreth 10 minuta më herët, Ahmet Shala, që ishte një zëvendës i saj, erdhi dhe

më tha se ajo nuk mund të vinte dhe se e kishte ngarkuar atë të prezantonte fjalën e saj, atë që ajo do të thoshte. Ai më tha se i duhej të prezantonte ato koncepte, me të cilat nuk pajtohej nëse ne nuk ishim kundër. E mendova dhe prapë thash më mirë të dëgjojmë opinionin për ato mendime të mbrapshta. I thash në rregull. Ahmeti paraqiti prezantimin e AKM-së, duke u kufizuar se ato ishin mendimet e shefes së tij, e jo të tijat personale. Profesor Hashi dhe unë e bëmë një kritikë të argumentuar të atyre me punimin e titulluar: “Privatizimi në Kosovë, një hap para, dy hapa prapa”. Debatimi më tutje, i cili përfshiu kolegun që ishte ministër i Tregtisë dhe Industrisë, profesor Ali Jakupi, Vetoni, profesor Selman Selmanaj, profesor Muhamet Sadiku e shumë të tjerë e ekspozuan AKM-në me një kritikë të ashpër. E gjithë kjo ishte në transmetim ‘live’ në KTV. U pa se nuk do të mund të qëndronin më tutje konceptet dhe sjelljet e M.Fuci dhe vërtet ajo shpejt u largua. Drejtori i ri, G. Dick, dhe pas një kohe edhe shefi i Shtyllës IV, Joakim Rucker e ndërruan kursin dhe vazhduan me këtë proces, me dobësitë e tij përcjellëse, por këta ishin shumë më konstruktivë dhe kooperativë. Rucker në fakt ka punuar për krijimin e pavarësisë ekonomike të Kosovës dhe me të kemi bashkëpunuar mirë. Disa mendojnë se privatizimi nuk është dashur të ndodhë. “Riinvest”-i mendonte dhe unë mendoj edhe tash, se ai ka qenë i pashmangshëm. Ka pasur edhe rëndësinë e tij të madhe politike lidhur me statusin. Janë bërë lëshime e keqpërdorime e ndoshta edhe kurdisje midis blerësve si dhe midis blerësve dhe shitësve, të cilat fatkeqësisht në shoqërinë tonë mbetin të padënuara. Pajisjet dhe teknologjia edhe ashtu kanë qenë të vjetruara dhe pa shumë vlerë, por ajo që është shitur lirë është toka, toka bujqësore dhe toka përreth fabrikave dhe ndërmarrjeve tjera. Në fakt ky është një dëm edhe ashtu nominal, pasi dëmi rreth çmimit e vlerës së shitur në kuptimin real bëhet jo shumë i rëndësishëm, kur edhe ashtu fondet e shitjes ende mbeten të ngrira me përjashtim të 20% që u paguhen punëtorëve menjëherë pas shitjes. Por ka edhe shembuj firmash që ishin në kolaps, e të cilat investitorët privatë i kanë aktivizuar. E fakti tjetër më me rëndësi është se, Serbia e humbi betejën me propagandën e vet rreth pronës dhe privatizimit në Kosovë. Pikërisht ky mik, kishte bërë që një Raport studimor më të vonshëm mbi efektet e privatizimit në Kosovë e titulloam: “Privatizimi në Kosovë, një gotë gjysmë bosh apo gjysmë e mbushur”.



Juergen VOSS
Deputy Heads of Pillar IV
UNMIK

Ekrem BEQIRI
President of the Board
KFOS

“Forumi 2015”

Në fillim të vitit 2002, pas disa iniciativave që kishte marrë Isuf Berisha, siç e thash edhe më lartë, KFOS- Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (i përfaqësuar nga Luan Shllaku dhe Isuf Berisha), KACI – Aksioni Kosovar për Iniciativa Civile (Veton Surroi dhe Ylber Hysa) dhe “Riinvest” (unë e Muhamet Sadiku) nënshkruam një marrëveshje për themelimin e një partneriteti në formë të një forumi, që do të angazhonte shoqërinë në debate mbi çështje të rëndësishme në një sfond të gjerë lidhur me integrimet euro-atlantike. Kur po e diskutonim emrin, fjala “forum” ishte diçka e vetëkuptueshme, por duhej edhe diçka që do ta dallonte. I shtuam edhe “2015” duke menduar se deri atëherë, për trembëdhjetë vjetët në vazhdim, jo vetëm që do të zgjidhej statusi politik i Kosovës, por Kosova nëse jo e integruar në BE, do të ishte afër integritetit, ose së paku do të ishte një shoqëri me tipare euro-atlantike për kah niveli i demokracisë dhe zhvillimi ekonomik. Disa na kishin kritikuar për këtë emër, na thoshin se jemi pesimistë dhe defetistë. “Nga perspektiva e sotme, dhjetë vjet pas themelimit të Forumit po shoh se kemi qenë tepër optimistë. Në ekonomi ka pak përparime, niveli i demokracisë është i ulët, pavarësia e Kosovës është shpallur dhe pranuar nga më shumë se 100 vende dhe ky është rezultati kapital. Shtatë vjet pasi shteti i pavarur i Kosovës, një fitore e madhe dhe një kapërcim i vështirë, është mbërthyer nga shumë probleme në ecjen e tij kah zhvillimi dhe integrimi në Evropë dhe NATO. Forumi inicioi shumë diskutime për tema të rënda: Pozita ndërkombëtare e Kosovës, identiteti, privatizimi, energjia, diaspora... Në Bordin e forumit, krahas neve të gjashtëve, ishin edhe Muhamedin Kullashi, profesor filozofie në “Paris 8”, Besnik Pula, profesor në ShBA, kurse në përbërjen e gjerë për të përcaktuar programin e punës rregullisht i ftonim edhe Azem Vllasin, Anton Berishën, Shkëlzen Maliqin, Venera Hajrullahun, Vjosa Dobrunën, Avni Mustafajn (atëherë në AUK), Fatos Hamzën, Ulpiana Lamën, e të tjerë. Pas demonstratave të dhunshme që shpërthyen në Kosovë, në pranverë të 2004-s, kur në mënyrë të vrazhdë u shprehën pakënaqësia dhe revolta për status quo-n nën UNMIK-un dhe lëvizjen e ngadalshme rreth statusit, me Forumin 2015 organizuam disa tubime, prej të cilëve një ndërkombëtar lidhur me status quo-n e dhe statusin diku në qershor 2004 dhe



vazhduam që ta mbajmë në këtë temë, krahas presionit që bëhej për këtë edhe nga faktori politik. Michael Stienner që atëherë ishte Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, pra një lloj guvernatori i Kosovës, pati dalë me një proklamantë “Statusi pas standardeve”, ku si çaqe për zgjidhjen e statusit kishte shpallë një 8 pika për fusha të ndryshme në mënyrë shumë të përgjithësuar, që synonin një gjendje (benchmarks) që duhej të arrihej para se të caktohej statusi. Por këto ishin, siç thash, mjaft të përgjithësuar dhe vështirë të deshifrueshme. Flaka Surroi, që ato kohë ishte sekretare e përgjithshme e Qeverisë së Kosovës, e kryeministër Bajram Rexhepi, na thirri mua edhe Isanë se a do të mund të punonim në zbatimin e këtyre qëndrimeve politike në një program të punëve dhe aksioneve dhe të nxirrnim koston e zbatimit të standardeve. Kjo nuk ishte një punë e lehtë, por Flaka me të drejtë e kishte konceptuar si problem qenësor dhe pothuajse pa na pyetur shumë na e la në dorë këtë

detyrë. Ne kishim krijuar një mori shkathtësish për formulim të problemit, pastaj për t'i nxjerrë objektivat për ta tejkaluar problemin duke nxjerrë nga kjo aktivitetet e punët e nevojshme dhe buxhetin. Pra, duhej zbatuar teknika e menaxhimit të projekteve, përkatësisht e zbrërthimit të projektit në aktivitete, nëaktivitete, të cilave mund t'u caktohet koha e nevojshme për kryerje dhe kostoja e tyre, në ndarjen e burimeve dhe krijimin e buxhetit për to dhe për projektin (WBS, Work Breake Down Structure). Flaka ishte marrë vesh me DFID dhe kontraktonin e tyre PAI, që ata të siguronin buxhetin për këtë punë. Ne krijuam 10 grupe, në secilën ministri, prokurori e gjyqe dhe për komuna që t'i trajnojmë në këtë teknikë, t'u japin asistencë me stafin tonë që secili nga fusha e vet t'i nxjerrim projektet me afate, punët dhe kostot dhe kjo do të përfundohet për 4/5 muaj. Me PAI kishim bashkëpunim të shkëlqyeshëm. Isa e bashkërendiste këtë projekt me efektivitet. Ai edhe nxori buxhetin shtesë që duhej, e që ishte mbi 200 milionë euro. Kjo punë i vuri në lëvizje shumë struktura dhe u tregua e dobishme.

Atë verë Forumi solli shumë politikanë, analistë, opinionistë nga vende të ndryshme të Evropës dhe vendet fqinje në Konferencën (2005) që të diskutojmë lidhur me temën "Status quo-ja dhe statusi". Ishte një konsensus se status quo-ja është e paqëndrueshme dhe e rrezikshme dhe shumica edhe e mysafirëve, duke përfshirë edhe përfaqësuesin e ELAIMEP nga Athina, e theksonin pavarësinë si të paevitueshme. Ky ishte një rezultat i plotë.

Energjia dhe Plani Nacional i Zhvillimit

Në vitet 2005 dhe 2006 u aktualizua shumë çështja e zhvillimit afatgjatë të energjisë në Kosovë, bazuar në rezervat e mëdha të linjitet afër Obiliqit e Prishtinës dhe në vise të tjera. Po ashtu, Qeveria ishte preokupuar me ndërtimin e një Plani zhvillimor, që do të përcaktonte prioritetet në një afat më të gjatë në mënyrë që kjo të merrej si bazë për një qeverisje më cilësore e me përparësi të qëndrueshme. Të dy këto çështje i shtynte sidomos ministri i Energjisë e Minierave, Ethem Çeku. Ishin bërë ndoshta 10 mijë faqe dokumente nga Banka Botërore, institute gjermane e të ngjashme. BE-ja, më saktë

Agjencia Evropiane për Rindërtim kishte sjellë dy ekspertë nga Greqia dhe i paguante që nga e gjithë kjo të krijonin një dokument në formë strategjie zhvillimi që do të mund ta aprovonte Kuvendi i Kosovës. Në procesin e konsultimeve që zhvilloheshin e ku po merrnim pjesë, edhe ne e pamë qartë se këta dy "ekspertë" po provonim ndoshta ta bënë strategjinë e parë në praktikën e tyre dhe ndonëse mundoheshin shumë, nuk e kishin dijen dhe përvojën për këtë punë. Ministri po bëhej nervoz me ta, njëherë u tha ta lënë punën, por punëdhënësi i tyre Agjencia Evropiane e Rindërtimit i mbajti derisa e prodhuan një dokument të kotë si shumë të tjerë. Pas një kohe ministri u interesua se, a thua mund ta bëjmë këtë dokument ne në "Riinvest". Kjo ishte punë që bëhej. Shihej qartë se kishte pikëpamje të ndryshme mbi mundësitë dhe nevojat e prodhimit të energjisë nga linjiti. Ato ditë në një studim mbi nevojat për energji dhe mundësitë e prodhimit në rajonin e Evropës Juglindore, kishte dalë se Kosova kishte përparësi komparative dhe se këtu mund të ndërtoheshin termocentrale deri në 4400 MW. Kjo edhe nuk ishte ide e re. Kjo ishte provuar të bëhej edhe në fillim të viteve '80, por ishte kundërshtuar nga Qeveria e atëhershme Kosovës, në krye me Ymer Pulën. Ishte e qartë se strategjia duhej t'i vinte disa kufizime në këtë drejtim por edhe të sigurote furnizimin e ekonomive shtëpiake, bizneseve dhe organizatave e institucioneve tjera në një periudhë 10-15 vjet. Ndërtimi aq agresiv dhe eksploatimi masiv i linjitet e djegia e tij prodhonte një sërë efektesh negative të drejtpërdrejta anësore. Ndotja e ajrit, tokës dhe ujërave që edhe ashtu ishte kritike, zhvendosja e popullatës, humbja e tokës bujqësore, konsumi i madh i ujit për këtë qëllim, në vend të bujqësisë, pra shumë e shumë rreziqe që edhe ishte e vështirë të llogariteshin. Ne nuk guxonim të merrnim vendime të tilla. Andaj në konsultat që po bëja me shumë ekspertë, erdhëm në përfundim se e shumta që do të mund të aprovohej për t'u ndërtuar si kapacitet i ri për periudhën 2005-2015, ishte një TC deri 1000 MW ose dy nga 500 MW. Përveç ekipit të "Riinvest"-it kishim angazhuar edhe njërin nga ekspertët më të mirë të kësaj fushe, profesor Ali Hamiti. Gjatë punës u ballafaquam me kërkesat e një grupi që insistonte për kapacitete më të mëdha, ata si inxhinierë të gjenerimit që ishin nuk i kuptonin problemet sociale-ekonomike. Megjithatë, ne mbetëm te limiti 1000 MW me shumë obligime për evitimin e ndotësve ekzistues dhe pasojave të tyre të mëdha që ilustrohen me kodrën e hirit e blözës rrëzë Prishtinës.

Kur e patëm ndërtuar një konsensus dhe po i bënim redaktimet e fundit këtij dokumenti me profesor A. Hamiti, para se ta dërgonim në Ministri si produkt final, pikërisht ministri po kërkonte nëpërmjet telefonit që të shkruanim mundësinë e prodhimit deri në 2700 MW. Ky numër më përkujtonte kërkesat e njërit nga këshilltarët e tij. Ia përkujtova argumentet dhe diskutimet që kishim bërë, por ai nuk hiqte dorë.

- Po, mirë i thash, kjo punë edhe ashtu është në dorën tuaj. Ju mund ta ndryshoni dokumentin si të doni kur t'ia dërgoni Kuvendit për aprovim. Nuk do të thotë se duhet ta dërgoni ashtu si themi ne, por ne me firmën tonë nuk mund të japim propozim për më shumë se 1000 MW. Dhe nëse ju shkoni në Kuvend me propozim tjetër, ne do t'i paraqesim pikëpamjet tona dhe propozimin tonë publikisht në konferencë për media.

Veç kësaj i thash që nuk e vejmë pikë përgjithmonë, por për ndërtime më shumë duhet të bëhen studime shumëdisiplinare për sasinë, kufizimet dhe lokacionet. Nuk insistoi më shumë. Dokumenti shkoi diku në gusht në Kuvend ashtu siç ishte përgatitur nga ne, e prezantuam edhe para komunitetit ndërkombëtar dhe gjithçka dukej mirë. Kuvendi e aprovoi diku në tetor dhe tash duhej vetëm zbatimi i këtij dokumenti. Megjithatë, menjëherë sa kishim hyrë në vitin 2006, u krijua një Komitet drejtues i projektit Kosova C 2100 MW, që kryesohej nga ministri, por administrohej nga një inxhinier i ri i diplomuar në Sllovaki, i talentuar por edhe i kufizuar mjaft. Ishte e habitshme se si po promovohesh një projekt që shkelte mbi një strategji të aprovuar nga Kuvendi. Promovimi ishte aq agresiv sa përfshiu pothuajse të gjitha strukturat e shoqërisë deri tek Akademia e Shkencave dhe Bashkësia Islame! Dhe gati të gjithë po i duartrokisnin!!! Projektit të ri po i jepnin përkrahje me radhë gjithë faktorët ndërkombëtarë, përpos disa qarqe në BE që ishin më të ndjeshme në mbrojtjen e mjedisit. Ne e kundërshtonim, por pothuajse ishim të vetmuar me një pjesë të medieve dhe kuptohet një pjesë e madhe e opinionit që na përkrahnin. Një pjesë e madhe e inteligjencies, e ekspertëve rrinte e heshtur. Me Luan Shllakun, drejtorin e KFOS dhe bashkëkryesues i 'Forumit 2015', vendosëm t'i biem fortë kësaj çështje. Krijuam një grup ekspertësh të fushave të ndryshme të udhëhequr nga Luani dhe profesor Ekrem Beqiri, i cili ishte një nga shtyllat e "Riinvest"-it. Ata do të përgatisnin një raport që do ta diskutonim në 'Forumit 2015' para opinionit dhe në

transmetim direkt televiziv të KTV. Doli një raport me shumë argumente të grupuar në 13 fusha, se përse nuk duhej zbatuar një projekt i tillë. Raporti mori titullin provokativ: "Kosova C 2100MW: Një përrallë moderne"... pra përrallë quhej ai argumentimi se ky projekt do ta shpëtojë Kosovën në aspektin zhvillimor. Para se të mbahej Forumi e lutëm ministrin të vinte me ekipin e tij dhe t'i prezantojë pikëpamjet e tija që në fillim, njësoj vepruam edhe me eksponentë ndërkombëtarë të këtij projekti, midis të cilëve atëherë ishte edhe Banka Botërore, ndonëse ishin shkelur shumë procedura në të cilat në raste të ngjashme insistonte vetë ajo, e sidomos Vlerësimi strategjik i mjedisit. Por salla ishte e mbushur plot. Nga qeveria nuk kishte ardhur askush, ndërsa institucionet ndërkombëtare kishin dërguar vëzhgues të shumtën nga stafi vendor. Ne dinim se ata tash ishin para ekraneve të TV në zyrat e tyre duke e përcjellë konferencën tonë, e që nuk kishin ardhur ishte një lloj disfate për ta. Luan Shllaku bëri një prezantim të fuqishëm të raportit dhe ilustroi bindshëm e shumëfish argumentet tona. Diskutimet po e përkrahnin raportin. Veton Surroi gjatë diskutimit tha se edhe në Afrikë kishin më shumë kujdes për shfrytëzimin racional të pasurive natyrore. Projekti Kosova C 2100 MW u bë përrallë. Gjatë drekës po i thosha Luanit se nëse unë di diçka nga politika, ky projekt u komprometua sot dhe nuk do të realizohet. Ai ishte ende skeptik, ka interesa të mëdha prapa, më thoshte. Në fakt projekti u mbajt gjallë edhe shumë kohë. Ende është ai komitet drejtues por me duket se inxhinieri i ri ndërkohë kishte dhënë dorëheqje. Edhe Qeveria e re që erdhi në pushtet më pastaj, ndonëse si opozitë e kishte kritikuar, e mori me entuziazëm projektin duke i ndërruar emrin nga Kosova C 2100 në Kosova e Re 2100. Megjithatë, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian dhe ministrja e re, prof. Justina Pula, në mënyrë diskrete kishin filluar të tërhiqen kujdesshëm. Banka bëri studimin mjedisor dhe erdhi në përfundim se nuk mund të shkohet në më shumë se 1000 MW, bile tash e ka reduktuar në 600.

Plani nacional kishte filluar të përgatitej diku në pranverë të vitit 2006. "Riinvest"-i e mori atë projekt në një konkurs të hapur. Ne kishim për detyrë të trajnonim rreth 120 ekspertë që punonin në ministri për planifikim strategjik, të prodhonim me ta 22 raporte sektoriale dhe ndërsektoriale dhe të formulonim draftin e Strategjisë. Kishim formuar një ekip të fortë e të zgjedhur, të forcuar edhe me ekspertët më të mirë jashtë

"Riinvest"-it dhe kishim marrë si konsulentë Mojmir Mrak dhe Mateja Rojec, ekspertë të shkëlqyeshëm sllovenë. Projekti financohej nga buxheti, por pjesa më e madhe nga DFID britanik dhe SIDA suedeze. SIDA e mbështeste aktivizimin e shoqërisë civile ndërsa DFID konsulencën e jashtme. U organizuan edhe konsulta të gjëra të shoqërisë civile. Puna kishte filluar mirë, derisa u involvuan shumë akterë që, ose xhelozonin "Riinvest"-in ose kishin ambicie për grabitje, por më tepër ishte edhe problemi i koncepteve të zhvillimit ku përfshihej edhe Kosova C. Në kohën kur duhej të fillonim me hartimin e draftit të planit, kur kishim krijuar një ekip prej rreth 25 ekspertëve më të mirë, në zyrë më erdhi një këshilltare e drejtorit të Bankës Botërore nga Uashingtoni, duke shprehur mendimin se më mirë do të ishte që drafti të shkruhej në sekretariatit që ishte krijuar për këtë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi që ky që e shkruani ju do të merrej gjithnjë si plani i "Riinvest"-it e jo i qeverisë. E ju, po më propozonin, mund të jepni kontributin atje gjithashtu. Mu duk se ishte një gjykim i drejtë dhe u pajtova. Më vonë pati shumë tensione rreth kësaj, u prodhua një draft që e shkruan konsulentët e jashtëm të sekretariatit, ku kishte shumë probleme ngase zhvillimi i Kosovës, sipas asaj duhej të mbështetej të shumtën në energji dhe miniera, e që ne e kundërshtonim fuqishëm. Veç kësaj edhe amerikanët nuk besonin në efektivitetin e këtij lloj plani gjithëpërfshirës. Lidhur me këtë plan "Riinvest"-i u kritikua nga njerëz të painformuar ose dashakëqij, duke përhapur dezinformata të llojllojshme e deri tek ato gjoja "për përfitime materiale rreth 2 milionë euro", ndonëse e tërë kontrata e "Riinvest"-it për gjithë punën e tij ishte 250 mijë euro. Puna u përfundua me një draft që asnjëherë nuk shkoi më tutje, duke u ngritur shumë pluhur dhe Kosova edhe sot e kësaj dite nuk ka një plan nacional me prioritete të qarta zhvillimi.

Early Warning – Paralajmërime

Jo shumë pas luftës, kah fundi i vitit 2000, na vizitoi një delegacion i lartë i UNDP-së. Po na propozonin të përgatisnim e publikonim një raport çdo tre muaj, ku do të pasqyroheshin lëvizjet në shoqëri. Nëpërmjet hulumtimit që përcillte perceptimet

e opinionit dhe analizave të analistëve nga fusha e ekonomisë, funksionimit të institucioneve, marrëdhënieve ndëretnike dhe sigurisë, do të shërbente si paralajmërim për krizat potenciale, – një "early warning" të krijuesit e politikave mbi burimet e krizës dhe tensionet eventuale politike dhe sociale. Raporti do të jepte edhe perceptimin e opinionit për institucionet dhe bartësit e funksioneve kryesore, pasqyronte edhe disponimin e votuesve. Pra ishte një burim i artë i informatave. Natyrisht që pranuan menjëherë. Krijua një ekip që do të bënte hulumtimin e opinionit nëpërmjet anketimit që udhëhiqej nga Ymeri (Havolli) dhe ekipi i analistëve (Shkelzen Maliqi, Muhamet Sadiku, Sejdi Osmani dhe të tjerë nga "Riinvest"-i, si dhe Lulzim Peci e Vesel Latifi). I tërë projekti udhëhiqej nga prof. Ekrem Beqiri, i cili edhe e redaktonte raportin në të tri gjuhët: shqip, anglisht dhe serbisht. Raporti bëhej gjithnjë e më i popullarizuar, përdorej shumë nga Administrata ndërkombëtare dhe UNMIK-u, citohet e referencohet gjithandej nga gazetarë e shkencëtarë. Fatkeqësisht shumë më pak përdorej nga politikanët tanë. Ata dinin vetëm të reagonin nëse kishin dalë keq te perceptimi i tyre në opinion : "Aiii, e keni prish krejt, pse më keni qitur ashtu...". Njëherë njëri më përcolli porosi, një lloj pakënaqësie nëpërmjet shefit të kabinetit . Kur e takova shefin e tij, i shpjegova se ne publikojmë perceptimin e publikut e jo mendimet tona. Andaj nëse ju jeni duke punuar mirë, shkaku pse opinionin mendon të kundërtën, mund të jetë se ata nuk dinë për punën tuaj, pra nuk e informoni mirë, ose frikohem se ata janë mirë të informuar, i thash si me gjysmë shaka e gjysmë seriozisht.

Është interesant se publikimi i këtij raporti në mars 2004, paralajmëroi rrezikun nga rritja e pakënaqësisë ndaj institucione vendore e ndërkombëtare. Raporti paralajmëroi për ngritje tensionesh në opinion, tregonte se perceptimi për UNMIK-un dhe institucionet e Kosovës ishte kryesisht negativ, vetëm 19% e respondentëve kishin mendim pozitiv për punën e UNMIK-ut. Kosova ishte lodhur nga status quo-ja, nga burokracia e UNMIK-ut dhe nga indolencia e politikanëve vendorë. Mjerisht këtë nuk e lexuan mirë as Qeveria, as politikanët tanë dhe as ata ndërkombëtarë dhe kur ndodhën demonstratat, shpejt pas kësaj, diku kah fundi i prillit më duket pothuajse të gjithë u "befasuan". Por nuk ishin vetëm vendorët që prekeshin me gjetjet e raportit.



Presidenti Rugova duke ia
uruar dekoratën prof. dr.
Muhamet Mustafës, atëherë
kryetar i "Riinvest"-it

Presidenti Rugova dekoroi "Riinvest"-in me "Medaljen të Artë të Pavarësisë"

14 MAJ 2005

"Ndiem shumë i nderuar që po marr pjesë në konferencën tuaj kushtuar 10-vjetorit të "Riinvest"-it. E përshëndes 10-vjetorin e Institutit tuaj, këto janë 10 vjet pune të frytshme, për ju dhe për Kosovën në vitet e vështira dhe tash në vitet në liri të vendit tonë. Ky jubile i rëndësishëm është stimulant për të vazhduar veprimtarinë e frytshme. Në këtë ditë jubilarë, ju do të diskutoni për zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës. Kjo do të jetë me rëndësi për Kosovën dhe institucionet e saja demokratike tash kur po përgatiten projekte të mëdha nacionale afatmesme mbi zhvillimin ekonomik të saj. Besoj se nga ky debat do të dalin konkludime me vlerë për institucionet tona. Po ashtu ne, në të gjitha fushat ekonomike duhet të angazhohemi, të gjejmë forma për sigurinë e investimeve që kemi filluar dhe për forma të tjera që sigurisht do të përfshihen në këto dy projekte të mëdha. Për çështjet me të cilat merret "Riinvest"-i, për Kosovë pra, për çështjet ekonomike e të tjera, është me rëndësi njohja e drejtpërdrejtë e pavarësisë së Kosovës.

Me këtë rast me dekret të veçantë kam vendosur ta dekoroj me "Medaljen të Artë të Pavarësisë", Institutin "Riinvest" në dhjetëvjetorin e punës për meritat e tij, për liri, pavarësi dhe demokracinë e Kosovës dhe kontributin në zhvillimin ekonomik dhe të projektimit të së ardhmes së Kosovës."

Dr. Ibrahim Rugova

President i Kosovës

14 maj 2005

"Riinvest"-i ishte rritur me hulumtues të rinj. Në vitin 2004 kishte afro 30 të punësuar, hulumtues të tri gjeneratave – themeluesit, dhe dy gjenerata hulumtuesish të rinj që ishin rekrutuar nga studentët më të mirë të Fakultetit Ekonomik. Në vjeshtë të atij viti e përfundonim projektin katërvjeçar me USAID-in që kishte absorbuar 60-70% të kapaciteteve, kështu që gjetjen e punëve nuk e kishim pasur ndonjë brengë të madhe. Në fund të gushtit ose në shtator në një takim me USAID-in e kishim të qartë se koha e projekteve të tilla të mëdha dhe disavjeçare kishte përfunduar dhe, siç na thanë ata, "Riinvest"-i tash duhet ta sprovonte qëndrueshmërinë e tij duke bërë garë në tregun e shërbimeve biznesore dhe tregun e investimeve të donatorëve për të fituar të ardhurat me të cilat do të mbulonte shpenzimet e funksionimit të tij. Nëse nuk mundet "Riinvest"-i, si do të mundet Kosova të qëndrojë e pavarur, po thoshte si me shaka Dale Pheipher, drejtor i USAID-it, shumë i përkushtuar në punën e tij për të krijuar diferencë pozitive.

Kjo edhe ishte e drejtë nga këndi i tyre pasi që kishin investuar në ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin tonë institucional gjatë katër vjetëve të fundit, por edhe nga ana tjetër kjo paraqitej si një lloj terapie "shok", pasi që përnjëherë duhet të kërkohet në treg pjesa më madhe e të ardhurave- pagave dhe shpenzimeve për një organizatë kërkimore prej 30 vetash e që nuk ishte e lehtë. Kjo kohë edhe nuk ishte pa sfida, por u zëvendësua me një portfolio të gjerë të projekteve të vogla që u kontraktuan me Fondacionin Soros, Bankën Botërore, UNDP-në, Qeverinë e të ngjashme.

Me 15 maj 2005 po kremtonim 10-vjetorin e punës sonë me një konferencë ku prezantonim për diskutim studime tonat. Presidenti Rugova erdhi për të mbajtur fjalën e rastit dhe për të uruar për jubileun tonë. Në fund të fjalimit të tij, ai kërkoi që të gjithë të pranishmit të ngritën, pasi që po e kumtonte një vendim të rëndësishëm. Me fjalë të zgjedhura ai kumtoi dhe e arsyetoi vendimin e tij për të dekoruar "Riinvest"-in me "Medaljen e Artë të Pavarësisë". Kjo ishte për të gjithë një befasi, po një befasi që e nderonte shumë "Riinvest"-in, që ishte krijuar në një organizatë të qëndrueshme, të pavarur në qëndrimet e tij gjatë një pune dhjetëvjeçare me plot sakrificë dhe përkushtim.

Edukimi

Disi në këtë kohë filluan të formohen me një ritëm të shpejtë e nganjëherë kaotik universitet private. Ato po bazoheshin kryesisht në profesorët dhe mësimdhënësit nga Universiteti i Prishtinës, por dinin të ofronin dhe paga atraktive, sidomos kur ziheshin ngushtë dhe para inspektimeve e vlerësimeve nga Ministria ose më vonë Agjencia e Akreditimit. Në këtë mënyrë stafi i "Riinvest"-it kërkohesh nga këta, qoftë për mësimdhënie plotësuese apo edhe për marrëdhënie të plotë të punës dhe ne u frikuam se kështu ai do të shpërndahet dhe shkapërderdhet. Gjithashtu, edhe nevoja për të krijuar të ardhura stabile dhe paga konkurruese e për të mos u varur tërësisht nga grantet e kontratat për punën kërkimore ose konsulencë, na shtyri që ta shqyrtojmë gjithnjë e më seriozisht mundësinë që të krijonim edhe ne një "universitet" dhe të ofronim studime nga fusha e Ekonomisë dhe Shkencave kompjuterike. Idenë për Shkenca kompjuterike ma sforconte dhe bashkëpunimi me Idriz Smajlin, që kishte qenë asistent imi dhe kishte doktoruar në inxhinierinë softuerike në Vjenë dha tash punonte atje, por ai kishte edhe një grup shokësh si Nysret Musliu, Yll Haxhimusa, Driton Statovci, Arian Shala. Ata e kishin diskutuar më herët me mua nevojën e një programi serioz të trajnimit për programer- inxhinier softuerik, pasi që tregu i Evropës Perëndimore do t'i kërkonte shumë e ne me popullatën e re do të mund të shfrytëzonim këtë shans, pasi që ata edhe duke qenë në Kosovë do të mund të punonin për kompanitë perëndimore. Kur e diskutuam me ta këtë ide, ata e përkrahën dhe shprehën gatishmëri që për këtë pjesë ta marrin mbi vete hartimin e programit dhe sigurimin e cilësisë, e që krijonte sigurinë e nevojshme te ne. Pas përgatitjeve lidhur me programin dhe stafin ne u paraqitëm për një licencë në Ministri dhe ishim të gatshëm të startojmë me studime në shtator të 2007-s. Që t'i hyjmë kësaj pune përveç trendit dhe nevojave të qëndrueshmërisë në rrjedhën e të ardhurave të "Riinvest"-it, na shtynte edhe gjendja jo e mirë në Universitetin e Prishtinës dhe fakti se gjendja atje nuk po përmirësohej. Për vitin e parë rekrutimi edhe nuk ishte aq i keq. Po në maj të vitit 2007 Ministria e Edukimit e kontrakttoi Këshillin Britanik të Akreditimit për një inspektim. Ata paraqitën një

raport, i cili qartë bënte një diferencim midis shumë bartësve privatë të arsimit të lartë në Kosovë lidhur me programet, stafin, kërkimet dhe potencialet e zhvillimit, megjithatë masat ndëshkuese të Ministrisë nuk po ndiqnin shumë faktet nga raporti, po merrnin masa horizontale ndëshkuese ndaj të gjithëve duke ndaluar regjistrimin për një vit akademik të studentëve të rinj, e që për neve që ishim në fillim të zhvillimit ishte një hendikep shumë i madh. Megjithatë, synimi që të kemi një Kolegj të vogël dhe cilësor, po vihej në sprovë serioze. Në këto kushte krijuam një partneritet me AAB, duke bashkuar potencialet për t'i plotësuar kushtet për t'u akredituar si Universitet.

Në mars të vitit 2009 Komisioni i përbërë nga ekspertë të jashtëm pas vlerësimit të bërë edhe propozoi që AAB-Riinvest të akreditohet si Universitet, por kjo nuk u respektua nga Bordi i Agjencisë. Të kota ishin ankesat. Gjithë këto institucione vetëm mbulonin qëndrime politike që ishin marrë gjetiu dhe shihej qartë se në këtë proces më shumë po e pësonin institucionet që tentonin të diferencoheshin me cilësi. Aty pamë në vepër kapjen e institucioneve nga politika. Asnjë përgjigje me shkrim nuk morëm për ankesat që bënim sipas procedurës administrative në Qeveri dhe Ministri. Megjithatë, vendosëm që me gjithë këto vështirësi, të vazhdonim me vizionin tonë. Në bazë të një marrëveshje që kishim nënshkruar me Staffordshire University, ku ishin shkolluar shumë nga ekspertët tanë të rinj, ne filluam të ofrojmë studime anglisht në Menaxhim biznesi, ku merrej diplomë britanike e këtij universiteti e barasvlershme me studentët që përfundonin studimet atje. Ne i kaluam validimet nga ky universitet që ishin shumë më rigorozë sesa inspektimi për akreditim që na bënte Agjencia. Ky validim provonte se ne kishim kapacitete dhe kushte që me stafin tonë t'i zhvillonim studimet në anglisht, sikurse që e bënte edhe ai universitet në Britani dhe në vend që kjo të mbështetej dhe shikohej si një arritje nga Agjencia dhe Ministria, ne po hasnim në vështirësi të pashpjegueshme. Pas tri vjetëve partneriteti me AAB, e vlerësuam bashkërisht se do të zhvilloheshim më me sukses si institucione të pavarura duke marrë parasysh orientimet zhvillimore dhe profilet që kishim. Tash ky Kolegj me afro 450 studentë, me 7 programe në gjuhën shqipe dhe katër në anglisht, ofron studime cilësore në bachelor dhe master dhe

në tregun e çrregulluar të arsimit të lartë. Misioni që të krijojmë një organizatë që prodhon ekspertë me dije konkurrense për nevojat zhvillimore të Kosovës dhe me kapacitet për konkurrencë në tregun global, është një shqetësim por dhe inspirim i fortë. Tash ky Kolegj ka marrë rrugën e arritjes së standardeve ndërkombëtare nën lidhshmëri me z. Bardhyl Meta, Bardha Qirezi, Dr. Alban Zogaj, Hazir Gashi, Dr. Arben Damini, Diana Lekaj.

Viti 2009: Përgjegjësia e qeverisjes së “Riinvest”-it bartet te gjenerata e re

Duke e parë stabilizimin e Institutit “Riinvest”, në vjeshtë të vitit 2009 shpallëm konkursin për drejtor ekzekutiv, me orientim që të bëjmë një zgjedhja jashtë themeluesve të Institutit. Në mesin e të paraqiturve ishte edhe Dr. Lumir Abdixhiku ndër hulumtuesit e talentuar në “Riinvest”, madje kërkesën e dërgoi nga Staffordshire University, ku po përfundonte doktoratën. Kishim edhe kandidatë tjerë, të mirë po kjo që Lumi ishte i gatshëm të merrte përgjegjësi na pëlqeu dhe duke njohur kapacitetet e tij, Bordi e emëroi drejtor. Vendosëm që gradualisht përgjegjësinë e qeverisjes së Institutit ta bartim te gjenerata III e hulumtuesve.

Aty janë edhe Dr. Alban Hashani, Dr. Alban Zogaj, Dr. Artane Rizvanolli, Fisnik Reçica, Albana Gashi, Saxhide Mustafa si dhe ata të gjeneratës më të re, si Agon Nixha, Ilir Mehmeti, Gent Beqiri, Premton Hyseni, Fisnik Bajrami, Diellza Gashi, Etida Zeka e shumë të tjerë që kanë punuar dhe kanë mbetur të lidhur për “Riinvest”-in, si Dr. Petrit Gashi, Dr. Besnik Krasniqi, Dr. Valentin Toçi, Dr. Arben Mustafa, Dr. Sokol Havolli e pastaj edhe Salvador Elmazi e shumë të tjerë. Ata do të bënin diferenca të reja pozitive dhe ky ishte një nga rezultatet më të mëdha që kishim arritur në ndërtimin e qëndrueshmërisë së këtij Instituti, i cila jo vetëm se u sprovua në një mjedis veprimi jo të lehtë, por u tregua se ka krijuar burime dhe kompetenca që me sukses do të përballen me të ardhmen gjithnjë duke i qëndruar besnik misionit dhe vizionit të “Riinvest”-it.

4

PARTNERËT
NË DEKADA



ISA MUSTAFA

KRYEMINISTËR I KOSOVËS

Umbushën 20 vjet të punës së Institutit "Riinvest", Institut i cili shënoi fillimet e të menduarit ekonomik ndryshe në Kosovë. U themelua në një ambient të errët politik, në kushte të okupimit, me objektiva të promovojë idenë e zhvillimit modern ekonomik.

Ambicie e madhe për rrethana të atëhershme, por e realizuar me sukses.

"Riinvest"-i sot mund të krenohet me të arritura të mëdha në hulumtime shkencore, në përgatitje dhe shkollim të një kuadri të aftë për të ardhmen, në vënien e themeleve të një institucioni kredibil të arsimit të lartë.

Më ndodhi të gjendesha në ekzil, në vendet perëndimore, në mesvitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, kur prof. Muhamet Mustafa më njoftoi për iniciativën e themelimit të Institutit "Riinvest". Prof. Muhameti kishte vullnetin, para së gjithash, për të ofruar një hapësirë për mendim tjetër ekonomik në Kosovë, për të krijuar një mekanizëm bashkëpunimi me institucionet dhe institutet ndërkombëtare në një fazë të rëndësishme tranzicioni që e priste Kosovën. Atëherë ngjante në një dëshirë, por sot është një realitet i përjetuar dhe i realizuar, jo utopi.


Kësaj dëshire iu bashkova edhe unë, posa u ktheva në Kosovë në vitin 1999, një herë si mbështetës dhe mandej si hulumtues i lartë dhe nënkryetar i Institutit. Them, pa mëdyshje, se vitet më produktive të hulumtimeve i kam kaluar me një ekip të mrekullueshëm të djemve dhe vajzave në këtë Institut. Por para së gjithash me një njeri me shprehje të pakrahasueshme

pune, me shumë energji dhe shumë ide, prof. Muhamet Mustafën. Është punuar në shumë projekte me mbështetje të donatorëve ndërkombëtarë, por edhe me ekspertizë ndërkombëtare në fusha vitale të ndërtimit të sistemit ekonomik të vendit. Janë zhvilluar shumë hulumtime, nga të cilat janë nxjerrë të dhëna primare që kanë plotësuar një boshllëk të madh për vlerësime makroekonomike në Kosovë. Janë përgatitur dhe janë shkolluar shumë nga ekspertët e sotëm të ekonomisë dhe njerëz që kanë marrë përgjegjësi për të qeverisur shtylla të rëndësishme të shtetit tonë.

Partneriteti i krijuar me shumë institucione ndërkombëtare ka një vlerë të veçantë, sepse ashtu si u zhvillua ky partneritet, ashtu u ngritën edhe vlerat reciproke të bashkëpunimit. Kur përfundonim një projekt, tryezë, ose krijojmë një partneritet të ri, fitoja përshtypjen se ia shtonim një vlerë të re punës sonë. Një pune që nuk ishte komerciale, por vlerësonte cilësitë, dijen; aftësitë për të ofruar zgjidhje. Të një ekipi i cili kultivonte solidaritetin e brendshëm në ndarjen e përvojave dhe në menaxhimin e rezultateve.

Si kryeministër i vendit, sot shoh me shumë interes për vendin kontributin e Institutit "Riinvest". Ky Institut, jo vetëm që ka shkruar një histori të re të të menduarit ekonomik në vendin tonë, por ai ka krijuar një bazament të ideve shkencore për të ardhmen ekonomike e sociale të vendit tonë, ka krijuar njerëz që mund ta bëjnë këtë me besim dhe kompetencë.

Uroj suksese të reja në dekadën e tretë!

USAID
KOSOVËJames Hope
USAID/Kosovo
drejtor Misioni

12 mars, 2015

Për: Ekipin editorial të Monografisë,
Instituti "Riinvest"

Nga: James Hope, drejtor Misioni i USAID-it

USAID-i ka qenë njëri ndër donatorët e parë ndërkom-bëtarë në vend më 1999, njëkohësisht edhe një partner i qëndrueshëm i Kosovës si dhe njëri ndër mbështetësit më të mëdhenj financiarë që nga atëherë. Falë bujarisë së popullit amerikan, USAID-i ka dedikuar afro \$800 milionë gjatë 16 vjetëve të fundit për të ndihmuar në rindër-timin e vendit, krijimin e institucioneve demokratike, dhe në ndërtimin e një baze për rritje të qëndrueshme.

Gjatë asaj kohe, ne kemi lidhur partneritet me ud-hëheqësit kosovarë për të ofruar zgjedhje kreative por edhe të qëndrueshme, të cilat shërbejnë për t'i plotësuar nevojat e menjëhershme por edhe ato të ardhshme të qytetarëve të këtij vendi. USAID-i është krenar që përf-shin Institutin "Riinvest" në mesin e partnerëve tanë. Duke parë "Riinvest"-in si një 'think-tank' lider, ne filluam bashkëpunimin me Institutin gati menjëherë, në vjeshtë të 2000-s. Gjatë viteve 2000 dhe 2004, USAID-i i ndihmoi Institutin në zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese dhe në rekomandimin e rregulloreve rreth çështjeve ekonomike.

Një tjetër arsye e rëndësishme e bashkëpunimit tonë ishte të zgjerojmë përfaqësimin e komunitetit biznesor në dialogun për rregulloret. Nëpërmjet partneritetit tonë me "Riinvest"-in, USAID-i ka ndihmuar në themelimin

e Aleancës Kosovare të Biznesit, e cila mbetet shumë aktive në promovimin e prodhimeve vendore dhe në këshillimin e Qeverisë për zhvillimin e rregulloreve të favorshme për komunitetin e biznesit në Kosovë. Zhvil-limi i kapaciteteve të organizatave lokale për t'i plotësuar nevojat a qytetarëve të vendit është një parim primar i iniciativës përparuese të USAID-it. Duke përdorur këtë filozofi këtu në Kosovë, ne përpiqemi që me secilin pro-gram t'i përgatisim institucionet dhe organizatat tona partnere të marrin përsipër punën që kemi filluar së bashku.

USAID-i është krenar të ketë qenë pjesë e zhvillim-it të hershëm të "Riinvest"-it dhe e inkurajoj institutin të vazhdojë fokusin në ofrimin e hulumtimit kualitativ ekonomik, të cilin njerëzit e Kosovës e meritojnë. Puna e institutit është shumë e rëndësishme për të ndërtuar një të ardhme më të ndritur për qytetarët e këtij shteti të mirë.

Për fund, do të doja të uroj Institutin "Riinvest" për shërbimin 20-vjeçar ndaj njerëzve të Kosovës. Ekipi i USAID-it ju dëshiron gjithë të mirat në shënimin e këtij rasti kaq të rëndësishëm.

Sinqerisht,

James Hope

USAID/Kosovo drejtor Misioni

CIPE



**John D.
Sullivan**

drejtor
ekzekutiv

15 mars, 2015

Lumir Abdixhiku, drejtor ekzekutiv
Instituti "Riinvest" për Hulumtime Zhvillimore
Lidhja e Prizrenit nr. 42
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

I dashuri z. Abdixhiku,

Qendra për Ndërmarrje Private Ndërkombëtare (CIPE) dëshiron të urojë Institutin "Riinvest" me rastin e shënimit të 20-vjetorit. Që nga themelimi i tij, Instituti "Riinvest" dhe CIPE kanë qenë partnerë strategjikë për t'i forcuar institucionet demokratike të Kosovës dhe për të përmirësuar mjedisin e saj rregullator të biznesit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

CIPE ka përkrahur "Riinvest"-in, nën udhëheqjen inspiruese të Dr. Muhamet Mustafës, për të drejtuar zhvillimin dhe rindërtimin ekonomik të Kosovës së pasluftës. Për shkak të suksesit të arritur, "Riinvest"-i shpejt arriti të njihej si lider regional në hulumtime ekonomike dhe avokim rregullash. Si njëri ndër partnerët më të vjetër dhe njëkohësisht më të besueshëm të CIPE-s, ne vazhdojmë të kemi një marrëdhënie pune produktive me udhëheqjen e re të "Riinvest"-it, me qëllim të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës në prokurim publik dhe qeverisje korporative në nivel publik dhe privat.

Tregimi i suksesshëm i "Riinvest"-it shërben si inspirim për kolegët e tyre gjithandej botës. Prej të gjithë ne nga familja CIPE, urime edhe për njëzet vjet të tjera!


Me shumë ngrohtësi,

John D. Sullivan

drejtor ekzekutiv

Andrew C. Wilson

zëvendës drejtor



KOMISIONI
EVROPIAN**Samuel Žbogar**

Shef i Zyrës
së Bashkimit
European në Kosovë
dhe Përfaqësues
Special i BE-së



5 maj, 2015

Kur mendoj për Riinvestin, tri gjëra menjëherë më bien ndërmend: se është qendër e prodhimit të diturisë, e ndarjes së edukimit-dhe e pranimi të përvojës së tjerëve. Kur kemi dashur që të kemi një pasqyrë të plotë rreth zakoneve dhe pritjeve të qytetarëve të Kosovës, Riinvesti na ndihmonte me sondazhe. Kur I përmendim qendrat e mira edukative në Kosovë tek kolegët dhe mysafirët tanë që vizitojnë Prishtinën, emri i Riinvestit është njëri ndër emrat që më së shpeshi e përmendim. Dhe unë jam personalisht krenar që kam qenë në gjendje të ndajë disa nga prioritetet tona politike dhe përvojave me studentët Riinvest – por edhe me profesorë!

E gjithë kjo tregon se sot një institucion serioz akademik, duhet të ketë ambicie si arsimore ashtu edhe kërkimore, nëse dëshiron të tërheqë studentët më të mirë dhe të konkurrojë në një treg global akademik. Fokusi i Riinvestit në studime ekonomike dhe hulumtimi është edhe më i rëndësishëm në kontekstin e situatës bashkëkohore të Kosovës. Na pëlqen të themi , e sidomos pas zgjedhjeve të 2014-ës , se Kosova duhet të dyfishojë përpjekjet e saj në fushën e qeverisjes ekonomike. Kjo është loja më e rëndësishme e Kosovës që është duke luajtur - pasi ajo është për fitoren e të gjithë qytetarëve , jo vetëm për disa prej tyre .

Bashkimi Evropian mbështet aktivitetet, të dedikuara për zhvillimin ekonomik , punësimin dhe mirëqenien . Ju i dini shumë mirë prioritetet tona : zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia mund të jenë të motivuar më së miri nëpërmjet

ekonomisë së tregut duke përmirësuar politikat fiskale për promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe përmirësimin e mjedisit biznesor. Ne mbështesim fokus të fortë mbi bujqësinë dhe kemi kuptuar se me rëndësi është që Kosova ka treguar potencial të fuqishëm në zhvillimin e turizmit .

Por më lejoni të shfrytëzoj këtë mundësi solemne të 20 viteve të punës suaj për të theksuar rëndësinë e të përqëndruarit në sektorë të tillë të rritjes të orientuar kah arsimi. Derisa investimet në arsim nuk japin rezultate të menjëhershme , janë një parakusht absolut për Kosovën për të zhvilluar një shoqëri të bazuar në dije dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik . Kjo duhet të bëhet në një mënyrë gjithë-përfshirëse , duke përfshirë shoqërinë civile , bizneset , investorët e huaj dhe madje edhe mediat .

Shoqëria lulëzon në qoftë se zhvillimi ekonomik është në nivel- por në fakt prova më e mirë e një lulëzimi të tillë shihet në fusha tjera më të buta, por që janë thelbësore për jetën shoqërore , sikurse arsimi, shëndetësia, shkenca dhe kultura . Kosova nuk duhet të nënvlerësojë këto fusha sepse ato janë politika të rëndësishme afatgjate zhvillimore.

Dhe është këtu , jo vetëm në kërkim të mundësive të reja , por gjithmonë duke insistuar në dimensionin njerëzor të zhvillimit të ardhshëm ekonomik dhe rëndësinë e standardeve të larta etike të shoqërisë së bazuar në dije , se institucionet akademike si Riinvesti duhet të gjejnë rolin e tyre - dhe të ardhmen ! Duke njohur stafin e përkushtuar dhe udhëheqjen e tanishme të Riinvest-it , unë jam më se i bindur se këto pritje do të përmbushen.

Ju e dini se si.

SDC

ZYRA ZVICËRRANE PËR BASHKËPUNIM

**Markus
Baechler**

Drejtor vendi,
Zyra Zvicerane për
Bashkëpunim, Kosovë



Urime 20-vjetori i "Riinvest"-it nga Zyra për Bashkëpunim Zviceran

17 mars, 2015

Për: **Ekipin editorial të Monografisë, Instituti "Riinvest"**

Nga: **Markus Baechler, SDC drejtor vendi**

Si Zyrë Zvicerane për Bashkëpunim, ne gjithmonë kemi punuar krah për krah me partnerët tanë lokalë, me qëllim që të sigurojmë zhvillimin e kapaciteteve lokale si dhe për të siguruar pronësinë lokale të ndërhyrjeve tona. Sapo filluam operimin tonë në fushën e punësimit dhe ekonomisë, ne kontaktuam me Institutin "Riinvest", i cili në atë kohë ishte i vetmi 'think-tank' lokal aktiv në fushën e zhvillimit ekonomik. Thujse përgjatë secilës fazë të zhvillimit programor, ne u takuam me "Riinvest"-in, qoftë për takime informative ose për t'i përdorur studimet e tyre hulumtuese, të cilat gjithmonë na kanë ndihmuar që të kuptojmë më mirë kontekstin e Kosovës dhe trendët e ndërlidhura të saj.

Përveç që kemi përfituar shumë nga njohuritë e Institutit "Riinvest", ne u patëm pajtuar të fillojmë një bashkëpunim në vitin 2005. Në atë kohë, Instituti "Riinvest" në bashkëpunim me Institutin për Shoqëri të Hapur (OSI), kanë qenë duke implementuar në Kosovë projektin Delta (Zhvillimi i ndër-marrjeve lokale nëpërmjet aksionit dhe aleancës). Qëllimi i këtij projekti

ishte ndërtimi i kapaciteteve njerëzore të zyrtarëve komunalë në dizajnimin dhe implementimin e strategjive për zhvillimin e aktiviteteve për projekte ekonomike, në drejtim të krijimit të një mjedisi më të mirë për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në këto komuna. Rreth 5 komuna janë përkrahur në atë kohë nëpërmjet bashkëpunimit tonë me "Riinvest"-in.

Më 2011, bashkë me Institutin "Riinvest", ne kemi lansuar një raport për përmirësimin e përfshirjes së komunitetit biznesor serb në aktivitetet ekonomike në Kosovë. Qëllimi i këtij projekti ishte të gjenerojmë një kornizë gjithëpërfshirëse dhe rekomanduese, se si palët e interesit mund të kontribuojnë dhe përkrahin mjedisin biznesor të serbëve të Kosovës, të bizneseve të serbëve të Kosovës, potencialet e tyre për zhvillim, pengesat për zhvillim dhe nivelin e bashkëpunimit me komunitetet e tjera biznesore në Kosovë. Puna hulumtuese dhe raporti ishin përgatitur nga Instituti "Riinvest".

Në të njëjtën kohë, bashkë me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Danimarkës (MFAD), ne i kemi besuar Institutit "Riinvest" implementimin e Entitetit të Lehtësimit për Sektorin e hortikulturës në Kosovë; projekt dyvjeçar që synonte të implementonte një hulumtim dhe zhvillim të strukturuar në zinxhirë të veçantë tregu apo sektori për të rritur ndikimin në sektorin e Hortikulturës. I gjithë intervenimi është bërë së bashku me palët kyçe (lokale) të interesit të zinxhirit të vlerës së Hortikulturës që çoi në zhvillimin e një analize të shëndoshë, në gjetjen e mundësive të përbashkëta të tregut

dhe implementimin e produkteve të reja dhe teknologjive inovative, që ishin duke u përdorur gjithnjë e më shumë nga aktorët e përfshirë në sektorin e Hortikulturës.

Për momentin, ne kemi një program që synon krijimin e mundësive të punësimit në sektorin privat që është më dinamik dhe gjeneron vende pune shtesë dhe mundësi të të ardhurave. Ky projekt zbatohet nga Swiss Contact dhe Instituti "Riinvest", të cilët punojnë së bashku nën modalitetin e partneritetit konsorcium.

Ne e vlerësojmë shumë bashkëpunimin e mirë që kemi pasur me Institutin "Riinvest" deri më tani dhe shpresojmë për një bashkëpunim të suksesshëm në programin aktual të Promovimit të punësimit në sektorin privat/PPSE por edhe për të punuar me "Riinvest"-in në projekte të tjera. Ne dëshirojmë t'i urojmë "Riinvest"-it për punën e bërë deri më tani, për gatishmërinë që të adaptojë mandatin e tij drejt qëllimeve të zhvillimit të vendit dhe për ofrimin e një shërbimi me cilësi të mirë, i cili ka qenë gjithmonë i jashtëzakonshëm.

Do të dëshiroja të uroj "Riinvest"-in për 20-vjetorin dhe shpresoj të vazhdojmë bashkëpunimin e shkëlqyeshëm në të ardhmen.

Gjithë të mirat,

Markus Baechler,

Drejtor vendi, Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, Kosovë

BANKA
BOTËRORE**Jan-Peter
Olters**Menaxher vendi,
BANKA BOTËRORE

15 prill, 2015

Të dashur kolegë,

Rezultatet e dobëta të tregut të punës mbeten thembra e Akilit për ekonominë e Kosovës. Përtej vijës politike, në mes të aktorëve kyçë të akademisë, shoqërisë civile, sektorit privat dhe medias, ekziston një konsensus i gjerë për nevojën e nxitjes së normave dinamike për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për të gjeneruar më shumë vende pune-e sidomos punë më kualitative dhe që paguhet më shumë për qytetarët dhe banorët e këtij vendi. Megjithatë, ekziston një konsensus shumë më i vogël në mes elitës politike dhe shoqërisë lidhur me shtyllat dhe prioritetet kryesore, siç është ajo e një strategjie gjithëpërfshirëse për zhvillim socio-ekonomik që do të drejtonte politikëbërjen ekonomike në dekadat e ardhshme. Në fakt, disa nga debatet më goditëse sillen rreth rolit që sektori privat (gjeneruesi më i rëndësishëm i punësimit) mund dhe duhet të ketë në ekonominë e Kosovës.

Që Kosova të bëhet një vend modern, dinamik, i begatë me perspektivat ekonomike të ngjashme me ato që mbizotërojnë në vendet e tjera evropiane, të gjithë aktorët e rëndësishëm të vendit duhet (i) debatojnë dhe unanimisht të dakordohen me përbërësit kryesorë të një modeli të përshtatshëm të rritjes; dhe (ii) të inkorporohen (nguliten) elementet kryesore në programet e zhvillimit të qeverive të njëpasnjëshme të formuara nga partitë politike që sot janë në qeveri, opozitë apo ende nuk janë themeluar.

Kosova ka pak forume (funksionale), në të cilat mundësohet debatimi mbi prioritetet e zhvillimit dhe si e tillë, shtyllat për një rritje modeli ekzistojnë por janë të pakta dhe me shumë përjashtime. Me të dhënat e tij në hulumtime të cilësisë së lartë dhe të përqen-

drimit në sfidat kryesore të zhvillimit, gjatë 20 vjetëve të fundit, "Riinvest"-i ka fituar jo vetëm kredibilitetin si një aktor i pavarur, profesional me aftësinë e dëshmuar për të prodhuar cilësi të lartë të politikave kërkimore, rigoroze, por edhe të arritshme, por ka shërbyer edhe si një thirrje e fuqishme, e aftë për të sjellë së bashku qeverinë dhe opozitën, politikanët, akademikët, dhe përfaqësues të sektorit privat, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit të përqendrohen, për të debatuar dhe të kërkojnë e gjejnë marrëveshje mbi sfidat kryesore, duke përfshirë edhe bërjen e politikave publike, klimën e biznesit, informalitetin ekonomik ose qeverisjen korporative. Në këtë, "Riinvest"-i është një Institut i domosdoshëm hulumtimi (një 'think-tank' në kuptimin më të mirë të fjalës), dhe ai mbetet i pakrahasueshëm në forcimin e pozitës së tij në qendër të debatit mbi sfidat e zhvillimit dhe kërkimit të mjeteve për përmirësimin e situatës për bizneset dhe njëkohësisht edhe për qytetarët e këtij vendi. Me rënien e normave margjinale të kontributit për zhvillim nga burimet "tradicionale" të rritjes, ky fakt bëhet edhe më i rëndësishëm për shoqërinë në tërësi të përfitojnë dhe shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që shërbejnë për rritjen e produktivitetit në sektorë kyçë të ekonomisë dhe si e tillë duhet zhvilluar një parametër ekonomik për një rritje më dinamike, më të qëndrueshme dhe më gjithëpërfshirëse në vitet dhe dekadat e ardhshme. Dhe kjo, sigurisht, e bën "Riinvest"-in edhe më të domosdoshëm, në vitet dhe në dekadat e ardhshme!

Urime për atë që është arritur dhe guxim për çfarë do të vijë në të ardhmen!

Singerisht Juaji,
Jan-Peter Olters
Menaxher vendi
Banka Botërore në Kosovë



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI TË HAPUR



Luan Shllaku
Drejtor ekzekutiv

12 mars, 2015

Kur fillova punën në vitin 1997 në Fondacionin Soros, më duhet të pranoj se shumë pak dija për shoqërinë civile në përgjithësi, e sidomos për atë në Kosovë. Në vitet e 90-ta kishte aq shumë iniciativa civile në njërën anë, dhe aq pak organizata civile të regjistruara, që sillte një paradoks shumë interesant: kur i tërë vendi ishte vendosur në binar civil të udhëheqjes, si dhe funksionimit në përgjithësi, numri i organizatave të cilave sot iu themi organizata joqeveritare, ose jofitimprurëse, ishte simbolik. Ekzistonin tri apo katër sosh. Ishin shumë të forta, të organizuara mirë dhe kishin kapur pozicion të rëndësishëm brenda zhvillimeve politike dhe socio-ekonomike të asaj kohe, të cilat ishin edhe mjaft turbulente. Në këtë kohë u njoha me njërën nga këto organizata, Institutin "Riinvest". Nën udhëheqjen e Muhamet Mustafës, i cili tashmë e kishte një bagazh të madh ekspertize dhe eksperience në fushat ekonomike, por edhe në politikë, Instituti "Riinvest" shumë shpejt zuri vend të rëndësishëm në skenën rajonale të insti-

tuteve zhvillimore, për të cilët mësuam se quhen 'think-tank'. Me analizat që Instituti vazhdimisht i bënte plotësohej mozaiku ekonomik i rajonit, i cili filloi të shihej me një dioptri specifike, pas lëvizjeve dezintegruese të ekonomive të ish-Jugosllavisë. Me "Riinvest"-in patëm fat që unë dhe kolegët e mi të Fondacionit Soros të vendosim një partneritet shumë të ngushtë në vitet e para të pasluftës, që kulmoi pas luftës, kur u bëmë bashkëpunues të 'Forumit 2015', të cilin së bashku edhe me organizatën KACI, e vumë në lëvizje në mars të vitit 2003. Një platformë avokuese si kjo, është ushqyer vazhdimisht me analizat e thella që Instituti "Riinvest" ia bënte ekonomisë kosovare, si dhe politikave publike në resorë të ndryshëm, që gjenëronin vazhdimisht jo vetëm informim më të mirë të opinionit për këto çështje zhvillimore, por edhe rekomandime konkrete për t'i avancuar çështjet me të cilat merrej 'Forumit 2015'.

Ajo që Institutin "Riinvest" e bënë shumë specifike brenda skenës së institucioneve civile në Kosovë, është se ai vazhdimisht ka shkolluar kuadro, sidomos në lëmin e ekonomisë, të cilët sot janë bërë bartës të iniciativave më të shënuara, jo vetëm të

shoqërisë civile, por edhe asaj universitare, akademike dhe administrative. Për të arritur këtë, instituti, shumë para se të dilte nga struktura e tij Universiteti "Riinvest", i ka specializuar kuadrot e veta në universitete prestigjioze evropiane. Ishte një veprim shumë largpamës dhe efikas që la gjurmë në zhvillimet më pozitive në skenën ekonomike dhe atë shoqërore në Kosovë.

Dhe në fund, një trajektore zhvillimore kaq e shëndosh dhe largpamëse e Institutit "Riinvest", patjetër që do t'u hapë rrugë gjeneratave të reja, të cilat vetë i shkolloi dhe iu dha shans të akumulojnë jo vetëm ekspertizë por edhe eksperiencë në punët e një 'think-tank' modern. Sot, Instituti udhëhiqet nga një brez i ri i ekspertëve që janë në rrugën më të mirë të bëhen ajka e ekspertizës kosovare në lëmenjtë që mbulojnë, për të cilën kemi aq shumë nevojë. S'kam fare dyshim se "Riinvest"-i do të vazhdojë të ketë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimet e ardhshme në shtetin tonë të ri, dhe se do të jetë, siç ka qenë deri sot, një vend energjie për ekspertët e rinj kosovarë.

Luan Shllaku

Drejtor ekzekutiv

FONDACIONI FRIEDRICH EBERT (FES)



Dr. Besa Luzha
Koordinatore e
Programit,
FRIEDRICH EBERT
STIFTUNG

12 mars, 2015

Instituti "Riinvest" është njëri ndër institutet e para me të cilat Fondacioni Friedrich Ebert (FES) ka bashkëpunuar që në fillim të punës së tij në Kosovë. Analizat mbi vizionin ekonomik, modelin e privatizimit dhe kahet e zhvillimit ekonomik të Kosovës, kanë qenë temat me të cilat kemi nisur debatin publik në mes të institucioneve dhe shoqërisë civile e ekspertëve për çështje fundamentale të zhvillimit të shoqërisë së Kosovës. Deputetëve të Parlamentit të Kosovës, mandatarëve të parë, së bashku me "Riinvest"-in u kemi ofruar trajnimet e para mbi buxhetin, politikat ekonomike dhe zhvillimore dhe kemi bashkëpunuar edhe në analiza konkrete mbi këto politika, të cilat u kanë ndihmuar deputetëve që të marrin vendime të mirinformuara.

Analiza mbi situatën e krijuar pas bllokadës së Marrëveshjes CEFTA, politikat energjetike dhe studimi i parë mbi informalitetin në Kosovë, i cili ofron të dhëna konkrete mbi sektorin infor-

mal të ekonomisë kosovare, janë dokumente të rëndësishme në të cilat referohen institucionet lokale dhe ndërkombëtare.

Të gjitha këto produkte të realizuara nga "Riinvest"- dhe me përkrahje të Fondacionit Friedrich Ebert, kanë ndihmuar debatin mbi politikat të bazuar në argumente, të dhëna dhe kanë ofruar rekomandime konkrete, shumë prej të cilave janë marrë në konsiderim nga vendimmarrësit. Këto kanë qenë të mundura vetëm falë përkushtimit të të gjithë stafit të "Riinvest"-it, që me dijen dhe profesionalizmin e tyre kanë kontribuar në realizimin e këtyre dhe shumë e shumë produkteve të tjera të përbashkëta në fushëveprimin e ekonomisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Së fundi, Akademia për Zhvillim Rajonal në partneritet me Komisionin Evropian dhe Institutin "Riinvest", është duke ofruar ndihmë konkrete në zhvillimin ekonomik lokal, duke i aftësuar zyrtarët përgjegjës në nivel të komunave për të hartuar, vlerësuar dhe implementuar projekte të rëndësishme të zhvillimit me ndikim në lokalitet apo komunë, përmes komponentit

të granteve të vogla, por më e rëndësishmja është që ata po aftësohen për të aplikuar për fonde evropiane dhe të donatorëve të tjerë me projekte konkrete, të hartuara drejt, dhe që mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm. Kjo është detyra e shoqërisë civile dhe misioni i FES-it në Kosovë, që me thellimin në fushat e specializuara sipas disiplinave të caktuara, t'i analizojnë politikat dhe veprimet e institucioneve vendimmarrëse me vështrim kritik dhe të ofrojnë modele, zgjidhje dhe alternativa konkrete për problemet konkrete.

Mbi këtë konstatim, Friedrich Ebert Stiftung falënderon Institutin "Riinvest" për këtë bashkëpunim shumëvjeçar, i cili do të vazhdojë edhe në të ardhmen, bazuar mbi të njëjtin mision-zhvillim e një Kosove demokratike dhe me vizion të qartë për zhvillim dhe integritet.

Dr. Besa Luzha,
Koordinatore e Programit,
Friedrich Ebert Stiftung



5

MIQTË TANË



IRAJ
HASHI

STAFFORDSHIRE
UNIVERSITETI

Kam qenë i lidhur me Institutin "Riinvest" qysh nga viti 1998 dhe i kam vizituar ata disa herë gjatë çdo viti që nga atëherë. Kam punuar me ta në projekte të ndryshme kërkimore, konferenca dhe aktivitete edukative siç janë ato të shkollave verore. I kam shikuar duke lëvizur nga një vend në tjetrin çdo vit dhe kam vërejtur fytyra të reja çdo herë që i kam vizituar. Unë i kam parë ata të rriten jo vetëm në numër, por më e rëndësishmja në cilësinë e punës së tyre dhe pjekurinë e stafit të tyre të ri. Kam parë udhëheqjen e Institutit duke u transferuar nga brezi i vjetër, themeluesit, te brezi i ri, i cili ka punuar shumë për t'i arritur këto avancime, zhvillimin e njohurive të tyre, kualifikimet dhe aftësitë gjatë këtij rrugëtimi. Derisa në vitet e mëparshme ata u mbështetën shumë në ndihmën e konsulentëve të huaj për projektet e tyre, gradualisht zhvilluan dhe ndërtuan aftësitë dhe kapacitetet e tyre, kështu që pjesën më të madhe të punës tani e bëjnë vetë pa pasur nevojë të kenë ndonjë konsulent të huaj pranë.

Ky ka qenë një udhëtim i mrekullueshëm për Institutin "Riinvest", themeluesit e tij, udhëheqësit e tanishëm, atij të kaluarit si dhe stafit të tij. Përgjatë viteve, Instituti ka qenë një terren trajnimi për shumë të rinj kosovarë, të cilët ka punuar atje për disa vjet rresht dhe janë zhvendosur për të punuar në institucione dhe kompani të tjera, ku kanë përdorur atë që kanë mësuar në "Riinvest". Instituti "Riinvest" ka qenë fantastik në investimin e tij në kapitalin njerëzor dhe, edhe pse jo gjithmonë ka pasur përfitim të drejtpërdrejtë nga ky investim, të paktën ka bërë një kontribut të rëndësishëm në ngritjen e nivelit intelektual dhe akademik të disa gjeneratave të studiuesve dhe akademikëve të Kosovës.

Tre faktorë e kanë bërë "Riinvest"-in të veçantë për mua. Së pari, ata gjithmonë kanë punuar me integritet dhe pavarësi dhe kurrë nuk u janë nënshtruar ndikimeve dhe presioneve politike. Ata asnjëherë nuk kanë qenë të varur nga Qeveria dhe për këtë arsye kanë qenë në gjendje që t'i ndjekin dhe realizojnë objektivat e tyre pa u shqetësuar në lidhje me

reagimin e qeverisë apo donatorëve për hetimet e tyre. Ata mund të kenë paguar një çmim për pavarësinë dhe integritetin e tyre, por ia ka vlejtur.

Së dyti, ata kanë qenë gjithmonë të gatshëm që të mbështesin stafin e tyre të ri, në mënyrë që t'i përmirësojnë njohuritë e tyre dhe të rrisin nivelin e tyre intelektual për t'u bërë hulumtues më të mirë. Edhe pse shumë prej tyre u larguan nga Instituti pas arritjes së kualifikimeve më të larta, kjo nuk e ndali Institutin që t'i përkrahë gjeneratat e ardhshme të stafit të tyre. Përkundrazi, ata vazhduan të ofrojnë mundësi të vetëpërmirësimit për stafin e tyre pavarësisht nëse ata vendosnin të qëndronin me institutin apo jo. Jo shumë institucione këtu në Kosovë ose në vendet perëndimore janë aq bujare me stafin e tyre. Por pastaj, jo shumë institucione në Kosovë ose në vendet perëndimore gëzojnë një respekt dhe dashuri të tillë nga ana e stafit të tyre aktual apo të mëparshëm.

Së treti "Riinvest"-i ka luajtur edhe rolin e një organizate serioze të shoqërisë civile, duke inkurajuar përfshirjen e qytetarëve në debatimin e çështjeve, të cilat kanë pasur ndikim të rëndësishëm në shoqëri dhe ngritjen e vetëdijes publike për shumë çështje- duke filluar nga metodat alternative të privatizimit të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore në fillim të viteve 2000, qeverisjen korporative të bankave dhe ndërmarrjeve të mëdha publike në fund të 2000-s, dhe debati i tanishëm mbi Kompleksin e Minierave të Trepçës. Ky është një shërbim ndaj shoqërisë, i cili nuk është ofruar asnjëherë nga organizata të tjera.

Në 20 vjetët e fundit, Instituti "Riinvest" ka shkuar nga fuqia ose forca, ka zgjeruar shtrirjen dhe cilësinë e punës së tij në mënyrë të konsiderueshme dhe, çka është më me rëndësi, falë themeluesve të tij, brezat e rinj kanë marrë përsipër drejtimin e Institutit. Instituti ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për kapitalin njerëzor dhe zhvillimin ekonomik të këtij vendi. Unë i përgëzoj themeluesit, të përfaqësuar nga profesor Muhamet Mustafa dhe gjeneratën e re të liderëve, të përfaqësuar nga Dr. Lumir Abdixhiku. Le të vazhdojë puna juaj e mirë edhe për shumë mote.

20-vjetori i "Riinvest"-it: një ëndërr e projektuar mirë



VETON
SURROI
PUBLICIST

Kur para njëzet vjetësh Muhamet Mustafa më kërkoi një nder, që të shkruaja një letër përkrahëse CIPE-s (Qendrës Ndërkombëtare për Ndërmarrësi Private) në Uashington, nuk dija saktësisht se çka është ajo që unë duhej të përkrahja. Më tingëllonte si emër ndërmarrjeje, "Riinvest", d.m.th. aktivitet komercial që çon kah ri-investimi. Asokohe, më 1995, ndërmarrësia dhe çdo aspekt tjetër i jetës në Kosovë ishte e ndrydhur nën okupimin serb dhe vetëm ideja se dikush po fillonte një iniciativë të re ishte njëkohësisht e lodhshme (për shkak të vështirësive lehtë të evidentueshme nga pushteti serb) dhe sfiduese (për shkak se ende kishte energji për të filluar gjë, ani pse diheshin vështirësitë).

Kisha besim te shpjegimi i Muhamet Mustafës, se po planifikohej një institut që do të merrej me ekonomi, që do të analizonte rrjedhat ekonomike dhe do të përgatiste vizionin për ardhmëri. Në Kosovën e okupuar, që të gjithë ishim ëndërrimtarë, që të gjithë jetonim dhe vepronim me ëndrrën se okupimit do t'i vinte fundi. Ëndrra e "Riinvest"-it mu duk si pjesë e një ëndrrë të projektuar mirë: një ditë, kur të çliroheshim, do të na duhen njerëz dhe ide për të ngritur në këmbë ekonominë e vendit të cilën okupimi po e fundoste qëllimisht.

Ky besim në ëndrrën e themeluesve të "Riinvest"-it më bëri të ndihem i shpërblyer gjatë gjithë këtyre viteve të jetës së "Riinvest"-it. Gjatë këtyre viteve, ndërsa merrja pjesë në konferenca ndërkombëtare të instituteve e organizatave të tjera me nam në botë, zëri pjesëmarrës i "Riinvest"-it, qoftë si diskutues, qoftë si material analitik për debat (i cituar nga diskutuesit, përfshirë edhe mua), krijonte nivelin e seriozitetit që argumenteve për dhe rreth Kosovës u jepte besueshmërinë e duhur.

Më 1999, kur duhej të nisej delegacioni kosovar për në Rambouillet, kërkova ndihmën e Muhamet Mustafës dhe ekspertëve të tjerë

të "Riinvest"-it, në mënyrë që, po qe nevoja, delegacioni i Kosovës të këshillohej me të shpejtë për çështjet ekonomike, me çështje të larmishme, si për shembull rregullimi i marrëdhënieve tatimore mes Kosovës e Serbisë në kohën kur Kosova duhej të ishte nën protektorat apo për çështjen e sukcesionit (përfshirë këtu pronat dhe borxhet ndërkombëtare).

Asokohe konstatova një shpërputhje mes këshillës dhe të këshilluarit: "Riinvest"-i ishte në rrugë të mirë të krijonte një këshillë konsistente ekonomike, por Kosova nuk ishte në rrugë të mirë të krijonte udhëheqje që do të dëgjonte atë, këshillën konsistente ekonomike.

Në këtë ambient, pak a shumë, është zhvilluar aktiviteti i "Riinvest"-it pas çlirimit. Në këtë ambient ky Institut mund të mos ketë prodhuar shumë këshilla që të jenë dëgjuar prej pushteteve, qoftë atij ndërkombëtar, qoftë atij vendor në Kosovë, por me një konsistencë ka krijuar gjenerata të reja studiuesish e praktikuesish, të cilët ruajnë sa dinjitetin e tyre akademik aq edhe pavarësinë nga nënshtrimi, qoftë politikës qoftë parapolitikës dhe presioneve të saj.

Gjatë gjithë këtyre viteve, pjesëmarrja e "Riinvest"-it në tryezat e shoqërisë civile ka qenë një domosdoshmëri edhe në kuptimin e thellësisë së debatit, edhe si dëshmi e evidente se në Kosovë ka mendim kreativ e analitik, ani pse ai nuk dëgjohet në institucionet shtetërore.

Sot, në të mbushur 20 vjet, "Riinvest"-i është i përgatitur për një kohë tjetër, kur do të çlirohemi nga primitivizmi në elita udhëheqëse, kur në këtë vend të mos ekzistojë shpërputhja mes kapacitetit për të dhënë këshilla dhe mungesës së kapacitetit për t'i pranuar ato.



SHKËLQIM CANI

MINISTËR I
FINANCËVE NË
REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË

Lidhja dhe bashkëpunimi me Kosovën, pjesë e kombit shqiptar, ka qenë një ëndërr e kahershme. Për shkak të rrethanave të kushtëzuara nga regjimet politike si në Shqipëri, edhe në Kosovë, dhe për shkak të ngjarjeve që bënë histori në fund shekullin e 20-të për kombin shqiptar, mundësia e bashkëpunimit ishte rreptësisht e kufizuar dhe ëndrra mbeti ëndërr...

Por jo pafund. Ngjarjet që pasuan luftën e vitit 1999 hapën një faqe krejt të re për Kosovën, të cilat u finalizuan me shpalljen e Pavarësisë më 17 shkurt 2008. Ishte kurorëzim, ku edhe ne ndjeheshim si kontribuues sadopak. Kjo sepse që në vitin 2007 kisha filluar bashkëpunimin me "Riinvest"-in. Bashkëpunimi me "Riinvest"-in filloi me zjarrin dhe dëshirën e njohjes së pjesës tjetër shqiptare, aq e afërt dhe aq e largët. E prita me kënaqësinë më të madhe propozimin për bashkëpunim dhe njëkohësisht me emocionet e një gjëje të re. Përgjegjësia e kontributit, e pjesëmarrjes në jetën akademike në Kosovë dhe e edukimit të brezit të ri të pasluftës ishin të mbuluara nga ndjesi të veçanta. Për shkak të mosnjohjes shumë të mirë të situatës, mbaj mend se sa pyetje më pushtonin. Duke filluar që nga gjuha, nga fjalori që duhet të përdorja, nga ritmi i të folurit... e kështu me radhë. Sigurisht që sot tingëllojnë si fëmijërore, por sot jemi 8 vjet më pas që kanë njohur zhvillim të paparë. Si në shumë fusha të tjera, edhe këto hamendësi nuk ekzistojnë më. Po për mua mbeten të bukura, se janë të fillimit.

Bashkëpunimi me "Riinvest"-in përfshiu mësimdhënien në programet e masterit dhe studime të kërkimit shkencor, ku "Riinvest"-i patjetër ka meritën si një nga institucionet leader në Kosovë, me studime që përfshijnë jo vetëm Kosovën, por edhe rajonin.

Kam qenë krenar që së bashku me profesoratin dhe stafin e "Riinvest"-it kemi punuar ngushtë për krijimin e programeve të para të specializuara në nivelin master në fushën e lëndëve të bankave bashkëkohore, Strategji të zhvillimit bankar, Financa ndërkombëtare, Menaxhimi i riskut bankar dhe Ekonomi zhvillimi. Me synimin e tërheqjes së një numri të konsiderueshëm studentësh që vinin jo vetëm nga bankat e shkollës, si proces normal i studimit, por edhe me përvoja direkt nga fusha e financës dhe e bankave, njerëz me dëshirë për të

përditësuar njohuritë e tyre, për të rritur konkurrueshmërinë në treg dhe për t'u aftësuar më mirë. Një interes i admirueshëm nga ata që kërkonin dije, që kërkonin të kapnin kohën e humbur, një vullnet i paparë nga ata që nuk i ndërprejnë studimet edhe në kushtet e vështira përpara luftës. Ishim me ta jo vetëm në raportin profesor – student, por edhe si miq, si vëllezër, si shokë. Kureshtja e tyre për të njohur më shumë për Shqipërinë, ashtu si imja për të njohur më shumë për Kosovën, ishte një shkollë më vete. Dhe për këtë më duhet ta falënderoj në mënyrë të veçantë "Riinvest"-in për mundësinë që më dha për të pasur më shumë shokë e miq në këtë anë të kufirit. Marrëdhënia me studentët ishte njëra anë. Por po kaq e veçantë dhe emocionuese ishte marrëdhënia me stafin akademik të "Riinvest"-it. Një staf i përkushtuar për të garantuar si element të parë në tërheqjen e studentëve cilësinë akademike. Programet e hartuara dhe të rishikuara nga viti në vit ishin baza e suksesit të mësimdhënies. Nevojat e ekonomisë së re të Kosovës ishin themelet e punës kërkimore- shkencore. Këtu u përfshinë edhe shumë studentë nëpërmjet temave të kursit apo punimeve për diplomë. Ndërkohë që vetë stafi akademik ishte i angazhuar në shumë veprimtari të karakterit kombëtar dhe ndërkombëtar. Më ka impresionuar aftësia e tyre, sidomos në punë analitike, metodat e përparuara shkencore të kërkimit, niveli i lartë në fushën e statistikës dhe IT-së, njohja shumë e mirë dhe lidhjet e tyre me shumë institucione publike e private në Kosovë e më gjerë. Kemi diskutuar shumë shpesh së bashku për rrugët e zhvillimit, për makroekominë, për financat dhe bankat. Këto janë fusha që i dua shumë dhe nuk hezitoj të ndaj me këdo përvojën, eksperiencën, dijet e mia. I hapur ndaj kolegëve që sillnin eksperiencë dhe këndvështrime origjinale, sidomos në veçoritë që paraqet ekonomia e Kosovës. Një bashkëbisedim dhe bashkëpunim që edhe tani që jam ministër i Financave, nuk e kam nënvleftësuar dhe, sa herë kam gjetur kohë, jam munduar të jem i pranishëm. Kjo, sepse në një mënyrë ose në një tjetër, dua apo s'dua unë, unë jam pjesë e këtij institucioni të nderuar.

"Riinvest"-i për mua është një pikëlidhje e fortë me Kosovën. Prandaj e vlerësoj, e çmoj, e nderoj dhe e vazhdoj. Faleminderit "Riinvest" për këtë eksperiencë të pazëvendësueshme!



BATON HAXHIU

KLAN KOSOVA

Në kohën kur të gjithë vraponin për të bërë politikën, në “Riinvest” bënë institucionin. Kjo natyrë e angazhimit intelektual në kohën e pasluftës ishte vështirë e shpjegueshme. Por ka mbetur shumë pak e kuptueshme edhe në ditët e sotme, kur të gjithë dëshirojnë famën dhe paret brenda natës. “Riinvest” është ndër të rrallët që ka refuzuar modelin e kohës së pasluftës ku motoja kryesore ka qenë përmbysja e gjithçkaje që ka një prejardhje dhe që ka dijen si koncept. “Riinvest” ka refuzuar moton e pasluftës: “kanë ndryshuar kohët, kanë ndryshuar njerëzit, kanë ndryshuar vlerat-tash jemi ne që vendosim?!”

“Riinvest” ka ndryshuar trendin duke relativizuar patriotizmin primitiv dhe ka vendosur kritere duke qenë të qartë me patriotizmin; se Patriotizmi është relativ.

“Riinvest” ka qenë i qartë se patriotizmi dhe dashuria ndaj vendit nuk barazohet vetëm me kapjen e pushtet; sepse kanë ditur me qartësi se për tjetrin patriotizmi, paraqet angazhimin konkret, material ose financiar; për të tretin, simbolika e flamurit është fillimi dhe mbarimi; për të katërtin, patriotizëm është ofrimi i një libri, një filmi kurse vet grupi i “Riinvest”-it kanë themeluar institutin e dijes.

Te ne, tash, në shumicën e rasteve suksesi dhe e arritura nuk e kanë as më të voglën ndërlidhje me intelektualen, me dijen, me institutet, dhe sukseset konjunkturale janë në proporcion të zhdrejtë me ndikimin intelektual.

Kosova pas luftës ka refuzuar të ketë mendimin për dijen institucionale dhe ka qenë në krizë duke qenë pagjasa përballë yryshit të mediokritetit. “Riinvest”, për dallim të shumëkujt, ka refuzuar të gjitha trendet e gjetura rrugës dhe me heshtje pune e ndikim të vazhdueshëm është shndërruar në udhëheqës të transformimit të realitetit shoqëror dhe politik në Kosovë.

Se sa do të vlerësohet kjo në të ardhmen, nuk ka asnjë lidhje me Institutin, por me vetëdijen dhe moralin e atyre për të cilët u bë sakrifica.

Në shoqëritë ku ka mungesë rregulli, njerëzit e dijes janë nxitës të debatit shoqëror dhe kanë ndikim në analizimin ideor të proceseve të rëndësishme.

Të bëhesh intelektual i një instituti të pavarur i një populli të vogël dhe të pazhvilluar gjithmonë është vendim me peshë.

Fatkeqësia e vendeve si Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia është se vlerësimi i rolit të intelektualëve publikë është i lidhur ngushtë me ndryshimet politike në zgjedhje dhe në parti. Kjo nuk ka ndodhur me “Riinvest”-in. Lexuesit e eseve të grupit të “Riinvest”-it, pastaj analizave politike, ekonomike, sociologjike, filozofike, për religjionin, pushtetin, globalizimin, identitetin, ndryshimet gjeostrategjike, e të tjera, do ta kenë krijuar ndjenjën e krenarisë për pasjen e një Instituti publik shqiptar i cili ka kontribuar lokalisht në debatet e zhvilluara globalisht pa qenë të ndikuar nga politika. Është mëkat që ato nuk kanë marrë përmasat e seriozitetit të duhur në Kosovë për shkak të fitores së mediokritetit, dhe për fat të keq kanë mbetur vetëm brenda Kosovës. Në rrethana normale, çdo periudhë kohore e krijon gjeneratën e vet të intelektualëve të rëndësishëm publikë. Pastaj, me gradualitet bëhet ndryshimi i saj me gjeneratën pasuese.

Në Kosovë, deformimet në zhvillimet shoqërore e kanë pamundësuar fitoren maksimale të “Riinvest”-it, por ky Institut ka krijuar individë që e kanë mbajtur peshën e analizave ekonomike dhe sociale, për të gjithë. Prandaj, dhemb shumë pse kemi humbur kaq shumë kohë që nuk e kemi pranuar me kohë që “Riinvest” të jetë si udhërrëfyes i programit ekonomik dhe politik të institucioneve të Kosovës. “Riinvest” nuk është vetëm institut i njerëzve që krijuan, është dije dhe kulturë, njëkohësisht.



AGRON
BAJRAMI

KOHA DITORE

Lajmi nuk vlen as për pesë pare, nëse nuk mbështetet në fakte. Në fakt, lajmi pa fakte as që është lajm! Por, ajo që njeriu e merr vesh si gazetar shumë shpejtë është se arritja deri tek faktet nuk është edhe punë aspak e lehtë. Përkundrazi! Zbulimi i fakteve, interpretimi i tyre në mënyrë të drejtë, dhe përfundimisht prezantimi i tyre para lexuesve në mënyrë kredibile, të besueshme, është ajo që e bën një artikull në gazetë të jetë i besueshëm.

Sigurisht, kjo vlen për çdo lloj raportimi, por posaçërisht peshon në raportimin e çështjeve ekonomike, ku njohuria e specializuar është shpesh herë e domosdoshme për të interpretuar një fakt, për të identifikuar një trend, për të përcjellë drejt një zhvillim, apo për të paraparë pasojat e mundshme për Kosovën dhe qytetarët e saj, madje edhe kur flasim për zhvillime globale që shumë kujt i janë dukur tepër të largëta për të ndikuar tek ne, sikur që ishin krizat financiare e ekonomike të disa viteve të fundit në Evropë dhe SHBA.

Instituti "Riinvest", me analizat, raportet, konferencat e tryezat e organizuara gjatë gjithë kohës ka qenë faktori qendror në informimin rreth çështjeve ekonomike dhe zhvillimore. Ka qenë burim i fakteve për të parë ku kemi gabuar në të kaluarën, si duhet punuar sot dhe çka na pret në të ardhmen. Ka qenë interpretuesi i politikave që e zhytën Kosovën çdo herë edhe më thellë në baltën e stagnimit ekonomik, por edhe ofrues i alternativave si duhet dalë prej saj. Ka qenë aktiv në avokimin e çështjeve të vlefshme për shoqëri, si pjesë e asaj cope të vogël të shoqërisë civile të Kosovës që mbeti e angazhuar gjatë gjithë kohës. Ka ngritur zërin kundër politikave të dëmshme, pa marrë parasysh kush i ka sajuar ato, kush i ka sponsorisuar, dhe kush i ka përkrahur. Ka qenë, dhe mbetet institucion që punon në shërbim të qytetarit, dhe jo për

interes të një grupi të ngushtë politik, ekonomik apo shoqëror, sikur shumë të tjerë.

Për këtë arsye, dhe për shumëçka tjetër, që nga themelimi 20 vite më parë e deri më sot, Instituti "Riinvest" ka qenë i pazëvendësueshëm, si për gazetarët ashtu edhe për publikun e gjerë. Posaçërisht Koha Ditore ka përfituar nga ekspertiza e Institutit "Riinvest", analizat e të cilit na kanë shërbyer në misionin tonë të informimit të saktë, të drejtë dhe me kohë të publikut Kosovar për ngjarjet dhe perspektivat ekonomike. Ndërsa kolumnet e drejtorit të Institutit, Lumir Abdixhikut, janë bërë sinonim për analizë të saktë ekonomike të zhvillimeve që kanë ndodhur, dhe paralajmërim të hershëm për ato që do vijnë.

Në këtë kohë kur secili mund ta thotë atë që e mendon, madje edhe kur e ka gabim, vlere e fjalëve të mbështetura në fakte, sikur edhe interpretimi objektiv i tyre, është shtuar shumëfish. Ndërsa fjala e thënë nga Instituti "Riinvest", peshon më shumë se çdo tjetër kur flasim për ekonominë.

Dhe jo vetëm ekonominë...



AFËRDITA SARAÇINI

RTV21

Viti 1995 shënon shumë hapa të rëndësishëm të ndërmarrë atëbotë në kuadër të shoqërisë civile. Njëri ndër hapat kryesorë dhe me shumë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit është edhe themelimi i Institutit "Riinvest". Institutit "Riinvest" në kushtet e paraluftës solli një informacion më shumë për të gjithë në Kosovë, sidomos gjatë viteve 1995-2000, ndërsa prej këtij viti e këndej Institutit "Riinvest" solli një frymë të re të të menduarit dhe një mendim tjetër lidhur me zhvillimin ekonomik në Kosovë dhe rajon.

RTV21 gjatë kësaj periudhe Institutin "Riinvest" e kishte si pikë referimi për hulumtimet lidhur me zhvillimin ekonomik, gjithnjë duke u konsultuar dhe duke marrë mendimin e ekspertëve që kanë kontribuar në këtë institut me vite.

Shumë çështje madhore ekonomike të vendit, shumë çështje që trajtoheshin edhe si tabu, janë trajtuar në debatet tona televizive, jo vetëm përmes konsultave të gazetarëve tanë me ekspertë të këtij Instituti, por edhe me pjesëmarrjen e ekspertëve në fjalë në debatet e tilla.

Institutit "Riinvest" ka dhënë kontributin e vet edhe përmes publikimeve të shumta mbi zhvillimin modern ekonomik të Kosovës, ka publikuar hulumtime mbi politikat për avancimin e bizneseve dhe krijimin e kushteve për bizneset sidomos për bizneset e vogla dhe të mesme, dhe si i tillë edhe ka krijuar opinion publik lidhur me atë se si duhet krijuar kushtet dhe cili është drejtimi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë.

Parametrat e Institutit "Riinvest" lidhur me zhvillimin ekonomik janë përmendur në debatet televizive në RTV21 jo vetëm nga ekspertë të këtij instituti, por edhe nga ekspertë tjerë, njohës të zhvillimit ekonomik si të vendit ashtu edhe të huaj.

Çështjet në të cilat janë ndalur ekspertët ekonomikë e që u janë referuar hulumtimeve të Institutit "Riinvest", kryesisht kishin të bëjnë me tregun e punës dhe zbutjen e papunësisë, qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës, pastaj hulumtimi i këtij instituti lidhur me investimet e jashtme direkte në Kosovë si dhe çështje tjera shumë vitale për ekonominë e Kosovës.

Njëzetvjetori i themelimit, Institutin "Riinvest" e gjen në një ambient ku ende kërkohet shumë punë dhe ku ky institut do ta ketë rolin e vet në mendimin kritik lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Kosovë, gjithnjë duke u bazuar në hulumtimet dhe punën profesionale në përgjithësi që bën ky Institut në këtë fushë.

Me respekt,

Afërdita Saraçini Kelmendi

ARBANA
XHARRA

GAZETA ZËRI

Në rrethana dhe kohë të ndryshme, gjithçka sheh, lexon dhe kupton ndryshe. Katërmëdhjetë vjet më parë, isha vetëm 19 vjeçe, kur nisa punën si gazetare. Një rrugëtim i ri për mua, plot sfida dhe të panjohura. Ekonomia ishte sektori i fundit që më kishte shkuar mendja se do ta mbuloja, për më shumë se dhjetë vjet gjatë karrierës sime. Nuk kisha njohuri në çështjet ekonomike, dhe aq më pak në leximin e linjave buxhetore, apo analizimin e interesave politike përmes numrave.

Por, gjeta një derë, që ishte çdoherë e hapur për mua, dhe një grup ekspertësh, që pa përtesë uleshin në tryezë për të më sqaruar të panjohurat, ato që në fakt definonin në thelb problemet esenciale të shtetndërtimit. Në fillim i lexoja thjesht si tekste dhe statistika, raportoja konferencat pa e kuptuar se kjo derë mobilizonte opinionin publik përmes medieve për çështje të mëdha ekonomike.

Instituti për Hulumtime Zhvillimore "Riinvest", nuk ishte thjesht një Institut për publikimin e raporteve, analizave dhe hulumtimeve. Ai sfidonte pushtetin me fakte dhe argumente. Rrethanat problematike të periudhës së vështirë në tranzicion, atëherë kur politika dominonte mbi ekonominë, ishin sfida të vazhdueshme, por "Riinvest"-i me përkushtim vazhdoi misionin e tij drejt avokimit të politikave zhvillimore, duke i qëndruar me llupë secilit që vinte, binte dhe sërish rikthehej në pushtet.

Nuk e kishte të panjohur ballafaqimin me degradimin, sepse "Riinvest"-i aktivitetin e tij e kishte nisur në një periudhë shumë më të rëndë, atë të regjimit të Milosheviqit. I themeluar në vitin 1995, vazhdoi për dy dekada me radhë, me përkushtim dhe profesionalizëm, në partneritet me organizata ndërkombëtare, duke u shndërruar gradualisht në faktorin më me ndikim të çështjeve ekonomike në opinionin publik të Kosovës. Në secilën periudhë, për këto 20 vjet, "Riinvest"-i

asnjëherë nuk iu nënshtrua politikës, përkundrazi duke e kritikuar me të gjeturat që prezantonte intensivisht përpara opinionit, ai ofronte edhe zgjidhje përmes strategjive për zhvillim ekonomik.

Ky Institut ishte nxitës i debateve për ambientin e investimeve në Kosovë, procesin e degraduar të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, ndërmarrësisë, etj. "Riinvest"-i, njëkohësisht solli një frymë të panjohur për shoqërinë civile në Kosovë, model tjetër të ofrimit të zgjidhjeve, përcjellë me peshën e tij, duke ofruar jo vetëm të gjetura, por edhe ekspertiza të fushave të ndryshme ekonomike dhe politika alternative.

Me profesionalizëm rriti kredibilitetin e tij në vazhdimësi, dëshmonte degradimin që i bëhej Kosovës me fakte mbi tavolinë, por ndërkohë ofronte zgjidhje për qëndrueshmëri ekonomike. "Riinvest"-i tash sa vite ka prirë me iniciativa, përmes forumeve publike, konferencave, debateve, analizave e publikimeve. Influenca e tij është rritur bashkë me ekspertët që ka zhvilluar brenda tij. Instituti i parë i llojit "thinj-tank" në Kosovë, hapi dyert për një gjeneratë të re, e cila u rrit dhe u zhvillua brenda tij. "Riinvest"-i ka arritur të prezantohet me ekspertët më me influencë të çështjeve ekonomike në vend, promovuesit e frymës së re të diskursit publik.

Ai vazhdon të mbetet adresa më kredibile dhe luan rolin kyç në hapjen e debateve për sfidat ekonomike në vend. Jo rrallëherë, "Riinvest"-i ka ndryshuar rrjedhjen e ngjarjeve ekonomike duke hapur debat publik, me ndikim në ngjarjet më të rëndësishme të sektorëve ekonomikë në Kosovë.

Sot, 20 vjet nga themelimi i tij, dhe tash 14 vjet sa unë kam përcjellë nga afër punën e "Riinvest"-it, e lexoj, e shoh dhe e vlerësoj si adresën më kredibile, dhe jo vetëm në Kosovë, të avokimit të shtyllës kryesore në vend. "Riinvest"-i ka arritur të instalojë standardin më të lartë të mendësisë moderne ekonomike në vend!



MICHAEL
WEICHERT

FRIEDRICH-EBERT
-STIFTUNG

FES-i ka qenë partner i "Riinvest"-it që nga viti 1997. Gjatë periudhës 1999 dhe 2005, kisha kënaqësinë të isha përgjegjës nga ana e FES-it për bashkëpunimin mes të dy institucioneve. Kontakti im i parë me profesorin Mustafa dhe kolegët e tij ka qenë në pranverë të vitit 1999. Si një vëzhgues i jashtëm, i mbaj mend shumë mirë ato ditë lufte në Kosovë, lajmet e tmerrshme, fotografitë dramatike dhe lajmet shqetësuese në media që vinin nga atje gjatë atyre ditëve. Derisa vija nga Sofja, aty ku i kemi pasur zyrat tona regjionale, arrita në Tetovë, ku shumë njerëz nga Kosova kishin ikur nga lufta për të gjetur strehë. Qyteti i vogël ishte përplot me njerëz dhe vetura. Ishte shumë vështirë të gjeje vend të lirë në njërën nga kafenetë e shumta, të cilat në të njëjtën kohë ishin edhe vendtakime për të gjithë, përfshirë ndërkombëtarët e shumtë, të cilët ishin prezentë si pjesëtarë të programeve humanitare ndërkombëtare si dhe korrespondentë nga organet e medieve anembanë botës.

"Riinvest"-i kishte themeluar një zyrë të vogël në qendër të qytetit. Duke mos e ditur se kur do të përfundonte lufta, ato ditë ne filluam një program studimor dhe propozues për rindërtimin e Kosovës pas luftës. Ne e dinim se shumë ekspertë nga Kosova ishin në Tetovë, duke pritur ditë më të mira, në kafenetë e qytetit. Derisa prisnim në Tetovë, ne dëshironim që t'ju ofrojmë mundësinë që t'i vënë në përdorim kapacitetet e tyre intelektuale dhe vizionare për të kontribuar për "ditët pas" dhe sfidave enorme që duhej të adresoheshim kur të përfundonte lufta dhe kur njerëzit e Kosovës të ktheheshin prapë në vendin e tyre.

Si rezultat, "Riinvest"-i dhe FES-i organizuan Konferencën e parë ndërkombëtare pas përfundimit të luftës, në ditët e hershme të korrikut 1999. Ngjarja u mbajt në Pallatin e Rinisë

dhe Sporteve, i cili kishte pësuar nga bombardimet gjatë luftës. Dritaret ishin të thyera dhe gjatë atyre ditëve me shi, uji hynte nga dritaret në dhomën e konferencave nëpërmjet vrimave të shumta të dritareve të thyera. Ishte sfidë të siguronim mjete teknike, por konferenca bëri bashkë një komunitet të njerëzve të çliruar dhe entuziastë të cilët dëshironin të kontribuonin në rindërtimin e një vendi dhe shteti të ri.

Unë e imagjinoj se disa nga ato punime të prezantuara dhe propozime të shumta kanë gjetur rrugën e tyre në procesin e rindërtimit që ka vazhduar që nga atëherë e deri më sot. Përvoja zemërngrohëse e bashkëpunimit tonë, kontakti dhe komunikimi ndërmjet ekipeve tona dhe në veçanti me prof. Mustafën mbeten përgjithmonë në kujtimet e mia.

Sarajevë, 31 mars , 2015

Michael Weichert

6

BORDI I
"RIINVEST"-it

ILAZ RAMAJLI

ANËTAR BORDI



Nga shtatori i vitit 1990 isha i detyruar të qëndroja jashtë Kosovës. Me gjithë kontaktet e shpeshta me familjarë, miq dhe bashkëpunëtorë kisha mungesë informacioni të plotë për atë se si zhvillohej jeta në Kosovë, me çka merreshin njerëzit që i kam njohur dhe me të cilët kam punuar. Njëri nga ata me të cilët herë pas herë takohesha në Lubjanë, Shkup e Tiranë, ishte miku im i çmuar, prof. Muahamet Mustafa. Nga Presidenti Rugova në gusht të vitit 1995 unë isha emëruar në pozitën e udhëheqësit të Zyrës së Republikës së Kosovës në Tiranë. Në fillim të vitit 1996 prof. Muahamet Mustafa kishte ardhur për një vizitë në Tiranë dhe natyrisht u takuam. Ai më tha se së bashku me disa shokë, ekspertë të fushave të ndryshme, kishte krijuar një institut dhe e kishin emëruar Instituti "Riinvest". Ideja e themeluesve ishte që Instituti të merrej me studime ekonomike. Muhameti fliste me entuziazëm për këtë ndërmarrje dhe shprehte besimin se do të mund të bëhen punë interesante dhe të vlefshme për Kosovën. Më erdhi mirë për këtë, por fillimisht nuk e kisha të qartë dimensionin dhe rëndësinë e një ndërmarrje të tillë.

Në dhjetor të vitit 1998 në Tiranë erdhi Sejdi Osmani,

gjithashtu mik imi, i cili në emër të Institutit "Riinvest" do të prezantonte publikimet e këtij Instituti në Panairin e Librit në Tiranë. Në kuadër të publikimeve të prezantuara ishte edhe publikimi me titull "Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës". Si shumë të tjerë që patën rastin ta shihnin këtë publikim, edhe unë u habita me përmbajtjen, kualitetin, të dhënat, konstatimet dhe rekomandimet që përmbante ky studim. E luta Sejdiun që të m'i jepte disa ekzemplarë të këtij publikimi me qëllim që t'ua shpërndaja ambasadave të shteteve të huaja në Tiranë. Fillimisht i shpërndava 10 ekzemplarë për ambasadat e shteteve kryesore të BE-së dhe Ambasadës së ShBA-së. Me gjithë faktin që viti 1998 ishte vit lufte në Kosovë, dhe në Shqipëri tanimë gjendeshin rreth 28000 refugjatë nga Kosova, thajse nga të gjitha ambasadat që kishin marrë publikimin u kërkuar që të takohesha me atashetë politikë apo ekonomikë, në mënyrë që të shpjegoja se kush është Instituti "Riinvest", kush janë themeluesit dhe ekspertët që kishin punuar në publikim, si është e mundur që një studim kaq përmbajtësor dhe i rëndësishëm të bëhet në Kosovën e okupuar, etj. Duke parë këtë interesim për publikimin dhe në mungesë

të ekzemplarëve të nevojshëm, unë fotokopjova publikimin dhe ua shpërndava të gjitha ambasadave të shteteve të huaja në Tiranë.

Pas përfundimit të luftës dhe mbarimit të misionit tim në Tiranë, u ktheva në Kosovë. Me ftesë të prof. Muahamet Mustafës fillova të punoj në "Riinvest" si drejtor administrativ dhe aty qëndrova deri në prill të vitit 2002. Gjatë kësaj kohe, me gjithë eksperiencën time shumëvjeçare, unë pata mundësinë të mësoj gjëra të reja nga shumë të punësuar dhe bashkëpunëtorë të jashtëm të "Riinvest"-it. Unë besoj se Instituti "Riinvest" ka luajtur dhe po luan një rol të rëndësishëm për Kosovën dhe qytetarët e saj. "Riinvest"-i ishte dhe vazhdon të jetë, sipas mendimit tim, pika më referente të cilën e vizitojnë dhe e citonin institucionet ndërkombëtare financiare dhe politike, kur ishte fjala për rindërtimin e pasluftës dhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. E konsideroj nder dhe privilegj që për një kohë kam punuar në "Riinvest" dhe më është dhënë rasti të punoj me ekspertë vendorë të afirmuar dhe njerëz e ekspertë të rinj të shumë fushave, të cilët ishin dhe kanë vazhduar të jenë të punësuar apo si bashkëpunëtorë të jashtëm të "Riinvest"-it.

NAIM HOXHA

ANËTAR BORDI



Pikërisht para 20 vjetësh u themelua një institucion, krijesë e brishtë, të cilën edhe dashamirët e shihnin paksa me dyshim. Kishte edhe nga ata që e vlerësonin si një hir të ditës të ca egocentrikeve. Me një fjalë dukej si e pa kohë e dënuar edhe me një dështim. Mirëpo, si zakonisht kur diçka ka sukses dhe ka vlerë, si diçka e rrallë del që ishte një realizim i një përcaktimi, një ëndrrë dhe vullneti i atyre që nuk pajtoheshin me përditshmërinë, me realitetin sa të hidhur dhe ca poshtëruese që dekurajonte çdo ide dhe nismë. "Riinvest"-i ishte një shembull shkollor i vizionit të guximshëm, të mirë dhe me kohë, i një qëndrese, guximi dhe vendosmërie që t'i përgjigjet kushtrimit intelektual e profesional. Nga krijimi i tij "Riinvest"-i ishte sa produktiv aq edhe inkurajues dhe nxitës si për qarqet akademike, profesionale e deri te studentët që ishin mbështetja dhe fondamenti ekzekutiv i projekteve dhe aktiviteteve të Institutit.

Para luftës në Kosovë, Instituti luajti rol të rëndësishëm në aspektin e njohjes dhe ndërkombëtarizim-

it të çështjes së Kosovës. Me botimet e tij jo vetëm për aktualitetet ekonomiko-shoqërore të Kosovës por edhe me vizionin dhe zgjidhjet zhvillimore të pasluftës, ishte pjesëmarrëse në konferencat e shumta ndërkombëtare. Botimi, tanimë klasik dhe vepër e patjkalueshme e mendimit ekonomik kosovar, "Aktivitetet demokracia dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës" ishte një punim i inspirimit akademik, shkencor e pse jo edhe patriotik i Institutit "Riinvest".

Në anën tjetër ato hapësira-lokale të pakta dhe joadekuate u shndërruan në zgjua të studentëve dhe pedagogëve ku trajnoheshin dhe angazhoheshin në realizimin e projekteve të ndryshme. Numër i madh profesorësh dhe pedagogësh universitarë, ministra e zëvendësministra, drejtorë të bankave dhe zyrtarë të lartë që sot punojnë në qeveri dhe institucione të ndryshme qeveritare që njihen si ekspertë, u inspiruan, aftësuan dhe u ngritën në ato pak lokale (garazh dhe shitore) të Institutit "Riinvest".

Edhe në kohën e luftës Instituti nuk e ndërpreu aktivitetin e vet. Duke i dëshmuar aftësitë që t'u adaptohet

kushteve të vështira dhe të gjejë inspirimin e motivim kulmor, "Riinvest"-i vazhdoi punën si në ndërkombëtarizmin e çështjes ashtu edhe në mbështetjen e organizmave vendore e ndërkombëtare me këshilla, raporte dhe të dhëna të shumta shoqërore dhe ekonomike. Instituti me aktivitetet e tij në nivelin ditor, konferenca, takime cilësore dhe gjithëpërfshirëse ndikoi në qartësimin dhe informimin e çështjes dhe u bë qendër informative e rëndësishme.

Prezenca e "Riinvest"-it në konferenca dhe takime ndërkombëtare me anëtarë të vet, me intelektualë dhe pedagogë të tjerë, me ekspertë të ndryshëm ndikoi në krijimin e të vërtetës për Kosovën dhe alternativës kundër një mekanizmi fashizoid të propagandës së Serbisë dhe mbështetësve të saj.

"Riinvest"-i i pasluftës është një storie e re me qëllime të njëjta. Ai u shndërrua në epiqendrën e mendimit ekonomik duke dominuar në hapësirën akademike e profesionale jo vetën në Kosovë por edhe gjerë. Ai u rrinte përbri dhe në shërbim institucioneve vendore e ndërkombëtare me këshilla dhe vërejtje, me konfer-

YMER HAVOLLI

ANËTAR BORDI



enca, takime, tryeza të ndryshme, dhe mbi të gjitha me botime profesionale e shkencore të shpeshta të mbështetura me anketa të shpeshta, involvoi të gjithë potencialin kreativ vendor në mbështetje të tejkalimit sa më të shpejtë të problemeve të rritura në vend.

Në fund, duhet theksuar rolin strategjik të "Riinvest"-it në krijimin e kuadrove dhe ekspertëve. "Riinvest"-i e orientoi tërë potencialin e vet në krijimin e kushteve sa më të volitshme për studentë dhe ekspertë të rinj, studimet master, doktoratave dhe në specializimet jashtë vendit. Pa frikë se mund të gaboj, konstatoj se asnjë institucion jashtë UP-së nuk ka pasur aq ndikim dhe meritë për ngritjen e cilësisë shkencore, akademike e profesionale në përgjithësi e posaçërisht në fushën e ekonomisë si "Riinvest"-i.

Nga sa u shkrua më lart, që paraqet vetëm një pjesë të vogël dhe të shkëputur nga opusi i gjerë i "Riinvest"-it, mund të përfundoj se Instituti "Riinvest" paraqet shembull të rrallë të një subjekti që ia ka bërë vendin vetes në historinë bashkëkohore të Kosovës. Ai është padyshim institucion për t'u krenuar.

Posa ishim kthyer nga Maqedonia në Kosovë, ku qëndruam si refugjatë gjatë luftës. Në atë kohë asgjë nuk ishte funksionale. Mungonin të dhënat, dokumente dhe informata, të cilat ndërkombëtarët i kërkonin ku janë e ku nuk janë. Më kujtohet një vizitë e një zyrtari të Departamentit të Shtetit, i cili kishte ardhur në vizitë në Institutin "Riinvest" dhe gjatë bisedës kërkoi edhe ndonjë të dhënë, statistika, vlerësim ekonomik, etj. Prof. Muhamedi po ia sqaronte se çdo gjë nga dokumentet që kemi lënë janë shkatërruar. Unë i thash se mund t'ua gjej ndonjë ekzemplar të projekti: Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës.

Ika shpejt te një shtëpi ku kisha fshehur një numër ekzemplarësh të këtij projekti, që i kisha mbështjell me një najlon dhe i kisha futur në rërë në oborrin e asaj shtëpie. Nga gjithsej ekzemplarët e fshehur (50 ose 60), vetëm 2 -3 prej tyre mund të lexoheshin disi, ngase të tjerët ishin dëmtuar krejtësisht nga myku dhe lagësht-

tia. I mora dhe vrap u ktheva. Ia zgjata njërin prej tyre prof. Muhametit. Drodhi pakëz kokën e më tha: s'bënë kjo ore Ymer. -Është ekzemplar që e kemi për momentin, edhe ky ekzemplar ka qenë "refugjat" sikur ne -ia ktheva.

Mysafiri nga Departamenti i Shtetit na falënderoi shumë. -Është shumë interesant për mua, do të jetë interesant edhe për kolegët e mi kur t'ua tregoj këtë ekzemplar dhe historinë e tij. Por do t'ua tregoj edhe për punën dhe entuziazmin e juaj për t'i ndihmuar vendit. Ky projekt kështu si është, për mua është vlerë dhe do ta pasurojë bibliotekën time, u shpreh ai!

Pak ditë më vonë kuptuam se Naim Hoxha e kishte ruajtur versionin elektronik të raportit të projektit "Aktivitetet Ekonomike dhe Zhvillimi Demokratik i Kosovës". Me mbështetjen financiare të Qeverisë së Kosovës në ekzil ky raport u ribotua dy herë në disa mijëra kopje në botime të veçanta në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

ISUF BERISHA

ANËTAR BORDI



Në situatën kur pothuajse në të gjitha fushat e jetës të shoqërisë kosovare aktivitetet ishin reduktuar në përpjekje mbijetese, formimi i Institutit "Riinvest" në vitin 1995 nuk kishte mbetur pa u shënuar nga kronikat e mediave të pakta të kohës në Kosovë. Por takimin dhe njohjen e parë me disa nga themeluesit dhe drejtuesit e këtij instituti e pata pasur diku në vitin 1996, kur Muhamet Mustafa dhe Muhamet Sadiku kishin ardhur në Zyrën e Fondacionit Soros në Prishtinë për të kërkuar mbështetje për projektet e tyre.

Duke parë kualitetin e projekteve të dorëzuara, unë në cilësinë e koordinatorit të programeve të Zyrës së Fondacionit Soros në Prishtinë, pata rekomanduar mbështetje për Institutin "Riinvest". Mirëpo, rekomandimi im që parë me rezervë dhe ishte kundërshtuar nga një pjesë e menaxhmentit të Zyrës së Sorosit në Prishtinë, gjë që kishte pasë rezonancë negative edhe në Zyrën qndrore në Beograd, ku edhe mirreshin vendimet finale. Pas

shumë përpjekjesh dhe angazhimesh si nga ana ime brenda, por edhe të llobimeve të jashtme nga ana e drejtuesve të "Riinvest"-it, ky Institut kishte marrë edhe mbështetjen fillimisht të rezervuar të Fondacionit Soros. Por çka ishte më e rëndësishme, Instituti "Riinvest" shumë shpejt pas themelimit kishte tëhequr vëmendjen dhe kishte marrë mbështetje të plotë strategjike nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare si CIPE e Washingtonit.

Dhe kjo vëmendje dhe mbështetje nga institucione të këtilla ndërkombëtare ishte e kuptueshme dhe plotësisht e merituar nga Instituti "Riinvest". Sepse IR kishte nisë punën e tij në kohën kur në shoqërinë kosovare ishte gjithnjë e më i prekshëm, që të mos themi se dominonte dëshprimi që vinte si rezultat i stagnimit disavjeçar dhe mungesës së imagjinatës politike dhe iniciativës të së ashtuquajturës rrezistencë pasive paqësore. Në këtë situatë të zhgënjimit dhe konfuzionit të përgjithshëm, Instituti "Riinvest" ishte një ndërmarrje shumë e guximshme që synonte të bënte studime dhe hulumtime strategjike

mbi perspektivat e zhvillimit të shoqërisë kosovare. Instituti "Riinvest" me vizionin e tij transcendente këtë situatë ku dominonte mendësia e reduktimit të përpjekjeve në mbijetesë dhe si i tillë dëshmonte përguximin intelektual dhe qytetar të themeluesve të tij. Ajo që më pat bërë përshtypje në takimin tim të parë me themeluesit e Institutit "Riinvest" ishte fakti se vendosmëria e tyre burrërore shoqërohej nga një entuziazëm rinor. Dhe shoqëria kosovare e kohës kishte shumë nevojë për këso lloj vendosmërie dhe entuziazmi, për vizionin strategjik të zhvillimit të saj, për projeksionin e tejkalimit të situatës dëshpruese nën pushtimin kolonial serb.

Sot, në 20-vjetorin e themelimit të Institutit "Riinvest", kur shohim se rrita e tij e pandërprerë ndër vite e ka dëshmuar në vazhdimësi atë si 'think tank' prijës në fushën e studimeve ekonomike në Kosovë, ndihem mirë që sadopak i kam kontribuar mbështetjes së zhvillimit të tij fillestar.

ARTANE RIZVANOLLI

ANËTARE BORDI



Nëse do të duhej të përshkruaja Institutin "Riinvest" si organizatë dhe përvojën time aty me tri fjalë, këto do të ishin: sfida, bashkëpunimi dhe zhvillimi profesional.

Sfida, sepse mua, si dhe shumë ekonomistëve të rinj që e kanë filluar karrierën profesionale aty, Instituti "Riinvest" na ka dhënë mundësinë dhe besimin për të punuar në hulumtime interesante dhe sfiduese, të cilat kanë trajtuar tema të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Shpesh këto kanë qenë tema të pahulumtuara më herët në Kosovë dhe Instituti ka luajtur rol të rëndësishëm në informim dhe nxitje të debatit në mesin e politikëbërësve dhe opinionit të gjerë publik.

Zhvillimi profesional, sepse përballja me sfida profesionale në kuadër të një game të gjerë të hulumtimeve, ka bërë që shkathtësitë dhe aftësitë e ekipit të Institutit "Riinvest", dhe posaçërisht shkathtësitë për të zgjidhur probleme në mënyrë inovative, të zhvillohen vazhdimisht gjatë punës. Por,

po aq i rëndësishëm sa zhvillimi i shkathtësive gjatë punës, është fakti që në këtë organizatë gjithmonë është vlerësuar shkollimi dhe trajnimi i punonjësve, dhe është bërë e pamundura që secili prej nesh të ketë mundësi të balancojë punën dhe zhvillimin tonë të mëtejshëm akademik e profesional.

Bashkëpunimi, sepse aty gjithmonë kanë ekzistuar përkrahja dhe bashkëpunimi, që na kanë mundësuar që detyrat sfiduese t'i përfundojmë me sukses si individë dhe si ekip. Kombinimi i ekspertëve me përvojë dhe ekonomistëve të rinj me plot motivim dhe përkushtim për punën, si dhe ambienti gjithmonë miqësor dhe i hapur ndaj ideve të reja, kanë qenë faktorë kyçë në këtë aspekt. Lidhjet profesionale dhe miqësitë e lindura gjatë punës në Institutin "Riinvest" kanë vazhduar të jenë të rëndësishme për secilin prej nesh edhe përtej punës në Institut.

Të gjitha këto karakteristika e bëjnë Institutin "Riinvest" të veçantë dhe të suksesshëm si organizatë dhe ka kontribuar në formimin dhe suksesin profesional e pjesëtarëve të stafit. Tani kur Instituti feston

20-vjetorin e tij, uroj që ai edhe për shumë vite të vazhdojë të luajë rolin e tij informues e mobilizues për tema kyçe ekonomike me profesionalizmin, objektivitetin dhe pavarësinë për të cilat shquhet, dhe të vazhdojë të jetë një vatër që do të tërheqë e zhvillojë edhe shumë gjenerata të tjera ekonomistësh e hulumtuesish të rinj në Kosovë.

MERITA GASHI

ANËTARE BORDI



Nga Parisi në Prishtinë, "Riinvest"-i, pjesë imja e rëndësishme profesionale!

Kur profesor Muhamet Mustafa më ftoi që të jem pjesë e Bordit të Institutit "Riinvest", unë sapo kisha përfunduar studimet e mia në Paris dhe kisha vendosur të kthehem në Prishtinë. Arsyet për kthim ishin të panumërta! Natyrisht ftesën që ma bëri prof. Muhamet Mustafa, u ndjeva shumë mirë dhe e pranova, (si mos ta pranoj!) duke e ditur që ke të bësh me "Riinvest"-in!

Me Profesor Muhamet Mustafën ishim njohur nga shkrimet që publikoja në disa gazeta në Kosovë atëherë kur unë jetoja në Paris, e që në fakt unë isha shumë kritike ndaj shumë gjërave të padrejta që iu bëheshin kosovarëve, dhe këtë e vlerësonte profesor Muhamet Mustafa, e çdo herë në bisedat tona fliste për sfidat dhe sukseset e "Riinvest"-it, si dhe mbi shkrimet që unë botoja, dhe ai si optimist që ishte, dhe unë si pesimiste për shtetin e Kosovës, përfundonim thuajse çdo bisedë.

Kurse për Institutin "Riinvest" sigurisht që isha në dijeni, kisha lexuar thuajse çdo raport që ky Institut publikonte. Dhe ajo që gjithmonë më ka bërë përshtypje të "Riinvest"-i, ishte që asnjëherë nuk iu nënshtrua politikës ditore. "Riinvest"-i fliste-publikonte dhe vazhdonte dhe vazhdon të thotë të vërtetën para opinionit.

Me punën e madhe që ka bërë "Riinvest"-i, sot çdo publikim që ai bën e marrin me shumë seriozitet të gjitha institucionet e Kosovës si dhe organizatat e huaja. Ato çdo herë bazohen në këto raporte të dala nga ky Institut, për faktin që "Riinvest"-i mban guximin, përkushtimin me një profesionalizëm ndaj punës që bëhet brenda këtij Instituti.

Sot, ajo që më bën shumë përshtypje tek Instituti "Riinvest" janë njerëzit që punojnë me përkushtim të madh. Unë takohem kryesisht me Bordin e këtij Instituti, dhe të punosh me Alban Hashanin, Lumir Abdixhikun, Saxhide Mustafën dhe të tjerë në Bord, është me të vërtetë e jashtëzakonshme. Të kesh një staf kaq të mirë, nuk dyshoj që "Riinvest"-i do

të jetojë edhe shumë dekada. Në "Riinvest" bëhet një punë e madhe. Unë ndihem me fat.

"Riinvest"-i ka shkruar historinë e Kosovës mbi ekonominë kosovare.

Jeto gjatë "Riinvest". Na duhesh!



Greece

Greek Participation in AGROKOS 2012

TIF

FOLKAN

STILIA KALISIM BEKAT

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

www.folkandip.it

7

PERIUDHA
2000-2009

07 / PERIUDHA 2000-2009

Pas përfundimit të luftës, Instituti "Riinvest" hyri në një fazë të re zhvillimi. Edhe pse me një përvojë domethënëse, megjithatë rritja e kapaciteteve kërkimore dhe institucionale paraqitej si një domosdoshmëri për të realizuar misionin e tij në kushte të reja, në Kosovën e çliruar, por nën administrim ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhe në Institutin "Riinvest" janë angazhuar Isa Mustafa dhe Ilaz Ramajli që ishin kthyer nga puna e tyre shtetndërtuese në ekzil dhe shumë e shumë të rinj të tjerë. Në këtë fazë, në periudhën 2000-2004, "Riinvest"-i realizoi një marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Në dy vjetët e para projektet në kuadër të kësaj marrëveshjeje janë zbatuar në bashkëpunim me CIPE, përderisa dy vjetët vijuese projektet janë zhvilluar në mënyrë të pavarur. Ky projekt arriti plotësisht objektivat e tij për forcimin e kapaciteteve institucionale të "Riinvest"-it dhe për realizimin e një agjende shumë intensive kërkimore.

Ky ka qenë intervenimi më substancial i cili ka përgatitur "Riinvest"-in për t'u bërë një organizatë kërkimore e qëndrueshme, duke prodhuar një sërë raportesh kërkimore të standardeve ndërkombëtare. Në saje të kërkimeve komplekse në shumë fusha, "Riinvest"-i ka marrë rol prej pionieri që nuk lë jashtë vërtetimit kërkimor asnjë çështje me rëndësi qenësore. Në kuadër të këtij projekti janë përgatitur raporte kërkimore në fusha të ndryshme, që nga politika e taksave, financimi i bizneseve, edukimi, zhvillimi rural e deri tek investimet e jashtme. Fushat e kërkimit, ato që përbënin prioritet për Kosovën, përcaktoheshin pas një diskutimi të gjerë në Bordin Këshillëdhënës. Përvojat më të mira të reformave dhe kërkimeve në ekonomitë e tregut dhe ekonomitë në tranzicion përdoreshin për të eksploruar çështjet e zhvillimit dhe reformave në Kosovë. Forumi i "Riinvest"-it ku debatoheshin këto çështje, në kohën kur nuk kishte institucione vendore, luante rolin e një parlamenti specifik, ku dëgjohej zëri i studiuesve dhe inteligjencies kosovare, men-

dimi i pavarur e shpesh kritik ndaj UNMIK-ut dhe faktorit vendor politik.

Periodha 2004-2010 e teston "Riinvest"-in për qëndrueshmërinë e tij financiare dhe programore në kushtet e tregut dhe konkurrencës. Kjo nuk ishte periudhë e lehtë dhe pa shqetësime, sepse bashkë me këtë po provohej edhe qëndrueshmëria e "Riinvest"-it në pozicionin e pavarësisë politike dhe financiare, në kushtet kur i njëjti kishte afro 30 të punësuar me paga përafërsisht konkurrencte edhe me organizata ndërkombëtare që punojnë në Kosovë. Instituti "Riinvest" gjatë kësaj periudhe kontribuoi në shumë sfera, duke filluar bashkëpunimin me shumicën e komunave, mbështetjen e planifikimit strategjik në nivel nacional, mbështetjen e sukseseve të Kosovës për progres në zbatimin e standardeve si çelës për të hapur çështjen e statusit politik dhe mbështetjen substanciale të negociatave në Vjenë për statusin politik me tërë fondin tonë kërkimor dhe kapitalin intelektual. Kështu "Riinvest"-i fuqizoi rolin dhe pozitën e tij si një institucion kredibil dhe i paanshëm.

Gjatë kësaj periudhe një projekt veçanërisht i rëndësishëm është koalicioni me KFOS në "Forumi 2015". Ky projekt ka zgjeruar mundësitë e "Riinvest"-it por edhe të inteligjencies dhe shoqërisë civile për të ndikuar në politikat vitale të zhvillimit dhe të integrimeve euroatlantike. Gjatë kësaj periudhe, Instituti "Riinvest" gjithashtu ndërtoi partneritet afatgjatë me Bankën Botërore, IFC, OSI/LGI (Open Society Institute/ Local Government Initiative) në Budapest, Fondacionin Friedrich Ebert -FES; KFOS-i; Zyrën Zvicerane për Zhvillim (SDC) në zbatimin e projektit DELTA -Zhvillimi i ndërmarrjeve lokale nëpërmjet aksionit dhe aleancave (Developing Enterprises Locally Through Action and Alliance), me fokus në ndërtimin e institucioneve brenda qeverisë komunale dhe shfrytëzimin e resurseve të sektorit privat që mbështesin reformat politike për zhvillimin e sektorit privat.

2000

Gjatë viti 2000, Instituti "Riinvest" vijoi angazhimin e tij në temat më genësore me të cilat përballej vendi. Gjatë marsit të vitit 2000, "Riinvest"-i hartoi Raportin 'Rindërtimi i Kosovës pas luftës'. Ky studim mbi pasojat e luftës dhe politikat e rindërtimit ishte dhe mbetet një aset shumë i vlefshëm. I njëjti përfshinte vlerësimin e pasojave të luftës për ekonomitë familjare dhe bizneset private, si dhe për ndërmarrjet shoqërore e publike. Krahas dy anketave të mëdha, e para me 3,500 familje dhe e dyta me 300/600 biznese private, u formua ekipi për vlerësimin e gjendjes në sektorë të ndryshëm, i cili përbëhej prej 17 grupeve ekspertësh. Në bazë të këtij aktiviteti kërkimor u përgatit raporti, i cili u prezantua në Konferencën ndërkombëtare "Rindërtimi i Kosovës pas luftës: Strategjia dhe politikat". Raportet nga kjo konferencë dhe studimet mbështetëse paraqesin një dokumentacion unik mbi pasojat e rënda të luftës në Kosovë si dhe politikat më frytdhënëse të rindërtimit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2000, Instituti "Riinvest" filloi edhe realizimin e Projektit 'Promovimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet shoqërisë civile'. Ky projekt u realizua në bashkëpunim me CIPE nga Uashingtoni dhe mbështetur nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara nëpërmes financimit të siguruar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

“Rindërtimi i Kosovës pas luftës:
Strategjia dhe politikat”.



2001

Në kuadër të Projektit 'Promovimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet shoqërisë civile', në mars të vitit 2001, "Riinvest"-i është angazhuar në përgatitjen e studimit lidhur me ndërmarrjet shoqërore dhe privatizimin e tyre. Qëllimi i këtij raporti ishte që "Riinvest"-i të prezantojë gjendjen e atëhershme të ndërmarrjeve shoqërore dhe identifikimin e ndryshimeve në afarizmin e tyre në vitet e fundit. Ky studim, si dhe konferenca që e pasoi atë, kanë kontribuar në prezantimin e qëndrimit të palëve të interesuara në raport me procesin e privatizimit në Kosovë, përderisa ka inkurajuar debatin e gjerë ndërmjet institucioneve demokratike të Kosovës të dala nga zgjedhjet, UNMIK-ut dhe shoqërisë civile, për krijimin e parakushteve për realizimin sa më të suksesshëm të procesit të privatizimit.

Gjithashtu, Instituti "Riinvest" në periudhën mars-qershor të vitit 2001 ka përgatitur një raport përmbledhës lidhur me ndërtimin e politikës fiskale në Kosovë. Ky studim krahas analizës së gjendjes ekzistuese ka nxjerrë dhe rekomandime për një politikë të qëndrueshme fiskale që do të zhvillohej me kombinimin e ndryshimeve të sistemit ekzistues dhe inkuadrimin të komponentëve të reja, në mënyrë që të vihej në funksion të rindërtimit ekonomik të Kosovës së pasluftës.

Gjatë shtatorit të viti 2001, Instituti "Riinvest" ka bërë një studim lidhur me sistemin e financimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë. Duke bërë një hulumtim në terren dhe intervista me palët e interesuara, "Riinvest"-i analizoi qasjen e bizneseve në burime të financimit si dhe të analizojë në tërësi mjedisin biznesor në Kosovë.

Krahas analizimit të gjendjes në mjedisin biznesor, studimi gjithashtu ofroi edhe rekomandime për të fuqizuar segmente të caktuara të këtij mjedisi.

Në dhjetor të vitit 2001, "Riinvest"-i ka bërë një studim lidhur me gjendjen sociale dhe zhvillimin e sistemit pensional në Kosovë. Ndërtimi i skemës së re të pensioneve, përkatësisht të sistemit të pensioneve në Kosovë, në kontekstin e gjendjes së përgjithshme sociale, papunësisë dhe varfërisë paraqiste njërën nga çështjet më urgjente sociale dhe ekonomike në Kosovë në atë kohë. Qëllimi i këtij raporti ishte rekomandimi dhe avokimi i ndërtimit të sistemit të pensioneve në Kosovë, si një segment i rëndësishëm i sigurimeve shoqërore dhe nënsistem i rëndësishëm i buxhetit të Kosovës, në ndërlidhje të ngushtë me institucionet financiare. Prezantoi gjendjen momentale sociale në Kosovë, që ndërlidhet me gjendjen e pensionistëve, duke u nisur nga problemet e gjertanishme të funksionimit të sistemit pensional në Kosovë si dhe nga përvojat e ndërtimit dhe të reformimit të skemave pensionale në vendet e tjera.

‘Promovimi i zhvillimit ekonomik
nëpërmjet shoqërisë civile’



2002

Gjatë prillit të vitit 2002, Instituti "Riinvest" ka organizuar një tryezë të forumit ndërkombëtar lidhur me zhvillimin ekonomik lokal në Kosovë. Tryeza për temë bosht kishte gjetjet e raportit hulumtues lidhur me zhvillimin ekonomik lokal. Raporti në vetvete kishte për qëllim prezantimin e problemeve aktuale të zhvillimit ekonomik lokal në Kosovë dhe propozimin e rekomandimeve mbi aktivitetet prioritare të nevojshme për ndërtimin e rolit të pushtetit lokal në zhvillimin ekonomik në pajtim me kërkesat e ekonomisë së tregut.

Gjatë qershorit të vitit 2002, Instituti "Riinvest" bëri një studim të gjerë lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore si dhe trajtoi reformat e ndërmarrjeve publike në Kosovë. Objektivi kryesor i këtij studimi ishte që të paraqesë situatën e tanishme të ndërmarrjeve shoqërore dhe t'i identifikojë ndryshimet që kanë ndodhur në funksionimin e ndërmarrjeve shoqërore gjatë viteve të fundit. Studimi u bazua në të dhëna parësore të grumbulluara përmes anketimit të një numri statistikisht përfaqësues të ndërmarrjeve shoqërore. Ky raport u pasua edhe me një konferencë ndërkombëtare, në të cilën kontribuan me punimet dhe diskutimet e tyre personalitete eminente në fushën e transformimit të pronës dhe tranzicionit. Në këtë periudhë, Institut "Riinvest" ishte platforma më kuptimplotë ku trajtohej çështja e privatizimit dhe çështje tjera kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës.

Gjatë shtatorit të vitit 2002, Instituti "Riinvest" bëri një studim të detajuar lidhur me investimet e jashtme direkte në Kosovë. Në këtë studim

u trajtuan mjedisi biznesor dhe strategjia e promovimit të Kosovës si destinacion për investimet e jashtme. Studimi, gjithashtu, përmes tryezave inicioi debat të gjerë dhe të angazhuar për ngritjen e vetëdijesimit mbi problemet prezente në fushën e politikave ekonomike. Raporti në mënyrë të veçantë ka trajtuar çështje të rëndësishme lidhur me investimet e jashtme, mes tjerash, barrierat, kornizën legjislative, institucionet e promovimit, si dhe prezantimin e përvojave ndërkombëtare në tërheqjen e investimeve të jashtme. Së fundi raporti ka nxjerrë dhe rekomandime lidhur me masat që duhet marrë në politikat ekonomike për krijimin e një ambienti më të favorshëm institucional për stimulimin e tërheqjes së investimeve të jashtme.

Gjatë dhjetorit të vitit 2002, Instituti "Riinvest" bëri një studim lidhur me ecuritë e ndërtimit të politikës së tatimeve dhe taksave në Kosovë. Studimi trajtonte faktorët që kanë ndikuar në konsolidimin e politikës së tatimeve dhe taksave në Kosovë. Mes tjerash, studimi analizon

ecurinë e të hyrave tatimore, strukturën e tatimeve, harmonizimin e politikës tatimore me problemet zhvillimore me të cilat përballej vendi në atë periudhë, përfshirë mundësitë për lehtësira tatimore për pajisje dhe bujqësi. Raporti gjithashtu nxjerr rekomandime lidhur me hapat që duhen ndërmarrë, mes tjerash, për të siguruar qëndrueshmëri buxhetore; duke eliminuar pabarazinë në treg; krijuar lehtësira tatimore për pajisje dhe lëndë të parë; ridefinimin e pragut të TVSH-së; reformimin e tatimit në të ardhura personale.

Të gjitha këto studime janë përcjell me tryeza të rëndësishme kur janë diskutuar gjetjet dhe janë komunikuar rekomandimet në një audiencë të gjerë.

Gjatë vitit 2002, Instituti Riinvest në bashkëpunim me Institutin për Shoqëri të Hapur (OSI) ka filluar zbatimin e Projektit DELTA: "Zhvillimi i ndërmarrjeve lokale nëpërmjet Aksionit dhe Aleancave" (Developing Enterprises Locally Through Action and Alliance), me fokus në ndërtimin e institucioneve brenda qeverisë komunale dhe shfrytëzimin e resurseve të sektorit privat që mbështesin reformat politike për zhvillimin e sektorit privat. Edhe pse ka filluar në vitin 2002, ky projekt është zhvilluar në disa faza: (i) DELTA I, si pilot projekt i cili ka përfshi shtatë komuna (Podujevën, Istogun, Kaçanikun, Klinën, Prizrenin, Vitin dhe Vushtrrinë) është realizuar në vitin 2002; (ii) DELTA II, ka përfshi pesë komuna (Gjilanin, Ferizajn, Pejën, Drenasin dhe Lipjanin) dhe është realizuar në vitin 2005; (iii) DELTA III, i cili ka përfshi pesë komuna (Shtimen, Obiliqin, Dragashin, Kamenicën dhe Malishevën) është zhvilluar në vitin 2007. Qëllimi kryesor i projektit ishte dhënia e asistencës teknike komunave pjesëmarrëse në projekt në hartimin e strategjive afatmesme zhvillimore ekonomike lokale (ZHEL) për të krijuar një ambient të përshtatshëm për biznes. Përveç OSI/LGI (Open Society Institute/Local Government Initiative) në Budapest, ky projekt është mbështetur edhe nga Banka Botërore; 'Friedrich Ebert Stiftung' (FES); KFOS-i; Zyra Zvicerane për Zhvillim (SDC); si dhe komunat pjesëmarrëse me dhjetë përqind pjesëmarrje.



2003

Në janar të vitit 2003, Instituti "Riinvest" ka bërë një studim lidhur me tregun e punës dhe papunësinë në Kosovë. Ky raport adreson çështjet e tregut të punës, punësimit dhe papunësisë në Kosovë si dhe trajton politikat që lidhen me zhvillimet e tregut të punës. Analiza e problemit të papunësisë, dimensionet dhe struktura e papunësisë në Kosovë. (ii) Vështrimi i kuadrit ligjor në Kosovë që ka lidhje me tregun e punës dhe papunësinë dhe stadi aktual i zhvillimit të institucioneve dhe politikave të tregut të punës. (iii) Analiza e eksperiencave të vendeve të tjera në tranzicion relevante me zhvillimet e tregut të punës në Kosovë. (iv) Propozimi i rekomandimeve për zhvillimin e tregut të punës dhe të politikave të përshtatshme të punësimit.

Në mars të vitit 2003, Instituti "Riinvest" ka hartuar një raport mbi ecuritë e financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë. Ky raport studimor analizonte mjedisin biznesor nga të dhënat e grumbulluara përmes anketës. Raporti i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përveç qasjes në financim, mes tjerash, analizonte edhe trendët e performancës së këtyre ndërmarrjeve; nivelin e eksporteve dhe importeve; barrierat e të bërit biznes.

Në qershor të vitit 2003, Instituti "Riinvest" ka hartuar një studim lidhur me sistemin buxhetor të Kosovës. Ky raport hulumtues kishte për qëllim të promovojë një dialog të angazhuar midis politikëbërësve dhe akterëve të tjerë kosovarë lidhur me ndërtimin e një sistemi buxhetor dhe të politikave adekuate buxhetore që sigurojnë qëndrueshmërinë e buxhetit të Kosovës, transparencë dhe efikasitet në menaxhimin e tij. Ky raport hulumtues

synonte t'i adresojë relacionet kryesore makroekonomike të buxhetit me rritjen ekonomike të Kosovës dhe problemet aktuale strukturore, të karakterizuara me nivel të lartë të papunësisë dhe të varfërisë, vështirësi në zhvillimin e sektorit privat, ngecje të privatizimit të sektorit shoqëror dhe të ristrukturimit të sektorit publik, deficitin e lartë në bilancin tregtar dhe mungesën e mjeteve cilësore financiare për mbështetje të investimeve.

Gjatë muajit nëntor, Instituti "Riinvest" ka bërë edhe një studim lidhur me politikat tregtare dhe promovimin e eksportit në Kosovë. Ky studim, mes tjerash, trajtonte dinamikën dhe strukturën e këmbimit tregtar; çështje të lidhura me liberalizimin dhe regjimin tregtar në Kosovë; rezultatet e anketës me 110 ndërmarrje eksportuese mbi pengesat e eksportit, faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që ndikonin në aftësinë e tyre konkurruese; si dhe problemet aktuale, vështirësitë dhe angazhimet e nevojshme për organizim më të mirë institucional në Kosovë dhe për implementimin e një qasjeje të integruar në promovimin e eksportit. Përveç të dhënave të grumbulluara përmes anketës, ky studim ka përpiluar edhe raste studimore nga vende të ndryshme të botës të hartuara për qëllim të këtij raporti.

2004

Gjatë muajit mars të vitit 2004, Instituti "Riinvest" hartoi një studim lidhur me edukimin dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në fokus të këtij studimi ishin masat përkatëse për rritjen e nivelit të përfshirjes së gjeneratave të reja në nivele të ndryshme të arsimit, veçmas në edukimin parashkollor, në përfshirjen më të madhe të vajzave në shkollimin e mesëm dhe të rinjve në arsimin e lartë. Gjithashtu fokus i këtij studimi ishte ndërthurja e zhvillimit të edukimit dhe zhvillimit ekonomik. Në këtë kuadër, raporti trajtoi modalitetet e rritjes së investimeve në arsim, që u vlerësua si ndër sfidat më të rëndësishme që duhet të përballojë ekonomia dhe shoqëria kosovare. Në këtë kuadër, raporti evidentoi që një rritje e tillë e investimeve kërkon një kombinim të rritjes së shpenzimeve qeveritare, pjesëmarrje më të lartë të fondeve private të brendshme dhe rritje të financimit nga donatorët. Me anë të këtyre fondeve mund të vihen bazat e një sistemi modern të arsimit, i aftë që t'i përballojë sfidat e ekonomisë së diturisë, globalizimit dhe zhvillimeve të hovshme teknologjike.

Gjatë muajit maj të vitit 2004, Instituti "Riinvest" hartoi një raport vlerësues edhe mbi ecurinë e investimeve të jashtme direkte në Kosovë. Ky raport trajtoi përparimet dhe ngeçjet në përmirësimin e mjedisit biznesor dhe strategjinë e promovimit të Kosovës si destinacion për investimet e jashtme. Studimi, gjithashtu, përmes një tryeze gjithëpërfshirëse vijoi debatin e gjerë dhe të angazhuar për ngritjen e vetëdijesimit mbi problemet prezentë në fushën e politikave ekonomike.

Në korrik të vitit 2004, Instituti "Riinvest" përgatiti një raport hulumtues

lidhur me zhvillimin rural të Kosovës. Objektivat e këtij raporti ishin që të përgatisë një bazë analitike për të ngritur një debat cilësor lidhur me çështjet e zhvillimit rural; identifikimin e rolit të bujqësisë dhe aktiviteteve të tjera jobujqësore për zhvillim rural; identifikimin e faktorëve dhe politikave të zhvillimit të qëndrueshëm rural me bazë të gjerë të zhvillimit si dhe të nxjerrë rekomandime të politikave të bujqësisë me fokusim në krijimin e bazës së gjerë për rritje ekonomike në viset rurale. I bazuar në të dhëna të grumbulluara përmes anketës me 1,000 amvisëri në të gjithë territorin e Kosovës dhe intervistave me akterë kyçë, ky raport është një burim i jashtëzakonshëm informimi për politikëbërësit dhe studiuesit.

Në shtator të vitit 2004, Instituti "Riinvest" përgatiti një raport hulumtues lidhur me ecurinë e procesit të privatizimit. Raporti hulumtues "Privatizimi në Kosovë: Përparime dhe ngeçje, që u përgatit enkas për t'u diskutuar në 'Forumi 2015', arriti që t'i kontestojë të gjitha dilemat e paraqitura e që ndërlidheshin me kontestimin e bazës ligjore, e që përmendej si motivi kryesor për ndërprerjen e procesit. Rezultatet e raportit dhe debati i zhvilluar në 'Forumi 2015' i dha një shtytje të fuqishme përpjekjeve për të rifilluar procesi i privatizimit.

2005

Gjatë vitit 2005, Instituti "Riinvest" ka përgatitur një analizë jashtëzakonisht mirë të elaboruar lidhur me qëndrueshmërinë ekonomike të Kosovës; sfidat, politikat dhe mundësitë. Ky raport është përgatitur për të shërbyer si bazë për tryezën e diskutimit, e cila nxiti një debat të angazhuar nga palët e interesit. Ky raport kishte për qëllim të trajtojë shkurtimisht sfidat me të cilat përballëj Kosova në rrugën e saj drejt krijimit të një ekonomie të qëndrueshme, në kohën kur kishin filluar negociatat për zgjidhjen e statusit politik e juridik. Objektivi kryesor është që të jepet një pasqyrë e gjendjes aktuale dhe të përvijohen prioritetet strategjike dhe politikat e nevojshme për t'u zbatuar nga Qeveria dhe të përkrahura nga akterët e tjerë të interesit, të cilat do të shërbejnë në krijimin e një perspektive të rritjes ekonomike të qëndrueshme. Ky raport hulumtues si dhe aktivitetet përcjellëse janë mbështetur financiarisht nga Fondacioni Fridrich Ebert.

Në vitin 2005, si edhe në vitet e tjera, Instituti "Riinvest" ka kryer një anketë me ndërmarrje në Kosovë. Kjo seri e anketave me NVM-të, me mbi 600 sosh, e shoqëruar me raportet hulumtuese, është bërë nga Instituti "Riinvest" përgjatë një periudhe dhjetëvjeçare. Si e tillë, ajo paraqet një bazë të pasur të të dhënave të përpiluar nga "Riinvest"-i për NVM-të në Kosovë. Anketat vjetore dhe raportet hulumtuese paraqesin opinionet e komunitetit të biznesit privat mbi çështje të ndryshme. Mbledhja e të dhënave është kryer nga anketuesit tanë, duke përdorur intervistat ballë për ballë me menaxherët/pronarët e këtyre NVM-ve në Kosovë. Këto raporte kishin për objektiv ofrimin e informacionit për organet vendimmarrëse të Kosovës mbi ambientin institucional,



kushteve për ushtrimin e afarizmit dhe barrierat për zhvillimin e NVM-ve, si dhe për të krijuar data baza valide në lidhje me zhvillimin dhe ambientin afarist.

Gjatë këtij viti, Instituti "Riinvest" gjithashtu ka grumbulluar të dhëna lidhur me Raportin e paralajmërimit të hershëm. Projekti ishte mbështetur nga UNDP. Këto të dhëna analizojnë pritjet e qytetarëve të Kosovës lidhur me fenomene të ndryshme socio-ekonomike dhe si i tillë krijonte një tablo lidhur me skenarët e mundshëm të zhvillimeve shoqërore në vend. Ky raport dhe raportet e tjera brenda serisë së raporteve të paralajmërimit të hershëm, ishin të rëndësishëm për politikëbërësit vendorë dhe ndërkombëtarë në parashikimin e zhvillimeve socio-ekonomike. Gjatë vitit 2005, Instituti "Riinvest" gjithashtu ka përgatitur një raport lidhur me kulturën fiskale dhe qëndrueshmërinë buxhetore.

2006

Gjatë vitit 2006, Instituti "Riinvest" ka hartuar një studim lidhur me kornizën e qeverisjes korporative në ndërmarrjet publike në Kosovë. Ky raport i mbështetur nga CIPE, ka promovuar konceptet moderne të qeverisjes korporative bazuar në parimet e OECD-së, duke elaboruar përvojat më të mira ndërkombëtare dhe duke nxjerrë rekomandime për Kosovën.

Gjatë këtij viti, Instituti "Riinvest" ka lehtësuar procesin e përgatitjes së Strategjisë dhe Planit Zhvillimor të Kosovës (2007-2013). Në një proces gjithëpërfshirës, u ofrua asistencë teknike për 22 grupe teknike të përbëra prej 120 zyrtarëve, për të përgatitur raporte për 22 çështje sektoriale edhe ndërsektoriale. Ky projekt dha kontribut në aftësimin e numrit kritik të ekspertëve për planifikimin strategjik dhe prodhoi 22 raporte që shërbyen dhe ende shërbejnë si bazë për hartimin e kornizës afatmesme të shpenzimeve.

Gjatë këtij viti, Instituti "Riinvest" gjithashtu hartoi Raportin e objektivave zhvillimore të mijëvjeçarit (raporti i dytë për Kosovën). Bazuar në një fond të gjerë të të dhënave, Instituti "Riinvest" evidentoi gjendjen dhe projekttoi caqet që duhej arritur Kosova në përmbushjen e këtyre objektivave. Përveç tetë objektivave që ishin pjesë e raportit gjenerik, raporti për Kosovën shtoi edhe një objektivi, i cili lidhej me cilësinë e qeverisjes. Ky raport është prezantuar në komisione parlamentare dhe në tryeza gjithëpërfshirëse. I njëjti është mbështetur nga UNDP.

Instituti Riinvest ne bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar për Ambient dhe Zhvillim (IIED) kanë zbatuar projektin ESTAP III (Plani Zhvillimor dhe Participimi i Komunitetit ne Sektorin e Minierave), te financuar nga Banka



Botërore në menaxhim të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave. Projekti ESTAP III ka pasur për qëllim kryesor që të gjejë mundësitë optimale për një shpërndarje të balancuar të përfitimeve nga mihja e xeheve, ndërmjet shoqërisë në përgjithësi, investitorëve dhe komuniteteve minerare. Gjatë këtij projekti janë realizuar konsultime me komunitetet minerare ne Kosove (komunitetin e Fushës së Sibovcit dhe komunitetin e Stantërgut), me Përfaqësues të Qeverisë dhe të kompanive minerare ne Kosove. Është bërë analizë e detajuar e të dhënave lidhur me gjendjen aktuale të komuniteteve minerare, kornizës ligjore dhe politikave. Bazuar në analizën e detajuar të të dhënave dhe në bazë të takimeve të mbajtura gjatë vitit 2006 dhe 2007 janë hartuar njëzet dokumente të rëndësishme në këtë fushë.

2007

Gjatë vitit 2007, Instituti "Riinvest" ka përgatitur një studim lidhur me diasporën dhe politikat e migrimit. Ky studim ofroi informacione lidhur me diasporën dhe nënvizoi sfidat dhe mundësitë e pjesëmarrjes më domethënëse të diasporës në përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në këtë raport posaçërisht janë trajtuar çështjet si: madhësia dhe profili socio-ekonomik i diasporës; kontributi i saj i tanishëm përmes remitencave, investimeve, kontributet me furnizimin me mallra të ndryshme, "turizmit" të diasporës; organizimi i institucioneve kosovare karshi diasporës dhe niveli në të cilin këto institucione i adresojnë nevojat dhe interesat e tyre; cilat politika duhet të zbatohen që të rrisin ndikimin dhe kontributin social, njerëzor dhe financiar të diasporës, si dhe politikat e përshtatshme të emigracionit që do të ishin konsistente me kushtet e tanishme socio-ekonomike, si dhe me zhvillimet e pritura në procesin e integrimeve në BE dhe në tregun e punës të saj.

Gjatë vitit 2007, Instituti Riinvest ka përkrahur ekipet komunale për hartimin e strategjisë afatmesme zhvillimore të Prishtinës e cila strategji përfshinte periudhën 2007-2011. Stafi i institutit Riinvest ka lehtësuar procesin e hartimit të kësaj strategjie duke siguruar përfshirje të të gjitha palëve të interesuara në mënyrë që një strategji e tillë të burojë nga poshtë-lartë.

Gjatë viteve 2006-2007, Instituti "Riinvest" ka mbështetur delegacionin e Kosovës për negociatat e Vjenës mbi statusin politik të Kosovës. Këtij misioni i ka paraprirë projekti lidhur me vlerësimin e kostos së standardeve për Kosovës, duke bërë operacionalizimin e tyre në të gjitha nivelet e organizimit

institucional, si kusht i fillimit të diskutimit lidhur me statusin përfundimtar të vendit. Në kuadër të këtyre përpjekjeve duhet theksuar involvimin e "Riinvest"-it me asistencë teknike për delegacionin e Kosovës në bisedimet e Vjenës. Lidhur me këtë, "Riinvest"-i kishte mobilizuar një numër të konsideruar të ekspertëve të vendit dhe ndërkombëtarë për përgatitjen e një platforme analitike duke targetuar çështjet më kritike të këtyre bisedimeve në favor të një konfrontimi të suksesshëm me palën serbe.

Duke përdorur gjithë fondin kërkimor, bazat e të dhënave dhe kapitalin intelektual, Instituti "Riinvest" ka mbështetur ekipin negociator të Kosovës, gjatë negociatave për statusin e Kosovës të zhvilluara në Vjenë, në periudhën 2006-2007. Përgjegjësitë e Institutit "Riinvest" në këtë angazhim ishin: udhëheqja e Grupit të ekspertëve për ekonomi dhe financa të ekipit negociator; formimi i 10 nëngrupeve punuese sipas fushave të caktuara: kompensimi i dëmeve të luftës (direkte dhe indirekte), statusi i pronës shoqërore dhe publike, kompensimi i Fondit të pensioneve, kompensimi i kursimeve devizore, dëmet në sistemin buxhetor, kompensimi i dëmeve në sistemin bankar të Kosovës, privatizimi, kadastra, pjesëmarrja e Kosovës në ndarjen e pasurisë së ish-RFJ-së, etj. Në kuadër të këtij grupi janë angazhuar 55 ekspertë vendorë dhe 4 ekspertë ndërkombëtarë. Ekspertët kanë dhënë kontributet e tyre në hartimin e raporteve dhe analizave në sektorë përkatës, si dhe në koordinimin e punëve të nëngrupeve; sigurimi i materialeve dhe analizave të argumentuara lidhur me çështjet që parashiheshin të ngriheshin në agjendën e negociatave me Serbinë nga fusha e ekonomisë dhe financave; sigurimi i

studimeve dhe analizave ekonomike mbi qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të shtetit të ardhshëm të Kosovës; sigurimi i konsulencës së jashtme për ekspertizë në çështjet më të ndjeshme; ofrimi i tërë bazës humltuese të "Riinvest"-it për nevojat e delegacionit të Kosovës për negociata; pjesëmarrja në negociatat në Vjenë.

Ekspertët e Institutit "Riinvest", me ndihmën e shumë ekspertëve të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë, prodhuan një sërë dokumentesh dhe analizash për nevojat e ekipit negociator. Më poshtë po i përmendim disa prej tyre: Raporti mbi dëmet e luftës dhe dëmet e tjera të shkaktuara nga pushteti serb, me anekse dhe studime ilustruese rasti; Raporti mbi parimet e suksesionit midis Kosovës dhe RFJ-së/respektivisht Serbisë dhe Malit të Zi, duke iu përmbajtur parimeve analoge të aprovuara nga komisioni për suksesion midis entiteteve të ish-Federatës Jugosllave, duke përfshirë edhe borxhin e jashtëm dhe obligimet për pagimin e tij; Raporti mbi viabilitetin/qëndrueshmërinë ekonomike të Kosovës; Raportet mbi dëmet e shkaktuara nga Serbia në: Fondin Pensional të Kosovë, kursimet devizore, sistemin bankar të Kosovës, sistemin buxhetor të Kosovës, dokumentacionin kadas-tral dhe pajisjet teknike kadastrale; Raporti mbi borxhin e jashtëm; Raporti mbi statusin e pronës shoqërore dhe publike të Kosovës në ish-RSFJ, dhe privatizimin; Raporti mbi Fondin federativ.

Ekspertët e Grupit për ekonomi dhe financa kanë marrë pjesë në dy raunde të bisedimeve të Vjenës dhe kanë prezantuar argumentet mbi pozitën



koloniale të Kosovës nën regjimin serb. Ata kanë prezantuar subjektivitetin e plotë të Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave dhe me sukses i kanë mbrojtur kërkesat e palës kosovare duke hedhur poshtë pretendimet serbe mbi pronën shoqërore dhe publike të Kosovës.

2008

Gjatë vitit 2008, Instituti "Riinvest" ka përgatitur një studim lidhur me kapacitetet hulumtuese në Kosovë. Ky raport është mbështetur nga Universiteti i Freiburgut. I njëjti analizoi kuadrin hulumtues në institucione publike dhe private, si në Universitet, kolegje, Akademi të Shkencave dhe institute të tjera publike dhe private.

Në vitin 2008, Instituti "Riinvest" gjithashtu ka hartuar një raport lidhur me trendët socio-ekonomike të vendit. Ky studim ishte mbështetur nga Ballkan Trust for Democracy. I njëjti evidentonte përparimin dhe ngecjen në sektorë të ndryshëm ekonomikë të vendit, përfshirë sektorin real dhe sektorin financiar. Gjithashtu raporti pasqyron ecurinë në reformat strukturore që Kosova kishte ndërmarrë gjatë kësaj periudhe të tranzicionit.

"Riinvest"-i gjithashtu hartoi një raport hulumtues lidhur me nivelin e korrupsionit në Kosovë. I mbështetur nga UNDP, ky raport është bazuar në të dhëna sasiore të mbledhura përmes anketimit të mbi 1,000 amvisërve në të gjithë territorin e Kosovës. Raporti analizoi perceptimin e qytetarëve lidhur me nivelin e korrupsionit si dhe hetoi përvojat e drejtpërdrejta të tyre me institucione të caktuara publike. Raporti gjithashtu trajtoi shkaqet kryesore që nxisin nivelin e lartë të korrupsionit në Kosovë si dhe ofroi rekomandime për ndryshim politikash.

Instituti "Riinvest" gjatë vitit 2008 ka hartuar edhe një studim lidhur me pylltarinë në Kosovë. Ky raport i mbështetur nga USAID-i ka bërë një kadastrim të pyjeve të Kosovës dhe potencialit të saj për të furnizuar

tregun me lëndë drusore, qoftë si burim i energjisë apo edhe si lëndë e parë në industrinë e drurit.

Në vitin 2008 Instituti "Riinvest" ka bërë një studim lidhur me rrjedhën e procesit të privatizimit në Kosovë. I përgatitur në kuadër të 'Forumi 2015', i njëjti nxjerr në pah përparimet dhe ngecjet në këtë proces. Duke shfrytëzuar të dhëna sasiore të grumbulluara përmes anketës përfaqësuese, raporti evidenton indikatorët e performancës së këtyre ndërmarrjeve para dhe pas privatizimit, përderisa analizon ndikimin e karakteristikave të ndryshme në performancën e këtyre ndërmarrjeve. Raporti është pasuruar edhe me raste studimore dhe gjetjet e tij janë prezantuar në një konferencë ndërkombëtare në kuadër të 'Forumi 2015'.



2009

Instituti "Riinvest" në vitin 2009 ka hartuar Strategjinë e Industrisë së Kosovës (2009-2013). Ky studim jep një pasqyrë origjinale të gjendjes së industrisë dhe sektorëve prodhues në Kosovë, si dhe për sfidat e ri-industrializimit të Kosovës. Bazohet në një hulumtim gjithëpërfshirës të rreth 1200 bizneseve prodhuese lidhur me kapacitetet e tyre prodhuese. Rekomandimet kanë të bëjnë me lansimin e politikave moderne të zhvillimit që sigurojnë një mjedis të përshtatshëm biznesor dhe një rol aktiv të shtetit duke evituar dëmet që mund të paraqiten në çrregullimin e tregut.

Analizat e prezantuara në këtë dokument sigurojnë informata të cilat përmirësojnë dukshëm nivelin e informimit për sektorët industrialë, të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e sektorëve të industrisë për periudhën afatmesme 2009-2013.

Gjithashtu, gjatë vitit 2009 Instituti "Riinvest" me mbështetjen e CIPE-s, ka bërë një studim lidhur me qeverisjen korporative në institucione financiare në Kosovë. Ky studim ka analizuar dhe vlerësuar cilësinë e qeverisjes korporative në institucionet financiare (bankat dhe kompanitë e sigurimeve) në Kosovë, duke u bazuar në kërkesat dhe standardet e njohura si parimet e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD). Qëllimi i këtij raporti është që të përmirësojë informacionin për akterët relevantë lidhur me të arriturat dhe situatën sa i përket qeverisjes korporative nëpër banka dhe kompani të sigurimeve, si dhe të bëjë rekomandime për politika të ndryshme për Qeverinë, BQK-në (Banka

Qendrore e Kosovës), si dhe për kompanitë e sektorit financiar dhe palët e tjera me interes për avancimin e mëtejme të gjendjes në këtë fushë.

Në tetor të vitit 2009, Instituti "Riinvest" ka bërë një studim lidhur me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike në Kosovë. Ky raport hulumtues kishte për qëllim që të përmirësojë informimin e vendimmar-rësve politikë dhe palëve tjera të interesuara lidhur me situatën e tanishme në ndërmarrjet publike, lidhur me nevojën e privatizimit të tyre duke marrë parasysh edhe përvojat e vendeve të tjera në tranzicion; dhe të nxisë përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe në mënyrë të veçantë t'i inkurajojë politikat publike që synojnë përfundim dhe suksesshëm të këtij procesi të rëndësishëm. Gjetjet nga ky raport janë prezantuar në një konferencë ndërkombëtare.

Instituti Riinvest në bashkëpunim me Institutin për Shoqëri të Hapur kanë zbatuar edhe projektin me titull: "Ngritja e kapaciteteve të qeverisë lokale për monitorimin dhe implementimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal" me pesë komunat pjesëmarrëse të projektit DELTA III (Shtimen, Obiliqin, Dragashin, Kamenicën dhe Malishevën). Qëllimi i projekti ishte ngritja e kapaciteteve të qeverisë lokale në aplikimin e veglave kompjuterike për planifikimin dhe implementimin e projekteve që dalin nga strategjia zhvillimore ekonomike e komunës përkatëse duke ndërtuar kështu një mekanizim i cili siguron proces relevant për implementim të strategjisë dhe qeverisje lokale të avancuar dhe transparente në vendimarrje.



8



PERIUDHA
2010-2015

08 / PERIUDHA 2010-2015

Viti 2010 karakterizohet me nismën e procesit të tranzicionit menaxherial të Institutit "Riinvest" dhe kalimin e kompetencave menaxheriale prej themeluesve të pjesëtarë të stafit të atëhershëm të Institutit "Riinvest". Në këtë proces, më 1 janar të vitit 2010, z. Lumir Abdixhiku caktohet si drejtor ekzekutiv i Institutit "Riinvest" – me mandat katërvjeçar (mandat i vazhduar më pas në vitin 2014 dhe për katër vjet të tjera).

Në fund të vitit 2010, për shkak të angazhimit politik, presidenti i Bordit dhe njëkohësisht njëri ndër themeluesit e Institutit "Riinvest", z. Muhamet Mustafa, ndërpreu të gjitha angazhimet udhëheqëse në Institut. Në këtë vijë, nga pozita e drejtorit kërkimor largohet edhe z. Alban Zogaj. Presidenti i ri i Bordit zgjidhet z. Sejdi Osmani, ndërkaj në pozitën e drejtorit kërkimor caktohet z. Alban Hashani. Ekipi menaxherial komplet ohet më 1 janar 2011, me caktimin e znj. Saxhide Mustafa në pozitën e zëvendës drejtoreshës ekzekutive të Institutit "Riinvest".

Struktura e re menaxheriale në vitin 2011 fillon reformimin e pozitave kërkimore, duke përfunduar kështu me një sistem rangues të katër niveleve – sistem i aplikueshëm edhe sot. Sipas këtij sistemi, nivelin e parë e për-

bëjnë "asistentët hulumtues"; nivelin e dytë "hulumtuesit"; nivelin e tretë "hulumtuesit e avancuar"; ndërkaj nivelin e fundit e përbëjnë "hulumtuesit seniorë". Kjo renditje përcakton dhe procedurën avancuese të stafit të ri dhe atij aktual të "Riinvest"-it.

Periudha 2010-2015 karakterizohet kryesisht me fillimin e angazhimit të Institutit "Riinvest" në projekte afatgjatë të Komisionit Evropian (KE). Kështu, nëpërmjet dy projekteve (secili me kohëzgjatje nga dy vjet), "Riinvest"-i fillon ndërtimin e një bashkëpunimi të ri me KE-në – bashkëpunim që synon aftësimin e zyrtarëve qendrorë e lokalë, si dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, në qasjen e fondeve dhe granteve të KE-së. Ky bashkëpunim do të shtrihej më pas edhe në dy nisma gjithërajonale nëpërmjet dy projekteve të tjera (secili me nga dy vjet kohëzgjatje) dhe nëpërmjet përfshirjes së Institutit "Riinvest" dhe Komisionit Evropian në pjesën veriore të Kosovës; përkatësisht në hulumtimin e analizën e ambientit biznesor atje, si dhe në ngritjen e kapaciteteve biznesore të akterëve lokalë në veri të Kosovës.

Në këtë periudhë, Instituti "Riinvest" fillon edhe një bashkëpunim tjetër afatgjatë me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) – një partneritet që do të shtrihej edhe për pesë vjetët e ardhshme (nga koha e

shkrimit të këtij raporti). Fillimisht nëpërmjet një projekti dyvjeçar të promovimit të sektorit të hortikulturës në Kosovë, dhe më pas nëpërmjet një konzorciumi të ndërtimit të tregjeve të turizmit, procesimit të ushqimit e sektorit privat të shëndetësisë – bashkëpunimi "Riinvest" – SDC arrin nivelin më të lartë bashkëpunues në eksperiencën 20-vjeçare të Institutit.

Po aq i rëndësishëm mbetet edhe bashkëpunimi i parvjetshëm me Center for International Private Enterprise (CIPE) gjatë periudhës në fjalë; ku realizohen katër projekte afatgjata në fushat e qeverisjes korporative (përfshirë edhe bizneset familjare) dhe prokurimit publik në Kosovë.

Bashkëpunimet e tjera, të elaboruara në seksionet në vijim, përfshijnë institucionet më kredibile vendore e ndërkombëtare. Përfshijnë bashkëpunime afatgjatë dhe të shëndosha me Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe implementimin e disa projekteve qenësore në fushën e investimeve kapitale, qeverisjes së hapur të sektorit bankar; përfshijnë bashkëpunim afatgjatë me Fondacionin Friedrich Ebert Stiftung (FES) në avokimin e çështjeve më me interes në fushën e sektorit privat, informalitetit, mundësive të barabarta për punësim e temave të ngjashme socio-ekonomike; përfshijnë bashkëpunime të shëndosha me United Nation Development

Programme (UNDP), në hartimin dhe prezantimin e raportit më prestigjioz të UNDP-së gjithandej – përkatësisht Raportin e Zhvillimit Njerëzor (HDR); dhe së fundi përfshijnë bashkëpunimin dyvjeçar me Think Tank Fund Budapest (TTF) në rritjen e kapaciteteve avokuese të Institutit "Riinvest".

Bashkëpunimet e tjera në këtë periudhë përfshijnë institucionet ndërkombëtare, si Ministrinë e Punëve të Jashtme të Danimarkës (MFAD); United Nations International Children's Emergency Fund (UNICEF); International Organization for Migration (IOM); Danish Refugee Council (DRC); PASOS Network; Center for Study of the Democracy (CSD); Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe (REC); Booz Allen Hamilton Kosovo (BAH); Rockefeller Brothers Fund (RFB); Profound Netherland; EDA Banja Luka; dhe përfshijnë institucionet vendore si Qeveria e Kosovës (përkatësisht Ministria e Diasporës dhe Ministria e Shëndetësisë); pjesën më të madhe të komunave të Kosovës; asociacionet e bizneseve (në rend të parë Odën Ekonomike të Kosovës dhe American Chamber of Commerce); rrjetin e organizatave qeveritare CIVIKOS; ProCredit Bank Kosovo; Sole Mizo Kosovo; Marigona Residence; Fshatin Ndërkombëtar në Prishtinë; Italiane Reggio Terzo Mondo (RTM); Organizatën Humanitare CARITAS – ndër të tjera.

2010

Në vitin 2010, në shenjë të 15-vjetorit të themelimit, Instituti "Riinvest" fillon edhe organizimin e Konferencës ndërkombëtare "Aktivizimi i burimeve të rritjes ekonomike në Kosovë"; konferencë që do të organizohet në vazhdimësi që nga atëherë. Qëllimi kryesor i konferencës ishte prezantimi i diturive të reja dhe përvojave të avancuara mbi aktivizimin e burimeve të zhvillimit ekonomik në një ekonomi të hapur në zhvillim, me referencë speciale për rastin e Kosovës. Konferenca gjithashtu synonte t'i promovojë aktivitetet hulumtuese në Kosovë që kishin të bënte me zhvillimin ekonomik dhe shoqëror dhe t'i forconte lidhjet dhe partneritetet me qarqet akademike dhe ekspertët e zhvillimit ekonomik në Evropë, ShBA dhe gjetiu, si dhe me organizatat ndërkombëtare. Gjatë konferencës, akademikë dhe ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë paraqitën punimet e tyre që kryesisht kishin të bëjnë me zhvillimin institucional dhe burimet e rritjes ekonomike, aspektet sektoriale dhe politikat industriale dhe rolin e kapitalit human dhe intelektual në zhvillimin ekonomik. Fjalimi kryesor i konferencës mbahej nga ambasadori i atëhershëm i ShBA-së në Kosovë, z. Christopher Dell. Pjesëmarrës e prezantues të tjerë të konferencës ishin Andrew Wilson (CIPE, Washington); Franz-Lothar Altmann (Southeast Europe Association, Munich); Borko Handjiski (Banka Botërore); Ken Jackson (Universiteti i Auckland); Peter Sturm (konsulent ekonomik, Paris); Iraj Hashi (Universiteti Staffordshire, Stoke-on-Trent); Will Bartlett (London School of Economics, Londër); Erol Katircioglu (Universiteti Bilgi, Stamboll). Në konferencë u prezantuan 19 punime shkencore.

Në vitin 2010, "Riinvest"-i fillon për herë të parë edhe angazhimin trans-kontinental në kërkim dhe avokim. Si pjesë e një rrejtje të gjerë partnerësh nën ombrellën e Center for International Private Enterprise (CIPE), Instituti "Riinvest" ishte angazhuar në fushën e qeverisjes korporative në vendet si Turqi e Pakistan. Në arsyetimin e CIPE-s, "Riinvest"-i ishte zgjedhur si partner regional për shkak të nivelit të lartë të përfaqësimit, profesionalizmit dhe eksperiencës që institucioni bartte asokohe.

Në vitin 2010, Instituti "Riinvest" lanson për herë të parë edhe treguesin e zhvillimit ekonomik "Leading Economic Indicators" si rezultat i një partneriteti me "Booz Allen Hamilton – Kosovo Branch" në Prishtinë. Indeksi në fjalë, duke shfrytëzuar metodologjinë standarde të "American Leading Indicator Index", synonte të bënte parashikimin e aktivitetit ekonomik për gjashtë muajt në vijim. LEI vazhdon të jetë edhe sot indeks me interes për Institutin "Riinvest".

Në vitin 2010, Instituti "Riinvest" angazhohet edhe në hartimin e dy strategjive komunale, atë të komunës së Podujevës dhe asaj të Fushë-Kosovës. Të dy dokumentet përpilohen në bashkërendim me përfaqësues të komunave përkatëse. I tërë procesi i projektit kishte kaluar nëpër disa faza: organizimi dhe fuqizimi i ekipeve dhe grupeve punuese për hartimin e strategjive, grumbullimi i të dhënave të rëndësishme dhe analiza e gjendjes socio-ekonomike në komunë, analiza e pozicionit konkurrues të komunës (SWOT), definimi i vizionit, identifikimi i synimeve, objektivave, programeve dhe projekteve, përfshirë edhe përshkrimin e shkurtër të projekteve, identifikimin e burimeve të fi-

nancimit dhe burimeve njerëzore, të gjitha këto aktivitete në përputhje me prioritetet zhvillimore të komunës. Përmes dhënies së udhëzimeve, asistencës së drejtpërdrejtë gjatë gjithë procesit të hartimit të strategjive dhe programeve trajnuese, zyrtarët dhe punëtorët e tjerë të këtyre komunave janë aftësuar për udhëheqjen në mënyrë të pavarur të procesit për hartimin e strategjive për zhvillim ekonomik lokal. Krahas asistencës permanente që ekspertët e "Riinvest"-it u kanë dhënë këtyre komunave në hartimin e këtyre dokumenteve të rëndësishme zhvillimore, Instituti ynë i ka zhvilluar edhe dy trajnime 3-ditore për anëtarët e ekipeve komunale për zhvillim ekonomik lokal, anëtarëve të grupeve punuese dhe të zyrtarëve tjerë të këtyre komunave. Një modul i veçantë për pjesëmarrësit e këtyre trajnimeve është zhvilluar edhe për ndërtimin e mekanizmave për monitorimin dhe implementimin e strategjive dhe projekteve të komunës.

Në këtë vit, Instituti "Riinvest" ishte angazhuar nga UNDP për realizimin e një studimi fizibiliteti dhe përpilimin e një plani të biznesit mbi mundësitë e ndërtimit të një qendre për trajnime të zanateve duke u bazuar në mangësitë e gjetura në industri.

Po në këtë vit, Instituti "Riinvest" angazhohet edhe në disa projekte kërkimore-komerciale, duke bërë analizën e tregut për banim për lagjen "Marigona Residence"; anketimin e kënaqshmërisë të klientëve të "ProCredit Bank Kosovo"; anketën e tregut të produkteve të qumështit dhe biznes planin për ndërmarrjen "Sole Mizo" dhe anketën rreth tregut banesor për nevojat e Fshatit Ndërkombëtar në Prishtinë.



2011

Viti 2011 shënon edhe fillimin e implementimit të njërit ndër projektet më të rëndësishme të Institutit "Riinvest", atë të "Promovimit të hortikulturës në Kosovë". Në vitin 2011, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (MFAD) përfaqësuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Kosovë, kishte zgjedhur Institutin "Riinvest" për zbatimin e Entiteti Lehtësues për Sektorin e hortikulturës në Kosovë, një projekt dyvjeçar. Fokusi i aktiviteteve kishte të bënte me metodologjinë e përcaktuar nga "Qasja e zinxhirit për pjesëmarrjen e tregut (PMCA)", metodologji e cila jepte udhëzime për të planifikuar dhe zbatuar një hulumtim të strukturuar dhe zhvillimit në zinxhirët e tregjeve të veçanta – në këtë rast të hortikulturës – ose sektorëve për të rritur ndikimin pozitiv në varfëri. Gjatë vitit ishin mbajtur grupe tematike dhe grupe punuese: rreth 30 prej tyre, 15 në Rahovec dhe 15 nëpër fshatra tjera (janë bërë gjithsej 30 dokumente planifikuese për këto grupe tematike). Janë bërë marrëveshje me Interex, Fatosi Com, ETC, dhe shërbime të ndryshme për shitjen e frutave dhe verërave të brenduara, të cilat janë detajizuar në raporte. Projekti gjithashtu ka organizuar pjesëmarrje në panairë: KASH – Tiranë, AgroKos, Prishtina International Fair, Festivali i Rrushit, vizitë studimore në Gjermani dhe vizitë studimore në Elbasan. Janë përpiluar raportet shtesë, si Raporti i TVSH-së, Raporti i financimit të agrobizneseve, Raporti i portfolios së verërave, standardi i frutave dhe standardi i Rahovecit. Është bërë rietiketimi i mbi 100 produkteve (verë raki dhe fruta), dizajne të reja për të gjitha këto. Pjesë e projektit ka qenë edhe lansimi i brendit "Frutat e Kosovës".

Në po këtë vit, Instituti "Riinvest" angazhohet për herë të parë në hartimin

dhe prezantimin e raportit prestigjioz të UNDP-së, pra "Raporti i zhvillimit njerëzor 2011. I titulluar "Sektori privat dhe punësimi", raporti i shtatë mbi zhvillimin njerëzor të Kosovës fokusohet në ndërlidhjet ndërmjet zhvillimit njerëzor dhe zgjerimit të sektorit privat. Raporti në fjalë kishte shërbyer për shumë vite si pikë reference e temave që ndërlidhen me sektorin privat dhe me punësimin. Raporti ishte prezantuar në një tryezë nacionale me pjesëmarrës të ndryshëm nga spektri politik, ekonomik dhe shoqëror i Kosovës.

Në vitin 2011, "Riinvest"-i dhe CIPE vazhdojnë bashkëpunimin disavjeçar nëpërmjet angazhimit në fushën e prokurimit publik në Kosovë. Në kuadër të këtij projekti, "Riinvest"-i dhe CIPE zhvillonin një hulumtim të gjerë mbi procesin e prokurimit publik në Kosovë dhe e krahasonin atë me praktikatat e tjera të mira të rajonit. Përveç kësaj, një Raport për qeverisjen korporative dhe transparencën në ndërmarrjet publike ishte paraparë të kryhet në mënyrë për t'i mbajtur aktive projektet e mëparshme dhe të përbashkëta. Për të përcaktuar dobësitë e sistemit të prokurimit publik dhe të zhvillojë një sërë rekomandimesh, Instituti "Riinvest" do të mblidhte të dhëna nga një varg i gjerë të palëve nga komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe media nëpërmjet intervistave të thella, një studim i 600 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe një fokus grupi. "Riinvest"-i do të plotësonte punën me një analizë të kuadrit ligjor për prokurimin publik me një fokus të madh në Ligjin e miratuar rishtazi për prokurimin publik. Gjithashtu "Riinvest"-i do të kryente dy studime rasti (case studies) për t'i nënvizuar përvojat specifike të sektorit privat me prokurimin publik. Për të ndihmuar në formulimin e rekomandimeve për praktikatat më të mira dhe mësimet e nxjerra, "Riinvest"-i do t'i shqyrtonte

edhe përvojat rajonale me prokurimin publik, të cilat ishin në gjendje të krijojnë transparencë më të madhe të konkurrencës dhe uljen e korrupsionit dhe të keqmenaxhimit të fondeve publike. Projekti në fjalë ishte përmbyllur me një tryezë gjithërajonale.

Në vijë të bashkëpunimit me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në vitin 2011, "Riinvest"-i ishte angazhuar për herë të parë në një studim të ambientit biznesor në veri të Kosovës. Qëllimi i projektit ishte krijimi i një kornize gjithëpërfshirëse dhe rrjedhimisht nxjerrja e rekomandimeve për palët e interesuara dhe mundësitë e tyre për të kontribuar në mbështetje dhe përmirësimin e mjedisit të bizneseve të komunitetit serb në tregun e Kosovës. Studimi kishte për qëllim hulumtimin e gjendjes aktuale të bizneseve serbe, potencialet e tyre për zhvillim, pengesat për zhvillimin dhe nivelin e bashkëpunimit me komunitetet e tjera të biznesit në Kosovë, me theks të veçantë në bizneset shqiptare. Për më tepër, studimi analizonte ndikimin politik në bashkëpunimin biznesor në mes të komuniteteve të biznesit. Raporti përfundimtar ishte prezantuar në një konferencë nacionale.

Viti 2011 karakterizohet edhe me prezantimin e Raportit "Sektori bankar: ndihmesë apo barrierë", pjesë e një bashkëpunimi në mes të Institutit "Riinvest" dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Raporti ofronte një analizë të gjendjes aktuale të sistemit bankar, dhe ndikimin potencial që sektori bankar ka mbi zhvillimin ekonomik. Raporti në fjalë ishte prezantuar në një konferencë nacionale me pjesëmarrës nga spektri politik dhe me njohës të fushës së sistemit bankar në Kosovë.

Në vitin 2011, pjesë e misionit avokues të tij, Instituti "Riinvest" në bash-

këpunim me Fondacionin "Friedrich Ebert Stiftung (FES)", kishte organizuar katër tryeza publike, qëllimi i të cilave ishte rritja e angazhimit qytetar në vendimmarrje ekonomike. Temat e tryezave në fjalë ishin: "Sfidat ekonomike 2011 plus"; "Zhvillimi i sektorit privat"; "Qasja alternative për energji"; dhe "Efektet e masave të reciprocitetit në ekonominë e Kosovës".

Në vitin 2011, Instituti "Riinvest", në bashkëpunim me UNICEF-in, kishte organizuar një seri trajnimesh për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të Republikës së Kosovës. Projekti i titulluar "Trajnimi për hulumtime statistikore dhe analiza të të dhënave", ishte i organizuar në tri seksione, nga i cili kishin përfituar mbi 60 pjesëmarrës.

Në vitin 2011, Instituti "Riinvest" kishte implementuar projektin e quajtur "KPEP Satisfaction Report", me qëllim për të matur nivelin e përgjithshëm të performancës dhe nivelit të mbështetjes që u dha nga KPEP për përfituesit e saj. Për më tepër, studimi kishte vlerësuar shkallën në të cilën klientët dhe palët e tjera janë të informuar në lidhje me programin, veçanërisht objektivat e tij kryesore, kënaqësinë e tyre në lidhje me shpërndarjen e programit nga ekipi KPEP, dhe përfitimet relative që ata kanë fituar nga të qenit një aktor në program. Raporti është shkruar në bazë të të dhënave primare. Të dhënat sasiore dhe cilësore janë mbledhur nga intervistat. Të dhënat sasiore ishin të nevojshme për t'i krahasuar dhe matur efektet e prekshme të ndihmës apo të partneritetit, ndërsa të dhënat cilësore shërbyen për të vlerësuar marrëdhënien dhe kënaqësinë e përgjithshme të afërm të firmave përfituese dhe organizatat partneritet drejt KPEP. Së fundi, përveç rezultateve të sondazhit, konkluzionet dhe rekomandimet specifike ishin të specifikuara në raport.

2012

Në vitin 2012, përkatësisht në muajin maj të këtij viti, Instituti "Riinvest" organizoi Konferencën ndërkombëtare dyditore 'Aktivizimi i burimeve për rritjen ekonomike në Kosovë'. Qëllimi i konferencës ishte zbulimi dhe prezantimi i njohurive të reja dhe përvojave të avancuara për aktivizimin e burimeve për rritjen ekonomike në një ekonomi të hapur të pazhvilluar – me theks të veçantë në Kosovë. Konferenca, po ashtu, kishte për qëllim forcimin e marrëdhënieve të qarqeve akademike dhe ekspertëve zhvillimorë nëpër Evropë, Amerikë dhe gjithandej. Konferenca u organizua në seksione plenare ku kontribuuesit prezantuan punën e tyre dhe e diskutuan me audiencën. Temat e prezantuara përfshinin çështje të shumta ekonomike në shtetet në zhvillim: bujqësi, investimet e huaja, kapitali njerëzor, promovimi i shtetit. Në konferencë u prezantuan 21 punime shkencore.

Në vitin 2012, Instituti "Riinvest" është angazhuar nga Ministria e Diasporës në hartimin e një raporti hulumtues mbi incentivat dhe lehtësirat të zbatuara në vende tjera për tërheqjen e investimeve nga diaspora. Objektivi kryesor i këtij studimi ishte analizimi i ligjeve të cilat rregullojnë aspektet e të bërit biznes në Kosovë dhe spikatja e dispozitave të cilat po pengojnë tërheqjen e investimeve nga diaspora. Pjesë e rëndësishme e raportit ishin edhe rekomandimet të cilat do paraqiten në një tryezë nacionale.

Në po këtë vit, Instituti "Riinvest" ka dhënë asistencë teknike për Ministrinë e Shëndetësisë në reformën shëndetësore rreth Ligjit të sigurimeve shëndetësore, si dhe organizmit të njëjste shëndetësore në Kosovë. Gjatë këtij viti "Riinvest" ka dhënë këshilla të vazhdueshme në formatin potencial

të organizimit të strukturës së re menaxhuese në kujdesin primar dhe sekondar në shëndetësi.

Gjithashtu, në vitin 2012, IOM-i dhe "Riinvest"-i kanë bërë vlerësimin e programit 'Asistenca për rikthim dhe ri-integrim për të riatdhesuarit vullnetarë në Kosovë'. Qëllimet e vlerësimit kanë qenë analizimi i suksesit të programit; analizimi i paketës ri-integruese dhe efektivitetit të saj në kontribumin e rikthimit të qëndrueshëm dhe ri-integrimit të suksesshëm; vlerësimi i performancës së përfituesve në hapjen e bizneseve të vogla; si dhe vlerësimi i strategjisë së zbatuar nga IOM-i. Janë mbajtur takime dhe intervista me zyrat e IOM-it në Kosovë (dhe zyrës së IOM-it në Vjenë nëpërmjet telefonit); janë bërë hulumtimi dhe përgatitja për pyetësorët; janë bërë vizita në terren dhe intervista me përfituesit dhe është përpiluar raporti final.

Në këtë vit, Danish Refugee Council (DRC) ka angazhuar Institutin "Riinvest" për të mbajtur trajnime dhe për të bërë hulumtim të tregut në Kosovë për projektin 'Stabilizimi i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Mitrovicë nëpërmjet iniciativave socio-ekonomike, profesionale dhe edukative' në lagjen e romëve në Mitrovicë. Puna ka qenë e ndarë në tri faza: vlerësimi i nevojave të liderëve të workshopit, konsulencë individuale për analizë të tregut dhe planifikim të biznesit dhe hulumtimi i tregut me 600 respondentë.

Në vitin 2012, Instituti "Riinvest" në bashkëpunim me CIPE në Uashington ka bërë prezantimin e raportit vlerësues të NP-ve në vend. Raporti dhe analiza vlerësuese janë përgatitur gjatë vitit 2012 dhe në to janë prezantuar



gjetjet e reja nga intervistat me përfaqësuesit e institucioneve vendore, ndërmarrjeve publike dhe akterëve të tjerë relevantë. Diskutimet në konferencë kanë shërbyer për pasurimin e raportit final, i cili është publikuar në muajin dhjetor të atij viti.

Në po të njëjtin vit, Instituti "Riinvest" ishte angazhuar nga UNDP me qëllim të anketimit të rreth njëmijë përfituesve nga programi i punësimit aktiv, ALMP. Anketimi – në bazë të cilit ishte ndërtuar një raport final – ishte bërë në gjithë Kosovën. Është përpiluar anketa dhe janë anketuar përfituesit (1082) si dhe grupi i kontrollit (150) për të identifikuar statusin e punësimit dhe aftësinë për punësim të të dy grupeve. Është bërë përpunimi i të dhënave nëpërmes SPSS dhe gjetja e 21 indikatorëve relevantë.

Si pjesë e rrjetit CIVIKOS, Instituti "Riinvest" ka dhënë një analizë të çështjeve tatimore dhe fiskale me të cilat ballafaqohen OJQ-të në Kosovë. Është bërë analiza e kornizës ligjore të OJQ-ve në vend krahas praktikave evropiane. Është bërë analizimi i mospërputhjeve të ligjeve të caktuara dhe zbatimit të tyre në praktikë; analizimi i zbatimit të statusit të përfituesit

publik për OJQ-të në Kosovë; analizimi i Ligjit mbi Asociimin, tatimin mbi të ardhurat, tatimin mbi pronën, trajtimin e donacioneve, TVSH-në dhe trajtimin e importeve. Pas krahasimit me praktikën evropiane janë dhënë rekomandime që mund të përmirësojnë gjendjen për OJQ-të vendore.

Në vitin 2012, është vazhduar me implementim e projekteve afatgjatë, përkatësisht "Promovimi i hortikulturës në Kosovë", financuar nga SDC dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës; si dhe projekti i "Prokurimit publik" mbështetur nga CIPE.

Në fushën e angazhimit të projekteve komerciale, Instituti "Riinvest" gjatë vitit 2012 ka bërë hartimin e një biznes plani për organizatën italiane Reggio Terzo Mondo (RTM). Biznes plani ka përfshirë edhe një anketë të konsumatorëve dhe intervista me akterë relevantë për hulumtimin e tregut dhe zhvillimin e brendit. Në të njëjtin vit janë mbajtur trajnime pesëditore për Shoqatën CARITAS në fushën e menaxhimit të projekteve dhe sigurimit të cilësisë.

2013

Viti 2013 shënon edhe fillimin e bashkëpunimit të parë të Institutit "Riinvest" me Komisionin Evropian; përkatësisht me mbështetjen financiare si pjesë e fondeve të EURED. Nëpërmjet një angazhimi dyvjeçar, të titulluar "Fuqizimi i kapaciteteve të zhvillimit ekonomik rajonal të Kosovës, përmes Akademisë zhvillimore, njësive komunale për zhvillim dhe menaxhim të projekteve si dhe implementimit të projekteve me ndikim të shpejtë", "Riinvest"-i synonte t'i konsolidojë dhe fuqizojë kapacitetet e regjioneve për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në zhvillimin ekonomik rajonal dhe të përgjithshëm të Kosovës. Aktiviteti kryesor i projektit ishte themelimi i Akademisë zhvillimore, trup ky që do të organizonte ligjërata në dy cikle me kohëzgjatje prej tre muajve secili, e ku pjesëmarrësit do t'u nënshtrohen 24 ligjëratave intensive. Synimi i këtyre ligjëratave ishte pra zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të akterëve rajonalë për të aplikuar, menaxhuar dhe zbatuar projekte zhvillimore të financuara nga donatorë të ndryshëm, me theks të veçantë projekte të financuar nga zyra e BE-së.

Nga të dyja ciklet kishin diplomuar rreth 80 zyrtarë komunalë nga të gjitha komunat e Kosovës dhe pjesëtarëve nga OJQ-të rajonale. Në fund të projektit, ishin ndarë edhe 10 grante në vlerë (secili) nga 10.000 euro për 10 komunat e organizatat lokale më të mira. Nëntë (9) komuna të Republikës së Kosovës dhe një organizatë joqeveritare rajonale, që kanë fituar grante për implementimin e projekteve të vogla me ndikim të shpejtë janë nderuar në një ceremoni solemne të zhvilluar në Prishtinë. Projektet zhvillimore të zbatuara, përfshijnë furnizimin me serra për gratë fermere, shpërndarjen

me makina qepëse për personat me aftësi të kufizuara dhe shpërndarjen me koshere bletësh për fermerët. Komunitatet përfituese janë komuna e Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës, Suharekës, Rahovecit, Drenasit, Skenderajt, Istogut dhe ajo e Mamushës si dhe OJQ-ja rajonale Handikos Pejë.

Viti 2013 karakterizohet edhe me angazhimin në dy projekte ndërkombëtare afatgjatë (dy herë nga dy vjet) të financuara po ashtu nga Komisioni Evropian. I pari, i titulluar "Shoqëria civile për qeverisje të mirë dhe anti-korrupsion në Evropën Juglindore: ndërtimi i kapaciteteve për monitorim, avokim dhe ngritje të vetëdijesimit", përbënte një angazhim të 23 organizatave të shoqërisë civile në gjithë rajonin. Bazuar në strategji dhe plan të veprimit të përbashkët, projekti i udhëhequr nga Qendra për Studime të Demokracisë (CSD) nga Bullgaria synonte ndërtimin e koalicionit të organizatave të shoqërisë civile në Evropën Juglindore, të cilat ndajnë mendime të ngjashme, për të përmirësuar: kapacitetin e tyre, njohuritë, si dhe përkushtimin për të ofruar analiza, monitorim dhe avokim të politikave, masave dhe reformave lidhur me qeverisjen e mirë dhe anti-korrupsionin, si dhe të rrisë bashkëpunimin dhe mirëkuptimin mes organizatave të shoqërisë civile përtej niveleve regjionale dhe nacionale. Përmes Iniciativës për Zhvillim Ligjor në Evropën Juglindore synohej promovimi i dialogut mes qeverive dhe shoqërisë civile si dhe përmirësimi i ambientit për aktivitetet e shoqërisë civile në nivel nacional dhe atë regjional.

I dyti ndërkaq, titullohej "Avokim për qeverisje të hapur, mbështetja e drejtës për informim në Evropën Juglindore" dhe kishte për qëllim inku-

Akademia Zhvillimore: "Fuqizimi I Kapaciteteve
të Zhvillimit Ekonomik Rajonal të Kosovës"



2013



rajimin e qeverive në Ballkanin Perëndimor për të qenë më transparente. Projekti financohet nga Unioni Evropian dhe udhëhiqet nga rrjeti PASOS. Ky projekt kishte për cak qeveritë në Kosovë, Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Duke përdorur metodologji të njëjtë, për të adresuar kornizë të njëjtë për qeverisje të hapur, projekti do të përfshijë trajnim ekspertësh të shoqërisë civile për metodologjinë e draftimit të zotimeve në “Partneritetin për Qeverisje të Hapur (Open Governance Partnership – OGP)” për secilin shtet, si dhe trajnim të organizatave të

shoqërisë civile të bazuara në avokim, monitorim dhe analizë të politikave. Projekti monitoronte ndikimin e politikave qeveritare, dhe do t’i zhvillojë zotimet që qeveritë do të marrin në kuadër të iniciativës “Partneritet për Qeverisje të Hapur”.

Një projekt tjetër afatgjatë i cili do të niste në vitin 2013, ishte ai në partneritet me Swiss Contact dhe PEM, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Nëpërmjet ndërtimit të një konzorciumi fitues, Instituti “Riinvest” do të ishte bartës i një angazhimi pesëvjeçar në fushën e intervenimeve në turizëm, në sektorin privat dhe në shëndetësi. Në këtë fushë do të themelohej një zyrë e re “Promoting Private Sector Employment – PPSE”; pjesë esenciale e menaxheriale e të cilës do të ishte edhe stafi i Institutit “Riinvest”.

Në bashkëpunim me FES, Instituti “Riinvest” në vitin 2013 zhvillon edhe studimin mbi informalitetin në Kosovë. Nëpërmjet hartimit të pyetësorit në vijë me literaturën më të fundit, Instituti “Riinvest” kishte anketuar rreth 600 biznese të vogla dhe të mesme në Kosovë; për të mbledhë më pas, përpunuar e prezantuar në një raport e tryezë nacionale të gjeturat e studimit. Prezantimi i raportit në tryezë kishte bashkuar një numër të madh përfaqësuesish të biznesit, të qeverisë e të institucioneve ndërkombëtare.

Në vitin 2013, Instituti “Riinvest” është kontraktuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, për të ndërmarrë një studim që përfshin një anketë me 400 serbë të Kosovës. Kjo anketë ka përfshirë veriun e Kosovës me komunat Mitrovica Veriore, Zubin Potoku dhe Leposaviqi (me

200 respondentë) dhe jugun e Kosovës me komunat Graçanicë, Shtërpçë, Partesh, Hoçë e Madhe, Rahoveci dhe Prilluzhë (me 200 respondentë).

Në bashkëpunim me BSC Kosova, Instituti "Riinvest" në dhjetor të 2013 kishte bërë prezantimin e rezultatit të anketës dhe hulumtimit me 600 biznese në vend. Në këtë tryezë kishin marrë pjesë përfaqësues të organizatave biznesore dhe avokues të tjerë të çështjeve të biznesit. Tryeza ishte transmetuar drejtpërdrejt në mediet nacionale dhe po ashtu ka shërbyer si referencë në disa shkrime e artikuj vijues.

Në vitin 2013, vazhdohet bashkëpunimi me CIPE nëpërmjet Projektit "Përmirësimi i konkurrueshmërisë së bizneseve kosovare në projektet publike". Ky projekt synonte të përmirësonte transparencën në shpenzimet publike për të siguruar një alokim më eficient të fondeve publike për të shërbyer nevojat e përbashkëta. Një pjesë të madhe të këtij projekti përfshinte krijimi i një doracaku (Toolkit) që do të shërbente si udhëzues hap-pas-hapi për bizneset që të bëjnë oferta konkurruese dhe t'i mbajnë përgjegjëse institucionet publike për çdo shpenzim publik jo-optimal. "Riinvest"-i, në kuadër të projektit, kishte organizuar edhe tryeza e trajnime, në bashkëpunim me konsulentë të jashtëm, rezultati final i të cilave përfshinte nevojën më shumë përgjegjësi, kapacitete të përmirësuara të organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar procesin e prokurimit, si dhe një konkurrencë më e shëndoshë nga bizneset për t'i fituar dhe shfrytëzuar fondet e përbashkëta.

Në vitin 2013, Instituti "Riinvest" kishte lansuar një anketë mbi mënyrën



e financimit të studimeve nga studentët në Kosovë. Anketa me 360 respondentë kishte për qëllim të nxjerrë të dhëna mbi mënyrën e financimit të studimeve nga studentët në Kosovë. Këto të dhëna tregonin më pas nëse studentët e përdorin mundësinë e financimit nëpërmjet kredive bankare dhe, sa është e përhapur kjo dukuri në Kosovë. Nga të dhënat e dala shqyrtoheshin mënyrat dhe alternativat e bankave për ofrimin e këtyre kredive studentore. Anketa përfshinte 5 grupe të ndryshme të respondentëve: studentët të cilët vijojnë studimet; studentët të cilët kanë braktisur studimet; prindërit e studentëve të cilët vijojnë studimet; maturantët e shkollave të mesme dhe punëdhënësit potencialë (si ata në sektorin publik ashtu edhe ata në sektorin privat).

2014

Në vitin 2014, përveçse ishte vazhduar me implementim të projekteve afatgjatë të Komisionit Evropian – përfshirë edhe iniciativat rajonale – dhe përveçse ishte vazhduar vazhdimi i projektit në kuadër të PPSE-së, Instituti “Riinvest”, për herë të parë, kishte fituar grantin institucional nga “Think Tank Fund” të Fondacionit për Shoqëri të Hapur me seli në Budapest. Nëpërmjet një granti dyvjeçar, Instituti “Riinvest” do t’i përmirësonte e reformonte dukshëm të gjitha kapacitetet vetanake për avokim, duke instrumentalizuar mjetet më moderne për komunikim. Ky grant do t’i hapte Institutit “Riinvest” një dritare të re komunikimi përtej mundësive komunikuese të mjeteve tradicionale. Pjesë esenciale e grantit ishte edhe hapja e të dhënave nëpërmjet ofrimit falas për secilin me interes, të të dhënave të grumbulluara nga Instituti “Riinvest” përgjatë gjithë veprimtarisë së tij. Hapja e të dhënave do të nxiste interesimin e kërkuesve të tjerë – jashtë “Riinvest”-it – për prodhimin dhe ofrimin e studimeve shtesë.

Në vitin 2014, Instituti “Riinvest” zgjeron bashkëpunimin me Komisionin Evropian nëpërmjet angazhimit në veriun e Kosovës, përkatësisht në tri komunat minoritare të veriut (Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zubin Potoku); duke ofruar studime mbi ambientin biznesor atje (anketimi i 150 bizneseve në pronësi të serbëve të Kosovës) dhe ofrimit të tetë cikleve trajnuese për 30 përfitues (biznese lokale dhe zyrtarë komunalë).

Në të njëjtin vit, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, Instituti “Riinvest” zhvillon studimin më të madh të bërë ndonjëherë në vend – rreth sektorit privat – duke anketuar plot 1000 biznese të ndara në pesë regjionet e Kosovës. Raporti hulumtues ishte prezantuar në një Konferencë nacionale me mbi 200 pjesëmarrës nga Qeveria, institucionet ndërkombëtare,

bizneset, media, shoqëria civile dhe akterë të tjerë. Në vitin 2014, Instituti “Riinvest”, mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), fillon implementimin e projektit njëvjeçar të titulluar “Investimet kapitale në Kosovë”. Projekti kishte paraparë bërjen e pesë (5) raporteve analitike mbi projektet më të mëdha kapitale në Kosovë. Më saktësisht është paraparë të bëhet hulumtimi dhe analizimi i proceseve të a) koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës; b) privatizimit të KEDS-it; c) koncesionimit të Brezovicës; d) ndërtimit të autostradës Prishtinë-Shkup; dhe e) ristrukturimit dhe privatizimit të PTK-së. Katër analizat e para janë paraparë të bëhen nga Instituti “Riinvest”, ndërsa analiza mbi PTK-në është paraparë të bëhet nga organizata Çohu. Avokimi mbi analizat në fjalë është paraparë të bëhet përgjatë gjithë vitit 2015 nga “Riinvest”-i dhe KFOS.

Si pjesë e angazhimit në projektin PPSE, përgjatë vitit 2014, Instituti “Riinvest” kishte zhvilluar dy studime (dhe anketime) në fushën e turizmit (për regjionin perëndimor të Kosovës) dhe në fushën e përpunimit të ushqimit (në bashkëpunim me PROFOUND Netherland). Studimet dhe bazat e të dhënave kishin shërbyer për angazhime të mëtutjeshme gjatë fazës implementuese – si pjesë pra e vlerësimit të tregut – në kuadër të zyrës së PPSE-së.

Në vazhdimësi të bashkëpunimit të përvjetshëm me CIPE, në vitin 2014 Instituti “Riinvest” është angazhuar në fushën e “Qeverisjes korporative në biznese familjare”. Projekti njëvjeçar kishte tre komponentë, (i) krijimin e një doracaku për qeverisje korporative, (ii) avokimin në drejtim të përmirësimit të situatës lidhur me qeverisjen korporative si dhe (iii) krijimin e një cikli trajnimesh për ndërmarrjet private.

Klima e Biznesit
në Kosovë

2015

Viti 2015 e gjen Institutin "Riinvest" me vazhdimin e projekteve më të rëndësishme të tij në pesë vjetët e fundit; përkatësisht në vazhdimin e fazave të dyta në tri angazhime implementuese të projekteve të financuara nga Komisioni Evropian. Kështu, në vitin 2015, pas një implementimi të suksesshëm të fazës së parë, Instituti "Riinvest" angazhohet edhe për dy vjetët e ardhshme në zhvillimin dhe implementimin e projektit të njohur si "Akademia zhvillimore II". Ngjashëm si në angazhimin paraprak, qëllimi kryesor i projektit "Akademia zhvillimore II", mbetet aftësimi i zyrtarëve të Qeverisë qendrore dhe lokale, si dhe i anëtarëve të shoqatave biznesore, për menaxhim dhe implementim sa më efikas të metodave zhvillimore të BE-së dhe instrumenteve të tjera, të cilat nxisin krijimin e vendeve të reja të punës. Rezultatet e angazhimit të "Akademisë zhvillimore I" ishin impresive, me ndikim tejet pozitiv, dhe interesim tejet të lartë të kryetarëve dhe zyrtarëve komunalë, dhe përfituesve të tjerë nga shoqata të ndryshme vendore. Në ciklin e parë të Akademisë zhvillimore, pas ndjekjes së 24 ligjëratave dhe organizimeve të ndryshme diplomuan 40 zyrtarë komunalë, në një ceremoni solemne. Po ashtu gjatë ciklit të parë, interesim të lartë kanë treguar edhe OJQ-të rajonale, si dhe anëtarë biznesesh, shoqata fermerësh dhe të tjerë. Projekti "Akademia zhvillimore II", udhëhiqet nga Instituti "Riinvest", në bashkëpunim të ngushtë me Fondacionin gjerman "Fredrich-Ebert-Stiftung" dhe Zyrën e BE-së në Kosovë.

Po në këtë vit vazhdohen edhe dy projektet rajonale; përkatësisht vazhdohet me fazën e dytë (dyvjeçare) të Projektit "Shoqëria civile për qeverisje të mirë dhe anti-korrupsion në Evropën Juglindore: ndërtimi i kapaciteteve

për monitorim, avokim dhe ngritje të vetëdijesimit" – sërisht i udhëhequr nga Qendra për Studime të Demokracisë (CSD) nga Bullgaria; si dhe faza e dytë e Projektit "Avokim për qeverisje të hapur mbështetja e së drejtës për informim në Evropën Juglindore" i udhëhequr nga rrjeti PASOS.

Në vitin 2015 vazhdon bashkëpunimi me Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) nëpërmjet angazhimit në raport hulumtues – dhe aktivitete alokuese – për relacionet tregtare në mes Republikës së Kosovës dhe Bosnjë e Hercegovinës. Në këtë projekt ishin të angazhuar edhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur në BeH dhe organizata kërkimore EDA nga Banja Lluka. Studimi kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes qytetare në BeH rreth rëndësisë së relacioneve tregtare në mes të dy shteteve – dhe rrjedhimisht nevojës për afrim politik.





DEVELOPMENT
ACADEMY

Vushitri

Graduation Ceremony

Commit
Social
Democr

Strengthening Kosovo's
Economic
Capacity

DEVELOPMENT
ACADEMY





9

PËRSHTYPJET
TONA

AGON NIXHA

Hulumtues i Avancuar



Angazhimi im në "Riinvest" vite më parë shënon hapjen e një kapitulli të ri të karrierës sime. Ishte pikërisht koha kur përfundova studimet dhe isha i gatshëm që përvojën akademike ta valorizoja, njëkohësisht duke qenë tejet kureshtar që të absorboja sa më shumë nga përvoja shumëvjeçare e kësaj organizate.

Intervistat, anketat, hulumtimet, raportet, artikujt dhe debatet – që pak a shumë rrumbullakojnë punën e një hulumtuesi, ishin dhe ende janë pjesë e pandashme e angazhimit tim. Që nga momenti kur shënohem në mëngjes, e gjithë dita sillet rreth punës hulumtuese. Temat janë të ndryshme. Herë merrem me klimë të biznesit, herë me bujqësi, herë me energji, e herë me qeverisje të hapur – të gjitha këto shumë të rëndësishme për zhvillimin e vendit, por njëkohësisht edhe për formësimin tim, sidomos atë intelektual. Kur flasim për angazhimin tim në "Riinvest", dua të ndalem pak më shumë dhe të veçoj një përvojë, për mua, të jashtëzakonshme.

Mjeshtri i zërimit po i bënte provat e fundit, kameramanët nga afro shtatë televizione nga Kosova dhe Shqipëria i kishin ngre kamerat, mysafirët kishin zënë vendet, pritej që në çdo moment të bëhej hapja. Bëhet fjalë për mega-konferencën "Klima e biznesit në Kosovë 2014", të organizuar nga Instituti "Riinvest". Thuhej që ishte më e madhja ndonjëherë e organizuar nga "Riinvest"-i. S'kishte pse mos të ishte. Do të prezantohej një raport tejet voluminoz që pasqyronte mirëfilli ambientin ekonomik kosovar. Bazohej në perspektivën e plot 1000 bizneseve dhe gjithë të tjerëve që janë hisedarë në

ekonominë e vendit. Hise jo të vogël kisha edhe unë. Më ishte besuar të udhëhiqja punën për realizmin e këtij projekti, për mua, jo me pak peshë. Me ndihmën e kolegëve, me sinergjinë që krijohej në punë, ia dolëm dhe me sukses e shpalosëm në konferencë. Fatkeqësisht, raporti shfaqte një ambient të rënduar ekonomik në vend. Pavarësisht kësaj, paraqitja e detajuar e gjendjes ekonomike dhe rrjedhimisht rekomandimet e dala, besoj që sadopak e kanë provokuar vëmendjen e gjithsecilit dhe do të kontribuojnë në ndërtimin ekonomik të vendit.

Të kthehem tash prapë te përditshmëria e "Riinvest"-it. Për pak t'i harroj pauzat e drekës. Në Institutin "Riinvest" ato janë ceremonial në vete. Nuk është tek ushqimi, jo. Është thjesht te diskutimet me plot përplasje mendimesh që i karakterizojnë këto pauza. Nganjëherë, madje shpesh e nisim me futboll, nganjëherë me politikë, nganjëherë me ekonomi, nganjëherë me kinematografi, e nganjëherë edhe me showbiz. Gjithë këto diskutime përfundojnë, herë duke u pajtuar e herë jo – pak ka rëndësi kjo, bashkë me përfundimin e kafesë që zakonisht vjen pas ushqimit për të na evituar lodhjen e pas ngrënies. Ndoshta duket e zakonshme, por për mua është e pazëvendësueshme.

Sado që tingëllon entuziaste e gjithë kjo punë, nganjëherë përcillet edhe me sfida jo shumë të këndshme. Por, kur mendoj them se sikur të mos ishin këto sfida, të mirat e tjera që ofron kjo punë do ta humbnin të bukurën. Thjesht janë pjesë e çdo pune, s'kanë pse të mos jenë pjesë edhe e punës sonë. Gëzuar 20-vjetori i "Riinvest"-it. Pritshim edhe plot përvjetorë të tjerë me sa më shumë të mira e suksese!

ALBANA GASHI

Zëvendës-menaxher financiar



Në 'Riinvest' jam rritur"; mund të duket si shaka, mirëpo me të vërtetë lirisht kështu mund të shprehem. Në kohën kur edhe u themelua Instituti, unë isha studente e vitit të tretë në Fakultetin Ekonomik. Profesori Muhamet Mustafa, njëri ndër themeluesit e Institutit, më angazhoi mua bashkë me shumë studentë të tjerë, si anketues në hulumtimin e parë që e realizoi Instituti, hulumtimi me titull "Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës".

Si studente që isha dhe e zgjedhur si studente e dalluar nga profesori për të marrë pjesë në hulumtim, ishte një motivim për të mësuar edhe më shumë, t'i përfundoj studimet me kohë, sepse vendin e punës e kishim të sigurt. Ashtu mendonim të gjithë, dhe me të vërtetë ashtu ishte. Me atë vullnet përfundova studimet me kohë dhe sipas nevojës angazhohesha në hulumtimet e Institutit. Mbj mend takimet që i bënim për t'u trajnuar për anketime, në një shtëpi në Velani, dhe sa herë kaloj nga ajo rrugë e shikoj atë vend me nostalgji.

Jo vetëm unë, por shumë e shumë studentë të tjerë, fillimisht kemi qenë pjesë e Institutit, sidomos në periudhën e pasluftës. Thënë të drejtën, unë edhe nga Franca u ktheva (ku kisha shkuar në kohën e luftës, në vitin 99) për Institutin "Riinvest". E doja, më pëlqente puna, më pëlqente stafi, fillimisht ishim shumë pak, por shumë shpejt filluan të shpallen konkurse. Prano-heshin hulumtues/e, secili më i zoti se tjetri.

Janë plot 15 vjet që jam pjesë e stafit të Institutit, dhe përgjatë këtyre viteve kam kaluar nëpër projekte të ndryshme. Kam mësuar shumë, bile më shumë se në studime. Pjesëmarrja në projekte të ndryshme, të financuara nga donatorë të ndryshëm, ka qenë një shkollë në vete, prej nga kam mësuar shumë, kam takuar shumë njerëz të profileve të ndryshme.

Çka e bënë të veçantë për mua, është angazhimi në Projektin DELTA, fillimisht si fasilitatore dhe pastaj edhe si menaxhere e projektit, projekt ky i cili për mua ka qenë shkolla më e mirë. I di me symbyllur fazat e hartimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal. I di komunat dhe fshatrat e atyre komunave të cilat kanë qenë përfutuese të projektit. Kam raporte të mira profesionale por edhe shoqërore me stafin e atyre komunave, disa prej të cilëve edhe pse nuk vazhdojnë të punojnë në ato vende pune.

Në përgjithësi, trajtimi i stafit dhe ambienti i punës e bëjnë "Riinvest"-in një ndër institucionet me kulturë të fortë organizative, që buron nga komunikimi i mirëfillt dhe puna ekipore e që realizohet dhe përkrahet pa dallim gjinie, pozite apo edhe niveli të shkollimit, bazuar në logjikën "Njeriu i duhur në vendin e duhur".

S'më mbetet gjë tjetër vetëm të them se jam shumë krenare që vazhdoj të jem pjesë e "Riinvest"-it, ndërsa me rastin e 20-vjetorit i dëshiroj punë të mbarë gjithë stafit dhe shumë suksese edhe për shumë vite të tjera!

ALBAN ZOGAJ

Hulumtues i Avancuar



Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë të jem pjesë e stafit që kremton 20-vjetorin e themelimit të Institutit "Riinvest", dhe të shpalos rrugëtimin tim, për 10 vjetët e kaluara, me "Riinvest"-in, familjen time të dytë. Kjo festë më risolli kujtimet e para, kur u pranova të bëhem pjesë e Institutit "Riinvest", dhjetë vjet më parë. Dhjetë vjet të mrekullueshme, me shumë ngjarje, me shumë suksese, por edhe me momente të vështira për të gjithë ne. Dhjetë vjet, nëpër të cilat u zhvillua "Riinvest"-i, por u zhvillova edhe unë bashkë me të.

Ishte mars 2005 kur fillova punën në Institutin "Riinvest", si hulumtues i ri, në ekip me profesorët e nderuar Muhamet Mustafa, Ekrem Beqiri, Isa Mustafa, Muhamet Sadiku e Ymer Havolli, të cilët më kishin përgatitur për punë (gjatë studimeve në Universitetin e Prishtinës), por edhe me kolegët e nderuar të gjeneratës së re. Të filloja punën në "Riinvest", menjëherë pas përfundimit të studimeve, dhe në një ekip të tillë, ishte jetësim i ëndrrës sime. Dhe, shpejt pas disa muajsh pune, vazhdova studimet e magjistraturës në Staffordshire University - Angli, dhe realizimin e pjesës tjetër të ëndrrës.

Pas pothuajse dy vjet studime në Staffordshire University, kthehem prapë në "Riinvest", edhe më i përgatitur për punë, për t'u angazhuar menjëherë në një projekt të rëndësishëm të "Riinvest"-it me Bankën Botërore, të cilin e udhëhiqte profesor Ekrem Beqiri, e që kishte të bënte me zhvillimin e projekteve energ-

jetike në Kosovë. Ishte përvojë e jashtëzakonshme të punoja në baza ditore me profesor Ekremin dhe me partnerët ndërkombëtarë në projekt.

Një prej momenteve kyçe për mua, në 10 vjetët me "Riinvest"-in, do të mbetet gjithmonë themelimi i Kolegjit Riinvest, në vitin 2007, dhe fillimi i punës si asistent ligjërues. Puna me studentë më jep kënaqësi të veçantë dhe është pjesë shumë e rëndësishme e karrierës sime.

Në vitin 2009, Bordi i Institutit "Riinvest" më emëroi drejtor për kërkime, detyrë të cilën e kam kryer me përkushtim të madh deri në vitin 2011, kur fillova studimet e doktoratës në Itali. Gjatë viteve 2012-2014 u emërova drejtor ekzekutiv i Kolegjit Riinvest.

Gjatë vitit 2014, intensifikova punën për të përfunduar studimet e doktoratës, që i mbrojta me sukses në shkurt 2015. Në këtë drejtim, dëshiroj të falënderoj shumë të gjithë kolegët në "Riinvest" për mirëkuptim dhe mbështetje. Pa mbështetjen e tyre, e sidomos të profesor Muhamet Mustafa, gjithçka do të ishte më e vështirë.

Aktualisht, jam ligjërues i lëndëve të Ekonomiksit në Kolegjin Riinvest, po udhëheq me studimet master dhe njëkohësisht jam pjesë e projekteve të shumta të Institutit.

Për fund, edhe një herë, dëshiroj të shfrytëzoj këtë rast të uroj familjen "Riinvest" për 20-vjetorin e "lindjes" dhe të theksoj bindjen time të thellë se "Riinvest"-in e presin edhe shumë suksese në të ardhmen.

ANTIGONA UKA

Asistent hulumtues



Sikur dua që në fillim ta veçoj rëndësinë e “Riinvest”-it si Institut i zhvillimeve socio-ekonomike në botën akademike (edukativo-arsimore); lirshëm theksoj se seminarët e përgatitura gjatë studimeve më njoftuan për së afërmi me Institutin “Riinvest”, i cili ishte pikë referimi në pothuajse secilin projekt studimi. Si i tillë, “Riinvest”-i çdo herë ka azhurnuar dhe shtuar vlerë kredibiliteti në diskutimet e sferës së ekonomisë në hapësirat universitare.

Pikënisja e formimit të njohurive të mia mbi teoritë e kërkimeve zhvillimore është Kolegji IBCM (International Business College Mitrovica), ku edhe përfundova dy vjetët e para të studimeve BA në fushën e menaxhmentit dhe marketingut. Më pas, Instituti “Riinvest” u bë pikësynimi im për punë praktike. Sipas strukturës hierarkike të këtij institucioni, praktika është hapi i parë drejt avancimit profesional. Praktika 4-mujore gjatë vitit 2013 në po këtë Institut ishte një përvojë shumë e vlefshme e punës. Ambienti shtytës, motivues dhe sfidues i punës më frymëzoi edhe më tepër. Si rezultat, në gusht të 2013-s u bëra bursiste e Universitetit West Liberty, në West Virginia të ShBA-së, ku edhe mbarova vitin e tretë dhe të fundit të studimeve BA. Gjatë qëndrimit tim në ShBA, gjithashtu isha e angazhuar me gjysmë orari në Departamentin e Zhvillimit Institucional të Universitetit West Liberty, dhe si asistente hulumtuese në ‘The Havana Consulting Group’.

Pas një praktike të frytshme në “Riinvest”, dhe gjithë

angazhimit në WLU dhe THCG, u ktheva prapë në Institut. Më konkretisht, që nga 1 shtatori i vitit paraprak jam e angazhuar si asistente hulumtuese (një pozitë më lartë në hierarki pas asaj të praktikës, siç edhe e do rendi) me angazhim të plotë në Institutin “Riinvest”. Kthimi im në një ambient tejet produktiv dhe influencues, në Institutin që përveç tjerash e admiroja për nga ndërtimi organizativ, ishte një hap tjetër drejt synimeve të mia profesionale. Shkëputja nga të qenit vetëm student, dhe lëvizja para drejt punës kërkimore ishte më se e mirëseardhur – sidoqoftë, akoma sfiduese.

Instituti “Riinvest” me gjithë namin e tij në fushën e zhvillimeve socio-ekonomike, patjetër se duhet gjithmonë e me tepër t’i përshtatet mjedisit dhe ritmit global. Prurjet e reja në shoqëri me gjithë kapitalin njerëzor dhe intelektual brendapërbrenda Institutit duhet të shihen si një dyçiftëzim ideal drejt përmbushjes së vizionit dhe përshtatshmërisë në çdo ndryshim eventual të mjedisit zhvillimor dhe hulumtues. Për më tepër, me të ditur që Instituti “Riinvest” ka qenë gjithmonë në krah të shkollarëve të rinj, pres që ky atribut të forcohet akoma më shumë dhe t’i jepet një rëndësi e duhur. Me sa e kam kuptuar, puna e një hulumtuesi do fillimisht vullnet dhe energji, duke mos lënë asnjëherë anash interaktivitetin dhe komunikimin ndërpersonal, e më pas ekspertizë dhe profesionalistët të pamatshëm për të arritur efektshëm qëllimet e synuara.

DIELLZA GASHI

Hulumtuese e avancuar



Gjatë studimeve kam dëgjuar dhe mësuar shumë për institutet hulumtuese 'think tanks' si dhe për rolin dhe ndikimin unik që institutet e tilla kanë në shoqëri. Që atëherë më kishte lindur dëshira që pas përfundimit të studimeve të punoj në një vend të tillë, në mënyrë që të kontribuoj sadopak, me njohuritë e përfituara, në zhvillimin e shoqërisë, pjesë e së cilës jam edhe vetë.

Me t'u kthyer në Kosovë, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dëshira u bë e mundur duke u punësuar në Institutin "Riinvest", ku edhe këtë vit shënoj katërvjetorin e punës. Këto katër vjetët e fundit në Institut më kanë mundësuar zhvillimin më të madh profesional deri më tani. Hapat e parë në Institut i kam filluar duke punuar si asistente hulumtuese, duke i asistuar hulumtuesit e avancuar dhe ata senior në punët e tyre të përditshme. Me kalimin e kohës, fillova të avancohem edhe unë dhe të marr përsipër përgjegjësi më të mëdha. Më është ofruar mundësia të merrem me aktivitete të ndryshme dhe kam mësuar shumë për të gjitha hapat e nevojitur në draftimin e projekt propozimeve, shkrimin e raporteve hulumtuese, si dhe menaxhimin e projekteve. Kjo periudhë më ka ndihmuar të zhvillohem edhe si person dhe të mësoj se si të menaxhoj situata të ndryshme të cilat mund të lindin gjatë punës në grup.

Një përvojë të veçantë, përgjatë rrugëtimit tim në "Riinvest", të cilën dua ta ndaj është prezantimi i punës sime për herë të parë në emision televiziv. Kisha kohë që i evitoja rekomandimet e menaxhmentit që si staf

të jemi sa më shumë prezentë në media, në mënyrë që ta prezantojmë punën të cilën si hulumtues e bëjmë në Institut. Në fillim të vitit 2013, me publikimin e raportit "Tërheqja e investimeve nga diaspora" dhe prezantimin në konferencë të organizuar së bashku me kolegë, erdhi ftesa nga mediumet vendore për të marrë pjesë në emisione. Edhe pse përsëri u mundova ta evitoj, këtë herë nuk munda, sepse drejtori insistoi që unë të marr pjesë dhe të ndaj punën tonë me publikun e gjerë. Mirëpo, përveç insistimit, drejtori më ndihmoi shumë edhe me këshilla se si të prezantohem duke e ndarë përvojën e tij të parë. Të nesërmen u prezantova në emisionin televiziv, në të cilin qytetarët mund të lidheshin përmes lidhjes telefonike për të bërë pyetje drejtpërdrejt. Emocioni ishte tepër i madh, tema ishte mjaft e ndjeshme dhe frikohesha se nuk do të mund t'u përgjigjem pyetjeve të bëra. Për fat të mirë timin, e tërë intervista kaloi në rregull. Ishte ajo intervistë dhe këshillat e dhëna nga drejtori të cilat më ndihmuan të tejkaloj frikën e prezantimit në media.

Duke menduar për 20-vjetorin e Institutit dhe të ardhmen, na bënë të kujtojmë se puna për gjatë këtyre viteve ka qenë e mbushur me plot sfida, dhe se sfida të ndryshme do të vazhdojnë të na përcjellin edhe në të ardhmen. Mirëpo, si rezultat i përvojës që e kemi fituar ndër vite, do të jemi në gjendje që më lehtë t'i përballojmë situatat me të cilat mund të ballafaqohemi. Dua ta përmbyll këtë shkrim me urimin për shumë përvjetorë të tjerë me plot suksese!

EDONA KURTOLLI

Hulumtuese e avancuar



Instituti "Riinvest" është pjesë shumë e rëndësishme e formësimit tim profesional. Pas një periudhe rreth tetëvjeçare, pas mbarimit të masterit, dhe pas përvojës së punës profesionale në vende perëndimore, u punësova në Prishtinë në Institutin "Riinvest". Në moshën 23 vjeçare kam filluar punën në pozitën e menaxheres së marketingut, por shumë shpejt u involvova në fushën e kërkimit; e cila siç dihet, është pjesë e pandashme dhe pjesë kryesore e Institutit. Duke kaluar nëpër projekte të ndryshme, dhe duke u ballafaquar me kërkesa të llojllojshme si të donatorëve, ashtu edhe të klientëve privatë, nga "Riinvest"-i mësova tri gjëra: 1) se kualiteti flet vetë, 2) se suksesi i një projekti varet nga harmonia ekipore, dhe 3) se rrjetëzimi është çelësi kryesor i suksesit.

Kualiteti i bën vetë promocion vetvetes, andaj edhe ishte shumë e lehtë që në menaxhimin e marketingut të "Riinvest"-it, suksesi të vijë pa kurrfarë pengese. Në çdo gazetë, raport televiziv, raport profesional, publikim, libër, temë diplome, kudo, kuotohej "Riinvest"-i, përmendej "Riinvest"-i, ishin numrat dhe hulumtimet e "Riinvest"-it ato që vendoseshin të parat në rend. Nëse e pyet këdo për "Riinvest"-in, përgjigjet do të jenë të ngjashme- se "Riinvest"-i është burim diturie, se "Riinvest"-i është ndër të parët në fushën e kërkimeve profesionale, dhe se "Riinvest"-i është padyshim lider i besueshëm në çdo aspekt profesional. Këto vlera janë ato të cilat unë si individ u mundova t'i adaptoj nga Instituti "Riinvest", lidershpi, profesionalizmi dhe besueshmëria.

Por kush është Instituti "Riinvest"? Instituti "Riinvest" janë njerëzit, janë hulumtuesit, administrata, menaxherët, drejtorët, themeluesit. Instituti "Riinvest" janë njerëzit që punojnë me përkushtim dhe mundohen që në secilin hap të jetës profesionale të tregojnë sukses, duke bërë gjithmonë punë të kualitetit më të lartë. Gatishmëria e secilit prej hulumtuesve të lartë për të të ndihmuar dhe për të të udhëzuar, ka qenë inspirimi im kryesor për të punuar me sa më shumë mund dhe zell në çdo projekt. Fjalët e tyre motivuese dhe shembulli i punës që na e tregonin vetë ata, ishte mënyra më e mirë për të mësuar.

Lidhjet e krijuara me institucione të ndryshme shtetërore, ndërkombëtare dhe private, janë një mundësi shumë e mirë për rrjetëzim, dhe sa do që ndërrohen vendet e punës, për një kohë mjaft të gjatë, mos të them për vite e vite të tëra, njerëzit do të të identifikojnë me "Riinvest"-in. E për mua kjo është kënaqësia më e madhe.

Nuk ka shkollë në botë që e zëvendëson eksperiencën e marrë nga Instituti "Riinvest", dhe besoj se nuk ka organizatë nga e cila mund ta merrja burimin e thellë të diturisë dhe informacioneve, përveç se nga "Riinvest"-i, i cili tashmë është bërë dhe do të vazhdojë të jetë shtëpia ime e dytë.

ERANDA BASHOLLI

Asistente financiare



Punën time në Institutin "Riinvest" e kam filluar para 15 vjetëve. Që nga atëherë, Instituti "Riinvest" gëzon një reputacion që bazohet në kualitetin e punës dhe përkushtimin e vet në aplikimin e shkathtësive akademike karshi sfidave të realitetit në të cilin jetojmë.

"Riinvest"-i gjithë këto vite të funksionimit të tij ka mundësuar zhvillimin reciprok të stafit punues dhe të vetë Institutit, ka ofruar gjithmonë satisfaksion për punë dhe ka ofruar komoditet, ku secili prej nesh aty ka gjetur motivimin për punë. Instituti njëkohësisht ka arritur që të shkojë krah për krah me ndryshimet dhe të trajtojë stafin në përputhje me ato ndryshime, në vazhdimësi të mundësohet mësimi i gjërave të reja dhe stafi në vazhdimësi tregohet bashkëpunues.

Ka siguruar bazën për arritjen e suksesit dhe avancimit në karrierë, ka ofruar mundësi të mëdha për stafin dhe ka nxjerrë kuadro të njohura për shoqërinë kosovare. Është vendi ideal që të mundëson të ofrosh njohuritë, mundësitë dhe kualitetet tua, i përsos në vazhdimësi shkathtësitë tua profesionale dhe në të njëjtën kohë të mundëson të fitosh dituri të vazhdueshme profesionale.

Instituti "Riinvest" gjithmonë ia ka mundësuar stafit të aplikojë diturinë e tij në mënyrë efektive dhe secili e ka ndier veten të respektuar dhe të dinjitetshëm.

Punën time në Institutin "Riinvest" e ka lehtësuar

në veçanti mbështetja nga menaxhmenti dhe nga kolegët në punë, ku me gjithë barrën e të qenit nënë e katër fëmijëve, përkrahja e kolegëve dhe motivimi është inspirim për punën dhe suksesin tim.

Nëse Instituti "Riinvest" ka besuar se njohuritë mbi aktivitetet kërkimore mund t'i shtyjnë përpara ndryshimet që duhet të ndodhin në një shoqëri me qëllim që ky vizion të arrihet, atëherë Instituti "Riinvest" këtë qëllim dhe e ka arritur.

FATON SELANI

Drejt看 Kreativ



Duke lënë anash modestinë, Instituti “Riinvest” gjithmonë ka qenë pikë referimi për çdo të dhënë ekonomike.

Isha pjesë e mediave gati 15 vjet dhe aty për herë të parë kam dëgjuar për Institutin “Riinvest” nga kolegë gazetarë, te cilët kohë pas kohe për ndonjë paqartësi në lidhje me zhvillimet ekonomike - drejtoheshin te, siç i quanin ata, “ekspertët e Institutit ‘Riinvest’” - këtu edhe lindi ajo simpatia ime për Institutin “Riinvest” dhe normalisht nga dëshira ime pas “Information Design” që gjithë ato grafikone e informata të hulumtimeve socio-ekonomike të Institutit “Riinvest” përgjatë 20 vjetëve të jenë të qasshme, të qarta dhe të kuptueshme për këdo, qofshin ata ekonomistë, gazetarë apo edhe studentë.

Ndoshta si fillim kjo ishte dëshira dhe arsyeja e vetme që i jam bashkuar ekipit të Institutit “Riinvest”. Por, qëllimi dhe dëshira ime është që për një kohë sa më të shkurtër Instituti “Riinvest” të ketë një imazh krejt ndryshe siç edhe e meriton. Tani po bëhen disa muaj që jam i angazhuar si drejtor kreativ në Institut dhe veç se kemi filluar me fuqizimin e Zyrës për marrëdhënie me publikun dhe besoj se që tani kemi një imazh të ri - normalisht kemi shumë punë për të bërë.

Ehhh...kolegët - gati të gjithë jemi të moshës së njëjtë dhe normalisht bisedat zgjatin pa fund “veç puna na thërret”. Ndoshta kjo është vetëm një fja-

li - por shpjegon për marrëdhëniet kolegjiale duke mos harruar që të gjithë janë shumë profesionalë.

Me plot energji e kolegë të shkëlqyeshëm ky është “Riinvest”-i të cilin e kam gjetur dhe besoj se kështu do të vazhdojë në të ardhmen.

FISNIK BAJRAMI

Hulumtues i Avancuar



Shpesh mendoj se çfarë i bën kompanitë dhe organizatat shumëvjeçare të jenë liderë në tregje të ndryshme. Natyrisht që përvoja e tyre ka shumë rëndësi. Por, a nuk do të duhej që mënyrat e vjetra të bien në hijen e atyre të reja? A nuk do të duhej që kompanitë dhe organizatat e vjetra të zëvendësohen nga kompani dhe organizata të reja? A nuk vlen cikli jetësorë i lindjes, rritjes, plakjes dhe vdekjes edhe këtu?

A nuk do të duhej që inovacioni të triumfojë? Unë besoj që po! Inovacioni, qoftë në kuptimin e drejtpërdrejtë, apo në kuptimin e promovimit të ideve dhe frymëve të reja, gjithmonë triumfon! Në fakt, këtu është edhe çelësi se si kompanitë dhe organizatat e suksesshme shumëvjeçare arrijnë të jenë gjithmonë liderë. Një shembull të tillë unë e shoh tek Instituti "Riinvest", i cili ka arritur të triumfojë për dekada, duke ofruar ekselencë në punë me ide dhe mënyra gjithmonë të reja. Më lejoni t'ua ilustroj.

Në Institutin "Riinvest" u punësua në moshë të re. Edhe pse i pajisur me njohuri të çmuar dhe edukim të vlerësuar, unë isha pa përvojë profesionale. Nga dita e parë e punës e deri më sot, vazhdoj të kem zell dhe ambicie për punë. Gjithmonë i gatshëm t'i luftoj idetë e vjetra, me këmbëngulësi i qëndroj pranë asaj që unë e konsideroj të drejtë. Këto virtyte, fatkeqësisht janë të pamjaftueshme për tregun aktual në Kosovë, por të domosdoshme për Institutin "Riinvest", ku gjeta hapësirë për të kontribuar si me punë ashtu edhe me ide. Në njërin anë, unë aty takova disa nga ekspertët më të njo-

hur të fushave të ndryshme në Kosovë, ndërsa në anën tjetër takova një frymë të re të rinjve – që karakterizohen me plot energji, punë, zell, ambicie, ide dhe njohuri. E më e mira shfaqej në bashkëpunimin e këtyre dy grupeve, që gjithmonë rezultonte në ekselencë. Sa rrallë rastis në Kosovë që të çmohet, të lavdërohet, ta mbështetet dhe të përqafohen puna dhe idetë e të rinjve. Por, të gjitha këto ishin të përditshme në Institutin "Riinvest". Puna dhe idetë e mia gjithmonë gjenin mbështetje. Pikërisht kjo frymë më ka bërë që motivi im për punë dhe arritje profesionale të jetë gjithnjë e më i madh.

Përbrenda "Riinvest"-it, ne kishim mision që t'i përkrahim kolegët dhe të mësojmë më shumë nga ta. Harmonia e shkëlqyer ekipore, diversiteti i ideve dhe diskutimet produktive na ndihmonin çdonjërit për zhvillim profesional. Për mua, ambiciet e fituara nga edukimi nuk u shuan tek unë, ashtu siç ndodh në shumicën e rasteve në Kosovë, por u forcuan në "Riinvest". Në "Riinvest" gjithnjë angazhoheshim për aktualen. Ne hulumtonim për trendët e biznesit, barrierat ekonomike, opinionet e qytetarëve apo politikat lehtësuese. Synimi ishte gjithnjë i njëjtë. Si në rastin e planeve të biznesit, ku konceptin e zhvillonim me metodat e fundit të biznesit, si në rastin e kërkimeve për ekonominë dhe ndërmarrjet, ku avokonim për ligjet dhe mbështetjen që të arrihen nivelet e ekonomive perëndimore, dhe si në rastin e projekteve zhvillimore, ku ofronim përkrahje për të rritur konkurrueshmërinë në nivele rajonale apo edhe evropiane. Ky është misioni ynë i jashtëm, t'i prijmë zhvillimit të ekonomisë sonë.

FISNIK REÇICA

Hulumtues i Avancuar



Përvoja ime e parë me Institutin "Riinvest" daton në fund të vitit 2009, kur "Riinvest"-i më angazhoi që të mbështes përpilimin e Strategjisë të industrisë së Kosovës. Në atë kohë isha duke punuar në Bankën ProCredit. Edhe pse ishte një përvojë e shkurtër, serioziteti i punës, mbështetja e ekipit si dhe mundësitë e shumta për zhvillim profesional dhe akademik, më bënë që në mars të vitit 2010 të lë karrierën e një bankieri dhe të bëhem pjesë e Institutit, në vitin kur "Riinvest"-i festoi 15-vjetorin e themelimit.

Kur iu bashkova "Riinvest"-it, atë e shihja lider në fushën e hulumtimit shkencor, në përkrahjen e sektorit privat si dhe në avokimin e politikave publike të nevojshme për krijimin e një ambienti të përshtatshëm biznesor për investitorë vendorë dhe të huaj. Puna ekipore dhe përkrahja e menaxhmentit ishin faktorë kryesorë në arritjen e sukseseve të vazhdueshme. Këtë e vërtetova gjatë angazhimeve të shumta në projekte të natyrave të ndryshme, si në hulumtim të tregut, ngritje të kapaciteteve dhe ofrim të shërbimeve biznesore për ndërmarrje private, si dhe në hulumtim dhe avokim të politikave qeverisëse që adresojnë nevojat e sektorit privat. Së fundi, këtë po e dëshmoj në projektin "Promovimi i punësimit në sektorin privat", ku "Riinvest"-i është pjesë e një konsorciumi ndërkombëtar i udhëhequr nga organizata zvicerane Swiss Contact, duke synuar zhvillim të tregut dhe gjenerim të punësimit, aq të nevojshëm për vendin tonë.

Në këto 5 vjet të përvojës në "Riinvest" përfitova nga njohuritë e kolegëve dhe partnerëve të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me të cilët bashkëpunuam në projekte të ndryshme. Për më tepër, falë qasjes së Institutit për të mbështetur ngritjen e kapaciteteve të brendshme, pata mundësi që njëkohësisht të jem pjesë e Institutit dhe të ndjek studimet e doktoratës në Britani të Madhe. Qasja proaktive dhe inovative e udhëheqësve të "Riinvest"-it mundësoi që programet e Universitetit Staffordshire të Britanisë së Madhe të ofrohen nga Kolegji Riinvest në Kosovë, ku kam nderin të jem pjesë e stafit ligjërues.

Sot, në 20-vjetorin e themelimit të "Riinvest"-it, vlerësoj se kualiteti dhe përkushtimi serioz i stafit, sigurimi i pakompromis i kualitetit, bashkëpunimi i ngushtë me partnerë vendorë, rajonalë e ndërkombëtarë, risitë që sjell dhe profesionalizmi që promovon, e bëjnë "Riinvest"-in akter shumë të rëndësishëm në trasimin e zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë. "Riinvest"-i sot është pjesë e konsorciumeve ndërkombëtare duke implementuar projekte multimilionëshe, që qëllim final kanë përmirësimin e ambientit të përgjithshëm biznesor, rritjen e konkurrueshmërisë të ndërmarrjeve të sektorit privat dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Me këtë trend të zhvillimit, në 25-vjetorin e themelimit, "Riinvest"-in e shoh në implementim të projekteve të ngjashme në rajon dhe më gjerë, duke eksportuar përvojën dhe njohuritë e krijuara ndër vite.

GENT BEQIRI

Hulumtues i Avancuar



Pak ditë pas humbjes së babait tim, në çastet më të vështira të jetës sime, fillova punën në këtë Institut ndër më të dëgjuarit në vend. E kujtoj edhe sot ndjenjën e fuqishme të përgjegjësisë madje edhe hezitimin që më impononte dilema se a do t'ia dal t'i justifikoja pritjet që natyrshëm lidheshin me punën e babait tim si bashkëpunëtor shumëvjeçar në Institutin "Riinvest".

Më shpejt se që prisja u ambientova me kolektivin, i cili padyshim është jashtë standardeve e stereotipave. Një kolektiv që funksiononte si një familje e madhe me raportet njerëzore, mirëkuptim, kolegjalitet e bashkëpunim, që të bën të ndjehesh mirë, i motivuar e përkushtuar në punë.

Padyshim është nder e privilegj të jesh pjesë e Institutit "Riinvest", këtij institucioni që është jo vetëm njëri nga më të njohurit, më prestigjiozët, më të respektuarit, më kredibilët e me reputacion të fuqishëm në vend, një institucion që tubon ajkën e inteligjencies kosovare dhe profesionistët më të shquar të ekonomisë, kësaj fushe aq të rëndësishme për zhvillimin e vendit.

Dhe është e pritshme që në një ambient të tillë profesional e intelektual ku bashkëpunimi, komunikimi, përballja e mendimeve dhe ideve janë në nivelin e duhur, të ketë ngritje, avancim dhe formësim të kuadrove të reja.

Ndjehem i privilegjuar që për këto pak vite kam arritur, veç tjerash, një aftësim solid në ekspertizën për menaxhimin e anketës, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave, e përpilimin e raporteve hulumtuese si dhe

ndërtimin e një përvoje të rëndësishme pedagogjike.

Dhe në fund, dua t'i bëj një falënderim të veçantë e t'i shpreh mirënjohje të thellë profesorit të nderuar e shumë të respektuar, z. Muhamet Mustafa, për mbështetjen e vazhdueshme, të sinqertë e të pakursyer për mua.

ILIRE MEHMETI

Hulumtuese e avancuar



Instituti "Riinvest" si vend i punës është bërë pjesë integrale e jetës sime. Si në aspektin e afërsisë kolegjiale, ngritjes profesionale dhe krijimit të kontakteve. Kam përvoja shumë të rëndësishme dhe të paharrueshme në po këtë vend të cilat do të mbesin gjatë në kujtesën time. Ngjarja më e paharrueshme gjatë viteve të mia në Institut vlerësoj të ketë qenë takimi im me gratë e rrjetit të Handikosit në Pejë. Në kuadër të projektit (dyvjeçar) "Fuqizimi i kapaciteteve të zhvillimit ekonomik rajonal të Kosovës", të mbështetur nga Zyra e BE-së në Kosovë, është synuar fuqizimi i akterëve rajonalë për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në zhvillimin ekonomik rajonal dhe të përgjithshëm të Kosovës. Në veçanti, pjesëmarrës nga e gjithë Kosova janë trajnuar për të aplikuar, menaxhuar dhe implementuar projekte zhvillimore të financuara nga donatorë të ndryshëm, me theks të veçantë projekte të financuara nga Zyra e BE-së, në një trup të emëruar Akademia zhvillimore. Puna më e vlefshme e gjithë projektit padyshim ka rezultuar të jetë shkrimi dhe dorëzimi i projekt propozimeve reale nga pjesëmarrësit, prej të cilave prisnin të nxirrnin financim nga ne në formë grantesh.

Nga 10 projektet e financuara, të cilat ishin prej më të ndryshmeve dhe me të vërtetë të nevojshme për komunitetin e tyre dhe gjithë vendin, projekti i Handikosit ishte më domethënës për mua. Dega e Handikosit në Pejë kishte propozuar mbështetjen e grave me nevoja të veçanta nga rajoni i Dukagjinit duke iu shpërndarë makina të qepjes për punë dore, qëndisje dhe gavrime për të rritur mirëqenien e familjeve të tyre. Me këtë synonim ofrimin e mundësive për

të punuar dhe shfrytëzuar kapacitetet dhe aftësitë e këtyre grave me nevoja të veçanta si dhe ngritjen e mundësive për gjenerim të të ardhurave përmes punëdores. Kjo përkrahje jo vetëm që mbështet zhvillimin dhe avancimin e rolit të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, përmes angazhimit të tyre në tregun e punës dhe avancimin e aspektit profesional të tyre (në fushën e punëdores dhe rrobaqepësisë), por më e rëndësishmja siguron aktivitetet afatgjatë, të cilat do të ndikojnë thellë në jetën dhe dinjitetin e këtyre njerëzve.

Pas trajnimit njëmuajor mbi përdorimin e makinave të reja dhe dhurimit të dhjetë makinave qepëse për dhjetë gratë pjesëmarrëse ishte organizuar një pritje për ne, ekipin e projektit, pikërisht nga këto gra, për të na njoftuar me punën e bërë dhe për të na falënderuar për mbështetjen. Prej momentit të njoftimit me këto gra isha shumë e impresionuar me vullnetin dhe ngazëllimin e tyre në punën e re. Ngazëllimi i cili shprehej me dëshirën e tyre për të më vënë në dijeni me tërë procesin e punës. Ngrohtësia e tyre vihej në pah duke mu drejtuar me emër, megjithëse më takonin për herë të parë, gjë e cila më la shumë përshtypje. Këto gra aq bujare në fund madje më dhuruan edhe një punëdore të qëndisur me mjeshtërinë e tyre mbresëlënëse. Projekte dhe kontribute si këto, që më janë mundësuar në Institutin "Riinvest", më bëjnë të çmoj këtë vend pune dhe më japin motiv për punë të mëtutjeshme dhe tejkalim të çfarëdo vështirësie. Shpresoj që ky vullnet do të më përcjell edhe në të ardhmen dhe do të më mundësoj të jap kontributin tim edhe në shumë projekte të këtij lloji.

ISREN FEJZULLAHU

Menaxher financiar



Të qenit pjesë e një Instituti të tillë, të respektuar, me kredibilitet të jashtëzakonshëm dhe padyshim një stafi të licencuar, më bën të ndihem krenar dhe njëkohësisht me fat.

Sigurisht serioziteti i punës dhe potenciali që mban, më shtyu të jem pjesë e tij. Por nuk mund ta besoj që, qe 11 vjet jam këtu i rrethuar me një harmoni dhe familjaritet mes kolegëve. Padyshim nuk mund të anashkalohet përvoja ime edhe ekspertiza e fituar gjatë këtyre viteve. Që në ditët e para të punës sime, e vërejta se me çfarë përpikërie, kujdesi dhe aftësie ishte i pasuruar Instituti. Pikërisht këto gjëra dhe respekti që mbajmë për njëri-tjetrin është arsye por edhe një ambicie edhe më shumë për ne që të ecim përpara, të punojmë dhe të vazhdojmë të jemi pjesë e "Riinvest"-it.

Gjatë këtyre viteve vlen të përmendet fakti që kemi pasur një avancim të jashtëzakonshëm, padyshim po flas në termin profesional dhe konkretisht për profesionin tim. Aq shumë gjëra kam fituar gjatë kësaj përvoje shumëvjeçare, sa që nuk kam as fjalë t'i përshkruaj. Të arriturat gjatë gjithë kësaj kohe mundem lirisht të them që janë të panumërueshme. Këtë gjë e tregon edhe vetë "historia". Pse po them histori, është se me plot 20 vjet punë të pandalshme dhe me një zhvillim të vazhdueshëm jemi bërë lider të qëndruesës dhe punës efikase. Kjo është ajo që na bëri histori por nuk do të thotë që mbaruam me kaq, përkundrazi shumë gjëra na presin përpara. Vullneti i pandalshëm yni, i shoqëruar me përkushtim na karakterizon edhe më shumë si Insti-

tut madje, madje edhe si familje. Krijimtaria kolektive është produkt yni, ku është njëra ndër të arriturat më të larta që edhe bënë personifikimin e punës sonë. Simbol i tërë këtij Instituti, është padyshim suksesi i arrirë, edhe pse të përballur me shumë sfida. Por konkretisht sprovat ishin ato që na fuqizuan dhe na profesionalizuan edhe më shumë. Nuk mund të them që është vend utopik, pasi do t'ju dukej e pabesuar, por shumë me vetëbesim mund të them që është një vend ideal për një punëtor, që dëshiron të punojë, të emancipohet dhe të jetë pjesë e familjes tonë.

Zhvillimi, inkuadrimi dhe avancimi i mëtutjeshëm i kuadrove të reja, që është e ndërlidhur sigurisht dhe me komunikimin dhe bashkëpunimin e fuqive intelektuale, ishte dhe shpresoj që të mbetet qëllimi i Institutit. Humilumtimet e vazhdueshme dhe projektet e paresitura na bëjnë edhe më të dedikuar gjatë punës sonë. Shpresoj që të vazhdojmë të mbesim në këtë hiperaktivitet të pasur me veprimtari të shumta dhe gjithmonë euforikë për punën tonë.

MENSUR MUSTAFA

Logjistikë



Në vitin 1995 fillova punën në Institutin “Riinvest”, e që deri atëherë punoja në kompaninë private Rima. Isha pra njëri nga punëtorët e parë pas themeluesve. Të jesh pjesë e këtij Instituti të krijon ndjenjën e besimit, duke pas parasysh komunikimin e ndërsjellë menaxhment dhe punëtor. Ofrimi i fleksibilitetit në punë dhe besimit të ndërsjellë rrallë mund të gjendet në institucione dhe si rezultat i kësaj ky institucion ka krijuar emrin e tij, duke bërë punë profesionale dhe duke krijuar një kulturë të brendshme të komunikimit dhe organizimit.

Në cilësinë e zyrtarit të logjistikës angazhohem në aktivitetet e ndryshme, duke përfshirë pagesat, furnizimet e zyrës, kujdesi për çështje brenda objektit, asistimi në terren për aktivitete logjistike. Përfshirja ime duke pasur angazhim gati me gjithë punëtorët, ka krijuar ndjenjën e besimit me kolegët për punën e përbashkët dhe institucionit në realizimin e punëve me kohë dhe cilësi.

Është krenari të qenit pjesë e këtij suksesi 20-vjeçar. Çdo herë mësohemi më gjëra të reja, kemi mirëkuptim të ndërsjellë dhe shumë rrallë punë nën presion. Agjenda ditore është e përgatitur paraprakisht, prandaj shumë rrallë ndodh të jemi në presion të kohës për realizimin e aktiviteteve tona.

Krijimi i komunikimit mes nesh dhe në takimet e ndryshme edhe me familjet tona, e ka bërë që ta ndiejmë këtë vend pune si shtëpinë e dytë.

Të jesh i punësuar në një Institut si “Riinvest”-i, është

privilegj për gjithë familjen, sepse me vete bart suksesin e gjithë institucionit dhe padyshim se ajo kulturë e punës të reflektohet kudo.

Ndjehem jashtëzakonisht i lumtur me gjitha arritjet e këtij institucioni dhe uroj të vazhdojmë më tutje për shumë vite.

MERITA ZHUSHI PEJA

Receptioniste



Viti 1998 ishte një vit i vështirë, pasi që me bashkëshortin dhe djalën vendosëm ta lëshojmë vendim e të emigronim në Amerikë. Amerika është një vend që t'i ofron të gjitha mundësitë, edhe pse kalova atje pothuajse 7 vjet, mendja më rrinte këtu, të kthehesha në vendim tim. Pasi u kthyem në vitin 2005 në Kosovë, nuk kishte mundësi të mëdha për punësim dhe ishte mjaft vështirë t'i shfrytëzoje edhe ato mundësi të pakta që ofroheshin. Kaluan disa vite pa ndonjë angazhim profesional dhe shpesh me bashkëshortin konsideronim mundësinë që të ktheheshim prapa në Amerikë.

Në nëntor të vitit 2007, aplikova në "Riinvest" në pozitën e receptionistes dhe ishte fat i madh që u pranua për dy arsye: një duke pasur parasysh se "Riinvest"-i ishte një brend mjaft i njohur për profesionalizëm, ku ishin të angazhuar emrat më të njohur të ekonomistëve dhe ishte kënaqësi të ishe në një mes të tillë, si dhe arsyeja e dytë ishte mundësia të mos e lëshoja vendin prapë. Të qenit pjesë e Instituti "Riinvest" është një privilegj i madh, të punosh me një staf aq të avancuar dhe të respektuar me të vërtetë të bën të ndihesh shumë mirë.

Tash e 7 vjet në këtë mes jo çdoherë ishte mirë, kishte momente jo të lehta në punë, ndonjëherë mungesë e njohurisë për të realizuar një punë, apo realizim i punëve në kohë për shkak të intensitetit të madh, por me përkushtim të madh dhe me ndihmën e kolegëve dhe mbështetjen e tyre gjithçka finalizohej mirë. "Ri-

invest"-i është shkolla e dytë për mua. Këtu arrita të mësoj shumë gjëra dhe vazhdoj edhe më tutje të mësoj dhe kjo më bën shumë krenare.

Instituti "Riinvest" është një Institut që t'i ofron të gjitha mundësitë e avancimit, po deshe t'i shfrytëzosh, dhe kjo vetëm falë punës profesionale. Mendoj shpesh se në Kosovë do të ishte mirë të kishte më shumë kësi lloj institutesh që të ofrojnë kushte punësimi, siç të ofron "Riinvest"-i.

Mund të them se "Riinvest"-i është burim diturie dhe lider i besueshëm. Uroj të vazhdojmë me këtë vullnet të punës dhe me këtë staf të mrekullueshëm edhe shumë vite bashkërisht.

PREMTON HYSENI

Hulumtues i Avancuar



Riinvest"-i, si Instituti i parë në Kosovë për hulumtime, ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimin e shkencës sociale në Kosovë. "Riinvest"-i kështu është shndërruar në pikë referuese për studiuesit për të dhëna rreth ekonomisë së Kosovës, duke qenë institucioni i parë privat që ka ofruar të dhëna të tilla të paanshme.

Pas 20 vjet aktiviteti dhe angazhimi, Instituti ka ndryshuar duke reflektuar nevojat e tregut dhe objektivin e "Riinvest"-it që të evitojë varësinë nga fondet publike për të arritur të ushtrojë aktivitetin si "think tank" udhëheqës në Kosovë. Rrjedhimisht sot "Riinvest"-i ka klientë/donatorë seriozë, të cilët prioritet në optimizimin me fondet e tyre kanë kualitetin. Puna e "Riinvest"-it përdoret për përmirësimin e politikave publike dhe biznesbërje të informuar.

Kjo e ka bërë "Riinvest"-in atraktiv për punonjësit e rinj të karrierës. Të qenit pjesë e "Riinvest"-it vjen me një ulëse në rend të parë për shumë zhvillime me rëndësi. "Riinvest"-i është pikë grumbullimi i informacionit duke qenë Instituti me infrastrukturën më të zhvilluar të hulumtimeve në terren si dhe forum i diskutimeve për ngjarjet aktuale.

Puna në "Riinvest" përcillet me atë çfarë edhe pritët nga një vrojtues i jashtëm. Krahas angazhimeve të shumta ka edhe privilegje që e përcjellin punën hulumtuese si hapësira për të ndenjur i përditësuar me literaturën e studimeve në të cilat "Riinvest"-i është i angazhuar; rrjetëzimi me kolegë të interesave të njëjta

studimore dhe akademike; sfida e punës me rezultat jo saktësisht të matshëm; dhe të qenit pjesë e një industrie që nuk të limiton në zgjedhjet e ardhshme.

Kolegji Riinvest i shton vlerë Institutit duke e bërë më atraktiv për tërheqjen e stafit të kualifikuar që synon ta praktikojë në tërësi përvojën akademike duke bërë hulumtim dhe duke e transmetuar atë te studiuesit e rinj.

Prezenca e "Riinvest"-it në rrjete, forume, jetën akademike dhe politike, e kanë bërë etiketën e "Riinvest"-it lehtë të identifikueshme edhe jashtë Kosovës. Puna e "Riinvest"-it qysh para luftës me donatorë prominentë (si CIPE) i ka krijuar këtij Instituti një eksperiencë të pabarazueshme nga organizatat e tjera në Kosovë. Instituti me portfolion akademike të stafit të tij ka pasaportë për aplikim dhe implementimin të projekteve me peshë.

Instituti "Riinvest" në strategjinë e vet 5-vjeçare parasheh që të mbajë pozitën e udhëheqësit për hulumtime dhe aktivitete të "think-tank" në Kosovë. "Riinvest"-i do ta arrijë këtë duke vazhduar të prodhojë hulumtim dhe opinion kualitativ. "Riinvest"-i do të fokusohet që t'i mbajë, t'i zgjerojë dhe t'i shtrëngojë lidhjet me bizneset si shtytës kryesorë të misionit të "Riinvest"-it që është zhvillimi ekonomik i Kosovës duke u bazuar në filozofinë e ndërmarrësisë.

SAXHIDE MUSTAFA

Zëvendëse e drejtorit ekzekutiv



Lidhja ime profesionale me "Riinvest"-in ka filluar para 12 vjetëve. Në vitet e pasluftës kur zhvillimi i vendit ishte i ngadalshëm, brenda "Riinvest"-it bëhej një punë e madhe. Hulumtimet dhe analizat ekonomike zhvilloheshin me një ritëm të shpejtë ku angazhoheshin një numër i madh ekspertësh vendorë e ndërkombëtarë, në mënyrë që Qeverisë dhe faktorit ndërkombëtar t'i ofroheshin informata sa më të sakta për situatën ekonomike, mjedisin biznesor e zhvillimin e sektorit privat. "Riinvest"-i konsiderohej si dera e dytë e vizitave pas Qeverisë nga delegacione të ndryshme që vizitonin Kosovën. Kjo bëhej falë kapërcimit të kufijve të punës së "Riinvest"-it, analizave dhe projekteve dhe zgjidhjeve që ofronte. Kultura e brendshme organizative, liria e shprehjes së mendimit, ngritja profesionale, bashkëpunimi me ekspertë të ndryshëm, janë vlerat e këtij institucioni që e bëjnë të qëndrojnë me kredibilitet dhe të hyjë në dekadën e tretë. Bashkëpunimi i stafit, ndarja e njohurive dhe shkathtësive dhe komunikimi jo vetëm tetë orë pune, vazhdon edhe sot si traditë nga gjenerata e parë. Ky socializim të krijon lidhje edhe më të fuqishme shpirtërore me këtë institucion jo vetëm me ne si staf, por edhe familjet tona.

Unë në "Riinvest" u kyça në cilësinë e juristes, por që avancimi dhe zhvillimi im profesional më tutje lidhet me ekonomi. Nuk ishte thjesht një inat të arrija në nivelin e kolegëve të mi, por ishte një motiv, shtytje për përparim dhe përfitim profesional.

Sfidat, po ashtu, janë pjesë e punës të cilat në këtë ambient pune janë të përbashkëta dhe lehtë të kapërcyeshme. Forcimi, avancimi i stafit bëhej dhe bëhet me dedikim dhe është për t'u çmuar dhe mund ta themi si vlerë shtuese dhe diferencim nga të tjerët. Rekrutimi i të rinjve me shumë transparencë dhe meritë vazhdon të jetë prioritet, rekrutimi i të rinjve me potencial dhe zhvillimi i tyre më tutje. Në cilësinë e menaxheres së çështjeve administrative dhe juridike e Institutit "Riinvest", me ju po ndaj një opinion të një aplikanti në vitin 2005, i cili pasi iu nënshtrua një testi për punësim për pozitën e hulumtuesit më tha, citoj: "Sikur edhe ministra të zgjidheshim nuk do të testoheshim më shumë, çka është gjithë ky testim". Atij i dukej shumë, por ne na bënte më të lehtë zgjedhjen e më të mirit. Shpesh më kujtohen fjalët e tij e kjo më bën shumë krenare për organizimin e një procesi të rekrutimi profesional, për punësimin e bazuar në meritë, për gjithë kolegët të cilët sot janë pjesë e "Riinvest"-it, por edhe për të tjerët që tani mbajnë pozita shumë me rëndësi në vend.

Puna në këto dy dekada në Riinvest mbështetet fuqishëm në misionin e themeluesve, e ne po zhvillohemi duke pas vizion drejtë trendeve të zhvillimit në nivel global. Tash e 12 vite të qenuarit pjesë e Riinvestit është shumë krenari. Gëzuar 20 vjetorin, na prift e mbara më tutje!

VISAR VOKRRI

Hulumtues i avancuar



shin vitet e para të pasluftës kur fillova studimet universitare dhe kisha filluar t'i marr mësimet e para në fushën e ekonomisë. Ishte fillimi i një epoke të re, i kthimit të shpresës për një vend të shkatërruar e rraskapitur nga lufta dhe okupimi shumëvjeçar. Përderisa vendi ishte ende nën dehjen e lirisë, Instituti "Riinvest" pas katër vjetësh pune nën okupim tani iu ishte rikthyer aktiviteteve të tij në rrethana krejtësisht të reja - në Kosovën e lirë dhe me përplot sfida në rrugëtimin e saj të ri. Kosovës mund t'i ketë munguar liria, por jo edhe ekspertët vizionarë të cilët kishin jetësuar Institutin e vetëm të llojit "think tank", i cili do të merrej me hulumtime dhe analiza ekonomike me të vetmin qëllim promovimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Gjatë tërë periudhës së studimeve, por edhe më pas, mundohesha që përveç burimeve akademike njohuritë e mia t'i pasuroj edhe me burime shtesë. Për mua Instituti "Riinvest" ishte pa diskutim e vetmja pikë referente kredibile në Kosovë. Këtu dhe fillon njohja ime me Institutin. Me kalimin e kohës për mua "Riinvest"-i u bë sinonim i aktiviteteve hulumtuese dhe avokuese lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit. Rrjedhimisht, interesimi im për t'i përcjellë këto aktivitete sa vinte e shtohet; e gjeja veten në shumicën e tryezave, prezantimeve apo edhe konferencave ku Instituti ishte prezent. Privatizimi, zhvillimi i sektorit privat, tregtia, apo edhe energjia, ishin temat bosht të asaj kohe. Të gjitha ato studime e analiza të bëra nga "Riinvest"-i ishin bërë pjesë e bibliotekës sime.

Në kohën kur "Riinvest"-i po shënonte 19-vjetorin e themelimit, unë iu bashkova ekipit të tij. Ende besoj që ishte një nga vendimet më të mira përgjatë karrierës sime profesionale. Isha i bindur që përvoja ime dhjetëvjeçare qoftë në sektorin publik apo privat, do të ishte një vlerë e shtuar për ekipin profesional të Institutit dhe njëkohësisht një mundësi e jashtëzakonshme për t'i zgjeruar njohuritë e mia hulumtuese. Nuk u gabova, pritjet e mia u tejkaluan. Për një kohë shumë të shkurtër arrita të absorboj shumë gjëra të reja. Për më tepër, tanimë nuk isha më vetëm një admirues i punës dhe kontributit të tyre në zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës; tashmë edhe unë kisha mundësinë që të kem copëzën time në këtë kontribut. Aty gjeta një ekip të përkushtuar, profesional dhe të etshëm për punë dhe suksese të mëtutjeshme. Të gjithë ndajnë të njëjtin pasion, dëshirën e madhe për të bërë ndryshime pozitive, të cilat do të mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm në vend. Ashtu si suksesi edhe sfidat janë të përbashkëta. Është pikërisht sinergjia e brendshme ajo e cila e bën këtë institucion si punëdhënëse model në Kosovë.

Tashmë kur Instituti "Riinvest" po mbush plot njëzet vjet me aktivitete, suksese e sfida të shumta, e them me plot bindje që është privilegj të jesh pjesë e kësaj familje, ku dedikimi i saj për misionin që ka është i pakrahasueshëm. Besoj që kjo frymë do të përcjellë Institutin edhe pas njëzet vjetësh tjera; me plot suksese tjera dhe zgjerim të mëtutjeshëm të kësaj familje të madhe.

YLLI TAFARSHIKU

Asistent hulumtues



Pas një përvojë gati 10-vjeçare në sektorin mediatik dhe atë të marketingut, konkretisht në Kohavision, Studio Moderna dhe Entermedia, iu bashkova ekipit të Institutit "Riinvest". Pritjet e mia të para ishin të mëdha, pasi po i bashkohesha Institutit më prestigjioz ekonomik në vend, prandaj edhe presioni ishte i madh. Edhe pse po vija me një përvojë profesionale mjaft të pasur por të ndryshme nga ajo e ekonomisë për të cilën edhe njihet Instituti "Riinvest", kualifikimi im akademik i koncentruar në fushën e politikave publike, menaxhmentit, dhe ai minor në fushën e ekonomisë, së bashku me përvojën profesionale, e bënë një përzierje mjaft interesante për detyrën që mu besua: Asistent hulumtuesh, në projektin që ka të bëjë me avancimin e komunikimit me publikun, pranë Zyrës për marrëdhënie me publikun në Institutin "Riinvest".

Në shtator të vitit 2014 nisa edhe zyrtarisht punën në Institutin "Riinvest". Brenda Institutit gjeta kolegë jashtëzakonisht miqësorë dhe të afërt, pjesa më e madhe e tyre të profilizuar dhe me përvojë disavjeçare në fushën e kërkimeve ekonomike, të cilët menjëherë më bënë të ndjehem pjesë e familjes dhe kulturës së punës të krijuar në Institutin "Riinvest". Po ashtu, shtrirja horizontale e strukturës menaxhuese dhe organizative të organizatës, ku pjesa më e madhe e vendimeve për organizatën merren së bashku dhe në konsultim të afërt me stafin e Institutit, ishte edhe një arsye më e madhe që të ndjehem anëtar me shumë vlerë për organizatën.

Së bashku me Faton Selanin, kolegun tim në Zyrën për marrëdhënie me publikun, filluam punën në fuqizimin e zyrës dhe ngritjen e nivelit të komunikimit me publikun. Strategjinë e arritjes së qëllimit kryesor, pra të ngritjes së nivelit të komunikimit me publikun, e menduam si një mjet përmes së cilit do të krijojmë një metodë të re, tejet bashkëkohore dhe efikase të komunikimit. Identifikimi i publikimeve të organizatës në publik përmes krijimit të një grupi të standardizuar të shtypshkrimit dhe tipografisë; krijimi i një zyre për media që do të merrej ekskluzivisht me komunikimin me gazetarë; fuqizimin e medieve digjitale, konkretisht ueb faqes dhe rrjeteve sociale të Institutit; krijimin e një platforme digjitale ku do të publikohen të dhënat e mbledhura të punës kërkimore të Institutit; si dhe komunikimi përmes krijimit të një aplikacioni modern për sistemet operative Android dhe IOS, janë vetëm disa prej mjeteve të parapara për realizimin e qëllimit.

Pjesa më e madhe e projekteve në fjalë, tanimë veçse kanë filluar të realizohen dhe të marrin formë, ndërsa disa prej tyre veçse janë në fazën përfundimtare. Përgjatë një periudhe dyvjeçare, Instituti "Riinvest" përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun, do të ndërtojë një model tejet modern komunikimi me publikun, model i cili do të jetë i vetëqëndrueshëm, duke i mundësuar kështu audiencës së Institutit komunikim me qasje tejet të lehtë dhe moderne.

10

BASHKËPUNËTORËT
NËPËR VITE

BUJAR
PIRAKOLEGJI
RIINVEST

Kur u ula t'i shkruaj këta rreshta mu kujtua një fjalë e urtë kineze: "Është më mirë ta ndezësh një qiri sesa ta mallkosh terrin". Terri në të cilin vendi ynë u fut, posaçërisht në vitet e '90-ta, nuk arriti të shuajë vullnetin dhe të ndalë hovin e punës së një grupi ekspertësh të cilët në vend se ta mallkonin gjendjen e krijuar, vendosën që të punojnë për ndryshimin e kësaj gjendjeje, duke hapur një institut që do të merrej me politikat zhvillimore të vendit. Ky Institut shpejt u shndërrua në "qiriun" më shndritës në fushën e vet, pozitë të cilën vazhdon ta mbajë edhe sot. Fatmirësisht edhe unë pata rastin të jap kontributin tim në këtë Institut, në një periudhë të mëvonshme, kontribut ky i dyanshëm duke pas parasysh se përvoja të cilën unë e kam marrë gjatë punës aty vetëm i ka plotësuar arritjet e mia të mëhershme.

Të jesh pjesë e Institutit "Riinvest", për mua nuk është vetëm kënaqësi por edhe privilegj. Nga ky Institut janë gjeneruar, krijuar dhe zhvilluar me dhjetëra ekspertë të fushave të ndryshme, kontributi i të cilëve shkon përtej Institutit. Një nga këto kuadro të cilat Instituti "Riinvest" ka zhvilluar jam edhe unë. Para se t'i bashkohesha Institutit, në vitin 2008, isha inxhinier i makinerisë me kualifikime inxhinierike në të tri nivelet e studimit, dhe me përvojë modeste në menaxhment dhe në edukim universitar.

Shtatë vjetët, si i quaj unë "të 'Riinvest'-it", si pjesë e Institutit, janë vitet të cilat kanë pasur ndikim në procesin e zhvillimit tim profesional dhe shkencor (hulumtues) duke marrë pjesë në projekte të ndryshme hulumtuese dhe profesionale, nga zhvillimi i projekteve deri tek ekzekutimi

i tyre. Në mesin e shumë projekteve në të cilat kam qenë i angazhuar janë: projekti "Analiza e konsumit të energjisë dhe zhvillimit të balanceve të energjisë" (i përkrahur atëherë nga Ministria e Energjisë dhe Minierave), projekti "Hartimi i strategjisë së industrisë së Kosovës" (financuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë), Projekti "Mbështetja teknike të NVM-ve" (i financuar nga SPARK), Projekti "Promovimi i hortikulturës në Kosovë" (i financuar nga Swiss Development Cooperation), etj.

Përvoja ime në "Riinvest", jo vetëm që ka zhvilluar aspektet e mia hulumtuese, por ka hapur horizonte të tjera: atë të ekonomisë, energjisë dhe industrisë si dhe ka nxitur vlerësimin kritik dhe mendimin strategjik, elemente këto të cilat janë pjesë komplementare e edukimit tim të inxhinierisë dhe që profesionalizmit tim i kanë dhënë forcë. Pra, Instituti "Riinvest", jo vetëm që mundëson shfrytëzimin e potencialeve ekzistuese të hulumtuesve të vet, por edhe ofron mundësinë e zgjerimit të këtyre potencialeve hulumtuese si dhe mundësinë e vazhimit të studimeve, si në studimet master ashtu edhe atyre të doktoratës, përmes partnerëve strategjikë ndërkombëtarë.

Angazhimi im në "Riinvest", përveç Institutit, ka vazhduar edhe në procesin mësimor në Kolegjin Riinvest, si dhe në programet bachelor dhe MBA të Universitetit Staffordshire të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, të cilat ofrohen nga Kolegji Riinvest. Të qenit pjesë e "Riinvest"-it është nderë dhe kënaqësi, por është edhe përgjegjësi. Dhe ky përvjetor i 20-të e dëshmon më së miri punën dhe seriozitetin e këtij institucioni.

BARDHA
QIREZIKOLEGJI
RIINVEST

Në vitin 2007 u angazhova në cilësinë e konsulentës dhe udhëheqëses së zyrës për sigurim të cilësisë në Universitetin Riinvest. Krahas këtij angazhimi, fillova të bashkëpunojn edhe me Institutin "Riinvest". Në Institut kryesisht jam angazhuar në projektet për edukim, vlerësim, emigracion dhe në trajnime për zyrtarë publikë dhe biznese në komuna të ndryshme të Kosovës në projektet DELTA dhe Akademia zhvillimore.

Ajo që gjithmonë më tërheq në Institut është komuniteti vibrant dhe gjithmonë në zhvillim. Në vitin 2007, stafi kryesor aktual i Institutit sapo kishin përfunduar studimet master jashtë vendit dhe një nga një regjistroheshin në studimet e doktoratës. Gjatë kësaj kohe ata sillnin ide të reja, energji dhe përkushtim dhe në të njëjtën kohë zhvilloheshin personalisht. Ky zhvillim gradualisht transformoi Institutin i cili shtoi produktivitetin, cilësinë dhe mënyrat e reja të depërtimit në shoqërinë kosovare por edhe ndërkombëtare. Mirë-

po Instituti si komunitet vibrant ka përparësi, sepse gjithmonë shfrytëzon përvojën e mëparshme dhe kështu nagazhon stafin e kolegjit. Kështu në Institut varësisht nga lloji i hulumtimit, vazhdimisht anagazhohen njerëz me përvojë dhe krijohet një sinergji e përvojave, ekspertizës dhe gjeneratave.

Në bashkëpunimin tim në cilësinë e drejtoreshës për planifikim akademik dhe marrëdhënie ndërkombëtare, kam pasur rast të punoj në krijimin e modulit për praktikë në Institut dhe në angazhimin e studentëve. Ky kontribut i Institutit ka bërë Kolegjin Riinvest një vend unik ku stafi i Institutit punon bashkë me studentët në projekte të ndryshme. Nga perspektiva ime si menaxhere dhe mësimdhënëse, bashkëpunimi me Institutin për stafin e Kolegjit kontribuon në mësimdhënie më të informuar dhe atraktive, hulumtim intedisiplinar, dhe angazhim me komunitetin e biznesit dhe institucionet publike me të cilat bashkëpunojmë.



PETRIT GASHI

LIGJËRUES NË
UNIVERSITETIN
E PRISHTINËS

Dy dekada të Institutit Riinvest tregojnë për një përkushtim të jashtëzakonshëm karshi një misioni shumë sfidues: të përkrahjes së rimëkëmbjes ekonomike të vendit. Ndër shtyllat kryesore të shoqërisë civile në Kosovë, kontributi i Institutit Riinvest është i paçmuar, si një zë i singertë në procesin e bërjes së politikave publike dhe në zhvillimin institucional në Kosovë. Shtrirja dhe thellësia e analizave të Institutit Riinvest janë unike për vendin. Për dy dekada me radhë, hulumtuesit e Institutit Riinvest kanë demonstruar një aftësi të jashtëzakonshme në identifikimin dhe trajtimin e çështjeve fundamentale të jetës ekonomike në Kosovë, përfshirë këtu zhvillimin

e sektorit privat, privatizimin e pronës në Kosovë, reformën institucionale, konkurrueshmërinë dhe tregtinë e jashtme, reformimin e politikës fiskale, reformat në arsim dhe shëndetësi, dhe shume të tjera relevante.

Isha me fat që për tetë vite të jem pjesë e Institutit Riinvest, dhe t'i kam kontribuar sado pak misionit të tij. Në këtë jubile, i uroj Institutit Riinvest jetë të gjatë dhe pjesëmarrje aktive në zhvillimet ekonomike të vendit. Sot, kur vendit i duhen reforma të thella ekonomike dhe politike për të krijuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie për të gjithë, zëri i Institutit Riinvest është më i nevojshëm se kurrë.

BESNIK KRASNIQI

LIGJËRUES NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Instituti "Riinvest" iu bashkova në vitin 2001. Si një i ri në moshën 22- vjeçare ishte një privilegj, mirëpo njëkohësisht edhe një sfidë në ndërtimin e karrierës time si ekonomist. Ishte privilegj, për arsye se u bëra pjesë e një organizate me profesionistët më të mirë të Kosovës në fushën e zhvillimit ekonomik. Në anën tjetër, ishte një sfidë, sepse nga pozita e studentit u bëra pjesë e ekipit të profesorëve të mi të dashur dhe të çmuar. Kjo sfidë, u shndërrua në motivin kryesor për ngritje profesionale dhe kërkime shkencore.

Të punosh në "Riinvest" është një shans jetësor. "Riinvest"-i më ka bërë të ndjem pjesë e diçkaje të veçantë dhe se unë isha i rëndësishëm për t'i ndihmuar organizatës për të arritur qëllimin fisnik – zhvillimi ekonomik i Kosovës. Ky misioni fisnik i Institutit "Riinvest" më bënte të ndjem krenar dhe njëkohësisht të jem përgjegjës në punën time, i vetëdijshëm se cilësia e punës time do të ndikonte në misionin fisnik të këtij tempulli të dijes dhe kërkimit shkencor.

Një organizatë ku çdo ditë mëson gjëra të reja dhe kultivon frymën e punës ekipore dhe zhvillon mendimin ndryshe. Në "Riinvest" e kam shijuar kuptimin e plotë të punës ekipore. Krijimi i mendimit kritik dhe ofrimi i zgjedhjeve alternative për zhvillimin ekonomik të vendit ishte orientim kryesor. Prandaj, për mua "Riinvest"-i është një shkollë e mendimit ekonomik, e cila vazhdon të jetë prijëse në promovimin e vlerave të ekonomisë

së tregut dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Një fragment i veçantë i punës në "Riinvest" ishte bashkëpunimi me universitete dhe ekspertë prestigjiozë ndërkombëtarë nga ShBA-ja, Anglia dhe Evropa. Kjo ishte një derë e hapur në botë për t'u integruar në fushën e dijes dhe kërkimit. Vlen të potencohet një ekspert nga Florida University, i cili pas qëndrimit të gjatë në "Riinvest" si konsulent i jashtëm na tha se "Jam i fascinuar me punën e juaj; intensiteti dhe standardet e punës suaj janë të krahasueshme me standardet në Amerikë. Ky ishte një motivim i jashtëzakonshëm për ne, sidomos për hulumtuesit e rinj.

Si i tillë, "Riinvest"-i më ofroi një mjedis sa motivues, po aq përkrahës që më mundësonte të rritesha profesionalisht çdo ditë dhe ta ndryshoj mënyrën e të menduarit për të krijuar diferencën në shoqërinë tonë. Një mjedis ku punonjësi identifikohet me organizatën dhe misionin e saj. Një organizatë e cila gabimet na i shndërroi në mësim, presionin në produktivitet dhe aftësitë në fuqi. Por mbi profesionalizmin dhe karrierën, gjëja më e rëndësishme që kemi mësuar nga JU ka qenë se, si të bëhemi njerëz të sigurtë dhe me integritet, si dhe të mësojmë se suksesi është kuptimplotë vetëm kur e fiton atë në mënyrë fer dhe të drejtë.

Ju faleminderit që më mundësuat që ta bëj diferencën në jetën time dhe të kontribuoj sadopak në krijimin e diferencës për vendin tim.

HAZIR
GASHIKOLEGJI
RIINVEST

Themelimi i Institutit “Riinvest” ndodhi në kohën më të nevojshme për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe paraqet një moment shumë të rëndësishëm në momentin e kthesave historike të Kosovës. Bashkëpunimi dhe angazhimi im në Institutin “Riinvest” daton qysh nga fillimi i punës së tij, por konkretisht kam filluar pjesëmarrjen me prezantimin në seminarin e mbajtur me temën: Problemet e informatizimit të ekonomisë në Kosovë më 16-17.01.1998 – prezantimi i punimit tim me temën Programet mësimore nga lëndët e informatikës shkollat e mesme. Në këtë konferencë dhe në të ngjashme morën pjesë një numër i madh ekspertësh të teknologjisë informative, të ekonomisë, juristë dhe inxhinierë, të cilët bënë hulumtime dhe dhanë sugjerime shumë të rëndësishme për zhvillim të Kosovës.

Një rol shumë të rëndësishëm “Riinvest”-i e ka luajtur edhe menjëherë pas përfundimit të luftës me forma të ndryshme. Ky moment shumë i rëndësishëm është edhe organizimi i shkollës verore në Ohër në shtator 1999, ku për tri javë studentët më të dalluar të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, së bashku me profesorë dhe asistentë bënë aftësimin për zhvillim të bizneseve duke filluar nga plani i biznesit e më tutje. Për mua kjo ishte një përvojë e shkëlqyer, ku isha edhe si

vijues dhe trajner për Internet dhe Excel. Përvoja e fituar nga kjo shkollë verore më ka ndihmuar që menjëherë pas kthimit të filloj një biznes tepër të suksesshëm për mua dhe familjen time, por edhe për komunën e më gjerë.

Respekti i madh për këtë Institut dhe përvojat e mira që ka ndjekur, më bëri që edhe unë të bëhem pjesë e tij. Prej 1 korrikut 2008 jam punësuar si i rregullt në “Riinvest”. Pasi që specialitet imi i ngushtë është zbatimi i informatikës në fushën e ekonomisë dhe trajnime për kompjuter dhe njohje të softuerëve të ndryshëm, në Institutin “Riinvest” kam qenë i angazhuar në projektet: Projekti Delta me disa komuna të Kosovës për hartimin e strategjive të komunave. Projekti i MEM për hartimin e bilancit energjetik të Kosovës si dhe studimin e softuerëve për bilance energjetike, Projekti LOGOS për vlerësimin e strategjive për dy komuna (Kaçanik dhe Hani i Elezit), Projekti i MTI-së për përpilimin e strategjisë së industrisë së Kosovës: hulumtimi i ndërmarrjeve të TIK, Projekti për trajnimin e zyrtarëve të MBPZHRK për statistika, Projekti për trajnimin e zyrtarëve të MASHT-it për statistika, etj.

Analizat dhe rekomandimet e Institutit “Riinvest” janë shfrytëzuar nga të gjithë si tregues i saktë i rrjedhave ekonomike dhe sociale në shoqërinë kosovare.

MUHAMET SADIKU

BASHKË- THEMELUES

Viti 1996. Në dukje të parë asgjë e re. Preokupim i Grupit themelues të Riinvestit ishte përgatitja e projektit "Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik

i Kosovës", i cili barte porosinë dhe idenë se Kosova mund të funksionojë si demokraci dhe ekonomi e tregut nën ombrellën e pavarësisë dhe të integriteteve.

Në kuadër të analizimit të përvojave ndërkom-bëtare lidhur me transicionin dhe në veçanti sfidën e privatizimit, filluam t'i vizitojmë vendet e rajonit që trashëguan një të kaluar të përbashkët politike dhe ekonomike.

Për të mësuar më shumë rreth kësaj çështjeje,

mbërrita në Zagreb. Bëra kontakte, biseda dhe tentoja të nxjerr mësim se çka duhej bërë dhe çka nuk duhej bërë me privatizimin në Kosovë. Një ditë kontaktova një mik timin në Zagreb.

la dëftova qëllimin e vizitës, me fokus në mësimet nga privatizimi në Kroaci. Mos është herët të flitet për privatizimin në Kosovë, ju jeni ende të okupuar nga Serbia, m'u përgjigj miku im. Po, jemi të okupuar, por nuk është herët të mendojmë për pavarësi, demokraci dhe kapitalizëm në Kosovë, iu përgjigja.

Mendoj pakë dhe m'u përgjigj: "Po, nëse përgatiteni tani, gabimet janë më të vogla dhe kostoja e ndryshimeve më e ulët".

SELMAN
SELMANAJKOLEGJI
RIINVEST

Në fund të tunelit dukej një dritë

Në kohën e ekzistimit të errësirës totale duke përfshirë të gjitha format e saja: mediale, arsimore, kulturore, shkencore, punësimi, dhe forma tjera, në vitin 1995 në fund të tunelit dukej një dritë, e cila filloi të reflektohet jo vetëm në hapësirën e këtij tuneli, por edhe jashtë tij. Kjo dritë filloi të reflektohet me themelimin e Institutit "Riinvest" në vitin 1995. Drita filloi të reflektohej nëpërmjet hartimit të studimeve të publikuara, promovimit të tyre si dhe nëpërmjet organizimit të seminareve dhe tryezave shkencore, veçanërisht, në periudhën 1995 deri në mars të vitit 1999, dhe bashkëpunimit ndërkombëtar të këtij instituti me institutet e ngjashme në disa shtete të Evropës.

Një ngjarje e rëndësishme për mua ishte fakti që isha pjesëmarrës në promovimin e studimit "Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë". Në Prishtinë u organizua promovimi i këtij botimi në gjuhën shqipe. Ky promovim në mua la një përshtypje të madhe në Prishtinën e asaj kohe, ku regjimi serb bënte përpjekje të vazhdueshme për shuarjen e të gjithë asaj që kishte karakter kombëtar shqiptar. Botimi në gjuhën anglishte u promovua në Universitetin e Evropës Qendrore në Budapest.

Me themelimin e Institutit "Riinvest", jam zgjedhur si kryetar i parë i Këshillit Shkencor. Para luftës në Kosovë, aktiviteti i këtij Instituti u reflektua edhe në organizimin e seminareve dhe tryezave shkencore me një rëndësi të posaçme, siç janë "Analiza kritike e Ligjit mbi privatizimin dhe transformimin e pronës në Serbi", "Faktorët limitues të

ndërtimit të sektorit privat në Kosovë", "Ndërtimi i sistemit ekonomik në Kosovë", "Zhvillimi i demokracisë", tryezë kjo që u mbajt 3 ditë para fillimit të bombardimeve të NATO-s. Arritje më e madhe e këtij Instituti në këtë periudhë ishte konsolidimi i kuadrit shkencor dhe profesional, zhvillimi i mendimit ekonomik dhe politik, dhe që është më me rëndësi për mendimin tim, ishte kthimi i vetëbesimit të kuadrit shkencor dhe profesional, të cilët u tubuan rreth këtij Instituti, dhe ruajtja e shtresës së mesme e cila pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, me një shpejtësi të madhe u shndërrua në shtresë të punëtorëve me mëdijtje.

Gjatë luftës në Kosovë, Instituti "Riinvest" vazhdoi aktivitetin e vet në Tetovë, ndërsa pas çlirimit të vendit, ky institut vazhdoi aktivitetin e vet në rrethana të reja, që kryesisht u fokusua në diagnostikimin e problemeve dhe dhënien e propozimeve për zgjidhjen e tyre, veçanërisht në fushën e transformimit dhe të privatizimit të pronës dhe në krijimin e kuadrove të reja, që morën tituj shkencorë, si magjistra dhe doktorë shkence në fushën e ekonomisë. Instituti "Riinvest" kaloi nga faza e adoleshencës në fazën e zhvillimit duke diagnostikuar fusha të reja të hulumtimeve.

Me kënaqësi po theksoj se Instituti "Riinvest" deri më tani m'i ka botuar tre libra autorialë.

Nga e tërë kjo rrjedh se unë mburren që isha dhe akoma jam bashkëpunëtor në vazhdimësi i këtij Instituti. Me rastin e 20-vjetorit të themelimit të këtij Instituti, i dëshiroj sukses të mëtejshëm institutit.

SALVADOR ELMAZI

ASOCIACIONI I
KOMUNAVE TË
KOSOVËS

E pranova me kënaqësi të veçantë ftesën për të shkruar rreth përshtypjeve të mia si bashkëpunëtor i Institutit "Riinvest" me rastin e 20-vjetorit të themelimit të tij. Më duhet të them se është nder i veçantë për mua të shkruaj për këtë Institut me renome që tejkalon kufijtë e Kosovës. Në njërën anë them se puna në "Riinvest" është vërtet ri-investim dhe kërkon angazhim serioz e përkushtim maksimal. Por në anën tjetër, kjo punë paraqet mundësi të artë për hulumtuesit që secili prej tyre të bëjë diçka pozitive për karrierën e vet profesionale por edhe për vendin, sepse Instituti "Riinvest" vazhdon të mbetet ndër vite një organizatë me një rëndësi të madhe publike në Kosovë.

Një avantazh i pakrahasueshëm i punës në "Riinvest" është kredibiliteti i këtij institucioni si dhe perceptimi i krijuar rreth tij, sepse "Riinvest"-i është vërtet një Institut hulumtues i besueshëm, rekomandimet e të cilit vazhdimisht janë të dobishme dhe të kërkuara nga të gjitha palët e interesuara, që nga Qeveria deri te donatorët e sektori privat. Kushdo që do të zhbirilojë më thellë në çështjet jo vetëm ekonomike lidhur me Kosovën, qoftë nga jashtë apo brenda Kosovës, burim të patejkalueshëm dhe shumë të çmuar e ka "Riinvest"-in. Ky, duhet pranuar, është një lehtësim i madh për të gjithë ata që interesohen për zhvillimet në Kosovë dhe rreth saj.

Është edhe një gjë tjetër që do të doja të nënvizoja - se raportet hulumtuese dhe rekomandimet e Institutit "Riinvest" janë të hartuara me një stil të veçantë. Ato janë rekomandime të kujdesshme dhe mirë të analizuara, që në rend të parë mbrojnë interesin publik. Rekomandimet e "Riinvest"-it janë të hartuara asisoj që të jenë të kapshme për të gjitha hallkat e shoqërisë sonë. Kam një bindje të fortë se në raportet hulumtuese të "Riinvest"-it mund të gjejmë gjëra të vlefshme dhe të aplikueshme për veten e tyre qoftë vendimmarrësit politikë, qoftë academia, shoqëria civile, komuniteti biznesor, por edhe hulumtuesit kushdo qofshin ata.

Puna në "Riinvest" nuk ndalet, ajo ecën gradualisht dhe është gjithëpërfshirëse. Pse e them këtë? Të ndalem pak më shumë në dy fushat ku unë personalisht kam qenë më shumë i fokusuar. Bie fjala, në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, "Riinvest"-i ka mbështetur pa dallim komunitatet e Kosovës qoftë me dhënie të përkrahjes për hartimin e strategjive të zhvillimit ekonomik lokal, qoftë në ndërtimin e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Ndërkaq, në fushën e qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike dhe kompanive financiare, "Riinvest"-i ka qenë institucioni prijtar në Kosovë që ka ngritur sfidat e ndërtimit të një sistemi të avancuar të qeverisjes së mirë të kompanive dhe ka dhënë rekomandime konkrete në këtë drejtim.

Për ta përmbyllur në fund, i dëshiroj Institutit "Riinvest" jetë të gjatë dhe i gëzohem bashkëpunimit të vazhdueshëm edhe në të ardhmen!

VENERA DEMUKAJ



LIGJËRUESE NË AUK

Të qenit pjesë e Institutit "Riinvest" për gjashtë vjet me radhë paraqet një përvojë shumë mbresëlënëse për mua. Qysh në ditët e para të punës sime në "Riinvest", e kuptova se udhëheqja e Institutit, e përbërë nga profesorë dhe profesionistë të njohur në vend, kishte vizion të qartë për Institutin: zhvillimin e potencialit humltues përmes tërheqjes së të rinjve dhe studentëve më premtues si dhe mbështetjen e tyre gjatë ngritjes dhe zhvillimit në karrierën humltuese/akademike. Përkushtimi serioz në realizmin e këtij vizioni mund të dëshmohej më së miri përmes të arriturave të Institutit "Riinvest" ndër vite, por edhe të arriturave personale të stafit të mëhershëm dhe atij ekzistues.

Kështu, angazhimi në kuadër të ekipit të humltuesve të "Riinvest"-it ka pasur ndikim në rrafshin profesional dhe personal të jetës sime. Në aspektin profesional, puna në "Riinvest" më ka mësuar si të humltoj dhe di-

skutoj rreth aspekteve të ndryshme të zhvillimit ekonomik në Kosovë, aftësi këto të cilat i kam kapitalizuar gjatë hapave të mëtejshme në karrierë. Por jo vetëm kaq. Falë kombinimit të duhur midis udhëheqjes mendjehapur dhe ekipit të ri në moshë, në Institutin "Riinvest" u krijua një mjedis vibrant, sfidues, e njëherësh edhe shumë i këndshëm për punë. Duke qenë pjesë e këtij ekipi, unë pata mundësinë që t'i kuptoj përparësitë dhe të metat e mia si humltuese. Si ekip, ne mësuam shumë nga njëri-tjetri dhe së bashku u rritëm profesionalisht. E tërë kjo përvojë më pastaj ndikoi edhe në jetët tona personale, pasi që si humltues të rinj dhe entuziastë krijuam miqësi dhe lidhje të ngushta, të cilat vazhdojmë t'i mbajmë edhe përtej angazhimit tonë në "Riinvest".

Instituti "Riinvest" është djepi, në të cilin u rrit dhe u zhvillua gjenerata e re e humltuesve dhe shkollarëve në Kosovën e pasluftës, ndaj me shumë krenari e them se "edhe unë jam pjesë e kësaj gjenerate"!



11



PUBLIKIMET E
“RIINVEST”-IT



2015

- Transparenca dhe llogaridhënia:
Autostrada Prishtinë-Shkup
- Koncesionimi i Kompleksit Turistik Brezovica
- Privatizimi i sektorit të energjisë
- Koncesionimi i Aeroportit
- Potencilaet Ekonomike në Veri të Kosovës

2014

- Raporti i Monitoritmi:
Plani Nacional i Veprimit 2014-2016
- Sondazhi i opinionit publik: niveli i besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve
- Udhëzuesi për prokurimin publik
- Klima e biznesit në Kosovë 2014
- Transparenca në Kosovë
- Globalizimi dhe ndërtimi i shtetit:
PROF. DR. SELMAN SELMANAJ:

2013

- Numëratori Ekonomik 2013
- Identifikimi i politikave të qeverisjes së hapur
- Të paguash apo të mos Paguash: Informaliteti nga këndvështrimi i bizneseve në Kosovë

2012

- Qeverisja Korporative në Ndërmarrjet Publike në Kosovë
- Praktikat e përdorura për tërheqjen e investimeve nga diaspora;
- Analiza e portfolios së verërave në Kosovë
- Përmirsimi i transparencës dhe qeverisja e fondeve publike në Kosovë
- Financimi i agrobizneseve në Kosovë;
- Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë: sektori privat dhe punësimi
- Përmirësimi i përfshirjes së komunitetit serb të Kosovës në aktivitetet ekonomike në Kosovë

2011

- Shteti dhe buxheti: kujdes faturën
- Sektori Bankar në Kosovë: ndihmesë apo barrierë

2010

- Strategjia e industrisë: 2010-2014
- Qeverisja Korporative 2

2009

- Përmirësimi i qeverisjes korporative dhe transparencë në institucionet financiare;
- Dilema dhe ngecje në rrugën e shpejtë: privatizimit i ndërmarrjeve publike në Kosovë
- Menaxhimi i investimeve
PROF. DR. MUHAMET MUSTAFA

2008

- Privatizimi dhe postprivatizimi në Kosovë:
Një gotë gjysmë bosh apo gjysmë e plotë
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Shtimes
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Obiliqit
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Dragashit
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Kamenicës
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Malishevës

2007

- Kornizë për zhvillimin dhe udhëzime për konsultim të komunitetit minerar në Kosovë;
- Diaspora dhe Politikë e Migracionit
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë 2007
- Tranzicioni dhe Reformat Institucionale në Kosovë:
PROF. DR. MUHAMET SADIKU
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Gjilanit
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Ferizajit
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Pejës
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Dresnasit
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Lipjanit

2006

- Raporti i paralajmërimit të hershëm për Kosovën
- Qeverisja Korporative 1
- Globalizimi dhe tranzicioni:
PROF.DR.SELMAN SELMANAJ
- Bizneset e Vogla dhe të Mesme:
MUHAMET MUSTAFA, PETRIT GASHI, BESNIK KRASNIQI
- Fjalori Ekonomik: HAJRULLAH GORANI
- Qëndrueshmëria ekonomike në Kosovë:
Sfidat, politikat dhe mundësitë
- Kultura Fiskale

2005

- Raporti i Paralajmërimit të hershëm për Kosovën;
- Profili dhe sfidat e zhvillimit Socio-Ekonomik të Kosovës;

2004

- Raporti i Paralajmërimit të hershëm për Kosovën
- Zhvillimi ekonomik lokal dhe investimet e jashtme direkte në Kosovë
- Lidershipi: ISA MUSTAFA
- Investimet e jashtme direkte dhe zhvillimi ekonomik lokal
- Zhvillimi rural në Kosovë
- Sistemi i edukimit dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë 2004
- Raport vlerësues mbi ecuritë e privatizimit;
- Menaxhimi i Projekteve dhe Investive:
PROF. DR.MUHAMET MUSTAFA
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Podujevës
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Istogut
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Kaçanikut
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Klinës
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Vitisë
- Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Komuna e Vushtrrisë

2003

- Korrupsioni dhe Ndikimi i tij në ekonominë e Kosovës
- Sistemi buxhetor në Kosovë: Politikat dhe qëndrueshmëria
- Politikat tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë;
- Tregu i punës dhe papunësia në Kosovë
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë 2003
- Menaxhimi i resurseve humane: DR. YMER HAVOLLI
- Vendorsja afariste: PROF. DR. IBRAHIM KUKAJ

2002

- Investimet e jashtme direkte në Kosovë;
- Zhvillimi ekonomik lokal
- Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe reforma e ndërmarrjeve publike në Kosovë
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë 2002

2001

- Aspektet kyçe të situatës sociale dhe ndërtimi i sistemit të pensioneve në Kosovë
- Disa çështje të ndërtimit dhe zbatimit të politikës fiskale në Kosovë
- Ecurit e ndërtimit të politikës së tatimeve dhe taksave në Kosovë
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë 2001
- Ndërmarrjet shoqërore dhe transformimi: privatizimi i tyre
- Ndërtimi i pas-luftës në Kosovë: strategjia dhe politikat
- Fjalor Anglisht-Shqip dhe Shqip-Anglisht i termave të marketingut: Dr. Nexhmi Rexha

2000

- Ndërtimi dhe funksionimi i institucioneve të administrimit lokal në Kosovë
- Pasojat e luftës dhe riaktivizimi i 193 ndërmarrjeve shoqërore
- Pasojat e luftës dhe zhvillimi i NVM-ve

1999

- Strategjia e zhvillimit ekonomik dhe gjenerimi i NVM-ve
- Ripërtritja dhe rinvdërtimi i Kosovës pas luftës: politikat dhe menaxhimi
- Kërkimet e Tregut, dhe Promovimi - DR. NAIL RESHIDI;

1998

- Sistemi i ekonomisë së hapur të tregut dhe tranzicion në Kosovë;
- Sistemi Ekonomik dhe Zhvillimi i Kosovës:
PROF. DR. MUHAMET SADIKU
- Aktivitetet Ekonomike dhe Zhvillimi Demokratiki Kosovës
- Tregu Financiar: DR. FADIL GOVORI
- Menaxhimi i projekteve investive:
PROF. DR. MUHAMET MUSTAFA
- Bazat e Marketingut:
DR. NEXHMI REXHA DHE DR. NAIL RESHIDI
- Strategjia e zhvillimit ekonomik dhe gjenerimi i NVM-ve
- Problemet e informatizimit të ekonomisë në Kosovë
- Pasojat e luftës në ekonominë dhe bizneset familjare

1997

- Kërkime Tregu: Dr. Nail Reshidi

1997

- Sistemet Ekonomike Bashkëkohore:
PROF. DR. SELMAN SELMANAJ
- Biznesi, Problemet dhe Perspektivat

12

STAFI AKTUAL
I “RIINVEST”-IT

LUMIR
ABDIXHIKU, PHD
DREJTOR EKZEKUTIV



Lumir Abdixhiku është drejtor ekzekutiv i Institutit "Riinvest". Ai i është bashkuar Institutit në vitin 2005 dhe që nga atëherë është i angazhuar në disa projekte kërkimore, të avokimit e zhvillimit – në Kosovë dhe jashtë saj. Pas përfundimit të studimeve universitare në Universitetin e Prishtinës, Lumiri në vitin 2006 ka marrë titullin magjistër shkence në Universitetin e Staffordshire të Britanisë; në fushën e Moralit fiskal. Në vitin 2013 ai ka marrë titullin doktor shkence i ekonomisë, nga Universiteti Staffordshire, pas katër vjetëve hulumtimi e kërkimi në fushën e determinantëve të evazionit fiskal të bizneseve në vendet e tranzicionit. Që nga viti 2007, Lumiri është gjithashtu ligjërues i lëndëve Mikroekonomi edhe Ambient biznesor në Kolegjin Riinvest, në Prishtinë. Lumiri gjithashtu mbanë një kolumne të rregullt javore, në gazetën ditore më prominente në Kosovë, "KOHA DITORE". Përgjatë dhjetë vjetëve të shkuara në Institutin "Riinvest", si kërkues e si drejtor ekzekutiv, Lumiri ka qenë i angazhuar në projektet e ndërlidhura me fushën e qeverisjes ekonomike, procesin e privatizimit, transparencën e investimet kapitale, zhvillimin e tregjeve në fushën e hortikulturës, turizmit e procesimit të ushqimit, në klimën biznesore dhe zhvillimor të sektorit privat, qeverisjen korporative, evazionin fiskal, politikat buxhetore, qeverisjen e hapur – si dhe në aktivitetet avokuese rreth temave më të rëndësishme socio-ekonomike e zhvillimore në Kosovë.

SEJDI
OSMANI
KRYETAR I BORDIT DREJTUES



Aktualisht është kryetar i Bordit Drejtues i Institutit "Riinvest", Sejdi Osmani është njëri prej themeluesve të Institutit. Ka qenë i angazhuar në pozita drejtuese dhe menaxher i shumë projekteve të Institutit: Drejtor ekzekutiv i Institutit "Riinvest" (2004-2009); Drejtor administrativ i Institutit "Riinvest" (2001-2004); menaxher i disa projekteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal; koordinator projektsh, pjesëtar i ekipeve i shumë projekteve hulumtuese. Është autor i rreth 20 artikujve lidhur me politikën fiskale dhe sistemin e taksave, autor i një sërë punimeve në fushën e administratës publike, privatizimit, qeverisjes korporative, administratës lokale dhe shërbimeve publike. Ka një përvojë të gjatë në fushën e publikimeve: Kryeredaktor i revistës javore për të rinj "Zëri i Rinisë" (1978-1982); redaktor i më se 30 botimeve dhe autor dhe bashkautor i afro 30 raporteve hulumtuese të Institutit "Riinvest". Ka marrë pjesë në një sërë konferencash vendore dhe ndërkombëtare.

ALBAN HASHANI, PHD

DREJTOR KËRKIMOR



Albani ka filluar punën në Institutin "Riinvest" në vitin 2006, pasi ka punuar një kohë në sistemin bankar. Aktualisht ai mban pozitën e drejtorit të kërkimeve në Institutin "Riinvest". Pas përfundimit të studimeve universitare në Universitetin e Prishtinës, Albani ka vijuar studimet e magjistraturës dhe doktoratës në Universitetin Staffordshire në Britani të Madhe, respektivisht në fushën e korrupsionit dhe transformimit të pronës. Në kuadër të Institutit "Riinvest", Albani ka qenë i përfshirë në shumë projekte kërkimore të ndërlidhura me çështje socio-ekonomike të vendit, përfshirë, mes tjerash, çështjen e privatizimit, qeverisjes korporative, korrupsionit, energjisë e mjedisit afarist. Gjithashtu, Albani rregullisht publikon në revista shkencore dhe merr pjesë në konferenca ndërkombëtare në lidhje me temat e demokracisë industriale dhe transformimit të pronës. Ai është edhe ligjërues në Kolegjin Riinvest ku mbulon disa lëndë të lidhura me ekonomiksin.

SAXHIDE MUSTAFA, MSC

ZËVENDËSE E DREJTORIT
EKZEKUTIV



Saxhide Mustafa është zëvendëse e drejtorit ekzekutiv. Saxhidja është pjesë e "Riinvest"-it që nga viti 2003, kur ka filluar punën në pozitën asistente administrative. Ajo ka të përfunduar Fakultetin Juridik - Universiteti i Prishtinës, pastaj studimet MA i ka përfunduar në Kolegjin Riinvest me temën "Qeverisja korporative dhe transparenca në ndërmarrjet publike në nivelin lokal-rast studimor Termokos Sh.A". Prej vitit 2012 është duke ndjekur studimet e doktoratës në Fakultetin Ekonomik, Universiteti Publik i Tiranës me temën "Qeverisja korporative dhe performanca e kompanive në Kosovë". Pozitën e zëvendëses së drejtorit ekzekutiv Saxhidja e mban që nga viti 2010. Ajo ka ndjekur disa trajnime si: Gratë në leadership- program i ndjekur në Kosovë dhe në Uashington, i financuar nga USAID-i, qeverisja korporative, menaxhimi i riskut, strategjia e korporatave, bordet, llogaridhënia, transparenca i financuar nga IFC dhe SDC, menaxhimi i inovacioneve - Fakulteti Ekonomik Lubjanë, financuar nga projekti TEMPUS, etj. Saxhidja përveç që merret me çështjet juridike dhe të personelit në Institutin "Riinvest", ajo është pjesëmarrëse edhe në projektet hulumtuese në fushën e qeverisjes korporative dhe zhvillimit ekonomik lokal. Saxhidja prej vitit 2010 është ligjëruese në Kolegjin Riinvest në lëndët Etika biznesore dhe e Drejta biznesore.

DIELLZA GASHI, MSC

HULUMTUESE E AVANCUAR



Diellza Gashi mban pozitën e hulumtueses së avancuar në Institutin "Riinvest". Ajo është bërë pjesë e Institutit në vitin 2011 si asistente hulumtuese. Diellza ka përfunduar studimet bazë në Universitetin Amerikan në Kosovë në vitin 2009. Pas përfundimit të studimeve bazë, Diellza ka vazhduar studimet master në Rochester Institute of Technology në Rochester, New York, për Administrim biznesi me fokus në Biznes ndërkombëtar. Që nga viti 2014, Diellza është kandidat për doktoratë në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Lubjanës, me specializim në menaxhimi dhe organizatat. Prej marsit të vitit 2011, Diellza punon edhe si asistente e mësimdhënies në Kolegjin Riinvest për lëndët e ndërlidhura me menaxhimin dhe organizatat. Përgjatë 4 vjetëve në Institutin "Riinvest", Diellza ka qenë e përfshirë në projekte të ndryshme të lidhura me fushën e hulumtimit të tregut, ndërtimit të aftësive humane, promovimin e zhvillimit regjional ekonomik, klimën e biznesit, investimet e diasporës dhe remitencat, si dhe zhvillimit të sektorit privat.

ILIRE MEHMETI, MSC


HULUMTUESE E AVANCUAR



Ilire Mehmeti u bë pjesë e Institutit "Riinvest" në nëntor të vitit 2011 dhe që nga atëherë ka qenë e përfshirë në shumë projekte hulumtuese dhe zhvillimore. Fillimisht, ka qenë e angazhuar në përgatitjen e raporteve si "Nga Rahoveci-brandi regjional", "Analiza e portfolios së verërave" dhe "Financimi i agrobizneseve" në kuadër të projektit 'Promovimi i hortikulturës në Kosovë'. Angazhimi ka përfshirë dizajnimin e pyetësorëve, intervistimin e akterëve relevantë, nxjerrjen dhe përshtatjen e të dhënave dhe interpretimin e tyre në një raport final. Megjithatë, Ilirja është inkuadruar edhe në projekte të tjera që kanë trajtuar fushat e zhvillimit të sektorit privat, klimës së biznesit dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi. Gjatë dy vjetëve të fundit përqendrimi i saj ka qenë në fushën e zhvillimit ekonomik rajonal dhe ngritjen e kapaciteteve rajonale, më konkretisht përmes koordinimit dhe organizimit të "Akademisë zhvillimore". Që nga viti 2012, Ilirja, po ashtu, është e angazhuar si asistente ligjëruese në Kolegjin Riinvest në fushën e Menaxhimit financiar të bizneseve. Ilirja ka përfunduar studimet bachelor për Ekonomi në Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK) dhe studimet master në Universitetin e Trier të Gjermanisë.

GENT
BEQIRI, MSC

HULUMTUES I AVANCUAR



Gent Beqiri është i angazhuar në Institutin "Riinvest" që nga gushti i vitit 2008 dhe që atëherë është përfshirë në studime dhe analiza ekonomike, studime të tregut, biznes plane dhe studime të fizibilitetit të bizneseve si dhe zhvillimin e NVM-ve dhe zhvillimin ekonomik lokal. Fokusimi i Gentit është në menaxhimin dhe implementimin e anketave të ndryshme, kryesisht në ato të NVM-ve. Ai është i fokusuar në përgatitjen e mostrave për realizimin e anketave, dizajnimin e pyetësorëve, trajnimin e anketuesve, monitorimin e procesit anketues si dhe përpunimin e të dhënave, nxjerrjen e analizave të avancuara statistikore dhe interpretimin e të dhënave. Së fundmi, angazhimi i plotë i tij koncentrohet në krijimin e një platforme të qasshme nga publiku i gjerë, platformë e cila përmban dhe bashkon të gjitha të dhënat statistikore të Institutit "Riinvest" që nga themelimi i tij. Në Kolegjin Riinvest, Genti është i angazhuar si ligjërues në lëndët Menaxhment dhe statistikë që nga viti 2009. Ai ka mbaruar studimet bachelor dhe master në Fakultetin Ekonomik, drejtimi Menaxhment dhe informatikë në Universitetin e Prishtinës.

AGON
NIXHA, MSC

HULUMTUES I AVANCUAR



Agon Nixha është hulumtues i avancuar në Institutin "Riinvest". Agoni i është bashkuar "Riinvest"-it në 2011-n dhe që nga ajo kohë është angazhuar në projekte të ndryshme me natyrë socio-ekonomike. Përveç hulumtimeve në Institutin "Riinvest", ai është i angazhuar si mësimdhënës në Kolegjin Riinvest në lëndën Mikroekonomia II dhe Paraja dhe bankat. Agoni mban diplomë master nga "University College London", me fokus në ekonomiks dhe politika krahasuese në vendet në tranzicion. Shkollimin bachelor e ka përfunduar në Universitetin Amerikan në Kosovë, që është në partnership me "Rochester Institute of Technology". Fokusi në këto studime kanë qenë ekonomiksi dhe menaxhmenti. Gjatë angazhimit në Institutin "Riinvest", Agoni ka udhëhequr projekte që ndërlidhën me klimën e biznesit, qeverisjen e hapur, qeverisjen korporative në biznese familjare, indikatorët e aktivitetit ekonomik dhe potencialet energjetike në vend. Përveç këtyre, ai është angazhuar në projektet mbi informalitetin, zhvillimin e sektorit të pemëve e perimeve të përpunuara dhe politikat industriale. Agoni është aktiv në avokimin e çështjeve që i hulumton në media të shkruara dhe në rrjete sociale. Për më shumë, ai ka qenë pjesëmarrës i shumë konferencave të organizuara në universitetet eminente si, "Oxford", "London School of Economics" dhe "University College London". Në të kaluarën, Agoni ka qenë i angazhuar si hulumtues bashkëpunëtor në "Center for Energy and Natural Resources", ku ka hulumtuar rreth efijencës së energjisë.

PREMTON
HYSENI, MSC

HULUMTUES I AVANCUAR



Premton Hyseni është hulumtues i avancuar në Institutin "Riinvest". Premtoni ka studiuar Ekonomi dhe politika publike në Universitetin Amerikan të Kosovës, dhe ka magjistruar në Ekonomi dhe politika ndërkombëtare në London School of Economics me temën "Ciklet politike të biznesit". Premtoni më herët ka punuar si auditor i brendshëm në Bankën ProCredit, dhe ka kryer program praktike në Departamentin e financave të Bankës Raiffeisen. Premtoni i është bashkuar "Riinvest"-it më 2012 dhe prej atëherë është angazhuar në shumë projekte hulumtuese dhe avokuese si Ekonomia joformale, Qeverisja e mirë, Prokurimi publik, Politikat makroekonomike, Zhvillimi i turizmit, etj. Premtoni ka marrë pjesë në shumë forume politikash dhe ka kontribuar në debatin rreth ekonomisë joformale, qeverisjes së mirë dhe normave të interesit në Kosovë. Premtoni, po ashtu, ligjeron Ekonometri dhe Makroekonomi në Kolegjin Riinvest.

VISAR
VOKRRI, MSC

HULUMTUES I AVANCUAR



Visari i është bashkuar Institutit në korrik të vitit 2014 në cilësinë e hulumtuesit të avancuar. Visari ka mbaruar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës në fushën e menaxhmentit. Për më tepër, ai ka mbaruar studimet master në Universitetin e Nottingham-it në Mbretërinë e Bashkuar në fushën e zhvillimit ekonomik dhe analizë të politikave ekonomike me fokus të veçantë në Politikat tregtare. Visari, gjithashtu, është i angazhuar edhe në cilësinë e ligjëruesit të lëndëve Sistemi ekonomik ndërkombëtar dhe Ekonomia evropiane në Kolegjin Riinvest. Para se t'i bashkohej Institutit "Riinvest", Visari ka punuar në institucione të ndryshme qoftë në sektorin privat apo publik në Kosovë përfshirë sektorin bankar, procesin e privatizimit në Kosovë, projekte të UNDP-së, EBRD-së dhe Bankës Botërore, dhe po ashtu në Qeverinë e Kosovës. Gjithashtu, Visari ka qenë i angazhuar në aktivitete të ndryshme hulumtuese dhe avokuese lidhur me qeverisjen e hapur, potencialin eksportues të Kosovës, zhvillimin e tregut në industrinë e përpunimit të ushqimit dhe shumë projekte të tjera lidhur me zhvillimin e sektorit privat.

ANTIGONA
UKA

ASISTENT HULUMTUES



Aktualisht, Antigona Uka është asistente hulumtuese në Institutin "Riinvest". Ka përfunduar studimet bazike në Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM). Një pjesë të studimeve i ka përfunduar në ShBA, më saktësisht në Universitetin 'West Libery' të Virxhinias Perëndimore. Angazhimi i saj në "Riinvest" ka filluar në mars të vitit 2013, ku ajo ka punuar si praktikante duke u angazhuar kryesisht me pjesën e punës në terren; siç janë anketat dhe intervistat, ndërsa si asistente hulumtuese është angazhuar që nga shtatori i vitit 2014 dhe projekti kyç ka qenë desiminimi i të dhënave. Pozita e saj i jep hapësirë për avancim të njohurive në fusha të përgjithshme të zhvillimeve ekonomike.

YLLI
TAFARSHIKU
ASISTENT HULUMTUES

Ylli Tafarshiku mban pozitën asistent hulumtues në Institutin "Riinvest". Ai iu bashkua Institutit "Riinvest" në shtator të vitit 2014, dhe më konkretisht është i përfshirë në projekte që kanë të bëjnë me komunikim dhe avokim. Ylli ka përfunduar studimet në Universitetin Amerikan të Kosovës, dhe mban diplomë bachelor në Arte dhe shkenca, me përqendrim kryesor në Politika publike dhe menaxhment, dhe atë minor në ekonomiks. Ai iu bashkua ekipit të "Riinvest"-it, pas një përvoje të gjatë dhe të pasur në sektorin e medieve dhe atë të marketingut. Në vitin 2006, ai filloi të punojë në kanalin kombëtar televiziv të Kosovës Kohavision, në video grafike, dhe më vonë si realizator televiziv. Pas një periudhe 5-vjeçare në mediet elektronike (KTV), ai iu bashkua ekipit të Studio Modernas në Kosovë si menaxher i printit, duke u njohur për së afërmi me mundësitë e marketingut të drejtpërdrejtë dhe industrisë së shtypit, përmes kanalit të printit, si formë e veçantë e marketingut të drejtpërdrejtë. Në vitin 2013 ai iu bashkua kompanisë së komunikimit Entermedia, duke u përfshirë në projekte që kanë të bëjnë me marketingun digjital.

FATON
SELANI

DREJTOR KREATIV



Faton Selani mban pozitën e drejtorit kreativ në Institutin "Riinvest". Ai iu bashkua Institutit "Riinvest" në shtator të vitit 2014, dhe më konkretisht është i përfshirë në projekte që kanë të bëjnë me komunikim dhe avokim. Fatoni ka përfunduar studimet në Universitetin Dardania, dhe mban diplomë bachelor në marketing. Por gjithmonë entuziast dhe i përkushtuar pas dizajnit dhe artit. Ai iu bashkua ekipit të "Riinvest"-it, pas një përvojë të gjatë dhe të pasur në dizajn dhe atë kryesisht në media. Në vitin 2000 si 16-vjeçar, ai filloi të punojë në 'Kosova Sot' si layout - dizajner më pastaj një kohë në Gazeta Express si drejtor artistik - përkatësisht në vitin 2005 dhe së fundmi në Gazetën Zëri si drejtor kreativ. Pas një periudhe 8-vjeçare në mediat e shkruara, ai i ishte bashkuar ekipit të Trembelave duke pas ndikim të drejtpërdrejtë në ndryshimin e pamjeve të shumë prej mediave të shkruara dhe digjitale në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Në vitin 2012 themeloi një Studio të dizajnit të quajtur "Tedel" ku ende vepron në kohë të lirë si "freelancer" duke pasur përvoja të shumta në branding, information design dhe layout në shumë prej organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

ISREN
FEJZULLAHU, MSC

MENAXHER FINANCIAR




Isren Fejzullahu është shëf i financave në Institutin "Riinvest". Isreni është pjesë e "Riinvest"-it që nga viti 2004, kur ka filluar punën në pozitën e kontabilistit. Ai ka përfunduar Fakultetin Ekonomik si dhe studimet MA (Banka, financa dhe kontabilitet) në - Universitetin e Zagrebit në vitin 1994, si dhe studimet e MA (menaxhment) në vitin 2010 në Kolegjin Riinvest. Isreni gjithashtu ka të përfunduar nivelin e parë të certifikimit si teknik i kontabilitetit në vitin 2006 si dhe nivelin e dytë si kontabilist i certifikuar në vitin 2008, pranë Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKACK-SCAAK). Pozitën e shefit të financave Isreni e mban që nga viti 2008. Ai përveç punës në Institutin "Riinvest", është edhe asistent në lëndët Kontabiliteti financiar, Kontabiliteti menaxherial si dhe Analiza financiare në Kolegjin Riinvest që nga viti 2007. Ai ka ndjekur disa trajnime, si: Strategjia e financimit publik të OJQ-ve i ndjekur në Kosovë dhe në Budapest-Hungari, i financuar nga USAID-i, dhe trajnime tjera të shumta të cilat sigurisht kanë ndikuar shumë gjatë punës së tij në avancimin e mëtutjeshëm dhe profesionalizimin e tij.

ALBANA
GASHI, MSC
ZËVENDËSMENAXHER
FINANCIAR



Albana Gashi Zhinipotoku ka kryer Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës dhe studimet master në Kolegjin RIINVEST. Punon në Institut që nga viti 2001, e angazhuar fillimisht si hulumtuese, duke kontribuar në hulumtime të shumta zhvillimore. Përvoja e saj e gjatë lidhet me angazhimin si menaxhere e projekteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, e që ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve lokale në hartimin e strategjive për zhvillim ekonomik lokal. Për një periudhë njëvjeçare, më saktë gjatë fazës fillestare (inception phase), Albana ka qenë e angazhuar në kuadër të projektit PPSE, projekt ky i cili implementohet në konzorcium nga Swiss Contact, Instituti "Riinvest" dhe organizata PEM, i cili projekt ka për qëllim promovimin e punësimit në sektorin privat. Që nga nëntori i vitit 2014, Albana i është bashkuar zyrës së financave duke kontribuar në kryerjen e detyrave financiare dhe kontabilitetit të institutit, por edhe të Kolegjit Riinvest.

ERANDA
BASHOLLI
ASISTENTE FINANCIARE



Eranda "Riinvest"-it iu bashkua më 2001 në pozitën e asistentes administrative. Më vonë, me suksesin e arritur në punë, përpikërinë dhe me besimin e fituar, ajo iu bashku Zyrës së financave në pozitën e asistentes financiare, të cilën pozitë e mban tash e 10 vjet. Eranda është përgjegjëse rreth evidentimit dhe raportimit të financave të pjesës më të madhe të projekteve në kuadër të Institutit "Riinvest".

MERITA
ZHUSHI

RECEPTIONISTE



Është pjesë e "Riinvest"-it prej vitit 2007 në pozitën e receptionistes. Ajo ka të përfunduar Gjimnazin e përgjithshëm dhe disa trajnime lidhur me administrim të zyrës në ShBA. Duke qenë pjesë e administratës që 8 vjet, Merita ka arritur të përmbushë me sukses angazhimin e saj në punë bazuar në etikën profesionale. Merita përveç kujdesit të agjendës ditore të drejtorit ekzekutiv dhe komunikimit direkt me stafin dhe palët, mbulon punët e fotokopjes, skenimit, organizimit të ngjarjeve të ndryshme. Merita ndihmon në përgatitjen e tryezave, në konferenca, seminare dhe work-shope.

MENSUR
MUSTAFA

LOGJISTIKË



Mensuri pozitën e zyrtarit të logjistikës e mban prej vitit 1995. Ai ka të përfunduar Shkollën e Mesme Ekonomike. Mensuri ka punuar në Gjermani për 5 vjet në sektorin e ndërtimtarisë. Mensuri në Institutin "Riinvest" realizon furnizimet e zyrës me materialet e nevojshme, si dhe bazuar në nevojat e projekteve, përkujdeset për furnizimin dhe mirëmbajtjen e inventarit brenda institucionit, dërgesat postare, etj. Mensuri, po ashtu, përkujdeset për arkivin e institucionit.




IN MEMORIAM

Prof. Dr. Ekrem Beqiri

(1944 — 2008)

~



Dr.sc. Ekrem Beqiri u lind në Pejë, më 10 mars 1944. Shkollën tetëvjeçare e kreu në Pejë, ashtu si edhe Gjimnazin në vitin 1962, me sukses të shkëlqyeshëm. Po në këtë vit i regjistron studimet universitare pranë Fakultetit të Teknologjisë dhe Metalurgjisë në Universitetin e Beogradit. Studimet i përfundon në drejtimin e Inxhinierisë kimike të këtij fakulteti në vitin 1967, me sukses të daluar. Studimet pasuniversitare i vazhdon në të njëjtin drejtim të Fakultetit të Teknologjisë dhe Metalurgjisë në Beograd dhe i përfundon ato në vitin 1972 me sukses të shkëlqyeshëm. Po në këtë fakultet në vitin 1982 mbron tezën e doktoratës. Pas kryerjes së studimeve universitare, në vitin 1968 punësohet në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë, së pari në thirrje të asistentit, kurse në vitin 1969 në thirrje të profesorit të Shkollës së Lartë. Vazhdon me punën në Shkollën e Lartë Ekonomike – Komerciale në Pejë, po ashtu në thirrje të profesorit.

Për qëllime të ndryshme profesionale në vitin 1966, nëpërmes IASTE qëndron dy muaj në Poloni, në Institutin e Fakultetit Politeknik në Napoli (viti 1974) qëndron gjashtë muaj, dhe gjashtë muaj të tjerë si student i Fulbright-it pranë Institutit Politeknik “Rensselaer” në ShBA. Që nga viti 1972 është angazhuar në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë, ku në vitin 1983 punësohet në këtë fakultet në thirrje të docentit për lëndën Operacionet teknologjike.

Dr.sc. Ekrem Beqiri ishte aktiv edhe në fushëveprimet e tjera, ku trajton dukuritë e ndryshme të jetës shoqërore dhe politike të Kosovës (revista Alternativa, Republika dhe Forumi). Është njëri ndër themeluesit e Komitetit Kosovar për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe

nënkryetar i këtij komiteti, kryetar i Bordit të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur. Ka qenë anëtar i Bordit të Universitetit të Prishtinës. Në periudhën 1996 -1999, profesor Beqiri ishte nënkryetar i Këshillit Shkencor të Institutit “Riinvest”, ku edhe punoi rregullisht që nga viti 2000 si menaxher i disa projekteve me rëndësi të madhe shoqërore. Ai bashkërendoi punën e intelektualëve kosovarë për hartimin e raportit të parë për zhvillimin njerëzor për UNDP. Më se katër vjet udhëhoqi projektin e rëndësishëm të Sistemit të paralajmërimit të hershëm duke prodhuar 14 raporte RPH me një përkujdesje dhe sukses të jashtëzakonshëm. Projekti lidhur me ndikimet e shfrytëzimit të xeheve në zhvillimin e komunitetit i punuar për nevojat e Bankës Botërore dhe i udhëhequr nga profesor Ekrem Beqiri, vlerësohet shumë lart në promovimin e praktikave të avancuara të involvimit të komuniteteve në konsultimet për zhvillimin e minierave dhe në përfitimet nga eksploatimi i tyre. Duke dashur që të kontribuojë me dijen e tij poliedrike dhe kreativitetin e madh, u inkuadrua aktivisht në përgatitjen e lansimit të Universitetit Riinvest si ideator, bashkëpronar dhe anëtar i Bordit Drejtues. Profesor Beqiri udhëhoqi grupin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të luftës në Kosovë, në kuadër të ekipit të ekspertëve për ekonomi e financa dhe mori pjesë në njërin nga raundet e bisedimeve në Vjenë lidhur me aspektet ekonomike.

Ka qenë autor ose bashkautor i 6 teksteve universitare dhe rreth 40 artikujve shkencorë afro gjysma prej tyre të botuar dhe prezantuar jashtë Kosovës. Profesori Ekrem ka qenë një nga kontribuuesit më frytdhënës në

“Forum 2015”. Afinitete të shquara kishte në fushën e dizajnit dhe ka fituar në një numër të konsiderueshëm të konkurseve për logo të institucioneve dhe organizatave të ndryshme. Është autor i logos së parë të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës dhe i logos së Trupave të Mbrojtjes të Kosovës.

Profesor Beqiri ka qenë intelektual poliedrik i profilit të lartë. Ndonëse me vokacion profesor i inxhinierisë kimike, profesor Beqiri kishte një kulturë të gjerë, mund të thuhet pa hezitim, poliedrike. Veçanërisht njëte mirë problemet sociale dhe ekonomike, e po ashtu, edhe problemet politike. Ishte një lloj i suksesshëm në zbatimin e metodave dhe modeleve kuantitative e po ashtu edhe kualitative të kërkimit shkencor. Me ndershmërinë më të madhe i vinte vetes standarde të larta rigoroziteti, por po aq ishte i gatshëm t’i udhëzonte dhe t’i ndihmonte të tjerët që të avancojnë në metodologjinë e të kërkimit shkencor. Punonte i heshtur por ishte vullkan i pashuar në dëshirën dhe punën e tij për të mirën e arsimit, dijes dhe përparimit në Kosovë. Interesin personal e vinte larg nën atë nacional dhe shoqëror. Humanist i rrallë. Ndonëse shumë i preokupuar dhe angazhuar në problemet e zhvillimit të Kosovës dhe atë në disa fusha njëkohësisht: arsimore – edukative, kërkimore, humanitare dhe angazhimit civil, vëmendja e shoqërisë shpesh e ka anashkaluar nga injoranca se kishte të bëjë me njërin nga intelektualët e vet më të mirë dhe nga injoranca që pengonte që në masë të nevojshme ta njohë dhe përdorë zellin, dijen, korrektësinë e tij.

Vjollca Jashanica

(1965 — 2008)



Mr. Vjollca Jashanica u lind në Suharekë. Fakultetin e Bujqësisë e kreu në Prishtinë më 1989, ndërsa më 2005 magjistroi në Universitetin e Sarajevës në shkencat e agronomisë. Para se të fillonte punën në Institutin “Riinvest”, V. Jashanica para lufte punoi në disa ndërmarrje bujqësore, duke dhënë kontribut të çmueshëm në avancimin e metodave bashkëkohore në përdorimin e agroinputeve.

Pas përfundimit të luftës, ajo u angazhua në disa projekte të rëndësishme të FAO në Kosovë si këshilltare nacionale në fushën e prodhimit dhe përpunimit të farërave. Nga fiti 2004 deri në punësimin e saj në Institutin “Riinvest”, ajo dha kontributin e saj si eksperte e pakontestueshme në këtë sektor duke u angazhuar në këshillime/ trajnime për fermerë, aftësimin e këshilltarëve publikë dhe privatë.

Vjollca Jashanica u punësua në Institutin

“Riinvest” në prill të vitit 2006 si hulumtuese e lartë. Fillimisht ajo u angazhua si fascilitatore në Projektin DELTA. Shquhej për përkushtim të jashtëzakonshëm në punë, aftësi hulumtuese dhe organizative. Ajo u angazhua si hulumtuese dhe dha kontribut të vlefshëm edhe në disa projekte të tjera të “Riinvest”-it, si Qeverisja korporative dhe transparencë në ndërmarrjet publike në Kosovë dhe Industria pyjore-sfidat e zhvillimit dhe shfrytëzimit të balancuar. Si menaxhere e projektit “Modernizimi i shërbimeve komunale” tregoi aftësitë e saja menaxheriale dhe analitike.

Ishte shumë e dedikuar për “Riinvest”-in. Me tiparet e saja si personalitet me karakter të fortë njerëzor dhe profesional, përherë krijonte atmosferë pune dhe optimizëm për të ardhmen e “Riinvest”-it. Vdekja e saj e hershme ishte një goditje e rëndë për familjen dhe Institutin tonë.

FALËNDERIME



Me rastin e këtij jubileu Instituti “Riinvest” falënderon anëtarët e Këshillit të parë të Institutit:
prof. Dr. Selman Selmanaj, prof. Dr. Ekrem Beqiri, prof. Dr. Ibrahim Kuka, prof. Dr. Mehdi Hetemi,
prof. Dr. Gazmend Luboteni, prof. Dr. Afrim Dushi.

Gjithashtu Instituti “Riinvest” dëshiron të falënderojë për kontributin e dhënë gjatë punës së tyre edhe:
Ilaz Ramajli, Nail Reshidi, Halim Gjergjizi, Haki Shatri, Avdullah Hoti, Petrit Gashi, Luan Gashi,
Safo Musta, Mrika Kotorri, Venera Demukaj Bislimi, Salvador Elmazi, Arben Gashi, Besnik Krasniqi,
Gazmend Ahmeti, Durim Hoxha, Ardiana Gashi, Enver Bajçinca, Besa Zogaj, Valza Kika Salihu,
Afërdita Berisha Shaqiri, Etida Zeka, Zana Jusufi, Shkumbin Saneja, Diana Berisha,
Gent Kumnova, Bahrije Dibra, dhe Nexhip Çavolli.



*duke promovuar zhvillimin ekonomik të Kosovës bazuar në filozofinë e ndërmarrësisë
promoting economic development of Kosovo based on philosophy of entrepreneurship*

ISBN 978-9951-430-46-3

